



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raporti përfundimtar i auditimit i ushtruar në Komisionerin për të Drejtën**  
**për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**  
**“MBI AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË**  
**“KOMISIONERI PËR TË DREJTËN PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE”**

**TIRANË, Gusht 2024**

## PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit .....	3
II. HYRJA .....	16
a. Objektivat dhe qëllimi .....	17
b. Identifikimi i çështjes .....	17
c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese .....	18
d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH: .....	18
e. Kriteret e vlerësimit: .....	18
f. Standardet e Auditimit .....	19
g) Metodot e auditimit .....	19
h) Dokumentimi i auditimit .....	20
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....	21
1. Informacion i Përgjithshëm .....	21
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit .....	21
2.1 Veprimtaria e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP). .....	21
2.2 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit. ....	55
2.3 Auditimi i llogarive vjetore .....	75
2.4 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. ....	82
2.5. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave .....	89
2.6 Prokurimet me fonde publike .....	100
2.7 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar .....	146
2.8 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme .....	152
IV. REKOMANDIME .....	153

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.**

**a.** Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 247/2 prot., datë 23/02/2024, i ndryshuar Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Komisionerin për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), për periudhën 01.01.2021 deri me datën 31.12.2023.

#### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit ku është e mundur të specifikohet dhe buxheti:**

Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave në epokën digjitale, duke nxitur autoritetet publike dhe kontrolluesit publikë e privat në ndërtimin e besimit reciprok me qytetarët, i cili sjell përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, neni 38, përcakton se Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë, *të cilët nuk paraqesin konflikt interesi*. Struktura buxhetore e KDIMDP për hartimin e PBA-së paraqitet në një program, me kod buxhetor 1089001.

#### **b. Rëndësia e auditimit.**

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën e aktivitetit 2021-2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, ku KDIMDP është subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në pasqyrimin në mënyrë sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

#### **c. Qëllimi i auditimit.**

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri ne 31.12.2023.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të Komisionerit, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë gjetje e rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga KDIMDP.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Veprimtaria e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP),*
- *Hartimi dhe zbatimi i buxhetit;*
- *Pasqyrat financiare vjetore të institucionit;*
- *Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;*

- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
- Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.
- Zbatimi i dispozitave ligjore në funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Etj.

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.**

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve. Zgjedhja e transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2021; 2022 dhe vitit 2023, është bërë bazuar në ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 1,826 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: *Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se KDIMDP për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 25 gjetje masa organizative dhe ka dhënë 31 rekomandime; 4 gjetje masa shpërblim dëmi dhe ka dhënë 4 rekomandime dhe 1 gjetje 3E dhe ka dhënë 1 rekomandim.

#### **f. Gjetjet kryesore sipas drejtimeve.**

1. Për periudhën objekt auditimi nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë zhvilluar në total 211 procedura/ hetime administrative/ inspektime, nga të cilat 192 janë kryer nga Drejtoria e Monitorimit të Programit të Transparencës dhe Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave si dhe 19 janë kryer nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri nuk është shprehur për përfundimin e 211 procedurave/hetimeve administrative/inspektimeve, në formën e një akti administrativ, si:

Vendim përfundimtar/ Deklaratë të përfundimit të procedurës administrative/ Rekomandim/ Urdhër/ Autorizim, parashikuar në Kodin e Procedurës administrative si dhe në Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 11 dhe 90 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr. 949 prot, datë 21.5.2021. Nga auditimi i 11 praktikave të procedurave administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale rezultoi se:

-Në 6 (gjashtë) praktika, Komisioneri nuk ka përfunduar procedurën e nisur, përmes deklaratës së përfundimit sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 90 të ligjit nr.45.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

-Në 2 (dy) raste, Komisioneri nuk është shprehur për verifikimet jo të plota të grupit të inspektimit, mosveprimet vijnë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr.45/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

-Në 4 (katër) praktika, nga ana e Komisionerit nuk është marrë vendim përfundimtar mbi shkeljet administrative të Kontrollorëve për të cilat parashikohen sanksione administrative sipas nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, mosveprimi i Komisionerit në formën e mosshprehjes së vullnetit të tij për përfundimin e procedurave administrative përmes nxjerrjes së aktit administrativ është në kundërshtim me nenin 90 të KPA-së, nenin 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr. 949 prot, datë 21.5.2021.

**2.** Zyra e Komisionerit ka nisur hetim administrativ ndaj Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, pas ngjarjeve të datës 22.12.2021 dhe 24.12.2021, mbi publikimin në aplikacionin *whatsapp* të bazës së të dhënave personale të nëpunësve/ punëmarrësve të sektorit publik dhe atij privat si dhe pronarë automjesh. Objekt i hetimit administrativ ishte verifikimi i ligjshmërinë së përpunimit të të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave “nëpunës” në sektorin publik dhe privat si dhe subjekteve të të dhënave “pronar të automjeteve”, nisur nga informacionet e publikuara në media.

Në përfundim të hetimit ndaj DPT dhe DPSHTRR, Komisioneri ka disponuar me vendim për dënimin me gjobë për secilin nga kontrolluesit si dhe ka informuar/ka vënë në dijeni mbi rezultatet e vendimmarrjes së tij Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Lidhur me hetimin administrativ të nisur ndaj AKSHI-t, nga ana e Komisionerit nuk është shprehur vullneti për nxjerrjen e një akti administrativ për përfundimin e procedurës administrative si: Vendim përfundimtar/ Deklaratë të përfundimit të procedurës administrative/ Rekomandim/ Urdhër, parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative si dhe Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit. Referuar përmbajtjes së procesverbalit nr. 478/3 prot, datë 05.7.2022, të mbajtur nga grupi i inspektimit lidhur me konstatimet e tij, ndër të tjera citohet se: *-AKSHI nuk përmbushi të gjitha kërkesat për informacion të parashtruar nga grupi i inspektimit duke penguar zhvillimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të hetimit administrativ në kundërshtim me parashikimet e nenit 32 si dhe nuk ka respektuar detyrimet e parashikuara në nenet 5, 6 ,7,18, 20, 21, 22, 27, 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe aktet nënligjore të Komisionerit.*

Në opinionin/ vlerësimin e grupit të auditimit, mosveprimet e Komisionerit për mospërfundimin e procedurës administrative ndaj AKSHI-t në formën e nxjerrjes së një akti administrativ, janë në kundërshtim me nenin 30, pikën 4 të nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, nenin 11 dhe 90 të KPA-së, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr. 949, datë 21.5.2021.

**3.** Zyra e KDIMDP nuk ka hartuar një rregullore të brendshme/manual lidhur me përcaktimin e kërkesave, metodave që ndiqen për procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, identifikimin e përgjegjësive si dhe evidentimin e punës së gjithsecilit në këtë proces si dhe në hierarkinë organizative institucionale. Referuar pikës 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin përcaktohet se, njësitë publike duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për procese dhe procedura përkatëse, duke filluar nga zbatimi i ligjeve, e duke vijuar me miratimin e rregulloreve të tyre të brendshme (udhëzime, direktiva) për

të evidentuar më hollësisht procedurat, përcaktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, si dhe procedurat e kontrollit. Për më tepër, edhe në rregulloren e brendshme të Zyrës së Komisionerit miratuar me Urdhër nr.71, datë 21.5.2021, rezultoi se mungonin përshkrimet e detyrave për çdo/inspektor/specialist brenda sektorit/drejtorisë, të proceseve të tyre të punës brenda sektorit përkatës, duke lënë vend për mbivendosje të tyre si dhe krijimin e problematikave në evidentimin e përgjegjësisë ligjore.

Pasqyrimi në rregulloren e brendshme të ndarjes së duhur të detyrave dhe fushave të përgjegjësisë për çdo punonjës zvogëlon mundësitë për modifikim të pa autorizuar apo të pa qëllimshëm apo keqpërdorim të tyre. Në bazë të nenit 20, shkronja c, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010.

**4.** Me Vendimin nr. 45, datë 20.09.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është vendosur sanksioni administrativ dënimin me gjobë në vlerën prej 50,000 lekë për A. B. me detyrë sekretare e përgjithshme, Bashkia Elbasan.

Në këtë procedurë administrative nuk është marrë në konsideratë kuadri ligjor e nënligjor në fuqi, konkretisht:

a. Fillimi i gjykimit të kundërvajtjes administrative nuk është bërë mbi bazën e procesverbalit, i cili duhet të ishte mbajtur nga personat e autorizuar nga ligji, të ketë shënuar identitetin e kundërvajtjes, llojin e kundërvajtjes dhe të jetë nënshkruar, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjen administrative*”, neni 14, pika 1 dhe pika 2.

b. Gjatë gjykimit të kundërvajtjes nuk janë administruar provat e nevojshme për zbulimin e së drejtës objektive, d.m.th të administrohen ato prova që hedhin dritë dhe sqarojnë kryerjen e kundërvajtjes dhe subjektin e saj, pasi seanca dëgjimore online e datës 14.07.2021 nuk është e dokumentar në formën e transkriptuar, regjistrim audio, ose një procesverbal/dokument të barasvlerëshëm i nënshkruar nga palët pjesëmarrëse, ose e konfirmuar në mënyrë elektronike.

c. Në gjykimin e kundërvajtjes nuk kanë marrë pjesë palët, të cilat nëpërmjet debatit, gjatë gjykimit dhe në përfundimin e tij ndikojnë në zbulimin e të vërtetës:

-Nuk është vënë në dijeni pala Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan, që ka vendosur formalisht dokumentin e Programit të Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018, për këtë nuk ka:

-Nuk ka Korrespondencë me Autoritetin Publik/Bashkia Elbasan në mënyrë shkresore ose elektronike me e-mail, etj.

-Nuk ka seancë dëgjimore të re ku të ketë marrë pjesë pala Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan, përveç asaj të datës 14.07.2021.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, neni 87, pika 1 dhe 2/dh, pika 3, Neni 53, pika 2 dhe neni 82.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, referuar komenteve sa më sipër, vendimi nr. 45, datë 20.09.2021 i Komisionerit për dënimin me 50,000 lekë gjobë për A. B. me detyrë sekretare e përgjithshme, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjen administrative*”, nenet 7, 14 dhe 19 dhe Ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, me ndryshimet vijuese të tij neni 53 pika 2, neni 82 dhe neni 87, pika 1, 2/dh, pika 3.

**5.** Shkolla “U. S.” me e-mailin e datës 25 janar 2024 ora 14:00 dhe e-mailin e datës 29.01.2024 ora 11.33, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me kërkesën me objekt: “Të marrë në shqyrtim praktikën e hedhjes e të përpunimit të të dhënave personale online në databazën qendrore SMIP të administruar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në këndvështrim të Ligjit 9887 “*Për mbrojtjen e të dhënave*”.

Përmes adresës zyrtare elektronike të Zyrës së Komisionerit, është dërguar përgjigje me e-mail me nr. 244/1 prot., datë 02.02.2024 shkollës “U. S.”, ku në mënyrë eksplicite është shprehur *“Përgjatë vitit 2023 ka ushtruar hetim administrativ ndaj QSHA në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale për sistemin SMIP. Në përfundim të hetimit administrativ Zyra e Komisionerit ka dalë me rekomandimin nr. 33, datë 27.06.2023, të cilin mund të gjeni të publikuar në faqen zyrtare të internetit në lidhjen, <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2023/01/Rekomandimin-QSHA.pd.....>”*.

Zyra Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka njoftuar Shkollën “U. S.” Tiranë, për regjistrimin e kërkesës së saj dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurës. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 44 pika 2/a. Në dosje nuk disponohet relacion/plan me veprime nga grupi i punës së caktuar nga titullari.

-Në mungesë të kryerjes së veprimeve procedurale nga grupi i caktuar, nuk ka një vendimmarrje nga Komisioneri, lidhur me këtë procedurë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 90.

-Nga intervistat e zhvilluara me personat përgjegjës të Zyrës së Komisionerit, është argumentuar se, dy e-maillet e dërguara nga Shkolla “U. S.”, nuk janë trajtuar si ankesë, por vënie në dijeni. Ky fakt është në kundërshtim me pjesën narrative të kërkesë-ankesës, si dhe provat dokumentare/ Libri “Firmat e prindit” SMIP, që i bashkëlidhen kërkesës.

Veprim në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 8417 Date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 3/b e nenit 41, neni 47, neni 48, neni 58 pika 3, neni 59 pika 3, neni 77, neni 90, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 5, 6 dhe 16 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, për sa më sipër, arrihet në konkluzion se, në mungesë të nisjes së një hetimi administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit, për verifikimin e zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit nr. 33, datë 27.06.2023 nga kontrolluesi/“Qendra e Shërbimeve Arsimore”, Tiranë, si dhe vlerësimin e problematikës/gjetjeve të konstatuara, për sa kërkohet/ankohet/ informohet/vihet në dijeni nga Shkolla “U. S.” Tiranë, trajtimi i kërkesë/ankesës nga Zyra e Komisionerit mbetet në kuadrin e një përgjigje shkresore formale, duke mos i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së ngritur nga ankuesi, si dhe duke mos përmbushur detyrimet ligjore që parashikon legjislacioni në fuqi.

**6.** Në 10 praktika të vendimmarrjes së Komisionerit në fushën e të drejtës së informimit dhe që parashikojnë sanksione administrative rezultuan parregullsi në procedurën e konstatimit të kundërvajtjes si dhe në përmbajtjen e dokumentacionit që shoqëronte Vendimin e Komisionerit. Konkretisht rezultoi se:

- Në 8 raste nuk është ndjekur dhe zbatuar procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, sipas pikën 1, të nenit 14 të ligjit të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, pasi nga personat përgjegjës për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk është kryer dokumentimi i saj me procesverbal të firmosur edhe nga kundërvajtësi.

- Në 7 raste mungon Urdhri i Komisionerit “Për kryerjen e hetimit administrativ”, mbi caktimin e personave përgjegjës për hetimin e çështjes, fakt në mospërputhje me nenin 43, të Kodit të Procedurës Administrative.

- Nga inspektorët/specialisti përgjegjës për kryerjen e inspektimit nuk janë hartuar dhe miratuar deklaratat e ekzistencës/jo të konfliktit të interesave në momentin e fillimit të hetimit administrativ, sipas shkronjës “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 të nenit 4, si dhe pika 1 në nenin

7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

- Në 6 raste nga personat përgjegjës të ngarkuar me monitorimin e faqeve zyrtare të Autoriteteve publike/Bashkitë nuk kryhet dokumentimi me procesverbal apo relacion i rezultateve të monitorimit për secilin nga rastet por, ato janë pasqyruar në dokumente me emërtim: “Raport konstatimi “*Rimonitorim i Programit të Transparencës së autoritetit publik*”. Dokumenti është i pa protokolluar dhe nuk ka të dhëna për strukturën përgjegjëse dhe personat përgjegjës që e kanë hartuar, duke mospërmbushur elementët formal të një dokumenti zyrtar.

- Në 2 raste, seanca dëgjimore nuk është e dokumentuar në formë elektronike (CD) /transkriptim i regjistrimit audio si dhe dokumentuar me procesverbal/dokument të barasvlershëm të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse. Mosveprimet vijnë në kundërshtim me nenet 13, 19 dhe 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Në të gjitha praktikatat dokumentacioni i praktikave është i pa arkivuar. Mosveprimet janë në mospërputhje me nenin 24 i Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, dhe pikën 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

- Në një rast nga personat përgjegjës nuk është mbajtur një relacion/ memo për rezultatet e veprimeve proceduriale të kryera në funksion të procedurës së zhvilluar, në kundërshtim me nenin 43, pika 3 të Ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

- Në një rast procesverbali i konstatimit të shkeljes administrative dhe ngarkimit me përgjegjësi të funksionarit publik rezultoi i pa protokolluar. Mosveprime në kundërshtim me pikën 1 të nenit 104 të Ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 24 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, si dhe pikën 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

7. Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatuase:

Komisioneri i Zyrës së KDIMDP për të tre vitet objekt auditimi ka dhënë shpërblime financiare për stafin duke shpërblyer dhe veten e tij, përkatësisht:

- Me urdhër shpenzimin me nr. 281-284, datë 22.12.2021, në shumën 816,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, ku vlerë e përllogaritur është 960,000 lekë për 42 punonjës, mbajtur tatim në burim në vlerën 14,400 lekë.

- Me urdhër shpenzimin me nr. 264-267, datë 30.12.2022 në shumën 1,150,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, për 46 punonjës në vlerën 25,000 lekë.

- Me urdhër shpenzimin nr. 240-243, datë 28.12.2023 në shumën 2,400,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, nga të cilat, në vlerën 50,000 lekë për 44 punonjësit e përhershëm të komisionerit, si dhe për punonjësit mbështetës brenda dhe jashtë strukturës, si dhe 25,000 lekë për 8 punonjësit e rekrutuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2023.

Për vitin 2022 dhe vitin 2023, nga institucioni nuk është mbajtur dhe llogaritur as tatim mbi të ardhurat e përfituara veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe me Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” paragrafi 12.

Sa më sipër, akti i miratimit të shpërblimeve nga Komisioneri ndaj vetës së tij është në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar neni 108, si dhe Ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me



ligj”, i ndryshuar neni 4. Ndërsa shpërblimi i administratës së Zyrës së Komisionerit është në kundërshtim me VKM-në me nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, pika 9, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 224 dhe 225, ku për vlerën e përdorur nuk është përgatit “Kërkesën për rritje të autorizuar”.

**8.** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “A.S.” shpk, me objekt: “Rikonstruksion/riparime të ambienteve të KDIMDP”, për vlerën prej 5,500,036 lekë në vitin 2022, u konstatua se: Dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së aspiratorit profesional 780 m<sup>3</sup>/h + tub fleksibël inoksi Ø200-3m + aksesore të ndryshëm montimi” nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht aspiratori profesional 780 m<sup>3</sup>/h + Tub fleksibël inoksi Ø200-3m + aksesore të ndryshëm montimi”, me vlerë 591,000 lekë është i pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat dhe vlera prej 591,000 lekë përbën shpenzime pa efikasitet.

Veprimet më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet vijuese të tij, nenet neni 419, 420, 476, 659, 698, 690 dhe neni 710, pika 3, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 20, datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 54, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1; Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “A. S.” Shpk, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.

**9.** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “A.” Shpk, me objekt: Blerje automjete në vlerën 2,998 mijë lekë pa TVSH, në vitin 2021, u konstatua se në kriteret/specifikimet teknike dhe në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, për të verifikuar kilometrazhin e automjeteve me jo më shumë se 60.000 km nuk është përcaktuar se çfarë dokumentacioni do të paraqes operatori ekonomik ofertues si: test teknik nga Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor, libër shërbimi etj gjë që ka sjellë përdorimin e fondit pa ekonomikitet.

Automjetet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, “Rekomandime të veçanta “Për kontratat tip malli”, pika 1. Dhe Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690 dhe neni 710, pika 3, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar neni 73, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20.

**10.** Për hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative” është lidhur kontrata me nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022 me operatorin ekonomik “F. P.” dhe është likuiduar vlera 990,000 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se kjo është një metodologji plagjatur, referuar Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (European Data Protection Board). Ky Institucion i BE ka publikuar për konsultim në faqen zyrtare

(edpb.europa.eu), Udhëzimin mbi përlllogaritjen e masave administrative në zbatim të GDPR (Guidelines 04/2022 on the calculation of administrative fines under the GDPR), në datën 16 maj 2022, me referencë konsultimi publik nr. 04/2022.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, Kontratën me Operatorin Ekonomik “F. P.” është lidhur nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.

**11.** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka akorduar shtesën për kualifikim në vlerën 20,000 lekë/ muaj, me fuqi prapavepruese që nga data e fillimit të përfitimit të shtesës për kualifikim, nëpunësve të Zyrës së KDIMDP, për punonjësit B. D., P. M., E. H.. Fuqia prapavepruese e këtij Urdhri ka krijuar për Zyrën e KDIMDP një detyrim të prapambetur prej **2,020,000 lekë**, i cili nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të institucionit e nuk është paraqitur në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë, në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 dhe Tabelës nr. 4, Aneksi nr. 2 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë 06.10.2020.

Nga auditimi u konstatua se miratimi dhe akordimi i shtesës për kualifikim nga Komisioneri për veten e tij është i pambështetur ligjërisht, pasi pozicioni i titullarit të institucionit të pavarur nuk përfshihet në kategoritë përfituese të mundshme të kësaj shtese për kualifikim. Nga auditimi, gjithashtu, u konstatua se asnjë nga Drejtorët e Përgjithshëm nuk plotëson kushtet për të përfituar shtesën për kualifikim, pasi (i) diplomat e nivelit master të zotëruara nga punonjëset janë përftuar brenda vendit, jo sipas përcaktimeve të VKM, (ii) diploma e një prej punonjësve nuk është ekuivalente me nivelin postmaster dhe (iii) kualifikimet nuk përputhen me përshkrimin e punës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Lidhjen 2/1 e VKM nr. 187, datë 08.03.2017.

Referuar listëpagesave të vëna në dispozicion, grupi i auditimit konstatoi se Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës ka vijuar të përfshijë këtë shtesë si element të pagës së punonjësve të sipërpërmendur, edhe pas shfuqizimit të aktit, me nga 40,000 lekë/muaj për secilin prej tyre, në kundërshtim me pikën 2 të Udhëzimit të MFE nr. 16, datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 325, datë 31.05.2023...”.

**12.** Për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 90 procedura prokurimi me vlerë të vogël në vlerën 39,980 mijë lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Autoriteti Kontraktor në përcaktimin e kufirit monetar, në procedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla, nuk ka marrë në konsideratë llogaritjen e grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure. Në këtë kontekst, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë përdorur si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës dhe për të bërë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit. Konkretisht për vitin 2021, dhjetë procedura për vlerën 4,947 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 4 procedura, për vitin 2022, njëmbëdhjetë procedura për vlerën 7,529 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 4 procedura dhe për vitin 2023, dymbëdhjetë procedura për vlerën 9,500 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 3 procedura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 41 “Procedurat standarde të prokurimit”, pika 3, neni 2 dhe neni 21,

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 52, pika 2, pika 11, Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 të APP-së, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9643 , datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, 8 dhe Neni 52.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me procedurat e prokurimit të sipër përmendura ka kryer një formalitet burokratik dhe jo procedura të mirëfillta prokurimi, duke mos maksimizuar efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim, por edhe kundërshtim me parimet për rritjen e integritetit në prokurimin publik të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), parime që kanë efekt të drejtpërdrejtë në konkurrencë, në çmimin e paguar nga administrata publike për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

**13.** Për periudhën objekt auditimi të gjitha kontratat për punët publike, mallrat dhe shërbimet në emër të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale janë nënshkruar nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës me autorizimet përkatëse nga Komisioneri. Gjithashtu Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës si nëpunës zbatues ka firmosur urdhër shpenzimet për transaksione bankare, në shumë raste ka marrë në dorëzim shërbimin/mallin ose punën publike në rolin e anëtares së komisionit të marrjes në dorëzim.

Autorizimi i nënshkrimit të kontratës është në kundërshtim me Nenin 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve”, paragrafi 3 dhe 4, si dhe kërkesat e Manualit për MFK të MF, në fuqi gjatë periudhës së auditimit

#### **h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

**1.** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa në vijim për përfundimin e procedurave administrative/ hetimeve administrative /inspektive në formën e nxjerrjes së një akti administrativ, parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

**2.** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa për përfundimin e procedurës administrative të nisur ndaj AKSHI-t dhe nxjerrjen e përgjegjësive ligjore për shkeljet e konstatuara nga grupi i hetimit.

**3.** Zyra e KDIMDP të marrë masa për (i) hartimin e një manuali/rregulloreje për përcaktimin e kërkesave, metodave që ndiqen për procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, identifikimin e përgjegjësive dhe evidentimin e punës së gjithsecilit në këtë proces si dhe për (ii) kryerjen e plotësimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

**4.** Nga Zyra e Komisionerit të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për trajtimin e kërkesave/ankesave/informacioneve/dijenive, duke kryer hetim administrativ në “Qendrën e Shërbimeve Arsimore”, Tiranë, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

5. Zyra e Komisionerit të marrë masa për (i) dokumentimin e veprimeve procedurale të kryera në funksion të procedurave administrative, si domosdoshmëri në rast përdorimi të një mjete ligjor të mundshëm (*si ankimi gjyqësor*) si dhe me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit, (ii) arkivim të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit si dhe në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

6. Nga Zyra e Komisioneri të analizohet vlera prej 4,366 mijë leke si shpenzim pa ekonomikitet, të nxirren përgjegjësitë dhe të marrë masa në të ardhmen që fondet të shpenzohen sipas parimeve të ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficensës.

7. Nga Zyra e Komisioneri të analizohet vlera prej 591,000 leke si shpenzim pa eficensë, të nxirren përgjegjësitë dhe të marrë masa në të ardhmen që fondet të shpenzohen sipas parimeve të ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficensës.

8. Nga Zyra e Komisionerit të analizohet vlera prej **2,998,324 lekë** si shpenzim pa ekonomikitet, të nxirren përgjegjësitë dhe të marrë masa në të ardhmen që fondet të shpenzohen sipas parimeve të ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficensës.

9. Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e marrjes në dorëzim), i cili të kryejë verifikimet përkatëse dhe të konfirmojë se ekspertiza në hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative është ose jo plagjiaturë.

10.1. Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve korrigjuese (kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht nga punonjësit) edhe përtej periudhës së auditimit, nëse kjo situatë ka vijuar, si dhe të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme përfshirjen e shtesës për kualifikim si element të pagës së punonjësve.

10.2. Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve korrigjuese (kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht nga punonjësit) edhe përtej periudhës së auditimit, nëse kjo situatë ka vijuar, si dhe të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme përfshirjen e shtesës për kualifikim si element të pagës së punonjësve.

11. Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe mos përsëritjen e rasteve të tilla për të ardhmen.

12. Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale nënshkrimit të kontratave për punët publike, mallrat dhe shërbimet duke korrigjuar praktikën e deritanishme, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

## 1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

### **I. Opinioni për auditimin financiar<sup>1</sup> i kualifikuar<sup>2</sup>:**

Ne kemi audituar hartimin e pasqyrave financiare të KDIMDP, për periudhën 01.01.2023-

1 - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

2 -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar", jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*"

31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

#### **Opinionit:**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2023, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

#### **Baza për opinionin:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 1,826 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionit të Kualifikuar” të auditimit.

- Nga auditimi i të dhënave të “Pasqyrës së Performancës” rezultoi se është pasqyruar në llogarinë 602 “Blerje mallra e shërbime” vlera prej 1,128,000 lekë, dhe janë kontabilizuar si shpenzime korrente, kur në fakt u përkasin shpenzimeve për blerjen e aktiveve afatgjata, duke denaturuar në këtë mënyrë pasqyrimin e zërit të aktiveve dhe shpenzimeve.

- Nga verifikimi analitik i llogarive të aktiveve afatgjata, konstatohet se në: Llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën bruto prej 114,000 lekë dhe në llogarinë 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme” në vlerën bruto prej 5,858,301 lekë, në total në vlerën prej 5,972,301 lekë nuk ka të bëjë me AAGJ Jo-materiale, por janë “Studim e projekte”, të cilat në momentin e konstatimit si investim nga KDIMDP duhet të ishin regjistruar në zërin 230 “Investime për Aktive Afatgjata jo materiale”. Keqklasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime” dhe llogarisë 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme” si dhe nënvlerësimin e “Aktiveve Afatgjata Materiale” në shumën bruto prej 5,972,301 lekë.

- Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2021; 2022 dhe 2023 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivitetet. Gjithashtu vlera prej 546,752 lekë për “Programin Alfa” dhe një “Program të trashëguar nga Ministria e Mbrojtjes”, vlerë e cila i përket llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” është klasifikuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 15 % dhe jo 20%, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të

institucionit.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit rezultoi se, në rubrikën D “*Fondet e konsoliduara nga Institucioni*” është pasqyruar llogaria 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” në vlerën 6,938,752 lekë, e cila ka të bëjë me “*Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së*” të realizuara nga të ardhurat e trashëguara, ku nga institucioni është marrë në dorëzim dhe është bërë kolaudimi i punimeve.

- Nga Drejtori e Financës dhe Shërbimeve për shpërblime e likuiduara, bazuar në VKM-në me nr. 795, datë 28.12.2023 “*Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të ACQUIS, në kuadër të procesit të negocimit me Bashkimin Evropian*” në shumën 630,347 lekë dhe shpërblimin e likuiduara bazuar në VKM-në me nr. 834, datë 28.12.2023 “*Për një ndryshim të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar*” pika 1 gërma a, në shumën 50,000 lekë, rezultoi se për këto vlera është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e punonjësve, duke ndikuar në llogaritjen/pasqyrimin jo të saktë të shpenzimeve për pagë.

### **Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit**

Strukturat menaxheriale të KDIMDP janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar<sup>3</sup>).**

Mbështetur në, ISSAI 4000 “*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë*”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion ka rezultuar se në veprimtarinë e Institucionit të Komisionerit, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë*”.

### **Baza për opinionin e përputhshmërisë.**

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “*Deklarata e Limës*”; INTOSAI P-10, “*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*”. Ne i kemi përmbushur

<sup>3</sup> **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga KDIMDP dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e ***opinionit të kualifikuar***.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

- Për periudhën objekt auditimi nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë zhvilluar në total 211 procedura/ hetime administrative/inspektive, nga të cilat 192 janë kryer nga Drejtoria e Monitorimit të Programit të Transparencës dhe Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave si dhe 19 janë kryer nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri nuk është shprehur për përfundimin e 211 procedurave/hetimeve administrative/inspektiveve, në formën e një akti administrativ, si: Vendim përfundimtar/Deklaratë të përfundimit të procedurës administrative /Rekomandim /Urdhër /Autorizim, parashikuar në Kodin e Procedurës administrative si dhe në Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 11 dhe 90 të Ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr.949 prot, datë 21.5.2021.

- Në 10 praktika të vendimmarrjes së Komisionerit në fushën e të drejtës së informimit dhe që parashikojnë sanksione administrative rezultuan parregullsi në procedurën e konstatimit të kundërvajtjes si dhe në përmbajtjen e dokumentacionit që shoqëronte Vendimin e Komisionerit. Konkretisht rezultoi se:

- Në 8 raste nuk është ndjekur dhe zbatuar procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, sipas pikës 1, të nenit 14 të ligjit të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjen administrative*”.

- Në 7 raste mungon Urdhri i Komisionerit “*Për kryerjen e hetimit administrativ*”, mbi caktimin e personave përgjegjës për hetimin e çështjes, fakt në mospërputhje me nenin 43, të Kodit të Procedurës Administrative.

- Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se: Komisioneri i Zyrës së KDIMDP për të tre vitet objekt auditimi ka dhënë shpërblime financiare për stafin duke shpërblyer dhe veten e tij , përkatësisht për vitin 2021, në shumën 816,000 për vitin 2022 në shumën 1,150,000 lekë dhe për vitin 2023 në shumën 2,400,000 lekë. Për vitin 2022 dhe vitin 2023, nga *institucioni nuk është mbajtur dhe llogaritur as tatim mbi të ardhurat e përfituara*.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “A.S.” shpk, me objekt: “*Rikonstruksion/riparime të ambienteve të KDIMDP*”, për vlerën prej 5,500,036 lekë në vitin 2022, u konstatua se: Dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së aspiratorit profesional 780 m<sup>3</sup>/h + tub fleksibël inoksi Ø200-3m + aksesore të ndryshëm montimi” nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht aspiratori profesional 780 m<sup>3</sup>/h + Tub fleksibël inoksi Ø200-3m + aksesore të ndryshëm montimi”, me vlerë 591,000 lekë është i pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “A.” Shpk, me objekt: Blerje automjete në vlerën 2,998 mijë lekë, në vitin 2021, u konstatua se: Në kriteret/specifikimet teknike dhe në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, për të verifikuar kilometrazhin e automjeteve me jo më shumë se 60.000 km nuk është përcaktuar se çfarë dokumentacioni do të paraqes operatori ekonomik ofertues si: test teknik nga Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor, libër shërbimi etj. Grupi i marrjes në dorëzim i ka marr automjetet në dorëzim

vetëm mbi bazën e fotove të leximit të matësit të kilometrave në korskotë, foto e cila nuk është dokument i besueshëm për tu marr në konsideratë për saktësinë/vërtetësinë e numrit të kilometrazhit.

- Për hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative” është lidhur kontrata me nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022 me operatorin ekonomik “F. P.” dhe është likuiduar vlera 990,000 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se kjo është një metodologji plagjatur, referuar Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (European Data Protection Board).

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka akorduar shtesën për kualifikim në vlerën 20,000 lekë/ muaj, me fuqi prapavepruese që nga data e fillimit të përfitimit të shtesës për kualifikim, nëpunësve të Zyrës së KDIMDP, për punonjësit B. D., P. M., E. H., ku deri në dhjetor 2023 është paguar shuma prej 1,920 mijë lekë. Miratimi dhe akordimi i shtesës për kualifikim nga Komisioneri për veten e tij është i pambështetur ligjërisht, pasi pozicioni i titullarit të institucionit të pavarur nuk përfshihet në kategoritë përfituese të mundshme të kësaj shtese për kualifikim. Nga auditimi, gjithashtu, u konstatua se asnjë nga Drejtorët e Përgjithshëm nuk plotëson kushtet për të përfituar shtesën për kualifikim, pasi (i) diplomat e nivelit master të zotëruara nga punonjëset janë përftuar brenda vendit, jo sipas përcaktimeve të VKM, (ii) diploma e një prej punonjësve nuk është ekuivalente me nivelin postmaster dhe (iii) kualifikimet nuk përputhen me përshkrimin e punës,

- Për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 90 procedura prokurimi me vlerë të vogël në vlerën 39,980 mijë lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Autoriteti Kontraktor në përcaktimin e kufirit monetar, në procedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla, nuk ka marrë në konsideratë llogaritjen e grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure. Në këtë kontekst, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë përdorur si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës dhe për të bërë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit. Konkretisht për vitin 2021, dhjetë procedura për vlerën 4,947 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 4 procedura, për vitin 2022, njëmbëdhjetë procedura për vlerën 7,529 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 4 procedura dhe për vitin 2023, dymbëdhjetë procedura për vlerën 9,500 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 3 procedura.

- Për periudhën objekt auditimi të gjitha kontratat për punët publike, mallrat dhe shërbimet në emër të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale janë nënshkruar nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës me autorizimet përkatëse nga Komisioneri. Gjithashtu Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës si nëpunës zbatues ka firmosur urdhër shpenzimet për transaksione bankare, në shumë raste ka marrë në dorëzim shërbimin/mallin ose punën publike në rolin e anëtares së komisionit të marrjes në dorëzim.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 247/2 prot., datë 23/02/2024, i ndryshuar, në Komisionerin për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga data 23.02.2024 deri më datën 17.05.2024, për periudhën e auditimit 01.01.2021-31.12.2023, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. F. I., (përgjegjës grupi),
2. D. P., anëtar



3. J. G., anëtare
4. L. Ll., anëtare

#### **a. Objektivat dhe qëllimi.**

*Objektivat specifike të auditimit* është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu veprimtaria e institucionit, procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

*Qëllimi i auditimit:* Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

#### **b. Identifikimi i çështjes**

Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit të Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së KDIMDP, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të KDIMDP, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi

dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### **c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese**

Drejtimi i KDIMDP është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Komisionerit për të Drejtën e Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe Kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

### **e. Kriteret e vlerësimit:**

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” i ndryshuar;
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimin MF nr. 5, datë 21.02.2022.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”;
- Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së;
- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

#### **f. Standardet e Auditimit**

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

#### **g) Metodatat e auditimit**

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u

fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit

## **h) Dokumentimi i auditimit**

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022 dhe atij të përputhshmërisë miratuar me Vendimin e

Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i Përgjithshëm**

Aktiviteti i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, udhëhiqet nga misioni i saj, në thelb të së cilit janë vlerat dhe parimet thelbësore, të cilat shprehen në vizionin e saj.

Të promovojmë dhe mbështesim një shoqëri që mban si vlera thelbësore garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

Të mbikëqyrni zbatimin e kuadrit ligjor të mbrojtjes së të dhënave dhe të së drejtës për informim, të garantojmë ushtrim të efektshëm të së drejtave në epokën digjitale dhe të rrisim ndërgjegjësimin e autoriteteve publike dhe kontrolluesve të të dhënave në sektorin publik dhe atë privat, i cili sjell përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë themelore, e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në nenin 8 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. E drejta për t’u informuar në lidhje me informacionin që prodhohet, apo mbahet nga autoritetet publike është pjesë thelbësore e së drejtës themelore të lirisë së shprehjes, të njohur nga rezoluta 59 e OKB-së, nga neni 19 i Deklaratës Universale të së Drejtave të Njeriut, nga neni 10 i Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut, nga neni 11 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE dhe që sanksionohet po ashtu në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

##### **2.1 Veprimtaria e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi monitorimet dhe hetimet administrative të kryera nga Zyra e Komisionerit, kriteret e përdorura në përzgjedhjen e procedurave objekt verifikimi, të dhëna mbi rezultatet e verifikimeve, sanksioneve dhe propozimeve për marrjen e masave administrative, rezultoi si më poshtë:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoritet i pavarur, përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr.119/2014 “Për të

drejtën e informimit” dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) në fushën e të drejtës për informim parashikohen në nenin 31 të ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe nenin 9/1 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Sipas kësaj dispozite, Komisioneri shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e Informimit”; shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike; kryen hetimet e nevojshme administrative gjatë ushtrimit të kompetencave të tij; njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”.


Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e “sekretit shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi; vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit; nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit; monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit; kryen sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit; bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës; me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit.

Sipas strukturës institucionale miratuar me Vendim të Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, nr. 84/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.86/2018 "*Për Miratimin Struktures, Organikes dhe Klasifikimin e Pagave të Komisionerit per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale*”,( i ndryshuar), Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit përbëhet nga Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës dhe Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave.

## **I. Mbi Veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtën e Informimit.**

Zyra e Komisionerit e zhvillon veprimtarinë e saj vjetore sipas Programit të Punës bazuar në rekomandime/dokumente kombëtare dhe ndërkombetare si: Rezoluta e Kuvendit, Strategjia institucionale e ndërsektoriale si dhe Progres Raporti i BE. Programi i Punës së Zyrës së Komisionerit miratohet cdo vit brenda datës 31 janar dhe rishikohet ne funksion të Rezolutës së Kuvendit, brenda 2 javësh nga miratimi i saj.

Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit është struktura që monitoron dhe mbikqyr zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit nga autoritetet publike. Kjo strukturë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive, në varësi të të cilëve janë inspektorët. Sipas kësaj strukture Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit përbëhet nga Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës dhe Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave sipas skemës si më poshtë:



### 1.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e programit të transparencës së autoriteteve publike.

Një nga fazat e rëndësishme në sigurimin e transparencës është edhe monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Transparenca proaktive nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës, kërkon impenjimin e institucioneve publike për ta përditësuar dhe plotësuar me informacion në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë arsye, Drejtoria kryen monitorim të transparencës së autoriteteve publike në baza vjetore, për të lehtësuar kryerjen e analizave krahasimore. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar nëpërmjet Urdhrit nr.187 datë 18.12.2020 “Programin e Transparencës të Rishikuar” i cili është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet publike sipas përcaktimit në nenin 2, të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Instrumentet kryesore për matjen e transparencës proaktive janë: publikimi i Programit Model të Transparencës të rishikuar në faqen zyrtare të autoriteteve publike sipas Urdhrit nr.187, dt. 18/12/2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar” dhe publikimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar” sipas Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”. Nga ana e Drejtorisë është përdorur metoda e kërkimit në internet për vlerësimin e treguesve dhe gjendjes reale në momentin e kërkimit në faqet zyrtare të autoriteteve publike.

**a) Për vitin 2021,** Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin online të 374 autoriteteve publike, nga të cilat 313 institucione qendrore dhe të varësisë, si dhe 61 NjVV. Autoritetet publike qendrore dhe të varësisë u monitoruan në lidhje me publikimin e “*Programit të Transparencës të Rishikuar*”, sipas Urdhrit nr.187, datë 18.12.2020, për të cilin u la si afat data 30 qershor 2021 për miratimin dhe publikimin në faqet e tyre zyrtare të internetit.

Sipas rezultateve të monitorimit të kryer nga Drejtoria, 300 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës, 286 kanë të publikuar kontaktet e koordinorit dhe 217 kanë të publikuar Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në përputhje me përcaktimet e ligjore.

Ndërsa, për 61 NjVV ka monitoruar publikimin e “*Programit Model të Transparencës për NjVV*”, sipas Urdhrit nr.211, datë 10.09.2018. Të gjitha autoritetet publike u monitoruan, gjithashtu, për caktimin dhe publikimin e të dhënave të koordinorit, si dhe publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas Urdhrit nr.188, datë 18.12.2020 të Komisionerit.

Rezultatet e monitorimit të njësisve të qeverisjes vendore, treguan se, 57 NjVV, ose 93% e tyre, kanë të publikuar Programin e Transparencës dhe nga këto, 55 kanë të publikuar informacionin/dokumentacionin plotësisht ose pjesërisht. Fokus i punës së Zyrës së Komisionerit

mbetet monitorimi më i detajuar i rubrikave të Programit të Transparencës të këtyre autoriteteve publike, në lidhje me plotësimin e detyrimeve sipas nenit 7 të ligjit për të drejtën e informimit. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka kryer verifikim të nivelit të transparencës proaktive të 100 institucioneve qendrore (kryeministria e ministritë dhe institucione të tyre të varësisë; institucione të pavarura; gjykata, sistemi i prokurorisë, universitete, shoqëri anonime ku shteti zotëron pjesën më të madhe të aksioneve) për periudhën shtator-dhjetor 2021. Metodologjia e përdorur i referohet treguesve, si: *“publikimi i Programit të Transparencës”*, *“përditësimi i Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve”* dhe *“publikimi i të dhënave të koordinatorit”*, *publikimi i të dhënave të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik*, *publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin 2021*.

Zyra e Komisionerit ka konstatuar se autoritetet publike qendrore dhe të varësisë kanë pasur një performancë më të mirë në publikimin e informacionit/dokumentacionit në Programin e Transparencës në faqet e tyre zyrtare, krahasuar me vitin e kaluar.

**b) Për vitin 2022**, Zyra e Komisionerit ka kryer 50 inspektime në 35 AP qendrore/varësie dhe 15 NJVV me shtrirje në të gjithë territorin e vendit, bazuar në mangësitë e konstatuara në Indeksin e Transparencës 2021. Pjesë e këtij procesi ishte edhe zhvillimi i 5 seancave dëgjimore. Nisur edhe nga bashkëveprimi me inspektorët e Zyrës së Komisionerit, në përfundim të procedurës, AP-të plotësuan detyrimet e transparencës proaktive si: publikimin/përditësimin e PT-së dhe RKP-së dhe caktimin e koordinatorit.

Zyra e Komisionerit ka verifikuar nivelin e transparencës proaktive në 150 institucione qendrore, për institucione si: Kryeministria/Ministritë dhe AP-të varësisë, institucionet e pavarura, sistemi gjyqësor, sistemi i prokurorisë, universitetet dhe shoqëritë me kapital publik. Monitorimi u realizua gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2022. Nga 150 institucione të monitoruara, 149 prej tyre e kanë të publikuar PT-në, ndërkohë, që të gjitha (100%) kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit.

**c) Për vitin 2023**, u monitoruan 12 IAL publike dhe 6 autoritete të sistemit arsimor publik, për verifikimin e nivelit të zbatimit të programit të transparencës, ku në përfundim Komisioneri doli me 18 rekomandime. Nga rimonitorimi i faqeve zyrtare një pjesë e madhe e tyre përditësuan informacionin e munguar. Gjithashtu u verifikua niveli i transparencës proaktive për 242 institucione të kategorive: të pavarura, ato qendrore dhe të varësisë, të sistemit të drejtësisë, shoqëritë publike ku shteti zotëron shumicën e aksioneve, IAL, si dhe urdhrat profesionalë. Në përfundim të këtij monitorimi, Zyra e Komisionerit arriti në përfundimin se 92 AP klasifikohen me transparencë proaktive të lartë, 125 me transparencë proaktive mesatare, 21 AP me transparencë proaktive të ulët dhe 4 AP me transparencë proaktive të pamjaftueshme. Së fundi, Zyra e Komisionerit ka monitoruar 61 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 12 Këshilla të Qarqeve, ku për këta të fundit u përdorën indikatorët matës të transparencës proaktive të institucioneve qendrore. Nga ky monitorim rezultoi se, 21 NJVV u klasifikuan me transparencë proaktive të lartë, 43 u klasifikuan me transparencë proaktive mesatare, 6 u klasifikuan me transparencë proaktive të ulët dhe 3 u klasifikuan me transparencë proaktive të pamjaftueshme.

**Konkluzion:** Nga ana e titullarit nuk është miratuar gjurma e auditimit për proceset kryesore të institucionit si: *proçesi i monitorimit të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe të hetimeve administrative*, ku të përcaktohen hapat e proceseve kryesore, referencat ligjore, aktivitetet e kontrollit dhe strukturat përgjegjëse. Konkretisht lidhur me veprimtarinë monitoruese, Zyra e Komisionerit nuk ka hartuar një rregullore të brendshme për procedurën e ndjekur për monitorimet



online, kriteret e përzgjedhjes së autoriteteve publike, afati kohor i monitorimit, evidencat e mbajtura si dhe raportimi i tyre në strukturat e tjera brenda Zyrës së Komisionerit.

Mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22, nenin 23 pika 5 e, si dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin. *(Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Gjurma e auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proces. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.)*

## **1.2. Rekomandimet dhe Vendimet për zbatimin e Programit të Transparencës**

**a) Për vitin 2021**, gjatë procesit të monitorimit të faqeve zyrtare të internetit të NjVV, për verifikimin e publikimit të Programit të Transparencës, sipas Urdhrit nr.211/2018, Zyra e Komisionerit ka konstatuar raste të publikimit formal të tij, pasi nuk kryhej publikim i plotë i informacionit të detyrueshëm në rubrikat e programit. Komisioneri konkludoi me 37 Rekomandime për këto autoritete publike. Me përfundimin e afatit të parashikuar në këto akte, u zhvilloi 20 inspektime në NjVV për verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve. Nga inspektimet e kryera, Zyra e Komisionerit konstatoi përmbushjen e detyrimit për publikimin e Programit të Transparencës nga 19 NjVV, ndërkohë 1 nuk e kishte plotësuar këtë detyrim. Për këtë arsye, Komisioneri u shpreh me vendim me sanksion administrativ për nëpunësin publik përgjegjës për zbatimin e këtij detyrimi ligjor. Në fillim të vitit 2021, Zyra e Komisionerit përfundoi procesin e hetimit administrativ, të nisur në dhjetor të vitit 2020, për ato autoritete publike qendrore dhe të varësisë për mos publikimin e Programit të Transparencës. Në përfundim, Komisioneri doli me 4 vendime me sanksione.

Në përfundimin të afatit për publikimin e Programit të Transparencës, sipas Urdhrit nr. 187/2020, për autoritetet publike qendrore dhe varësisë, Zyra e Komisionerit filloi procedurën e inspektimit administrativ në 5 institucione, të cilat nga monitorimi paraprak nuk kishin marrë asnjë masë për plotësimin e këtij detyrimi. Në përfundim të procedurës së hetimeve administrative këto autoritete plotësuan detyrimin për publikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve.

**b) Për vitin 2022**, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin *online* të Programit të Transparencës të organeve të prokurorisë, të cilat edhe pse e kishin të publikuar si ikonë këtë instrument, nuk e kishin përditësuar/pasuruar atë sipas rubrikave përkatëse, me pretendimin se ky i fundit është i njëjtë me atë të PT-së së Prokurorisë së Përgjithshme. Në përfundim të kësaj veprimtarie, Komisioneri doli me 28 rekomandime specifike për strukturat e të gjitha niveleve, në mënyrë që informacioni në rubrikat respektive të ishte i harmonizuar me modelet në fuqi, detyrime të cilat u përmbushën brenda afatit të përcaktuar.

**c) Për vitin 2023** është kryer monitorimi i programeve të transparencës dhe përditësimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve në faqet zyrtare të internetit të autoriteteve publike si: institucione të pavarura, ato qendrore dhe të varësisë, të sistemit të drejtësisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqëritë publike ku shteti zotëron shumicën e aksioneve. Sipas Zyrës së Komisionerit ka rezultuar se, në të gjitha Autoritetet Publike është caktuar koordinatori për të

drejtën e informimit dhe të dhënat e tyre përditësohen edhe në portalin *pyetshtetin.al*; 305 autoritete publike kanë publikuar/përditësuar programin e transparencës dhe në 310 AP është funksional/përditësuar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Në përfundim të tyre dhe procesit të rimonitorimit. Nga kryerja e monitorimit online, është vijuar edhe me zhvillimin e 33 inspektive në terren, kryesisht pranë institucioneve të varësisë të pushtetit qendror dhe institucioneve të pavarura. Komisioneri doli me 9 vendime urdhërimi për mosvënien në zbatim/mospërditësim të programit të transparencës, shoqëruar edhe me sanksion administrativ për personin përgjegjës. Gjithashtu Zyra e Komisionerit ka monitoruar 12 IAL publike dhe 6 autoritete të sistemit arsimor publik, për verifikimin e nivelit të zbatimit të programit të transparencës, ku në përfundim Komisioneri doli me 18 rekomandime.

Numri i rekomandimeve të dhëna për autoritetet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e Programeve të Transparencës në formë tabele jepen si më poshtë:

Viti	Nr.total i Rekomandimeve
2021	35
2022	28
2023	18

### 1.3 Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit.

Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit është një sistem që mundëson qasje më të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe grupeve të interesit në informacion publik. Nëpërmjet regjistrimit garantohej edhe e drejta e ankesës pranë Zyrës së Komisionerit, në rast të refuzimit të dhënies së informacionit nga autoritetet publike. Sistemi garanton gjurmimin në kohë reale të procesit të trajtimit të kërkesës/ankesës.

-*Përgjatë vitit 2021*, Zyra e Komisionerit ka kërkuar nga 53 institucione instalimin e REKPDI, detyrim të cilin e përmbushën vetëm 12 autoritete. Duke konstatuar ecurinë e ngadaltë në shtrirjen e këtij sistemi, Zyra e Komisionerit mundësoi me fondet e veta buxhetore instalimin e tij edhe për 24 autoritete të tjera publike duke e çuar në fund të vitit në 95 institucione kanë funksional këtë

-*Gjatë vitit 2022*, u realizua dyfishimi i instalimit të REKPDI, duke e çuar në 195 numrin e AP-ve nga 95 që kjo shifër ishte në fund të 2021.

-*Gjatë vitit 2023* u realizua instalimi i REKPDI në 27 autoritete të reja, duke e çuar në 222 numrin e AP, nga 195 që kjo shifër ishte në fund të 2022. Janë zhvilluar trajnime të rregullta me koordinatoret për mënyrën e përdorimit të tij. Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI ka vijuar punën për mirëmbajtjen e shërbimit të kërkesës për informacion dhe ankesës nëpërmjet portalit unik qeveritar *AMS/e-albania*. Ky sistem është funksional për 163 autoritete publike dhe i vjen në ndihmë qytetarëve, si një mënyrë alternative për të marrë informacion me karakter publik.

## II. Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave

Referuar Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit, Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe/ose grupeve të interesit, të cilët pretendojnë se u është cenuar e drejta për marrjen e informacionit publik;
- kryerjen e hetimeve administrative pranë autoriteteve publike në lidhje me to;
- zhvillimin e seancave dëgjimore publike;
- hartimin e akteve administrative në përfundim të procesit të hetimit administrativ.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, ka kompetencën të vendos sanksione administrative në raste të konstatimit të shkeljeve të dispozitave ligjore. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

**Gjatë vitit 2021**, referuar të dhënave nga Zyra e Komisionerit, për ankesat e depozituara për mosdhënie informacioni janë zhvilluar 23 inspektime pranë autoriteteve publike, si dhe 52 seanca dëgjimore. Në përfundim, Komisioneri ka dalë me 41 Vendime, prej të cilave 36 urdhërimi për dhënie informacioni, 1 rrëzimi, 2 mospranimi dhe 2 me sanksion administrativ. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka publikuar në portalin [www.pyetshetin.al](http://www.pyetshetin.al) listën e ankesave të administruara, në mënyrë që të aksesohen lehtësisht nga qytetarët dhe grupet e interesit. Ankesat e paraqitura janë grupuar në tre kategori: nga qytetarë, nga organizata të shoqërisë civile dhe nga gazetarë/media investigativ.

**Gjatë vitit 2022**, Zyra e Komisionerit është shprehur me 51 vendime për 61 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë 35 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 9 vendime rrëzimi, 4 vendime mospranimi dhe 3 vendime me sanksion administrativ.

**Gjatë vitit 2023**, institucioni është shprehur me 45 vendime për 46 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë 41 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 3 vendime rrëzimi, dhe 1 vendim me sanksion administrativ.

**Konkluzion:** Zyra e KDIMDP nuk ka hartuar një rregullore të brendshme lidhur me përcaktimin e kërkesave, metodave që ndiqen për procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, identifikimin e përgjegjësive si dhe evidentimin e punës së gjithësecilit në këtë proces si dhe në hierarkinë organizative institucionale. Për më tepër, edhe në rregulloren e brendshme të Zyrës së Komisionerit miratuar me Urdhër nr.71, datë 21.5.2021, konstatohet mungesa e përshkrimeve të detyrave për çdo inspektor/ specialist brenda sektorit/ drejtorisë, të proçeseve të tyre të punës brenda sektorit përkatës, duke lënë vend për mbivendosje të tyre si dhe krijimin e problematikave në evidentimin e përgjegjësisë ligjore. Pasqyrimi në rregulloren e brendshme të ndarjes së duhur të detyrave dhe fushave të përgjegjësisë për çdo punonjës zvogëlon mundësitë për modifikim të pa autorizuar apo të pa qëllimshëm apo keqpërdorim të tyre. Në bazë të nenit 20, shkronja c, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, përcaktohet se: “*titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit lidhur me strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit*”;

Referuar nenit 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, përcaktohet se, njësitë publike miratojnë aktivitetin e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara. Detajuar më tej, në pikën 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ku përcaktohet se, njësitë publike duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për proçese dhe procedura përkatëse, duke filluar nga zbatimi i ligjeve, e duke vijuar me miratimin e rregulloreve të tyre të brendshme (udhëzime, direktiva) për të evidentuar më hollësisht procedurat, përcaktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, si dhe procedurat e kontrollit.

**III. Vendimet dhe sanksionet administrative të vendosura nga Komisioneri për periudhën 2021-2023, në fushën e të drejtës së informimit.**

Referuar raporteve vjetore mbi numrin e vendimeve të Komisionerit, në formë tabelore paraqiten të dhënat si më poshtë:

Viti	Nr. total i Vendimeve	Nr. i vendimeve me Sanksione Administrativ
<b>2021</b>	46	7
<b>2022</b>	51	3
<b>2023</b>	54	10

Burimi:KDIMDP

Për vitin **2021**, rezultoi se janë marrë 7 (shtatë) vendime nga ana e Komisionerit që parashikojnë sanksione administrative ndaj funksionarëve publik, nga të cilat janë zgjedh<sup>4</sup> 5 praktika për vlerësim të procedurave të ndjekura.Vendimet janë si më poshtë:

1. Vendimi i Komisionerit nr.12, datë 02.03.2021
2. Vendimi i Komisionerit nr.13, datë 02.03.2021
3. Vendimi i Komisionerit nr.21, datë 09.04.2021
4. Vendimi i Komisionerit nr.45, datë 20.09.2021
5. Vendimi i Komisionerit nr.48, datë 04.11.2021

Për vitin **2022**, rezultoi se janë marrë 3 (tre) vendime nga ana e Komisionerit që parashikojnë sanksione administrative ndaj funksionarëve publik, nga të cilat janë zgjedh 2 praktika për vlerësim të procedurave të ndjekura.Vendimet janë si më poshtë:

1. Vendimi i Komisionerit nr.43, datë 02.11.2022
2. Vendimi i Komisionerit nr.53,datë 25.11.2022

Për vitin **2023**, rezultoi se janë marrë 10 (dhjetë) vendime nga ana e Komisionerit që parashikojnë sanksione administrative ndaj funksionarëve publik, nga të cilat janë zgjedh 4 praktika për vlerësim të procedurave të ndjekura.Vendimet janë si më poshtë:

1. Vendimi i Komisionerit nr.62, datë 13.12.2023
2. Vendimi i Komisionerit nr.64, datë 13.12.2023
3. Vendimi i Komisionerit nr.66, datë 15.12.2023
4. Vendimi i Komisionerit nr.68, datë 19.12.2023

➤ Mbi procedurën administrative të ndjekur deri në marrjen e vendimit përfundimtar në praktikat e vendimeve të Komisionerit si më poshtë:

1. Vendimi i Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.62, datë 13.12.2023;
2. Vendimi i Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.64, datë 13.12.2023
3. Vendimi i Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.66, datë 15.12.2023;;

<sup>4</sup> *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit", i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

*Përkuftizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampinonët të kenë të njëjtin shans për t'u zgjedhur".*

4. Vendimi i Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.68, datë 19.12.2023;
5. Vendimit i Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.12, datë 02.3.2021;
6. Vendimit i Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.13, datë 02.3.2021;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, në të gjitha praktikat e zgjedhura për auditim, shkresat përcjellëse drejtuar autoriteteve publike për njoftimin e Vendimit të Komisionerit rezultojnë me nënshkrimin e *Drejtoreshës së Përgjithshme të Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës E. H.* dhe vulën e institucionit dhe jo të titullarit të institucionit. Veprimet vlerësohet si në mospërputhje me:

- Nenet 28 -29, të ligjit nr. 44/20151, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për arsye të mungesës së Urdhërit të Komisionerit për delegimin e kompetencës së nënshkrimit të dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Komisionerit.
- Modelin 1 të shtojcës nr.1, të VKM-së nr.4, datë 19.6.2017 për miratimin e “*Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë*”
- Nenin 12 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet ndër të tjera se: ..... *Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari.*
- Nenet 5, pika 3, të rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit ku përcaktohet se; “*Komisioneri përfaqëson institucionin në marrëdhëniet brenda e jashtë vendit*”;
- Nenin 32 shkronja d) të rregullores së brendshme, ku përcaktohet se: “*Në mungesë të titullarit të institucionit aktet dhe dokumentet nënshkruhen nga zyrtari i autorizuar nga Komisioneri, duke shënuar në dokumentin zyrtar, sipas rastit, "Në mungesë dhe me urdhër".*

Mbi bazueshmërinë e Vendimeve të Komisionerit.

Vendimmarrja e Komisionerit bazohet në rezultatet e monitorimit të pasqyruara në raportin e monitorimit të programit të transparencës dhe të hetimit administrativ të kryer nga Zyra e Komisionerit.

- Parregullsitë e evidentuara në procedurën e konstatimit të kundërvajtjes si dhe në përmbajtjen e dokumentacionit që shoqëron Vendimin e Komisionerit.
1. Bazuar në dokumentacionin që përmbante dosja rezultoi se, nuk është ndjekur dhe zbatuar procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative pasi nuk është mbajtur procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes. Zyra e Komisionerit ka zhvilluar seancë dëgjimore në prani të kundërvajtësit dhe ky veprim procedural mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit ligjor në kuptim të nenit 13, pika 1 shkronja b) të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, por nga personat përgjegjës për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk është kryer dokumentimi i saj me procesverbal të firmosur edhe nga kundërvajtësi si detyrim i parashikuar në pikën 1, të nenit 14 të ligjit të lartpërmendur.
  2. Mungon Urdhri i Komisionerit “*Për kryerjen e hetimit administrativ*”, mbi caktimin e personave përgjegjës për hetimin e kësaj çështjeje, fakt në mospërputhje me nenin 43, të Kodit të Procedurës Administrative.

3. Nga inspektorët/ specialisti përgjegjës për kryerjen e inspektimit nuk janë hartuar dhe miratuar deklaratat e ekzistencës/jo të konfliktit të interesave në momentin e fillimit të hetimit administrativ, sipas shkronjës “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 të nenit 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
4. Proçesi i monitorimit të kryer gjatë muajit nëntor 2023, nuk është dokumentuar me proçesverbal/relacion nga personat përgjegjës të ngarkuar me monitorimin e faqeve zyrtare të Autoriteteve publike/Bashkitë. Në përmbajtjen e dosjes u konstatua dokumenti me titull shtojca “*Monitorim i Programit të transparencës*”, në të cilin mungonin të dhënat e nëpunësve përgjegjës që kanë hartuar dokumentin.
5. Referuar përmbajtjes së Vendimeve të Komisionerit, përcaktohet se janë kryer rimonitorime të tjera të faqeve zyrtare të Autoriteteve Publike/Bashkive nga të cilat, ka rezultuar se Autoriteti publik nuk ka ndërmarr veprime për publikimin/përditësimin e kategorive të informacionit të Programit të Transparencës sipas parashikimeve të LDI. Rezultatet e monitorimit të faqes zyrtare të Autoritetit Publik për secilin nga rastet janë pasqyruar në një dokument me emërtim: “Raport konstatimi “*Rimonitorim i Programit të Transparencës së autoritetit publik*”. Dokumenti është i pa protokolluar dhe nuk ka të dhëna për strukturën përgjegjëse dhe personat përgjegjës që e kanë hartuar, duke mospërmbushur elementët formal të një dokumenti zyrtar.
6. Në praktikat e Vendimeve të Komisionerit me nr.12 datë 02.3.2021 dhe nr.13, datë 02.3.2021 u konstatua se, seanca dëgjimore nuk është e dokumentuar në formë elektronike (CD) /transkriptim i regjistrimit audio si dhe dokumentuar me proçesverbal/dokument të barasvlershëm të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse. Gjithashtu, rezultatet e monitorimit të faqes zyrtare të Autoritetit publik paraqiten në dokumente të pa protokolluara, në të cilat s’ka të dhëna mbi personat përgjegjës për konceptimin e tij, duke mospërmbushur elementët formal të një dokumenti zyrtar.

➤ **Konstatimet e mësipërme bazohen në referencat ligjore si më poshtë:**

- Pika 3, e nenit 18 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, përcaktohet se: “*Procedurat e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative*”,
- Shkronja b) e pikës 1, të nenit 13, të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, ku përcaktohet se: “*Për kundërvajtjen administrative parashikohet mbajtja e aktit administrativ që konstaton shkeljen apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte të organeve të pushtetit vendor, në rastet kur konstatimi i shkeljes është i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja*”;
- Pika 1, e nenit 14 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “*Proçesverbali i përmendur në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji mbahet në vendin e kryerjes së kundërvajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull, në prani të kundërvajtësit dhe të dëshmitarëve të pranishëm dhe nënshkruhet nga përpiluesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka. Në proçesverbal shënohen identiteti i kundërvajtësit dhe lloji i kundërvajtjes*”.
- Neni 43 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Shkronja “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 të nenit 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Nenet 13 dhe 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

-Nenin 24 i Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, si dhe nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Për më tepër, referuar literaturës juridike në Republikën e Shqipërisë, procedura për dhënien e dënimeve administrative është tërësia e veprimeve që kryejnë organet përkatëse shtetërore dhe palët gjatë gjykimit të kundërvajtjes mbi bazën e procesverbaleve për konstatimin e tyre, me qëllim që të zbulojnë të vërtetën objektive në një shkëlqje të pretenduar dhe, sipas rastit të japin dënime të përshtatshme administrative ose të deklarojnë të pafajshëm personat e akuzuar për shkelje”.

Në procedurën për dhënien e dënimeve administrative duhet të merren në konsideratë:

**-a.** Fillimi i gjykimit të kundërvajtjes bëhet mbi bazën e procesverbalit, i cili duhet të jetë mbajtur nga personat e autorizuar nga ligji, të ketë shënuar identitetin e kundërvajtjes, llojin e kundërvajtjes dhe të jetë nënshkruar. Nga praktika e administruar rezultoi se nuk ishte mbajtur një procesverbal nga personat përgjegjës për konstatimin e kundërvajtjes, si dhe mungonte urdhëri i titullarit për kryerjen e hetimit administrativ si dhe për caktimin e grupit të inspektorëve si përgjegjës për përmbushjen e detyrave në funksion të këtij hetimi.

Nisur nga rregullimi ligjor i procedurës së konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative , i parashikuar në shkronjën b) të pikës 1, të nenit 13, të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “*Për kundërvajtjen administrative parashikohet mbajtja e aktit administrativ që konstaton shkeljen apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të nga personat e ngarkuar me ligj ose me akte të organeve të pushtetit vendor, në rastet kur konstatimi i shkeljes është i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja*”, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar seancë dëgjimore në prani të kundërvajtësit dhe ky veprim procedural mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit ligjor në kuptim të nenit 13, pika 1 shkronja b) të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, por nga personat përgjegjës për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk është kryer dokumentimi i saj me procesverbal të firmosur edhe nga kundërvajtësi konform pikës 1, të nenit 14 të Ligjit të lartpërmendur.

Në seancat, ku palët shprehen verbalisht mund të diskutohen të gjitha çështjet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit qofshin ato ligjore ose të faktit si dhe mbahet procesverbal në të cilin përmbledhen/pasqyrohen të gjitha pretendimet e tyre.

**-b.** Gjatë gjykimit të kundërvajtjes duhet të administrohen provat e nevojshme për zbulimin e së drejtës objektive, d.m.th të administrohen ato prova që hedhin dritë dhe sqarojnë kryerjen e kundërvajtjes dhe subjektin e saj. *Fakt i cili nuk ka ndodhur, me argumentet si më poshtë vijon:*

- Proçesi i monitorimit të kryer gjatë muajit nëntor 2023, nuk është dokumentuar me procesverbal/relacion nga personat përgjegjës të ngarkuar me monitorimin e faqeve zyrtare të Autoriteteve publike. Në përmbajtjen e dosjes u konstatua dokumenti me titull shtojca “*Monitorim i Programit të transparencës*” pa të dhënat e nëpunësve përgjegjës që e kanë hartuar dokumentin.

- Referuar përmbajtjes së Vendimeve përcaktohet se nga Zyra e Komisionerit janë kryer rimonitorime të tjera të faqeve zyrtare të Autoriteteve publike nga të cilat, ka rezultuar se Autoriteti publik/Bashkia nuk ka ndërmarr veprime për publikimin/përditësimin e kategorive të informacionit të Programit të Transparencës sipas parashikimeve të LDI. Rezultatet e monitorimit të faqes zyrtare të Autoritetit Publik për secilin nga rastet janë pasqyruar në një dokument , me emërtim: Raport konstatimi “*Rimonitorim i Programit të Transparencës së autoritetit publik*”.

Dokumenti është i pa protokolluar dhe nuk ka të dhëna për strukturën përgjegjëse dhe personat përgjegjës që e kanë hartuar, duke mospërmbushur elementët formal të një dokumenti zyrtar.

- Mungon Urdhri i Komisionerit “Për kryerjen e hetimit administrativ”, mbi caktimin e personave përgjegjës për hetimin e kësaj çështjeje, fakt në mospërputhje me nenin 43, të Kodit të Procedurës Administrative.

-c. Në gjykimin e kundërvajtjes duhet të marrin pjesë palët, të cilat nëpërmjet debatit, gjatë gjyqimit dhe në përfundimin e tij ndikojnë në zbulimin e të vërtetës.

- Nga studimi i akteve në tërësi të procedurës së konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, rezultoi se veprimet procedurale nuk janë të dokumentuara, konform akteve ligjore në fuqi.

- d. Në përfundim të gjyqimit, kur vërtetohet faji, vendoset dënimi i kundërvajtësit, ose pafajësia e tij, kur akuza nuk vërtetohet.

Për sa më sipër, mosdokumentimi i veprimeve procedurale për të gjitha fazat e ndjekura nga Zyra e Komisionerit gjatë zhvillimit të procedurave administrative, ka sjellë si pasojë, mungesën e plotësisë së dosjes së procedurës, një domosdoshmëri në rast përdorimi të një mjeti ligjor të mundshëm (si ankimi gjyqësor). Gjithashtu, audituesit e jashtëm nuk mund të arrijnë në konkluzionin se janë ndjekur të gjitha hapat ligjor dhe procedural sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, referuar komenteve sa më sipër, dokumentacioni provues që ka shërbyer për marrjen e Vendimeve të Komisionerit paraqet mangësi formale dhe procedurale, të cilat janë në mospërputhje me pikën 3, të nenit 18 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, pikën 1 të nenit 14 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, nenin 43, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjën “c” të pikës 1, shkronjat “b” dhe “c” të pikës 2 të nenit 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nenin 24 i Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, nenet 13, 19, 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër, ngarkon me përgjegjësi Drejtoreshën e Përgjithshme të Drejtorisë së Informimit E. H. dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale B. D..

➤ Mbi procedurën administrative të ndjekur deri në marrjen e vendimit përfundimtar në praktikat e vendimeve të Komisionerit si më poshtë:

- Vendimi i Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.43, datë 02.11.2022;
- Vendimi i Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.48, datë 04.11.2021;
- Vendimit të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.21, datë 09.4.2021;
- Vendimit të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr.53, datë 25.11.2022.
- Nga inspektorët/specialisti përgjegjës për kryerjen e inspektimit nuk janë hartuar dhe miratuar deklaratat e ekzistencës/jo të konfliktit të interesave në momentin e fillimit të hetimit



administrativ, sipas shkronjës “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 të nenit 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

- Dokumentacioni i praktikave është i pa arkivuar. Mosveprimet janë në mospërputhje me nenin 24 i Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, dhe pikën 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

- Mbi bazueshmërinë e Vendimit të Komisionerit nr.21, datë 09.4.2021

Nga përmbajtja e dosjes me titull “Për hetimin administrativ ushtruar në Bashkinë Bulqizë për ankesën e depozituar nga ankuesi konstatohet se: Me shkresën nr.444 /1prot, datë 11.3.2021, Zyra e Komisionerit i ka kërkuar Autoritetit publik, vlerësimin e informacionit brenda datës 17.03.2021. Autoriteti Publik me shkresë nr.444/2 prot, datë 17.3.2021 ka kthyer përgjigje se informacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion për arsye se konsiderohet konfidencial. Me shkresë nr.1176/2 prot, datë 24.03.2021, AP ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur.

Zyra e Komisionerit ka vlerësuar se informacioni i kërkuar nga ankuesi konsiderohet informacion publik dhe nuk rezulton t’i nënshtrohet kufizimit ligjor të parashtruar nga Autoriteti Publik. Bazuar në pikën 2, Vendimit nr.21, datë 09.4.2021, të Komisionerit sanksionohet si më poshtë : “Dënimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit z.L.D në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Komisioneri ka vlerësuar se është shkelur detyrimi ligjor për dhënien e informacionit, parashikuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

- Mbi bazueshmërinë e Vendimit të Komisionerit nr.43, datë 02.11.2022.

- Në pikën 3 të dispozitivit të Vendimit nr.43, datë 02.11.2022, të Komisionerit sanksionohet si më poshtë : “Dënimin e Koordinatorës për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Komisioneri ka vlerësuar se është shkelur detyrimi ligjor për dhënien e informacionit, parashikuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Bazuar në pikën 3 të nenit 19, të LDI, Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji, për kundravajtjet administrative të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 2, të nenit 18 të LDI.

Vendimi bazohet ndër të tjera, në verifikimin e dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ si dhe deklaramentit në seancën dëgjimore të Koordinatorës për marrjen e përgjegjësisë të trajtimit të ankesës.

- Nga personat përgjegjës që kanë zhvilluar seancën dëgjimore nuk është dokumentuar me procesverbal zhvillimi i seancës datë 05.10.2022. Në seancat, ku palët shprehen verbalisht mund të diskutohen të gjitha çështjet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit qofshin ato ligjore ose të faktit si dhe mbahet procesverbal në të cilin përmbledhen/pasqyrohen të gjitha pretendimet e tyre. Zyra e Komisionerit ka zhvilluar seancë dëgjimore në prani të kundërvajtësit dhe ky veprim procedural mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit ligjor në kuptim të nenit 13, pika 1 shkronja b) të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, por nga personat përgjegjës për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk është kryer dokumentimi i saj me procesverbal të firmosur edhe nga kundërvajtësi konform pikës 1, të nenit 14 të Ligjit të lartpërmendur.

- Nga personat përgjegjës të zhvillimit të procedurës nuk është mbajtur një relacion/memo për rezultatet e veprimeve procedurale të kryera në funksion të procedurës së zhvilluar.

Sipas nenit 43, pika 3 e Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet se: “Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore. Nëse vendimi është i ndryshëm nga ai i propozuar, duhet të shoqërohet me arsyetimin përkatës”.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi Drejtoreshën e Përgjithshme të Drejtorisë së Informimit E. H., Inspektoren E. M. dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale B. D..

- Mbi bazueshmërinë e Vendimit të Komisionerit nr.48, datë 04.11.2021

Në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit nr.48, datë 04.11.2021, të Komisionerit sanksionohet si më poshtë :

*“Dënimin e Specialistes së Komunikimit në Autoritetit Publik në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerë 150,000 lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.*

Komisioneri ka vlerësuar se është shkelur detyrimi ligjor për dhënien e informacionit, parashikuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Vendimi i Komisionerit bazohet, në rezultatet e hetimit administrativ, provave dhe argumentave të palëve gjatë seancës dëgjimore.

- Parregullsitë e evidentuara në procedurën e konstatimit të kundërvajtjes si dhe në përmbajtjen e dokumentacionit që shoqëron vendimin e Komisionerit,

Rezultoi se, nuk është ndjekur dhe zbatuar procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative. Bazuar në dokumentacionin që përmbante dosja rezultoi se, nuk është mbajtur procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes. Zyra e Komisionerit ka zhvilluar seancë dëgjimore në prani të kundërvajtësit dhe ky veprim procedural mund të konsiderohet si përmbushje e detyrimit ligjor në kuptim të nenit 13, pika 1 shkronja b) të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, por nga personat përgjegjës për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk është kryer dokumentimi i saj me procesverbal të firmosur edhe nga kundërvajtësi konform pikës 1, të nenit 14 të Ligjit të lartpërmendur.

Mungon Urdhri i Komisionerit “Për kryerjen e hetimit administrativ”, mbi caktimin e personave përgjegjës për hetimin e kësaj çështjeje, në mospërputhje me nenin 43, të Kodit të Procedurës Administrative.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi Drejtoreshën e Përgjithshme të Drejtorisë së Informimit E. H. dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale B. D..

- Mbi bazueshmërinë e Vendimit të Komisionerit nr.53, datë 25.11.2022.

- Në pikën 6, të Urdhërit nr.200, datë 14.11.2022 të Komisionerit, “Për kryerjen e hetimit administrativ” përcaktohet se: “Procesverbali dhe dokumentet provuese që i bashkëlidhen atij, i nënshtrohen shqyrtimit të Komisionerit, vendimi i të cilit është përfundimtar”.

- Në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit nr.53, datë 25.11.2022, të Komisionerit sanksionohet si më poshtë : *“Dënimin e z.M. Q, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*

- Komisioneri ka vlerësuar se është shkelur detyrimi ligjor për dhënien e informacionit, parashikuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ekzistenca

e informacionit/dokumentacionit kërkuar nga pala ankuese, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik/ IMT, Bashkia Tiranë, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

- Vendimi bazohet ndër të tjera, në rezultatet e inspektimit të kryer nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit, ngritur me Urdhër nr.200, datë 14.11.2022, të Komisionerit “Për kryerjen e hetimit administrativ në Bashkinë Tiranë”. Procesverbali i inspektimit administrativ datë 16.11.2022, është hartur nga znj. E. M., me detyrë inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit të Ankesave, z. A. M. me detyrë inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit të Ankesave si dhe Kryeinspektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit.

Procesverbali i konstatimit të shkeljes administrative dhe ngarkimit me përgjegjësi të funksionarit publik rezulton i pa protokolluar, edhe pse në përmbajtje të tij përcaktohet se: “Procesverbali mbahet në dy kopje, njëra nga të cilat i dorëzohet Autoritetit Publik”.

Procesverbali nuk ka të dhëna se është dorëzuar zyrtarisht në zyrën e protokollit të Bashkisë Tiranë. **Konkluzion:** Mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me pikën 1 të nenit 104 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, si dhe pikën 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi Drejtoreshën e Përgjithshme të Drejtorisë së Informimit E. H. dhe inspektorët E. M. dhe A. M..

#### **IV. Mbi Procedurat administrative/ Hetime administrative/ Inspektime pa vendimmarrje të Komisionerit.**

Për periudhën objekt auditimi nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë zhvilluar në total 211 procedura/ hetime administrative/inspektime, nga të cilat 192 janë kryer nga Drejtoria e Monitorimit të Programit të Transparencës dhe Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave si dhe 19 janë kryer nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Respektivisht sipas viteve procedurat/inspektimet pa vendimmarrje rezultojnë si më poshtë:

Viti	Nr.procedurash nga Drejtoria e monitorimin të Prog. të Transparencës dhe Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave	Nr.procedurash nga Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale
2021	46	2
2022	76	7
2023	70	10

Burimi:KDIMDP

Për sa më sipër, Komisioneri nuk është shprehur për përfundimin e 211 procedurave/ hetimeve administrative/inspektimeve, në formën e një akti administrativ, si: Vendim përfundimtar/ Deklaratë të përfundimit të procedurës administrative/ Rekomandim/ Urdhër/ Autorizim, parashikuar në Kodin e Procedurës administrative si dhe Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit.

Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 11 dhe 90 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr.949 prot, datë 21.5.2021, ku përcaktohet se:

Në zbatim të legjislacionit në fuqi Komisioneri nxjerr këto akte normative nënligjore dhe akte administrative si:

- a) "Udhëzim" është akti nënligjor normativ në zbatim të ligjit nr. 9887/2008 nëpërmjet të cilit rregullohet veprimtaria në një fushë/sektor të caktuar;
- b) "Vendim" është akti nënligjor normativ në zbatim të ligjit nr. 9887/2008 nëpërmjet të cilit rregullohet një veprimtari e caktuar;
- c) "Vendim" është akti administrativ nëpërmjet të cilit detyrohet kontrolluesi/perpunuesi ose autoriteti publik të zbatojë dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9887/2008, nr. 119/2014 dhe nr. 146/2014;
- d) "Rekomandim" është akti administrativ nëpërmjet të cilit kërkohet të rregullohet veprimtaria e kontrolluesit/perpunuesit ose autoritetit publik brenda një afati kohor të caktuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887/2008 dhe nr. 119/2014;
- e) "Urdhër" është akti i Komisionerit që rregullon një marrëdhënie konkrete;
- f) "Autorizim" është akti administrativ nëpërmjet të cilit lejohet të kryhet një veprimtari e caktuar në zbatim të ligjit nr. 9887/2008, sipas rastit edhe e kushtëzuar.

Për të vlerësuar shkaqet e mungesës së vendimmarjes, nga ana e grupit të auditimit, u krye auditimi me zgjedhje<sup>5</sup>. Konkretisht u audituan 11 (njëmbëdhjetë) praktika të procedurave administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me emërtimet si më poshtë:

1. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit "T. M. sh.p.k", filluar me Urdhër nr.1129 prot, datë 16.6.2023 të Komisionerit.
2. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit "Sh. C.", filluar me Urdhër nr.1819 prot, datë 13.11.2023 të Komisionerit.
3. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit "E. C. ", filluar me Urdhër nr.2056 prot, dt.06.7.2023 të Komisionerit.
4. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit "E. D. M. sh.p.k ", filluar me Urdhër nr.1130 prot, dt.16.6.2023 të Komisionerit.
5. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit Shkolla "J. R. " sh..p.k, filluar me Urdhër nr.1818 prot, dt.13.11.2023 të Komisionerit.
6. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit "A. M. P. sh.p.k ", filluar me urdhër nr.1782 prot, dt.17.10.2023 të Komisionerit.
7. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit "T. F. & L. sh.a"; filluar me Urdhër nr.2054 prot, datë 06.7.2023 të Komisionerit.

---

<sup>5</sup> Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit", i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkuftizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur".

8. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “V. M. & P.”, filluar me Urdhër nr. 1736/1 prot ,dt.26.10.2023 të Komisionerit.
9. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “R. G. P. sh.a”; filluar me urdhër nr. 2082 prot , datë 12.12.2022 të Komisionerit.
10. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “R. A. sh.a, filluar me urdhër nr. 2083 prot, datë 12.12.2022 të Komisionerit.
11. Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “R. E. P. sh.p.k, filluar me Urdhër nr. 1672 prot, datë 30.9.2022 të Komisionerit.

➤ Për praktikat nga ( 1-6) u konstatua si më poshtë:

1. Lidhur me përmbajtjen e praktikave, në secilën dosje administroheshin aktet si: Urdhër i Komisionerit “*Për kryerjen e hetimit administrativ*”, Njoftim për fillimin e hetimit drejtuar Kontrolluesit, dhe Relacioni nga grupi i inspektimit mbi rezultatet e hetimit të kryer pranë kontrolluesit.
2. Lidhur me procedurën e ndjekur në këto praktika rezultoi se: Me Urdhër të Brendshëm të Komisionerit ka nisur hetimi administrativ për subjektet/ Kontrolluesit e lartpërmendur, me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale të kontrollit nga grupi i caktuar i inspektimit, në kuadër të zbatimit të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”. Në të gjitha praktikat, në relacionet përkatëse, grupet e inspektimit janë shprehur për pamundësi në identifikimin ligjor dhe të plotë të subjektit, pas kryerjes së verifikimeve në terren te kontrolluesi si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Grupi i inspektimit ka sugjeruar Komisionerin për mbylljen e praktikës për secilin rast pa një vendim përfundimtar, pasi ndodheshin në kushtet e zbatimit të nenit 95 të Ligjit nr.45/2015“Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
3. Në praktikën nr.6, “*Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “A. M. P. sh.p.k;* u konstatua se: Grupi i inspektimit ka kryer verifikimin në terren të adresës së kontrolluesit sipas deklarimeve në regjistrin e QKB-së, dhe ka rezultuar se Kontrolluesi nuk e ushtronte aktivitetin në këtë adresë. Nga ana e grupit të inspektimit nuk janë kryer verifikime të mëtejshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi adresën e saktë të ushtrimit të aktivitetit nga Kontrolluesi. Mosveprime që vijnë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr.45/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se:“*Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”.

Grupi i auditimit kontatoi se, nga ana e Komisionerit nuk është shprehur vullneti për nxjerrjen e një akti administrativ për përfundimin e procedurës administrative. Në bazë të pikës 3 të nenit 90 të KPA-së, përcaktohet se:“*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.*”

Pika 3, parashikon se të dyja llojet e procedurave administrative (qoftë të filluara kryesisht ose me kërkesë) duhet të përfundohen detyrimisht me një akt administrativ të posaçëm, të quajtur “*deklarata e përfundimit*”. Këto raste përfshijnë: *vdekjen e palës ose mbarimin e një personi juridik*

(neni93), tërheqjen ose braktisjen e kërkesës (neni 94), **pamundësinë në objektin apo qëllim (neni 95) dhe mospagimin e tarifave të procedurës (neni 96).**

Vendimmarrja në këto raste (deklarimi i përfundimit) përcakton pamundësinë ose padobinë e vazhdimit të procedurës.

Për sa më sipër, kur organi vlerëson që si rrjedhojë e situatës së krijuar bëhet objektivisht e pamundur marrja e një vendimi përfundimtar, atëherë ai ka detyrimin që përfundimin e procedurës t'a arsyetojë, me qëllim që palët e interesura, të cilat nuk janë dakord me përfundimin në këtë mënyrë të procedurës hetimore, të ushtrojë të drejtën e ankimit. Në këtë rast, organi publik deklaron një vullnet shtetëror nëpërmjet një akti, pavarësisht se organi nxjerr një akt ku pasqyron pamundësinë për zhvillimin e procedurës hetimore, është e kuptueshme se ky nuk është vendim përfundimtar. Ai është një akt që nuk i jep zgjidhje çështjes objekt gjykimi, por ka elementët e aktit, në kuptimin që pala e interesuar mund ta ankimojë dhe të kërkojë shfuqizimin e tij, nëse çmohet se është marrë në kundërshtim me ligjin.

Pra një deklaratë e tillë është një akt administrativ që sjell të gjitha pasojat e synuara juridike. Ai duhet të arsyetohet dhe mund të ankimohet si çdo akt administrativ (përmes ankimit administrativ)

Mosveprimi i Komisionerit për përfundimin e procedurave të mësipërme përmes “deklaratës së përfundimit“, vjen në kundërshtim me pikën 3 të nenit 90 të ligjit nr.45.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

➤ **Për praktikën nr.7, u konsatua si më poshtë:**

“Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “T. F. & L. sh.a”; filluar me Urdhër nr.2054 prot, datë 06.7.2023 të Komisionerit“.

1. Lidhur me përmbajtjen e praktikës, nga grupi i auditimit u administrua dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhër nr.2054, datë 06.7.2023 i Komisionerit “Për kryerjen e hetimit administrativ”,

-Njoftim nr.2054/1, dt.06.7.2023 mbi ushtrimin e hetimit drejtuar Kontrolluesit;

-Procesverbal i hetimit administrativ, nr.2054/2 prot, datë 23.8.2023 mbajtur nga grupi i inspektimit, (përfaqësuesja e Kontrolluesit ka refuzuar të firmosë procesverbalin. mbi rezultatet e hetimit të kryer pranë kontrolluesit),

-Njoftim nr.2054/3 prot, dt.23.08.2023 “Për pjesëmarrje në procesin e shqyrtimit administrativ“,

-Relacion nr.2054/4 prot, datë11.9.2023 “Mbi hetimin administrativ pranë kontrolluesit “T. F. & L. sh.a”, hartuar nga grupi i inspektimit.

2. Lidhur me procedurën e ndjekur konstatohet si më poshtë:

- Referuar përmbajtjes së Rekomandimit nr.36, datë 27.12.2022 të Komisionerit, rezulton se, pas kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, në zbatim të Urdhrit nr.206, datë 24.11.2022 të Komisionerit, grupi i inspektimit ka konstatuar se Kontrolluesi/ T. F. & L. sh.a”, nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara në ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale. Përmes këtij rekomandimi, Komisioneri ka lënë si detyrë përmbushjen e 6 (gjashtë) rekomandimeve sipas afatet të përcaktuara.

Gjithashtu në aktin e Rekomandimit është përcaktuar detyrimi i Kontrolluesit për të njoftuar për masat e marra si dhe në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast

*shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.*

-Referuar përmbajtjes së procesverbalit nr.2054/2 prot, datë 23.8.2023 të mbajtur nga grupi i inspektimit, mbi verifikimin e zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit nr.36, datë 27.12.2022 të Komisionerit, grupi i inspektimit ka arritur në përfundimin se: *Kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimet e parashikuara në nenet 18, 21, 22 dhe 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar si dhe Udhëzimin nr.47 të Komisionerit.*

-Referuar Relacionit nr.2054/4 prot, datë 11.9.2023 “Mbi hetimin administrativ pranë kontrolluesit “T. F. & L. sh.a”, grupi i inspektimit ka njoftuar Komisionerin mbi rezultatet e hetimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit, dhe provat e administruara prej tyre. Grupi i Inspektimit ka sugjeruar se : *“Duke marrë parasysh, bashkëpunimin e kontrolluesit në plotësimin e mangësive të konstatuara në këtë hetim administrativ, të mbetet në vlerësim të Komisionerit përcaktimi i veprimeve të mëtejshme”.*

-Referuar pikës 6 të Urdhërit nr.2054, datë 06.7.2023 i Komisionerit “Për kryerjen e hetimit administrative”, përcaktohet se: *-Procesverbali dhe dokumentet provuese që i bashkëngjiten atij, i nënshtrohen shqyrtimit të Komisionerit, vendimi i të cilit është përfundimtar.*

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi se, nga ana e Komisionerit nuk është marrë vendim përfundimtar, edhe pse është njoftuar përmes relacionit të grupit të inspektimit mbi shkeljet ligjore të kryera nga Kontrolluesi. Bazuar në nenin 43, pika 3 të KPA-së përcaktohet se:*Drejtuesi i njësisë përgjegjëse merr përsipër vetë ose cakton me akt të shkruar nëpunësin përgjegjës për zhvillimin e procedurës administrative.Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore. Nëse vendimi është i ndryshëm nga ai i propozuar, duhet të shoqërohet me arsyetimin përkatës.*

Mosveprimi i Komisionerit për përfundimin e procedurës së mësipërme vjen në kundërshtim me nenin 43, pika 3, nenin 90 të KPA-së, nenin 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative, ku përcaktohet se: *“Kur organi administrativ, kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative, konstaton shkeljen e dispozitave, të cilat parashikojnë kundërvajtjen administrative, pas shqyrtimit, vendos dënimin me gjobë apo dënime të tjera administrative, në varësi nga parashikimi i ligjit të posaçëm, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr.949, datë 21.5.2021.*

➤ **Për praktikën nr.8, u konsatua si më poshtë:**

“Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë kontrolluesit “V. M. & P.”, ka nisur me Urdhër nr.1736/1 prot,dt.26.10.2023 të Komisionerit .

Në përfundim të hetimit administrativ, grupi i inspektimit ka informuar titullarin përmes relacionit, se në subjektin e inspektuar gjendej vetëm administratori, dhe nuk kryheshin procese përpunuese të të dhënave personale. Në dosje nuk disponohen dokumente që vërtetojnë faktet e konstatuara si dhe nuk janë kryer verifikime të tjera nga grupi i inspektimit mbi numrit e punonjësve të Kontrolluesit si *“Deklarimi i formularit të ndryshimit të numrit të punonjësve ESIG 027.* Mosveprime që vijnë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr.45/2015 “Kodi i Procedurës

Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “*Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”.

Sipas relacionit, grupi i inspektimit ka sugjeruar përfundimin e procedurës administrative për subjektin “V. M. & P.” pa një akt administrativ, referuar pikës 2 të nenit 90 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Nga ana e Komisionerit nuk është nxjerr një akt administrativ si dhe mungon shprehja e vullnetit të tij lidhur me vlerësimin e veprimeve procedurale të kyera nga grupi i inspektimit.

➤ **Për praktikat nr.9 nr.10 dhe nr.11 u konstatua si më poshtë:**

- Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “R. G. P. sh.a”; filluar me Urdhër nr.2082 prot, datë 12.12.2022
- Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “R. A. sh.a, filluar me Urdhër nr.2083 prot, datë 12.12.2022.
- Hetim administrativ i Zyrës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesit “R. E. P. sh.p.k, filluar me Urdhër nr.1672 prot, datë 30.9.2022.

Në përfundim të hetimit administrativ, grupi i inspektimit ka informuar titullarin përmes relacionit, për shkeljet administrative të konstatuara nga ana e Kontrollorëve si dhe ka sugjeruar se përfundimi i procedurës të mbetet në diskrecion të titullarit, bazuar në pikën 2 të nenit 90 të KPA-së. Gjithashtu, grupi i inspektimit ka propozuar që: “*Zyra e Komisionerit të dalë me një Rekomandim Unifikues për Sektorin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, drejtuar Shoqatës Kombëtare të Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë. Gjithashtu gjatë planifikimit të hetimeve administrative në vijim sugjerojmë që Zyra e Komisionerit të ketë në vëmendje verifikimin për zbatimin e detyrimeve ligjore që do të lihen në Rekomandimin Unifikues*”.

Nga grupi i auditimit u konstatua se: Komisioneri nuk ka nxjerr akt administrativ për përfundimin e tre proceduave administrative. Mosveprimet e tij vijnë në kundërshtim me nenin 90 të KPA-së, nenin 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr.949, datë 21.5.2021.

**Konstatimet e mësipërme bazohen në analizën dhe referencat ligjore si më poshtë:**

Shkeljet administrative të Kontrollorëve të konstatuara nga grupi i inspektimit konsistojnë në mosrespektim të dispozitave ligjore si: nenet 5, 6, 18, 20, 21, 27, 28 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, për të cilat parashikohen sanksione administrative sipas nenit 39 të këtij ligji.

Neni 8 i Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative, përcakton se: “*Kur organi administrativ, kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative, konstaton shkeljen e dispozitave, të cilat parashikojnë kundërvajtjen administrative, pas shqyrtimit, vendos dënimin me gjobë apo dënime të tjera administrative, në varësi nga parashikimi i ligjit të posaçëm.*”

Neni 90, Kreun XI, “Procedura administrative”, përcaktohen rregullat për përfundimin e një procedure administrative të filluar, në varësi të faktit nëse procedura administrative është nisur me kërkesë ose kryesisht (pikat 1 dhe 2), ose nëse ekziston ndonjë arsye e përmendur në nenin 93 deri në nenin 96 për të përfunduar procedurën pa një vendim përfundimtar.(pika 3).



**-Pika 1 e nenit 90** përcakton detyrimin e organit publik për të përfunduar një procedurë administrative, e cila është filluar me kërkesë, me vendim përfundimtar për themelin e çështjes. Në këtë rast vendimi përfundimtar përcakton “thelbin” ose “themelin” e kërkesës, duke e pranuar ose refuzuar atë me arsyetimin se kushtet ligjore janë plotësuar apo përkatësisht nuk janë plotësuar. Gjithashtu përfundimi i procedurës administrative lidhet ligjërisht me njoftimin e suksesshëm të aktit administrativ të nxjerrë, pasi ky është i vetmi veprim, i aftë të sjellë pasojat e dëshiruara juridike.

Vendimi përfundimtar është konkretizimi i respektimit të të gjitha veprimeve proceduriale, të domosdoshme për t’u kryer nga organi kompetent në përputhje me dispozitat ligjore. Vendimi që merret nga organi kompetent duhet të përmbajë të gjitha elementët formal që kërkon ligji. Ai evidenton përfundimet e procesit hetimor administrativ të zhvilluar nga organi. Për më tepër referuar nenin 64, pika 4 që përcakton se: *“Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera”*

**- Pika 2 e nenit 90** përcakton se, përfundimi i një procedure administrative të filluar kryesisht nga organi publik është në diskrecionin e ligjshëm të atij organi, pasi ai mund të vendosë ta përfundojë ose jo, përveç rastit të një dispozite të veçantë të ligjit që kërkon shprehimisht përfundimin e detyrueshëm me një vendim të shprehur.

Nisur nga fakti që ligji për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe ligji për të drejtën e informimit nuk e kanë të rregulluar këtë situatë, organi publik mbështetet në rregullat e Kodit të Procedurës Administrative. Pra përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht përcaktohet si dhe kufizohet nga parashikimet e dispozitave të ndryshme të kodit. Konkretisht referuar neneve të ndryshme të tij arrijmë në përfundimet si më poshtë:

**Së pari**, organi publik gjatë ushtrimit të diskrecionit të tij për të mos përfunduar procedurën me vendim përfundimtar duhet të marrë parasysh arsyet që e çuan në fillimin e procedurës administrative, (pika 2, e nenit 41 të KPA). Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur:

a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës;

b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik..

**Së dyti**, organi publik duhet të respektojë parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit sipas së cilit diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) është i parashikuar me ligj;

b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;

c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi;

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

**Së treti**, organi publik gjatë ushtrimit të diskrecionit të tij për të përfunduar ose jo procedurën duhet të mbajë në konsideratë parimet e përgjithshme të këtij kodi, sipas së cilave përfundimi me një vendim të shprehur nuk është vetëm një detyrim i organit publik përkatës, por edhe një kërkesë thelbësore e një procedure administrative të tillë. Ai është një vazhdim i detyrimit për të proceduar

(të parashikuar në bazë të pikës 1, të nenit 41) dhe një konkretizim i parimit të marrjes të vendimeve sipas nenit 16. Përveç kësaj, një detyrim i tillë synon të sigurojë:

- mbrojtjen ligjore të palës (neni 1);
- transparencën e administratës publike (neni 5);
- sigurinë ligjore si për palët e interesuara ashtu edhe rendin e përgjithshëm juridik.
- mbikëqyrjen dhe kontrollin ligjor të veprimeve administrative (neni 4 )
- ushtrimi i ligjshëm i diskrecionit (neni 11)
- si dhe efektivitetin dhe efikasitetin e sjelljes administrative (neni 18).

Të njëjtat parime kanë vlerë edhe për shumicën e procedurave të filluara kryesisht.

**Së fundi**, referuar të drejtës dhe qëndrimeve të konsoliduara në fushën administrative përcaktohet se çdo organ publik gjatë një procedure administrativ, ashtu siç duhet të respektojë të gjitha kushtet ligjore për fillimin e saj duhet të mbajë në vëmendje se janë po aq të rëndësishme edhe disa momente procedurale, mbi të cilat ajo konsiderohet e përfunduar. Marrja e një vendimi përfundimtar, si dhe prania ose vërtetimi i disa fakteve, të cilat parashikohen me ligj mund të shërbejnë si shkak për përfundimin e procedurës administrative.

### **Për sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur, konkluzionet për 11 praktikat e mësipërme i paraqesim si më poshtë:**

-Në 6 praktika, Komisioneri nuk ka përfunduar procedurën e nisur, përmes deklaratës së përfundimit sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 90 të ligjit nr.45.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

-Në 2(dy) raste, Komisioneri nuk është shprehur për verifikimet jo të plota të grupit të inspektimit, mosveprime që vijnë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr.45/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

-Në 4(katër) praktika, nga ana e Komisionerit nuk është marrë vendim përfundimtar mbi shkeljet administrative të Kontrollorëve për të cilat parashikohen sanksione administrative sipas nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, referuar komenteve sa më sipër, mosveprimi i Komisionerit në formën e mosshprehjes së vullnetit të tij për përfundimin e procedurave administrative përmes nxjerrjes së aktit administrativ përbën shkelje të parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit si dhe vjen në kundërshtim me nenin 90 të KPA-së, nenin 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010“Për kundravajtjen administrative, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr.949 prot, datë 21.5.2021.

Shkeljet e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkojnë me përgjegjësi z. B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Mbi sa trajtuar më sipër, nëpërmjet observacionit mbi Projekt-Raportin e Auditimit, administruar në KLSH me nr. 247/7 prot., datë 22.07.2024, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shprehet se mban të njëjtin qëndrim me observacionin e dërguar mbi Akt-Konstatimin nr. 12, datë 17.05.2024, administruar në KLSH me nr. 247/5 prot., datë 28.05.2024, si më poshtë:

### **Pretendimi i subjektit:**

Theksojmë edhe njëherë se praktikat të cilat kanë objekt ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), (konkretisht trajtimi i ankesave) mbyllen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së

Shqipërisë” (në vijim “KPA”), dhe më konkretisht me pikën 1 të nenit 94 të tij ku parashikohet se: “1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë...”. Vlen të theksohet se, performanca e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit nuk duhet matur me numrin e vendimmarrjes, por me rezultatin e arrirë në përmbushjen e detyrimit për dhënien e informacionit, rezultat ky i arritur nëpërmjet ndërmjetësimit/bashkepunimit/ndihmës aktive dhe monitorimit me Autoritetet Publike. Lidhur me monitorimin e transparencës proaktive, praktikata mbyllet pas një sërë veprimesh të ndërmarrura nga ana e Zyrës së Komisionerit, dhe në ato raste kur ka rezultuar se autoriteti publik, bazuar në këto veprime, është ndërgjegjësuar dhe ka vënë në zbatim Programin e Transparencës ose e ka përditësuar/ndërlidhur atë, praktika mbyllet me relacion nga struktura përkatëse. Sqarojmë se ky është një proces i vazhdueshëm dhe monitorimi nga ana jonë është i vazhdueshëm, edhe në rast të mbylljes së praktikave me vendimmarrje ose relacion (në rastet kur autoriteti publik është ndërgjegjësuar), sërish monitorimi mbi këto autoritete vijon.

Sa i përket praktikave që kanë objekt ligjin nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave”), ritheksojmë edhe njëherë se ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në këtë ligj, në përfundim të hetimeve administrative, Komisioneri mund të shprehet vetëm nëpërmjet tre akteve (Vendim/ Sanksion, Urdhër, Rekomandim). Nuk mund të merren “*a priori*” parashikimet e KPA, për rastet kur ligjvënësi ka mirëpërcaktuar funksionin dhe kompetencat e Komisionerit si dhe të akteve të shprehjes së vullnetit të tij nëpërmjet lex specialis. Në çdo rast tjetër, kur nuk jemi në kushtet e shprehjes së vullnetit me një prej akteve që ka përcaktuar ligji specifik, Komisioneri nëpërmjet relacionit të hetimit administrativ përcakton veprimet e mëtejshme administrative dhe/ose përfundimin e procedurës, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave, KPA, si dhe rregulloren e brendshme të Zyrës së Komisionerit, ku referuar kësaj të fundit, grupet e hetimit administrativ i përmbahen procedurës së brendshme duke hartuar relacionin përkatës, që në gjykimin tonë përmbush kriteret ligjore si dhe ato formale për t’u njehsuar me “Deklaratën e përfundimit”, për përmblylljen e procedurës administrative pa akt në përputhje me legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen e të dhënave. Vlerësojmë se procedurat e ndjekura nga Komisioneri janë në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 90 të KPA.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*I. Për situatat në të cilat, Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk përcakton formën e përfundimit të procedurës administrative, gjejnë zbatim rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative pasi raporti i specialitetit (lex specialis) ekziston kur elementet përbërëse të një norme të përgjithshme janë të gjitha të pranishme edhe në një normë të posaçme, e cila përveç tyre përmban edhe disa elemente specifike, që e cilësojnë normën e dytë, në raport me normën e parë.*

*Në bazë të pikës 3 të nenit 90 të KPA-së, përcaktohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ. Ajo duhet të arsyetohet dhe mund të ankimohet si çdo akt administrativ. Tërheqja ose braktisja e kërkesës, parashikuar në nenin 94, është një nga rastet në të cilat kërkohet që nga ana e organit publik të përfundohet procedura administrative me aktin administrativ të deklarimit të përfundimit. Auditimi i përputhshmërisë të sektorit publik ka për qëllim vlerësimin nëse aktivitetet e njëjësive të sektorit publik janë në përputhje me kuadrin ligjor që drejtojnë ato njësi dhe jo të vlerësimit të*

performancës së subjektit të audituar. 2. Lidhur me pretendimin se “Relacioni” përmbush kriteret ligjore si dhe ato formale për t’u njehsuar me “Deklaratën e përfundimit” për përfundimin e procedurës administrative theksojmë se, “Relacioni” është akti nëpërmjet të cilit grupi i hetimit administrativ shprehet mbi rezultatet e hetimit administrativ, provat e administruara prej tyre dhe vlerësimin mbi gjetjet e konstatuara, ndërsa vendimi përfundimtar merret dhe nënshkruhet nga Komisioneri pasi ka vlerësuar veprimet procedurale të kyera nga grupi i inspektimit. Nëse grupi i inspektimit ndodhet në kushtet e parashikuara nga nenet 93-96 të KprA, vendimi për përfundimin e procedurës që në këto raste është “Deklaratën e përfundimit ” merret nga Komisioneri. Për këto arsye, relacioni i hartuar nga grupi i inspektimit nuk mund të barazohet/njësohet me “Deklaratën e përfundimit ”, pasi nuk përmbush kriteret ligjore si dhe ato formale. Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

➤ **Mbi procedurën/hetimin administrativ të nisur nga Zyra e Komisionerit ndaj AKSHI-it dhe rezultatet e arritura.**

1. Me Urdhër të Komisionerit nr.17, datë 25.02.2022 “Për kryerjen e hetimit administrativ”, është ngritur grupi i inspektimit për zhvillimin e kontrollit pranë Kontrolluesit “Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit” bazuar në raportimet mediatike mbi publikimin e të dhënave personale të shtetasve të cilët posedonin automjete të regjistruara dhe të dhënave personale të shtetasve nëpunës në sektorin publik dhe privat.

Në pikën 5 të Urdhërit të Komisionerit citohet se: “Për përfundimet e arritura nga grupi i hetimit administrativ të mbahet procesverbal, ku të pasqyrohen shkeljet e mundshme të ligjit, provat që vërtetojnë shkeljen, pretendimet e kontrolluesit, si dhe masat që duhet të merren për rivendosjen e të drejtës së shkelur”.

Në pikën 6 të Urdhërit citohet se: “Procesverbali dhe dokumentet provuese që i bashkëlidhen atij, i nënshtrohen shqyrtimit të Komisionerit, vendimi i të cilit është përfundimtar”.

2. Referuar përmbajtjes së procesverbalit nr.478/3 prot, datë 05.7.2022, të mbajtur nga grupi i inspektimit lidhur me konstatimet e tij, ndër të tjera citohet se:

-AKSHI nuk përmbushi të gjitha kërkesat për informacion të parashtruara nga grupi i inspektimit duke përfshirë zhvillimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të hetimit administrativ në kundërshtim me parashikimet e nenit 32 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Konkretisht:** Grupi i hetimit administrativ kërkoi demonstrimin “onsite” të portalit “e-Albania” dhe sistemit të ndërveprimit GG, në lidhje me përpunimin e të dhënave “Nëpunës” dhe “Targat”, që kryhen nga platformat TIK respektive. Për sistemin e ndërveprimit GG u dha informacion pjesërisht, ndërsa demonstrimi i funksionimit të këtij sistemi u krye nga ana e përfaqësuesve të operatorit ekonomik ‘Infosoft System”.

-Sa i përket portalit “e-Albania”, nga përfaqësuesit e Kontrolluesit u dha informacion i përgjithshëm, por demonstrimi “onsite” i funksionimit të portalit qeveritar, nuk u përmbush.

-Përfaqësuesit e Kontrolluesit/ AKSHI nuk përmbushën kërkesat e grupit të kontrollit, për paraqitjen e informacionit në lidhje me ndërveprimin e sistemeve “e-Taxation” dhe e DPSHTRR me sistemet e tjera , në raport me 55 regjistrat e deklaruar” nëpërmjet GG.

-Mospërmbushja e kërkesave të parashtruara nga grupi i inspektimit për demonstrimin /aksesin “onsite në sistemin “e-taxation” në ratsin e DPT dhe portalin “e-Albania”, ka penguar zhvillimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të hetimit administrativ në kundërshtim me parashikimet e nenit 32 “Detyrimi për bashkëpunim”, në të cilin është shprehur në mënyrë eksplicite se:

1. *Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre.*
2. *Komisioneri ka akses në sistemin e kompjuterave, në sistemet e arkivimit, që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin, që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre, për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar me ligj”*

**Shkeljet e lartpërmendura nuk pasqyrohen në relacionin e hartuar nga grupi i hetimit me datë 20.12.2022.**

Për pasojë nga Komisioneri referuar nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pika *dh/1) kontrolluesit dhe përpunuesit, që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100 000 deri në 1 000 000 lekë, nuk është marr masë administrative për kundërvajtjen administrative.*

***Në procesverbal, për pos sa më sipër nga grupi i hetimit janë pasqyruar shkeljet si më poshtë:***

- AKSHI nuk ka ndërmarr masa konkrete në kuadër të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuar nga Udhëzimi nr.47 të Komisionerit për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh si dhe për shkak të natyrës së vecantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

- AKSHI nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme, konkretisht për strukturën e Njësisë së Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit të atashuar pranë DPT-së, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga personat e paautorizuar, vecanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Udhëzimin nr.47 të Komisionerit.

- Kontrolluesi (AKSHI) nuk ka respektuar detyrimet e parashikuara në nenet 5, 6, 7, 18, 20, 21, 22, 27, 28 dhe 32 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Vendimin nr.6, Udhëzimin nr.19 dhe Udhëzimin nr.47 të Komisionerit.

**Shkelje të cilat nuk pasqyrohen në relacionin e datës 20.12.2022.**

Grupi i hetimit në relacionin me datë 20.12.2022 i është drejtuar Komisionerit mbi hetimin e ushtruar pranë AKSHI-t .Në përmbajtje të relacionit citohet se:

*-Pas fillimit të hetimit administrativ dhe pa u mbyllur procedura, autoritetet shqiptare gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator 2022 janë përballur me sulme kibernetike të rënda ku AKSHI fiku për disa ditë sistemet informatike qeveritare dhe pezulloi cdo shërbim elektronik online. Në procesin e investigimit të këtij sulmi morën pjesë Microsoft DART dhe ekipi investigues i krimit*

*-Në këto kushte në zbatim të parimit të efikasitetit të parashikuar në nenin 18 të KPA-së, për të shmangur aktivitetin procedural të panevojshëm dhe nxjerrjen e një vendimmarrje që mund të mos jetë relevante me situatën reale më lidhje me proceset përpunuese dhe në bazë të neneve 90-96 të Kodit të Procedurës Administrative, grupi i kontrollit sugjeron përfundimin e hetimit administrativ dhe deklarimin të mbyllur pa vendimmarrje përfundimtare pranë Kontrolluesit. Mbetet në vlerësimin tuaj përcaktimi i veprimeve të mëtejshme.*

***Fakt i cili nuk është përmendur në procesverbal, pra relacioni nuk përputhet me procesverbalin.***

**Theksojme se,** relacioni me datë 20.12.2022 është hartuar pas 6 muajve nga data e mbajtjes së procesverbalit (procesverbal i mbajtur në datë 05.7.2020).

Për sa më sipër, rezultoi se nga ana e Komisionerit nuk është shprehur vullneti për nxjerrjen e një akti administrativ për përfundimin e procedurës administrative ndaj AKSHI-t si: Vendim përfundimtar/ Deklaratë të përfundimit të procedurës administrative/ Rekomandim/ Urdhër, parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative si dhe Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit.

Në opinionin/vlerësimin e grupit të auditimit, mosveprimet e Komisionerit për mospërfundimin e procedurës administrative ndaj AKSHI-t në formën e nxjerrjes së një akti administrativ, janë në kundërshtim me nenin 30, pikën 4 të nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, nenin 11 dhe 90 të KPA-së, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr.949, datë 21.5.2021.

### **Konstatimi i mësipërm bazohet në argumentat dhe referencat ligjore si më poshtë:**

- **Së pari**, grupi i inspektimit ka konstatuar se Kontrollori/ AKSHI nuk ka respektuar detyrimet e parashikuara në nenet 5, 6, 7, 18, 20, 21, 22, 27, 28 dhe 32 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe aktet nënligjore të Komisionerit. Referuar nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përcaktohet se: *1. Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:*

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
  - b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
  - c) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të korrigjuar ose fshirë të dhënat, të përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji, dënohen me 15 000 deri në 300 000 lekë;
  - ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
  - d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
  - dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.
- dh/1) kontrolluesit dhe përpunuesit, që veprojnë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, dënohen me 100 000 deri në 1 000 000 lekë.**

4. Gjobat vendosen nga komisioneri, kur vërehet se janë shkelur detyrimet e përcaktuara në ligj.

**Për sa më sipër, nga ana e Komisionerit nuk janë vendosur sanksione administrative për shkeljet e detyrimeve ligjore të konstatuara nga grupi i inspektimit dhe të pasqyruara në procesverbalin e hetimit administrativ.**

-**Së dyti**, Komisioneri ka vepruar në kundërshtim me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit parashikuar në nenin 11 të KPA-së, pasi në dy rastet e tjerë të hetimit (*trajtuar në vijim*) të kryer për këtë çështje ka vepruar përmes nxjerrjes së vendimeve për dënimin e Kontrolluesit me gjobë. Komisioneri ka ushtruar standart të dyfishtë.

Konkretisht, për publikimin e databazës me të dhënat e pagave të qytetarëve dhe databazës me të dhënat e targave automjeteve, Zyra e Komisionerit ka filluar hetim administrativ ndaj Drejtorisë

së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si me poshtë:

- **Hetimi administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.**

-Me Urdhër të Komisionerit nr.208, datë 28.12.2021 “Për kryerjen e hetimit administrativ”, është ngritur grupi i inspektimit për zhvillimin e kontrollit pranë Kontrolluesit “Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Në përfundim të hetimit Komisioneri ka disponuar me vendimin nr. 51, datë 24.11.2022 për dënimin me gjobë për kontrolluesin DPSHTRR.

Me shkresën nr. 2069 prot, dt.08.12.2022, Komisioneri ka informuar/ka vënë në dijeni mbi rezultatet e vendimmarrjes së tij Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- **Hetimi administrativ pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve.**

-Me Urdhër të Komisionerit nr.203, datë 22.12.2021 “Për kryerjen e hetimit administrativ”, është ngritur grupi i inspektimit për zhvillimin e kontrollit pranë Kontrolluesit “Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”

Në përfundim të hetimit Komisioneri ka disponuar me vendimin nr.52, datë 24.11.2022 për dënimin me gjobë për kontrolluesit DPT.

Me shkresën nr.2079 prot, datë 09.12.2022, Komisioneri ka informuar/ka vënë në dijeni mbi rezultatet e vendimmarrjes së tij Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Referuar nenit 30, pika 2 dhe 2/1 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përcaktohet se: *“Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.*

*2/1. Për rastet që shkelja përbën vepër penale, bën kallëzimin përkatës.*

*Koment i grupi të auditimit*

E drejta për mbrojtje të të dhënave personale buron nga e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës, në themel të së cilës është dinjiteti njerëzor. Ajo parashikohet nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe përbën një të drejtë themelore të individit. Sot, mbrojtja e të dhënave personale përfaqëson një aspekt kyç, si për aktivitetin e shoqërive tregtare, ashtu edhe për individët, sidomos duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin e shërbimeve. Këto të fundit janë pjesë e një procesi të pakthyesëm, që përfshin rritje masive të përdorimit të internetit dhe platformave online, ku rrjedhimisht mbrojtja e të dhënave personale merr rol vendimtar dhe qendror.

Edhe në legjislacionin shqiptar mbrojtja e jetës private dhe të dhënave personale është një nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, së bashku me aktet nënligjore të zbatimit të tij. Ky kuadër normativ garanton zbatimin e kësaj të drejte dhe njëkohësisht rregullon përpunimin e të dhënave personale, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private.

“E dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Çdo organizatë, ndërmarrje, apo institucion që mbledh, përdor, shkëmben apo mban të dhëna personale duhet të ketë një strategji për mbrojtjen e tyre, e cila, nëse është e ndërtuar në mënyrën

e duhur dhe e mirëmenduar, i ndihmon ato të parandalojnë humbjen, vjedhjen, apo cenimin e të dhënave, si dhe të zvogëlojnë dëmet e pasojat që shkaktojnë shkeljet apo incidentet ndaj të dhënave personale.

**Konkluzion:** Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, P. M. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Mbrojtjes së të Dhënave Personale, R. B. me detyrë Drejtor i Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave, E. Sh. me detyrë Inspektor Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Siguria të Dhënave, U. H. dhe R. L. me detyrë Inspektor në Drejtorinë e vlerësimit të ankesave dhe harmonizimit.

### **- Vendimi i Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale nr. 45, datë 20.09.2021.**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua:

Me shkresën nr.898/6 datë 20.09.2021 nga E. H. me detyrë Drejtor i përgjithshëm Drejtoria Informimit i është dërguar Bashkisë Elbasan vendimi i Komisionerit nr. 45, datë 20.09.2021.

Koka e shkresës ka Republika e Shqipërisë; Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale; Drejtoria e Përgjithshme për të drejtën e informimit; Drejtor i Monitorimit të Programeve të transparencës.

Në fund ka firmosje nga E. H. dhe vula e Zyrës së Komisionerit, nuk ka firmosje nga Komisioneri si titullar i Institucionit.

Shkresa përcjellëse është në kundërshtim me rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Institucionit, dokumentet standart të miratuar me vendim të Komisionerit nr. 173, datë 29.05.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 5, VKM nr.4 “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13.

Në këtë vendim është vendosur në pikën 2. Dënimi i nëpunësit të lartë të Autoritetit Publik znj. A. B., me detyrë sekretar i përgjithshëm i Bashkisë Elbasan, në cilësinë e nëpunësit të lartë civil, me gjobë 50,000 lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Kjo gjobë është dhënë pasi Bashkia Elbasan nuk ka vendosur në faqen e saj, programin model të transparencës referuar urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e programit të transparencës për njësit ewb të qeverisjes vendore”.

Ky vendim është marr, bazuar në procesverbalin e mbajtur në Bashkinë Elbasan, për hetimin administrativ të kryer referuar urdhrin nr. 64, datë 14.05.2021 të Komisionerit.

Procesverbali është mbajtur inspektorët S. S., me detyrë inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit të Ankesave, A. K. me detyrë inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit të Ankesave S. B. me detyrë inspektor në Drejtorinë Monitorimit të Transparencës.

Në procesverbal ndër të tjera është shprehur:

-Pas verifikimit në faqen zyrtare të internetit, Zyra e Komisionerit konstaton se Autoriteti Publik nuk ka përmbushur Rekomandimin nr. 36, datë 23.12.2020.

-Përfaqësuesja e Autoritetit Publik A. U. sqaron “Për sa i përket detyrimit tim si kordinatore e të drejtës për informim në lidhje me regjistrimin e kërkesave dhe përgjigjeve, bashkëlidhur ju vendos një kopje të regjistrin të përditësuar deri më datë 16.04.2021. dhe një kopje të regjistrin të përditësuar të vitit 2020 totali 35 kërkesa për informim. Përditësimi i fundit në faqen zyrtare të regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve është kryer në dhjetor të vitit 2020. Arsyeja e mos



përditësimi të regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare është mosfunksionimi i faqes dhe pamundësia teknike për të bërë ndryshimet/përditësimet e nevojshme.

Nga kontakti me kryetarin e Bashkisë Elbasan ju bëj me dije se personi përgjegjës për vënien në zbatim të rekomandimit nr. 36 datë 23.12.2020 i komisionerit është sekretarja e përgjithshme A. B.. Përfaqësuesi i autoritetit publik parashtrij këto pretendime:

Përfaqësuesi i autoritetit publik parashtrij se është dakort me konstatimet e grupit të inspektimit. Procesverbali pasi lexohet nga të pranishmit dhe pasi u gjet i shkruar drejt nënshkruhet rregullisht. Procesverbali është nënshkruar për Bashkinë Elbasan nga A. U. me detyrë kordinatore e të drejtës për informim dhe I. S. me detyrë nënkryetar bashkie.

Në procesverbal nuk është ngarkuar asnjë me përgjegjësi për moszbatimin e rekomandimit nr. 36 datë 23.12.2020 të komisionerit, përfshi dhe sekretaren e përgjithshme që është gjobitur.

Procesverbali nuk është mbajtur në prezencë ose në mungesë me sekretaren e përgjithshme A. B., edhe pse është gjobitur.

Mbajtësit e procesverbalit/procesverbali nuk pasqyrojnë pretendimet e kundërvajtësit, pasi vet procesverbali nuk ka kundërvajtës, ose faktin që kundërvajtësi është i pranishëm dhe nuk pranon të pasqyrojë pretendimet e tija dhe as të nënshkruaj procesverbalin.

-Procesverbali nuk ka të përcaktuar, që ky procesverbal ti bëhet i njohur zyrtarisht sekretares së përgjithshme A. B..

Për këtë gjobë nuk është mbajtur procesverbal me personin e gjobitur në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, neni 14 . pika 1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “*Procesverbali i përmendur në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji mbahet në vendin e kryerjes së kundërvajtjes dhe në kohën e konstatimit të saj, si rregull, në prani të kundërvajtësit dhe të dëshmitarëve të pranishëm dhe nënshkruhet nga përpiluesi, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka. Në procesverbal shënohen identiteti i kundërvajtësit dhe lloji i kundërvajtjes*”. Pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “*Në rastet kur kundërvajtësi kundërshton nënshkrimin e procesverbalit, ky fakt evidentohet në atë procesverbal*”.

Procesverbali nuk është dorëzuar zyrtarisht në protokollin e Bashkisë Elbasan.

Referuar procedurës administrative, procesverbali i cili mban nr. 838/3 datë 18.05.2021 të protokollit të Zyrës së Komisionerit, nuk ka:

- a. Funksion konstatues me fuqi provuese të veçantë, pasi nuk është mbajtur në zbatim të nenit 14 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”.

-b. Funksion akuzues, pasi nuk shërben për fillin e gjykimit të kundërvajtës administrative.

*Koment i grupit të auditimit.*

Referuar literaturës juridike në Republikën e Shqipërisë “Procedura për dhënien e dënimeve administrative është tërësia e veprimeve që kryejnë organet përkatëse shtetërore dhe palët gjatë gjykimit të kundërvajtjes mbi bazën e procesverbaleve për konstatimin e tyre, me qëllim që të zbulojnë të vërtetën objektive në një shkëlqje të pretenduar dhe, sipas rastit të japin dënime të përshtatshme administrative ose të deklarojnë të pafajshëm personat e akuzuar për shkelje”.

Në procedurën për dhënien e dënimeve administrative duhet të merren në konsideratë:

-a. Fillimi i gjykimit të kundërvajtjes bëhet mbi bazën e procesverbalit, i cili duhet të jetë mbajtur nga personat e autorizuar nga ligji, të ketë shënuar identitetin e kundërvajtjes, llojin e kundërvajtjes dhe të jetë nënshkruar.

*Fakt i cili nuk ka ndodhur.*

-b. Gjatë gjykimit të kundërvajtës duhet të administrohen provat e nevojshme për zbulimin e së drejtës objektive, d.m.th të administrohen ato prova që hedhin dritë dhe sqarojnë kryerjen e kundërvajtës dhe subjektin e saj.

*Fakt i cili nuk ka ndodhur, me argumentin si më poshtë vijon:*

Në vendimin nr. 45, datë 20.09.2021 është shprehur në ligjëratë të drejtë: Në datën 14.07.2021 u zhvillua seanca dëgjimore online, në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Publik, sekretares së përgjithshme znj. A. B., në cilësinë e personit përgjegjës për përmbushjen e detyrimit për vënien në zbatim të programit institucional të transparencës, si dhe znj. A. T. (U.), me detyrën e koordinatores për të drejtën e informimit. Gjatë seancës dëgjimore, znj. A. B. konfirmoi se Autoriteti Publik kishte marrë të gjitha masat dhe ishte në fazë finalizimi të publikimit të programit institucional të transparencës brenda ditëve në vijim. ***Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, vlerësoi ndërgjegjësimin e treguar dhe masat e marra nga ana e Autoritetit Publik*** dhe informoi këtë të fundit mbi monitorimin e vazhdueshëm të faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore.

Seanca dëgjimore nuk është e dokumentar në formën e transkriptuar, regjistrim audio, ose një procesverbal/dokument të barasvlershëm për e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse, ose e konfirmuar në mënyrë elektronike

-c. Në gjykimin e kundërvajtës duhet të marrin pjesë palët, të cilat nëpërmjet debatit, gjatë gjykimit dhe në përfundimin e tij ndikojnë në zbulimin e të vërtetës.

*Fakt i cili nuk ka ndodhur, me argumentin si më poshtë vijon:*

Në Vendimin nr. 45, datë 20.09.2021 është shprehur në ligjëratë të drejtë: Pavarësisht sa më sipër, ndryshe nga sa u deklarua në seancën dëgjimore, nga monitorimi i kryer nga ana e Zyrës së Komisionerit, deri në datën e këtij vendimi, rezulton se Autoriteti Publik/ Bashkia Elbasan, ka vendosur formalisht dokumentin e Programit të Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr.211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pa e ndërlikuar/pasuruar me informacionin përkatës, duke mos zbatuar detyrimin ligjor për vënien në zbatim të tij.

Për këtë pretendim të ri:

-Nga Zyra e Komisionerit, nuk është caktuar një afat për finalizimin të publikimit të programit institucional të transparencës, në seancën dëgjimore të datës 14.07.2021, duke cilësuar se pas këtij afati n.q.s. nuk e realizoni, do arrihet në vendimin përfundimtar, por është shprehur vetëm se “.....dhe informoi këtë të fundit mbi monitorimin e vazhdueshëm të faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore”.

-Nuk është vënë në dijeni pala Autoriteti Publik/ Bashkia Elbasan, që ka vendosur formalisht dokumentin e Programit të Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr.211, datë 10.09.2018, për këtë nuk ka:

-Asnjë korrespondencë me Autoritetin Publik/ Bashkia Elbasan në mënyrë shkresore ose elektronike me e-mail, etj.

-Nuk është mbajtur procesverbal/ose dokument të barasvlershëm të këtij pretendimi.

- Nuk ka seancë dëgjimore të re ku të ketë marrë pjesë pala Autoriteti Publik/ Bashkia Elbasan, pra përveç asaj të datës 14.07.2021.

Veprim në kundërshtim me . Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 87, pika 1 dhe 2/dh, pika 3, Neni 53, pika 2 dhe neni 82.

- d. Në përfundim të gjykimit, kur vërtetohet faji, vendoset dënimi i kundërvajtësit, ose pafajësia e tij, kur akuza nuk vërtetohet.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, referua komenteve sa më sipër vendimi nr. 45, datë 20.09.2021 i Komisionerit për dënimin me 50,000 lekë gjobë për A. B. me detyrë sekretare e përgjithshme, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjen administrative”, nenet 7, 14 dhe 19 dhe Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij neni 53 pika 2, neni 82 dhe neni 87, pika 1, 2/dh, pika 3. për pasoj është juridikisht i pavlefshëm.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, E. H. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Informimit, S. S., me detyrë inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit të Ankesave, A. K. me detyrë inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit të Ankesave S. B. me detyrë inspektor në Drejtorinë Monitorimit të Transparencës.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” është paraqitur observacioni me shkresën nr. 457/28 prot., datë 19.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 247/7 prot., datë 22.07.2024, në lidhje Projekt Raportin e Auditimit dhe akt konstatimit nr. 4, datë 17.05.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me paragrafin e fundit të pikës 4, faqja 174 e Projektraportit: “Në vlerësimin e grupit të auditimit, referuar komenteve sa më sipër, vendimi nr. 45, datë 20.09.2021 i Komisionerit për dënimin me 50,000 lekë gjobë për A. B. me detyrë sekretare e përgjithshme, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, nenet 7, 14 dhe 19 dhe Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij neni 53 pika 2, neni 82 dhe neni 87, pika 1, 2/dh, pika 3.”, Zyra e Komisionerit i mbetet të njëjtit qëndrim me atë të dhënë më herët për akt – konstatimin nr. 4, datë 17.05.2024 të Kontrollit të Lartë të Shtetit (në vijim “KLSH”), përcjellë me shkresën nr. 476/26 Prot, datë 24.05.2024. Gjithashtu vlerësojmë se vendimi nr. 45, datë 20.09.2021 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka asnjë element në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar. Në çdo rast, vendimarrja e Komisionerit i nënshtrohet rishikimit gjyqësor dhe është gjykata administrative institucioni i vetëm që ka tagrin për t’u shprehur mbi vlefshmërinë ose jo të akteve administrative të Komisionerit.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Observacion nuk qëndron. Argumenti tekniko juridik përse nuk qëndron është dhënë në Projekt Raportin e Auditimit dhe aktkonstatimin nr. 4, datë 17.05.2024.*

*Për posë sa më sipër. Grupi i auditimit ka realizuar gjurmën e auditimit, duke disponuar procesverbalin përkatës, konformë dispozitave përkatëse për njësimin e dokumenteve zyrtare.*

*Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

**Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit me nr.247/2 prot, datë 23.02.2024, grupi i auditimit mori në vlerësim ankesën e Shkollës “U. S.” Tiranë, dërguar në formë elektronike (e-mail), Kontrollit të Lartë të Shtetit, protokolluar pranë këtij të fundit me nr.272 prot, datë 19.02.2024.**

Përmes ankesës subjekti ka ngritur shqetësimin për paligjshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore gjatë përpunimit të të dhënave personale të fëmijëve shqiptar, përmes databazës së Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar. Nisur nga qëndrimi zyrtar i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave me nr.244/1 prot., datë 02.02.2024 , ankuesi kërkon të kryhen verifikimet përkatëse nga KLSH.

Nga grupi i auditimit u administrua dokumentacioni i praktikës pranë Zyrës së Komisionerit në funksion të ankesës, me përmbajtje si më poshtë:

-Dokument nr. 1, datë 25.01.2024: “Kartela shoqëruese e praktikës me nr.244 prot, datë 25.01.2024, bashkalidhur e-mail i datës 25 janar 2024 ora 14 .00.

-Dokument nr. 2, E-mail , datë 29.01.2024 dërguar nga Shkolla “U. S.” Tiranë, në vijim të e-mailit datë 25.01.2024.

-Dokument nr.3, me nr.244/1 prot, datë 02.02.2024 “Kthim përgjigje me e-mail” (me anë të së cilës dërgohet Rekomandimi nr.33, datë 27.06.2023 i Komisionerit, për kontrolluesin QSHA.)

-Dokumenti nr.4, pa datë, me përmbajtje: provat, Libri “Firmat e Prindit” SMIP; VKM nr. 742, datë 03.12.2021, dërguar me e-mail të datës 25.01.2024.

Dosja mbyllet me inventar me titull “Praktika nr. 244, datë 25.01.2024”, dhe nr.rendor 4, firmosur nga znj. E. M. me detyrë inspektore, Drejtorja e vlerësimit të ankesave dhe harmonizimit, dhe znj. B. V. me detyrë Specialist arkiv/prot.

Nga verifikimi i dokumentacionit, vendosur në dispozicion nga Zyra e Komisionerit , u konstatua se:

Shkolla “U. S.” me e-mail të datës 25 janar 2024 ora 14:00 i është drejtuar Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me kërkesën me objekt: “Të marrë në shqyrtim praktikën e hedhjes e të përpunimit të të dhënave personale online në databazën qendrore SMIP në këndvështrim të ligjit 9887 “për mbrojtjen e të dhënave”. Ky e-mail është protokolluar nga Zyra e Komisionerit me nr. 244 prot, datë 25.01.2024. Bashkëlidhur shoqërohet me kartelën e praktikës e cila mban të njëjtin numër protokolli dhe datë.

Referuar shënimeve të kartelës së praktikës, titullari i institucionit ka caktuar nëpunësit përgjegjës për trajtimin e ankesë/kërkesës si më poshtë:

R. B. me detyrë drejtor i Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të dhënave.

1. E. Sh. me detyrë inspektor Drejtorja e Hetimit Sektorial dhe Siguria e të Dhënave.
2. E. M. me detyrë inspektor Drejtorja e Hetimit Sektorial dhe Siguria e të Dhënave.
3. D. A. me detyrë inspektor Drejtorja e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike.

Përmes adresës zyrtare elektronike të Zyrës së Komisionerit është dërguar përgjigje me e-mail me nr.244/1 prot, datë 02.02.2024 shkollës “U... S...”. Në mënyrë eksplicite në e-mail shprehet se:

*“..... Lidhur me shqetësimet e ngritura nga ana e juaj në botimin “Firmat e Prindit” mbi praktikën /përpunimit të të dhënave personale online në sistemin e menaxhimit të Informacionit Parauniversar (në vijim “SMIP”, të administruar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, Zyra e Komisionerit ju informon se autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ka në vëmendje të vazhdueshme monitorimin dhe mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale në sisteme elektronike të tilla, përfshirë dhe SMIP.*

*Në këtë kuadër, ju bëjë me dije se, Zyra e Komisionerit, ashtu sikurse dhe në vitet e kaluara i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe sektorit arsimor. Konkretisht përgjatë vitit 2023 ka ushtruar hetim administrativ ndaj QSHA në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale për sistemin SMIP. Në përfundim të hetimit administrativ Zyra e Komisionerit ka dalë me rekomandimin nr. 33, datë 27.06.2023, të cilin mund të gjeni të publikuar në faqen zyrtare të internetit në lidhjen, <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2023/01/Rekomandimin-QSHA.pdf>.*

*Zyra e Komisionerit, gjithashtu ndjek një plan të lidhur me verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore për përfundimin e ligjshëm të të dhënave personale”.*

➤ *Vlerësim i procedurës së ndjekur nga Zyra e Komisionerit në trajtimin e kërkesës.*

Zyra e Komisionerit si autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përpunimin e të dhënave personale në sisteme elektronike, përfshirë dhe SMIP, pas ardhjes në dijeni të kërkesë/ankesës (*e cila ka sjell në vëmendje problematika për të cilat Zyra e Komisionerit jo vetëm i ka konstatuar më herët por ka nxjerr edhe rekomandim për rregullimin e situatës nga institucionet përgjegjëse*), duhet të merrte në konsideratë nisjen e një hetimi administrativ mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Kontrolluesin/QSHA. Në Rekomandimin nr.33, datë 27.06.2023 “Për kontrolluesin “Qendra e Shërbimeve Arsimore” janë përcaktuar detyrimet që duhet të zbatoheshin nga QSHA brenda afateve të caktuara kohore.

Zyra Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ka kryer verifikimin e zbatimit të rekomandimit nr. 33, datë 27.06.2023 “Për kontrolluesin “Qendra e Shërbimeve Arsimore”, me përmbajtje si më poshtë:

“Rekomandoj:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të ligjit.

2. Kontrolluesi të marrë masa dhe të ndjek procedurën e parashikuar në udhëzimin nr.463, për përfshirjen e tij, në aneksin 1 të këtij udhëzimi;

3. Kontrolluesi të marr masa për përpunimin e të dhënave të përdoruesve, gjatë autentifikimit (identifikimit) përmes portalit “E-albania”, në sistemin SMIP, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit, duke mundësuar një mënyrë që të shmang përdorimin e llogarive personale të përdoruesve administrativ, të krijuara për një qëllim tjetër.

4. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje, zbatimin e detyrimeve, sipas parashikimeve të nenit 18 të ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave në faqen zyrtare [www.smip](http://www.smip) dhe aplikacionet e regjistruara në “Play Store” dhe “App Store”.

5. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve, sipas parashikimeve të nenit 20 të ligjit dhe udhëzimit nr. 19 të komisionerit.

6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e rregullores “për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave peersonale”, lidhur specifikisht me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen kontrolluesi, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave etj.

8. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në udhëzimin nr. 47 të komisionerit.

9. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve si vijon:

-vazhdimisht, detyrimet e treguar në pikat 1 dhe 6 si më sipër.

-brenda këtij viti kalendarik, detyrimet e treguara në pikat 2 dhe 3 më sipër.

-brenda 15 ditëve detyrimet përcaktuara ë pikën 4.

-brenda 30 ditëve, detyrimet e përcaktuara në p[ikëm 5 si më sipër.

-brenda 45 ditëve, detyrimet e përcaktuar në pikat 7 dhe 8 si më sipër.”

-Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit, nga një Kontrollues ose Përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Zyra Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka njoftuar Shkollën “U... S...” Tiranë, për regjistrimin e kërkesës së saj dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurës. (E –mail datë 25 janar 2024 ora 14 .00 dhe e-mail datë 29.01.2024 ora 11.33, e-mail i cili nuk është protokolluar, dërguar nga Shkolla “U. S. ”, Tiranë).

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 44 pika 2/a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se organi publik “Njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës”.

-Në dosje nuk disponohet relacion/plan me veprime nga grupi i punës së caktuar nga titullari i përbërë nga z. R. B., z. E. Sh., znj. E. M. dhe znj. D. A..

-Në mungesë të kryerjes së veprimeve proceduriale nga grupi i caktuar, nuk ka një vendimmarrje nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me këtë procedurë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 90 “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se : “Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij”.

-Nga intervistat e zhvilluara me personat përgjegjës, është argumentuar se, dy e-maillet e dërguara nga Shkolla “U. S.”, nuk janë trajtuar si ankesë, por vënie në dijeni. Ky fakt është në kundërshtim me pjesën narrative të kërkesë-ankesës, si dhe provat dokumentare/ Libri “Firmat e prindit” SMIP, që i bashkëlidhen kërkesës.

Veprim në kundërshtim me “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , neni 48, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj”, pika 3/b e nenit 41, neni 47, neni 48, neni 58 pika 3, neni 59 pika 3, neni 77, neni 90, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 5, 6 dhe 16 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, për sa më sipër, arrihet në konkonzion se, në mungesë të nisjes së një hetimi administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit, për :

-verifikimin e zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit nr.33, datë 27.06.2023 nga kontrolluesi/“Qendra e Shërbimeve Arsimore”,Tiranë si dhe vlerësimin e problematikës/gjetjeve të konstatuara, për sa kërkohet/ ankohet/ informohet/vihet në dijeni nga Shkolla “U. S.” Tiranë, trajtimi i kërkesë/ankesës nga Zyra e Komisionerit mbetet në kuadrin e një përgjigje shkresore formale, duke mos i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së ngritur nga ankuesi, si dhe duke mospërmbushur detyrimet ligjore që parashikon legjislacioni në fuqi.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, P. M. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Mbrojtjes së të Dhënave Personale, R. B. me detyrë Drejtor i Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave, E. Sh. me detyrë Inspektor Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Siguria të Dhënave, E. M. Inspektor Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Siguria të Dhënave dhe D. A. me detyrë Inspektor Drejtoria e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” është paraqitur observacioni me shkresën me nr. 457/28 prot., datë 19.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 247/7 prot., datë 22.07.2024, në lidhje Projekt Raportin e Auditimit dhe akt konstatimit nr. 6, datë 17.05.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

Në këtë kuptim, e-maili i ardhur nga shkolla “U. S.” nuk është vlerësuar të trajtohet si ankesë pasi nuk adresohet nga një subjekt të dhënash apo nga një përfaqësues i autorizuar prej tij. Shqetësime apo kërkesa të tilla merren parasysh nga Zyra e Komisionerit dhe shërbejnë si elementë për t’u futur në planin e punës së Zyrës dhe për t’u zbatuar më pas nga struktura e hetimit sektorial që ka në objekt të veprimtarisë kryerjen e hetimeve kryesisht.

Megjithatë, Zyra e Komisionerit nuk ndodhet as në kushtet e mosveprimit, duke qenë se e-mailit i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 244/1 prot., datë 02.02.2024 (sikurse e citon edhe grupi i auditimit në përfundim të aktit të konstatimit).

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Observacion nuk qëndron. Argumenti tekniko juridik përse nuk qëndron është dhënë në aktkonstatimin nr. 6, datë 17.05.2024 dhe në projektraport.*

*Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

## **2.2 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.**

### **a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.**

Financimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kryhet si më poshtë:

- Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (Ilogaria 600; 601; 602 dhe 606) me financim të brendshëm nga fondet buxhetore;
- Për shpenzimet për investime (Ilogaria 230- 231), të cilat financohen nga fondet buxhetore dhe donacionet.

Struktura buxhetore e KDIMDP për hartimin e PBA-së paraqitet në një program, me kod buxhetor 1089001.

#### **Planifikimi buxhetor i vitit 2022-2024**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2022-2024”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të VKM nr. 119, datë 03.03.2021 “Për miratimin e taveveve

*përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024*” dhe Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Me shkresën nr. 819, datë 30.04.2021, KDIMDHP ka dërguar në MFE “*Mbi dorëzimin e kërkesave të programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024*” (faza e parë/ strategjike).

Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja.

• Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për **politikat ekzistuese** KDIMDHP:

- Për Artikulli 606&601 “*Paga dhe sigurime*” kërkohet rritje në vlerën 11,400 mijë lekë.

Me Ligjin e Buxhetit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, numri i miratuar i punonjësve ka qenë 44, ndërkohe që ky ndryshim (shtese 5 pesë punonjës) nuk është shoqëruar me reflektimin në fondin e shpenzimeve të personelit në vitin 2021 e për më tej në tavanet e PBA 2022-2024, si rrjedhojë është kërkuar shtesë fondi në shumën 9,000 mijë lekë.

Gjithashtu fond shtesë për mbulimin e punonjësve me kontratë të përkohshme, e cila është në shumën prej 2,400 mijë lekë.

- Për Artikulli 602, “*Mallra dhe shërbime të tjera*”, kërkohet rritje prej 10% me shume se tavanet e miratuara, në shumën rreth 2,000 mijë leke, si kosto administrative për mbulimin e aktiviteteve të shtuara në veprimtarinë e Zyrës për shkak të detyrimeve që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit në strategjitë kombëtare (të pambuluara nga buxheti), dhe më konkretisht:

-Strategjia Antikorrupsion dhe Strategjia në Administratën Publike në shumën 1,000 mijë lekë

-Strategjia për edukimin Ligjor në shumën rreth 1,000 mijë lekë.

-Koston administrative për personelin e shtuar do të përballohet nga buxheti brenda taveve buxhetore. Shtesa për financim parashikohet të jete i njëjtte për do vit buxhetor 2022-2024.

- Për Artikullin 231 “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuar*”, janë parashikuar kërkesa shtesë mbi tavanet e miratuar, të prioritarizuar si me poshtë:

- “*Zhvillimin e përditësimit të Regjistrit elektronik kombëtar online për Autoritetet Publike/koordinatoreve/kërkesave për informacion*”, parashikohet të jete minimalisht në shumën **7,500 mijë lekë**, e ndarë në tre vite, ku për çdo vit kërkohet të realizohet edhe mirëmbaja e Regjistrit qendror, i instaluar në KDIMDP, si dhe për secilin Autoritet Publik.

Platformë/Portali i transparencës është portali ku qytetarët gjejnë të dhënat e të gjithë koordinatoreve të të drejtës për informim për të gjitha Autoritetet Publike në RSH, i ndërthurur me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, nëpërmjet të cilit shfaqen të gjitha kërkesat për informacion të qytetarëve si dhe krijohet mundësia e bërjes së kërkesave për informacion direkt nga ky portal. Gjithashtu, në portal shfaqen dhe ankesat e ardhura pranë Zyrës së Komisionerit. Ky regjistër është miratuar me VKM-ne nr. 145, datë 13.03.2018 (të detyrueshëm nga autoritetet publike), ku është instaluar në 27 institucione nga donatorët, si fazë e parë, ndërkohe që është përfshirë për tu zhvilluar më tej, në planin e veprimit në Strategjinë Sektoriale Antikorrupsion për vitet 2020-2023 dhe më tej, në autoritete publike. Zyra e Komisionerit, duke qenë në pamundësi buxhetore (kërkesa buxhetore të përsëritura në disa PBA radhazi gjatë vitit 2020, ka kërkuar zyrtarisht pranë institucionit të pavarur dhe atyre vendore zbatimin e këtij detyrimi i cili buron nga VKM-ja nr. 145, datë 13.03.2018 për ta instaluar këtë platforme me shpenzimet buxhetore të secilit institucion. Kjo alternative do të lehtësonte barrën e alokimit tërësisht të fondeve në buxhetin e Zyrës së Komisionerit përtej vitit 2021, pasi kostot e instalimit të kësaj platforme janë relativisht të përballueshme nga secili prej institucioneve. Informojmë se ka pasur reagim nga 22 autoritete, të cilat e kanë instaluar me fondet e tyre, gjatë vitit 2020. Gjithsesi, mbetet prioritet akordimi i fondeve shtesë, pranë Zyrës së Komisionerit, pasi nuk garantojmë zbatimin e një prej indikatorëve



me kryesore te Strategjisë Sektoriale Antikorrupsion: Instalimi i regjistrit qendror te kërkesave dhe përgjigjeve, si një nga databazat e mbikëqyrjes se garantimit te transparencës.

Detyrimi minimal për do vit (referuar strategjisë se mësipërme dhe plotësimit te indikatorit) është 25 autoritete çdo vit. duke filluar nga viti 2021. Aktualisht kjo platforme është e instaluar ne 60 autoritetet publike, ndërsa veten për vitin 2021 duhet te shtrihet edhe ne 24 te tilla, ku detyrimi ne minimumin e mundshëm për vitet 2022-2024 është 25 çdo vit. Deri ne fund te vitit 2024 detyrimi qe buron nga strategjia dhe plani i saj i veprimit është shtrirja ne 99 Autoritete publike (përfshire edhe vitin 2021), ose thëne ndryshe numri i AP, për plotësimin e këtij indikatorit, duhet te jete ***gjithsej 159 autoritete publike***, nga 60 që janë aktualisht me platforme.

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për **politikat e reja** KDIMDP:

- Nga KDIMDP planifikohet rritja e kapaciteteve njerëzorë-administrative me 16 punonjës mbështetur në detyrimet që institucioni ka për të përmbushur në lidhje me zbatimin e:

- Ligjit për mbrojtjen e te dhënave personale i harmonizuar me GDPR dhe Direktivën e Policisë;

- Ratifikimin e Konventës 108 + dhe Konventës 205/2009;

- Projektligjit "Për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", pasi me miratimin e këtij projektligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhënave Personale do te jete përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyren dhe promovimin e se drejtës për ripërdorimin e dokumenteve.

Fuqizimi i Zyrës së Komisionerit do te përfshijë edhe nivelin me te larte hierarkik te shërbimit civil, krijimin e pozicionit te Sekretarit te Përgjithshëm, pozicion i cili është parashikuar ne ndryshimet e fundit, që pritej të miratohej, me konkretisht ne projektligjin (ligji i ri) nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e te dhënave personale", i ndryshuar, neni 79 dhe 82.

Ndryshimi i numrit të punonjësve kërkon një shtesë fondi për artikullin 600 & 601 "Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërorë & shëndetësore", ne shumen 23,800 mijë leke.

Si rrjedhojë rritja e numrit të punonjësve kërkon shtesë për kosto administrative ne proporcion me numrin e shtuar te punonjësve , pra fonde shtesë për artikullin 602 "*Mallra dhe shërbime të tjera*", e cila parashikohet te jetë në shumen 10,000 mijë lekë.

- Për artikullin 231 "Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme trupëzuara", parashikohet të realizohet sipas prioriteteve:

- "Blerje pajisje kompjuterike/elektronike/instrumente/vegla/pajisje zyre", në shumën 6,000 mijë lekë për pajisjen e stafit te ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese për vitin 2022 dhe i detajuar me tej për çdo vit 2023-2024 (nëse realizohen kërkesat shtesë për burime njerëzore e financiare për vitin 2022).

- "Krijimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrit elektronik të thirrjeve te padëshiruara", i cili do te administrohet nga Zyra e Komisionerit. Ky soft parashikohet te jete ne shumën 11,000 mije leke.

**Konkluzion:**

Sa më sipër vërehet se kërkesat shtesë nga Institucioni tejkalojnë tavanet e miratuara si për shpenzimet korrente, ashtu dhe ato kapitale.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MFE, me shkresën nr. 11001/93, datë 21.06.2021 është dërguar analiza e programit buxhetor afatmesëm për vitin 2022-2024 faza e parë, për Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *ku theksi është vënë në hedhjen e të dhënave të PBA-së në sistemin AFMIS.*

**Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II<sup>të</sup> të PBA 2022-2024**

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor

Afatmesëm 2022-2024 janë miratuar me VKM nr. 440, datë 22.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, ku për Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka pasur ndryshime me tavanet fillestare të miratuara me VKM-në me nr. 119, datë 03.03.2021, edhe pse nga KDIMDP ka pasur kërkesa shtesë si për shpenzimet ekzistuese dhe për ato të reja, për të tre vitet 2022-2024.

Me shkresën nr. 1372/4 prot., datë 31.08.2021 të KDIMDP, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2022 dhe relacioni shoqërues në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”.

Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2022-2024 të hartuar nga Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2021), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Emërtimi i programit	Fakti 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
01110	Planifikim Menaxhimi	65,965	74,840	74,840	77,325

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shumica e planifikuar prej **74,840** mijë lekë për vitin 2022 në PBA është më e lartë krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2021 në shumën **9,875** mijë lekë, ose **me një rritje në masën prej 13%**.

#### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I<sup>re</sup> të PBA 2023-2025**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2023-2025”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të VKM nr. 130 datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” dhe Udhëzimit nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Me shkresën nr. 903/1, datë 01.05.2022, KDIMDP ka dërguar në MFE “Mbi dorëzimin e kërkesave të programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” (faza e parë/ strategjike).

Nga Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja.

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për *politikat ekzistuese* KDIMDP;

- Shtesë fondi, për Artikullin 600&601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore” vlerën 9,000 mijë lekë, ku shtesa e 5 (pesë) punonjësve nga një vit më parë, nuk ishte e shoqëruar me reflektimin në fondin e shpenzimeve të personelit për vitin 2022. e cilat është kërkuar nga institucioni edhe në PBA-në 2022-2024.

Shtesë Fondi për mbulimin e pesë punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë) në shumën 2,400 mijë lekë, e cilat është kërkuar nga institucioni edhe në PBA-në 2022-2024.

- Shtesë fondi për artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, në shumën rreth 5,500 mijë lekë për vitin 2023, më shumë se 30% se tavanet e miratuara, si kosto administrative për mbulimin e aktiviteteve të shtuara në veprimtarinë e Zyrës, si pasojë e detyrimeve që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit në strategjitë kombëtare (të pambuluara nga buxheti) dhe jo vetëm, detajuar në formatet respektive me një trend rritës proporcional për secilin vit buxhetor 2023-2025.

- Shtesë fondi për artikullin 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” të parashikuar me një shtesë prej 26,500 mijë lekë, mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive, për investimet sa më poshtë:

- “Blerje pajisje TIK për domein kontroller të IDI dhe mirëmbajtje”, e cila është parashikuar të jetë në shumën 18,000 mijë lekë, për vitin 2023.

- “Krijimi, zhvillimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrimit elektronik të thirrjeve të padëshiruara”. Kjo platformë është kërkuar dhe në PBA-në 2022-2024, por nuk është miratuar por është realizuar nga Institucioni me alokim fondesh nga MFE, ku është financuar pjesërisht me fond të akorduar 5.500 mijë lekë, por për shkak të vonesave të miratimit të ligjit specifik ky fond është parashikuar të mbetet i papërdorur deri në fund të vitit 2022. Nga institucioni është kërkuar, që fondi i plotë prej 11,000 milion lekë që është parashikuar si projekt, të financohet në buxhetin shtesë për vitin 2023.

- “Program aplikativ për automatizimin e proceseve të punës të Zyrës së Protokoll/arkivës”, i cili është parashikuar të ketë një kosto prej 3,000 mijë lekë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kërkuar të ndërtojë një program për automatizimin e proceseve të punës me synim administrimin efektiv të dokumentacionit brenda Institucionit. Zyra e Protokoll-Arkivit, me qëllim reduktimin dhe menaxhimin në kohën të shqyrtimit të dokumentacionit brenda afateve kohore dhe rritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj palëve të treta.

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për politikë e reja:

- Shtesë fondi, për artikullin 600 & 601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore” vlerën 23,000 mijë lekë, për shtesë në numër punonjës prej 11 vetë, e cilat është kërkuar nga institucioni edhe në PBA-në 2022-2024.

- Si rrjedhojë me rritjen e numrit të punonjësve është kërkuar shtesë për kosto administrative në proporcion me numrin e shtuar të punonjësve, pra fonde shtesë për artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, e cila parashikohet të jetë në shumën 12,000 mijë lekë.

- Shtesë fondi për artikullin 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, e cila është parashikuar me një shtesë prej 7,500 mijë lekë mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive, për investimet sa më poshtë:

- “Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/vegla/zyre”, parashikohen të jenë në shumën 6,000 mijë lekë, për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese për vitin 2023 dhe i detajuar më tej për secilin vit 2024-2025 (nëse realizohen kërkesat e vitit 2023).

- “Regjistri i subjekteve kontrollues (Mbrojtja e të dhënave)”, e cila është parashikuar të jetë në shumën 3,500 mijë lekë, pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti më pas. Platforma parashikohet të financohet me fondet e vitit 2023.

- “Dixhitalizimi i Programit të Transparencës”, e cila është parashikuar të jetë në shumën 3,500 mijë lekë, pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti më pas. Platforma parashikohet të financohet me fondet e vitit 2024.

- “Shtimi i funksionaliteteve të Regjistrimit elektronik të kërkesave për informacion”, e cila është parashikuar të jetë në shumën 2,500 mijë lekë, pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti më pas. Platforma e shtuar parashikohet të financohet me fondet e vitit 2025.

### Konkluzion:

Sa më sipër vërehet se kërkesat shtesë nga Institucioni tejkalojnë tavanet e miratuara si për shpenzimet korrente, ashtu dhe ato kapitale.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MFE, me shkresën nr. 11324/50, datë 08.06.2022 është dërguar analiza e programit buxhetor afatmesëm për vitin 2023-2025 faza e parë, për Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *ku theksi është vënë në hedhjen e të dhënave të PBA-së në sistemin AFMIS.*

### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II<sup>të</sup> të PBA 2023-2025**

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKM nr. 535 datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, ku për Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pasur ndryshime me tavanet fillestare të miratuara me VKM me nr. 130 datë 02.03.2022, si më poshtë:

000/lekë

Artikulli	Viti 2023		2024		2025	
	Strategjike	Teknike	Strategjike	Teknike	Strategjike	Teknike
Faza						
600-606	71,000	80,000	71,000	74,000	72,000	78,000
230-231	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
<b>Totali</b>	<b>72,000</b>	<b>81,000</b>	<b>72,000</b>	<b>75,000</b>	<b>73,000</b>	<b>79,000</b>

Me shkresën nr. 1338/5 prot., datë 31.08.2021 të KDIMDP, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2023 dhe relacioni shoqërues në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2023-2025 të hartuar nga Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2022), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Emërtimi i programit	Fakti 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025
01110	Planifikim Menaxhimi	78,282	81,000	75,000	79,000

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shuma e planifikuar prej **81,000** mijë lekë për vitin 2023 në PBA është më e lartë krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2022 në shumën **2,718** mijë lekë, ose **me një rritje në masën prej 3%**.

Nga Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja edhe në fazën teknike të ndryshuara nga faza strategjike përkatësisht:

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për politikat ekzistuese KDIMDP:

- Shtesë fondi, për Artikullin 600&601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore” vlerën 7,060 mijë lekë, ku shtesa e 5 (pesë) punonjësve nga një vit më parë, nuk ishte e shoqëruar me reflektimin në fondin e shpenzimeve të personelit për vitin 2022. e cilat është kërkuar nga institucioni edhe në PBA-në 2022-2024. Mungesa e financimit rezultonte edhe në tavanet e PBA 2023-2025, në fazën paraprake ( strategjike).

Shtesë Fondi për mbulimin e pesë punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë) në shumën 2,400 mijë lekë, e cilat është kërkuar nga institucioni edhe në PBA-në 2022-2024.

- Shtesë fondi për artikulli 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*”, në shumën rreth 7,500 mijë lekë për vitin 2023, më shumë se 30-40% se tavanet e miratuara, si kosto administrative për mbulimin e aktiviteteve të shtuara në veprimtarinë e Zyrës, si pasojë e detyrimeve që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit në strategjitë kombëtare (të pambuluara nga buxheti) dhe jo vetëm, detajuar në formatet respektive me një trend rritës proporcional për secilin vit buxhetor 2023-2025.
- Shtesë fondi për artikullin 231 “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*” parashikuar me një shtesë prej 35,000 mijë lekë, mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive, me një shtesë nga faza strategjike në shumën prej 8,500 mijë lekë, për investimet sa më poshtë:
  - “Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/vegla/zyre”, e cila parashikohen të jetë në shumën 3,000 mijë lekë, për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese për vitin 2023, ndërsa evidentohet si politikë e re në vitet më pas 2024-2025, sipas formateve respektive.

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për politikat e reja:

- Shtesë fondi, për artikullin 600 & 601 “*Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore*” vlerën 15,900 mijë lekë, për shtesë në numër punonjës prej 11 vetë, e cilat është kërkuar nga institucioni edhe në PBA-në 2022-2024.
- Si rrjedhojë me rritjen e numrit të punonjësve është kërkuar shtesë për kosto administrative në proporcion me numrin e shtuar të punonjësve, pra fonde shtesë për artikullin 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*”, e cila parashikohet të jetë në shumën 13,000 mijë lekë.
- Shtesë fondi për artikullin 231 “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*”, e cila është parashikuar me një shtesë prej 6,500 mijë lekë mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive, me një pakësim nga faza strategjike në shumën prej 3,000 mijë lekë, për investimet sa më poshtë:
  - “Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/vegla/zyre”, parashikohen të jenë në shumën 3,000 mijë lekë, për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese për vitin 2023 dhe i detajuar më tej për secilin vit 2024-2025 (nëse realizohen kërkesat e vitit 2023).

### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I<sup>rë</sup> të PBA 2024-2026**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dërguar kërkesat për “*Projekt Buxhetin për vitin 2024-2026*”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të VKM nr. 195, datë 05.04.2023 “*Për miratimin e taveve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026*” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 28.02.2023 “*Për përgatitjen e PBA 2024-2026*”.

Me shkresën nr. 846/1/1, datë 28.04.2024, KDIMDHP ka dërguar në MFE “*Mbi dorëzimin e kërkesave të programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026*” (faza e parë/strategjike).

Nga Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja.

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për politikat ekzistuese KDIMDP:

- Shtesë fondi, për Artikullin 600&601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore” vlerën 18,300 mijë lekë, me rreth 25 % të tavanëve indikative. KDIMDP arsyeton se në VKM nr. 195, datë 05.04.2023, “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, nuk është reflektuar financimin në paga e sigurime shoqërore për numrin e miratuar të punonjësve me ligjin e Buxhetit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe referuar Vendimit të Kuvendit nr.24/2023 “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ku numri i miratuar i punonjësve është 52, i cili është i mbuluar pjesërisht me fondin e nevojshëm të shpenzimeve të personelit për vitin 2023, ku kjo mungesa e financimit rezulton edhe në tavanet e PBA 2024-2026.

- Shtesë Fondi për mbulimin e pesë punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë) në shumën 2,800 mijë lekë, e cilat është kërkuar nga institucioni edhe në PBA-në 2024-2026.

- Shtesë fondi për artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, në shumën rreth 20,000 mijë lekë për vitin 2024, si kosto administrative për mbulimin e aktiviteteve të shtuara në veprimtarinë e Zyrës:

- Si pasojë e detyrimeve që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit për plotësimin e shumë indikatorëve të përcaktuara në disa strategji kombëtare të miratuar (të pambuluara nga buxheti) dhe legjislacionit të ri në të dy fushat e përgjegjësisë (mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informim) e përllogaritur në vlerën rreth 5,000 mijë lekë.

- Si rezultat i miratimit të ndryshimeve të reja ligjore, ku nga KDIMDP do të ndërmerret një fushatë e gjerë ndërgjegjësuese në të gjithë territorin e vendit me target grupe sektoriale të kontrolluesve dhe qytetarëve, të cilët do të njihen gjerësisht me detyrimet e risitë e reja ligjore, por ndërkohe edhe të drejtat e tyre, gjatë zbatimit të këtyre akteve, e përllogaritur në vlerën rreth 10,000 mijë lekë.

- Si kosto mirëmbajtjes së databazave shtetërore, ku Zyra e Komisionerit është administrator apo dhe programeve/softeve të implementuara në vitin 2023, e përllogaritur në vlerën rreth 5,000 mijë lekë për vitin e parë 2024, si dhe me një trend proporcional për secilin vit buxhetor 2025-2026, detajuar në formatet respektive.

- Shtesë fondi për artikullin 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” parashikuar me një shtesë prej 17,000 mijë lekë, mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive, për investimet sa më poshtë:

- “Blerje pajisje TIK për domein kontrollor të IDI dhe mirëmbajtje”, e cila është parashikuar të jetë në shumën 13,000 mijë lekë, për vitin 2024.

- “Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/ vegla/zyre”, të cilat parashikohen të jenë në shumën 4,000 mijë lekë, për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese për vitin 2024 dhe i detajuar më tej për secilin vit 2025-2026 në vlerën 3,000 mijë lekë për secilin vit.

• Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për politikat e reja:

- Shtesë fondi për artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, në shumën rreth 22,000 mijë lekë për vitin 2024, si kosto administrative për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare.

- Shtesë fondi për artikullin 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, e cila është parashikuar me një shtesë prej 14,500 mijë lekë mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive, për investimet sa më poshtë:

-“Krijimi, zhvillimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrimit elektronik të thirrjeve të pakërkuar”, e cila është parashikuar të jetë në shumën 11,000 mijë lekë, me fondet e vitit 2024. Nga KDIMDP është kërkuar dhe fonde për mirëmbajtjen vjetore, kosto e të cilës do të mbulohet nga shpenzimet operative për secilin vit PBA 2024-2026.

- “Dixhitalizimi i Programit të Transparencës”, e cila është parashikuar të jetë në shumën 3,500 mijë lekë, pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti më pas. Platforma parashikohet të financohet me fondet e vitit 2024.

### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II<sup>të</sup> të PBA 2024-2026**

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 janë miratuar me VKM nr. 456, datë 19.07.2023 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, ku kërkesat e shtesë të kërkuar nga Komisioneri në fazën strategjike nuk janë marrë parasysh.

Me shkresën nr. 1429/1 prot., datë 01.09.2023 të KDIMDHP, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2024 dhe relacioni shoqërues në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2024-2026 të hartuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2023), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Emërtimi i programit	Fakti 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
01110	Planifikim Menaxhimi	108,335	90,000	91,000	91,000

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shumica e planifikuar prej **90,000** mijë lekë për vitin 2024 në PBA është më e ulët krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2023 në shumën **17,335** mijë lekë, ose **me një ulje në masën prej 16%**.

Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja edhe në fazën teknike të ndryshuara nga faza strategjike përkatësisht:

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për politikat ekzistuese KDIMDP:
  - Shtesë fondi, për Artikullin 600&601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore” vlerën 60,500 mijë lekë, i përlllogaritur për çdo vit 2024-2026, për 60 punonjës sipas strukturës së ndryshuar.
  - Shpenzimet e parashikuara në tavanet përfundimtare si të fazës së parë dhe të dytë i referohen numrit të punonjësve në vitin 2022, prej 49 punonjësish me pagat e vjetra, duke mos marrë në konsideratë numrin aktual të punonjësve miratuar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe me tej Vendimit nr. 24/2023 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikes dhe klasifikimit të pagave të Komisionarit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ku është miratuar struktura me një numër prej 60 punonjësish.
  - Shtesë fondi për artikullin 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” parashikuar me një shtesë prej 22,000 mijë lekë, mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive, me një shtesë nga faza strategjike në shumën prej 5,000 mijë lekë, për “Blerje

Automjeti”.

**Konkluzion:**

- Nga grupi i auditimit u konstatua se, PBA-së 2022-2024; 2023-2025 dhe 2024-2026 e përgatitura nga KDIMDP në të dy fazat strategjike dhe teknike janë paraqitur kërkesa buxhetore në tejkalim të tavanit të miratuar.

Gjithashtu kërkesat shtesë buxhetore kanë ndryshuar nga faza strategjike në fazën teknike, duke shtuar politika te reja dhe duke ndryshuar vlerat e politikave ekzistuese për të cilat nuk ka argumente dhe një analizë pse kanë ndryshuar kërkesat, si dhe indikatorët të qartë mbi përlllogaritjen e kërkesave shtesë të bëra nga KDIMDP, në fazën teknike.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 3 “Hapat ndërinstitucionale për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm” ku përcakton se:

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm bëhet në dy faza:

- Faza e parë e përgatitjes së projekt-dokumentit të programit buxhetor afatmesëm njihet si faza strategjike:

- Vendimet më të rëndësishme në nivel strategjik dhe buxhetor, do të merren gjatë fazës strategjike dhe do të përkthehen në tavane të qëndrueshme dhe të pandryshueshme të shpenzimeve që duhet të respektohen gjatë fazës teknike. Është gjithashtu e rëndësishme që të gjitha vendimet kryesore strategjike/prioritare për financimin e politikave të reja të merren gjatë fazës strategjike, duke përfshirë dhe vendimet për investime të reja publike.

- Faza e dytë e përgatitjes së dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm quhet faza teknike e përgatitjes së buxhetit (vjetor):

Duke marrë parasysh që vendimet strategjike për buxhetin afatmesëm merren gjatë fazës së parë të përgatitjes së buxhetit, **objektivi i fazës së dytë është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavaneve të qëndrueshme të shpenzimeve të vendosura gjatë fazës strategjike**. Objektivi kryesor i kësaj faze është të sigurojë që vendimet e marra gjatë fazës strategjike të zbatohen dhe që ligji vjetor i buxhetit të përgatitet në mënyrë efektive.

- Nga analiza e zërave të investimeve të parashikuara në PBA ka një mospërputhje të ndarjes së tyre mes politikave të reja dhe atyre ekzistuese, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 4.5 “Hapat për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit” paragrafi 3.4 “Ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja”, si dhe udhëzimet plotësuese vjetore “Për përgatitjen e dokumenteve të PBA-së”, pika 3.

- Sipas Udhëzimeve plotësuese vjetore për “Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”, ku përcakton se “Të gjitha njësitë e Qeverisjes Qendrore, do të përgatisin kërkesa buxhetore për PBA-të, përmes sistemit AFMIS dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM. Raportet e kërkesave buxhetore të gjeneruara përmes sistemit AFMIS do të dorëzohen zyrtarisht në Ministrinë përgjegjëse për financat”, nga auditimi u konstatua se KDIMDP ka përgatitur kërkesave buxhetore për fazën strategjike dhe teknike jashtë sistemit AFMIS dhe PIM, me argumentin e ruajtjes së të dhënave personale si dhe ka cituar se:

Zyra e Komisionerit ka patur komunikime zyrtare nga periudha e implementimit të sistemit AFMIS, ku citojnë se: Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit ka ushtruar një hetim administrativ në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale për sistemin AFMIS dhe jo vetëm, ku me Rekomandimin nr. 20, datë 26.04.2023 i është rekomanduar:

*Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë marrjen e masave për përpunimin e të dhënave të përdoruesve gjatë autentifikimit në sistemin AFMIS, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore*



*të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, duke ofruar një mënyrë që shmang përdorimin e llogarive personale të krijuara për një qëllim tjetër...”. Për sa më sipër, deri në plotësimin e këtij detyrimi, Zyra e Komisionerit do të mbetet jashtë sistemit AFMIS.*

- Nga auditimi u konstatua se në asnjë nga PBA e përgatitura nga KDIMDP nuk janë përgatitur tregues performace gjinore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; udhëzimit të përbashkët nr. 21 datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm, si dhe Udhëzimeve plotësuese vjetore par “Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 9/a.

- Nga auditimi u konstatua se projektet të cilat janë kërkuar në PBA 2022-2024, të cilat nuk janë miratuar dhe realizuar në buxhetin vjetor 2022, nuk janë kërkuar si projekte për tu realizuara në 2023-2025, por janë shtuar projekte të reja. Veprime në kundërshtim me udhëzimin MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Po ashtu dhe nga krahasimi i projekteve të PBA 2023-2025 me atë të PBA 2024-2026 ka ndryshime në lidhje me projektet, çka tregon se objektivat dhe qëllimet për të cilat janë bërë kërkesat për fonde shtesë në lidhje me këto projekte nuk kanë qenë të mbështetura në nevoja reale të institucionit për këto projekte, në një analizë e detajuar prioritizimi, duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, veprime në kundërshtim me nenin 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, mungon një evidencë e dokumentuar mbi analizën e kërkesave buxhetore shtesë bërë nga strukturat përkatëse të KDIMDP, listimin e tyre sipas prioriteteve më emergjente dhe rekomandimet e përcjella prej tyre në strukturën përkatëse, si në Kryeministri për koordinimin e strategjive, si dhe korrespondenca me këtë strukturë.

***b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.***

### **Viti 2021**

Në zbatim të Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Me shkresën nr.24318/1, datë 14.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të shkresës nr. 1636/1, prot datë 24.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dërguar miratimi i detajimit të fondeve buxhetore për **shpenzimet korrente**, në vlerën 77,000 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 6075, datë 02.04.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar miratimi i detajimi të fondeve buxhetore për **shpenzimet kapitale**, në vlerën 1,000 mijë lekë.

- Me shkresën nr.7527/1, datë 06.05.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të shkresës nr. 780/11, prot., datë 23.04.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dërguar miratimi i detajimit të fondit të veçantë, në vlerën 250 mijë lekë.

### **Ndryshimet buxhetore:**

- Pas kërkesës së KDIMDP me nr. 893, datë 12.05.2021 drejtuar Ministrisë së Financës për rishpërndarjen e fondeve, brenda sistemit nga llogaria ekonomike 606 “Trans për Buxhet Familjar & Individ” në llogarinë ekonomike 602 “Mallra dhe Shërbime të Tjera” të shumës prej 60 mijë

leke. Kjo kërkesë ka ardhur në zbatim të Vendimin nr. 673, date 02.09.2020 te Këshillit te Ministrave, "Për pajisjen me numër telefoni celular te funksionareve publike", i ndryshuar me VKM-në me nr. 855, datë 04.11.2020, pika 14 "Për ofrimin e shërbimit për funksionarët e përcaktuar në pikat 5–12 të këtij vendimi lidhet kontratë individuale me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm, që veprojnë në vend, për një numër të vetëm celular ose njësitë e qeverisjes së përgjithshme lidhin kontratë me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm, që veprojnë në vend sipas legjislacionit në fuqi. Detyrimi financiar, në rastin kur lidhet kontratë individuale, paguhet nga funksionari, i cili kompensohet nga institucioni, kundrejt dokumentit të blerjes së shërbimit të numrit telefonik celular, por jo më shumë se kufijtë përkatës mujorë. Detyrimi financiar, në rastin kur lidhet kontratë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, paguhet për shërbimin e ofruar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, sipas faturës mujore për vlerën e shpenzuar", ku si rezultat i këtij ndryshimi detyrimet do të paguhen nga llogari 602 "Mallra dhe Shërbime të Tjera".

- Ndryshimet si rezultat i aktit normative nr. 34, datë 03.12.2021, dërguar me shkresën nr. 21918/5, datë 09.12.2021 nga MFE, ku kërkon nga institucioni që brenda datës 10.12.2021 të dërgohen zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike, detajimi i shtesave dhe pakësimeve të planit të rishikuar të buxhetit 2021, për shpenzime korrente dhe për shpenzime kapitale, sipas klasifikimeve buxhetore deri në nivel artikulli dhe produkti.

- KDIMDP me shkresën nr. 2054/2, datë 14.12.2021 ka dërguar në MFE, planin e detajuar për shpenzime korrente (i ndryshuar), ku kemi pakësim të llogarisë ekonomike 600 në shumën 7,500 mijë lekë, llogarisë 601 në shumën 1,000 mijë lekë dhe llogarisë 602 në shumën 3,000 mijë lekë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 21918/94, datë 22.12.2021 dërgon miratimin e detajimit të ndryshimeve sipas planit të rishikuar të buxhetit.

- Për shpenzimet kapitale për investime, në PBA 2021-2022 është parashikuar një buxhet prej 1,000 mijë lekë, dhe është alokuar kjo shumë, duke mos pësuar ndryshime gjatë vitit.

## **Viti 2022**

Në zbatim të Ligjit nr.115, datë 16.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit";

- Me shkresën me nr.22922/101, datë 18.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të shkresës nr. 2180/1, prot., datë 05.01.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dërguar miratimi i detajimit të fondeve buxhetore për **shpenzimet korrente**, në 71,840 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 6063, datë 04.04.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar miratimi i detajimi të fondeve buxhetore për **shpenzimet kapitale**, në vlerën 6,500 mijë lekë.

- Për projektin ekzistues "Blerje pajisje zyre & Kompjuterike/elektronike/vegla e instrumente" në vlerën 1,000 mijë lekë dhe për:

- Projektin e ri për "Regjistrin elektronik te thirrjeve të pakërkuara", i cili është çelur si fondi i ngrirë në vlerën prej 5,500 mijë lekë, ku nga MFE arsyetohet se nga KDIMDP nuk është bërë përditësimi i kërkesave buxhetore për vitet 2022-2024, me buxhetin e miratuar, ne sistemin AFMIS, respektivisht ne modulën e PBA dhe atë te PIM, sikurse është kërkuar nga MFE me Shkresën nr.22128, prot, datë 10.12.2021.

- Me shkresën nr. 1481/2, datë 02.02.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të shkresës nr. 191, prot., datë 25.01.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dërguar miratimi i detajimit të fondit të veçantë, në vlerën 250 mijë lekë.

### **Ndryshimet buxhetore:**

Fondet buxhetore kanë pësuar ndryshime si rezultat:

- Me Aktin Normativ, nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i KDIMDP-së, është pakësuar në vlerën totale 4.878 mijë lekë konkretisht në zërin “Paga dhe Sigurime” në vlerën 1,346 mijë lekë për paga dhe në zërin 602 “Mallra dhe shërbime” në vlerën 3,532 mijë lekë. Pakësimi u konkretizua në uljen e shpenzimeve të parashikuara për mbulimin e aktiviteteve jashtë apo brenda vendit, të cilat kanë dhe mund të ndikojnë në realizimin e treguesve sasiorë.

- Kërkesës së KDIMDP me nr. 985, datë 12.05.2022 drejtuar Ministrisë së Financës për shtesë fondesh për vitin 2022 me argumentin se: Ne zbatim të Ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", si dhe akteve administrative në zbatim të tij, Zyrës së Komisionerit i janë akorduar fondet buxhetore për funksionimin e aktivitetit institucional dhe miratuar numri i përgjithshëm prej 44 punonjësish. Me Vendimin e Kuvendit nr. 84/2020 "Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 "Për miratimin e strukturës, organikes dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i është miratuar struktura dhe organigrama e kësaj Zyre, e cila krahasuar me vitin 2020 është shtuar me 5 punonjës. Në buxhetin e Zyrës së Komisionerit për vitin 2022, konstatohet se fondi i miratuar për shpenzimet e personelit, nuk ka reflektuar mbulimin financiar të shtesës së punonjësve, mangësi e cila është prezantuar dhe në kërkesat buxhetore të projekt buxhetit Afatmesëm 2022-2024 e ne vijim, si dhe në të tjera komunikime administrative për buxhetin 2022. Nisur nga të dhënat e realizuara deri më 30 Prill 2022, konfirmuar nga Dega e thesarit, si dhe me reduktimin e shpenzimeve të personelit me “Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022", i cila ka thelluar mungesën e fondeve të personelit dhe në mënyrë proporcionale dhe mbulimin e shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është kërkuar shtesë fondi për shpenzime personeli në vlerën 6,500 mijë lekë dhe shtesë për shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 600 mijë lekë, ku ndryshimi është bërë bazuar:

- Në Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, buxheti i KDIMDP është shtuar me 7,000 mijë lekë për llogarinë ekonomike 600 dhe njëkohësisht numri i të punësuarve është rritur me 5 persona, pra në total numri i punonjësve për KDIMDP-në është 49 punonjës.

- Kërkesës së KDIMDP me nr. 1827, datë 08.11.2022 drejtuar Ministrisë së Financës për rialokim fondesh nga shpenzime të personelit në shpenzime operative për mallra dhe shërbime, ku fondi i rialokuar do të përdoret jo vetëm për mbulimin financiar të aktiviteteve të shtuara, si rezultat i funksioneve dhe kompetencave shtese të Zyrës së Komisionerit, por edhe për shkak të rëndësisë dhe intensitetit në vijim të takimeve që do të zhvillohen në Bruksel, në kuadër të procesit të integritetit evropian. Me shkresën e MFE me nr. 20723/1, datë 17.11.2022 është dërguar miratimi i transferimeve të fondeve nga llogaria ekonomike 600 në llogarinë ekonomike 602 për vlerën 4,000 mijë lekë.

- Me Aktin Normativ, nr. 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, buxheti i KDIMDP-së, është bërë rialokim fondi nga njëri projekt në tjetrin, duke çngurtësuar fondin e ngrirë për "Regjistrin elektronik të thirrjeve të pakërkuara", i cili është çelur në fillim të vitit si fondi i ngrirë në vlerën prej 5,500 mijë lekë, nga të cilat 3,500 mijë lekë nga ky fond kanë kaluar për “Blerje pajisje kompjuterike/ elektronike, instrumente/vegla/ zyre” dhe ky fond është pakësuar në vlerën për 2,000 mijë lekë.

- Rritje të llogarisë ekonomike 606 në shumën prej 540,000 lekë në zbatim të VKM-së me nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës”, miratuar

akordimi i fondit nga MFE me shkresën nr. 120/1, datë 09.01.2023 në mbështetje të kërkesës nr. 15, datë 04.01.2023 të KDIMDP, i alokuar tek fondi i veçantë.

### **Viti 2023**

Në zbatim të Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Me shkresën me nr. 23774/43, datë 20.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të shkresës nr. 01/1, prot datë 04.01.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dërguar miratimi i detajimit të fondeve buxhetore për **shpenzimet korrente**, në vlerën 90,330 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 22851/160, datë 13.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar miratimi i detajimi të fondeve buxhetore për **shpenzimet kapitale**, në vlerën 6,000 mijë lekë, për Projektin “Blerje programe softje (Sistemi elektronik i menaxhimit e praktikave dhe të dhënave)”.

- Me shkresën nr. 23774/162, datë 14.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të shkresës nr. 264, prot., datë 31.01.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dërguar miratimi i detajimit të fondit të veçantë në vlerën 250 mijë lekë.

### **Ndryshimet buxhetore:**

Fondet buxhetore kanë pësuar ndryshime si rezultat:

- Kërkesës së KDIMDHP me nr. 963, datë 18.06.2023 drejtuar Ministrisë së Financës për rialokim fondesh brenda shpenzimeve kapitale nga projekti “Blerje programe softje” në “Blerje pajisje zyre & Kompjuterike/elektronike/vegla e instrumente” të vlerës prej 600 mijë lekë, për faktin e rritjes së numrit të punonjësve dhe plotësimin me pajisjet e nevojshme për vijueshmërinë e punës, ku MFE me shkresën nr. 9156/1, datë 26.05.2023 miraton transferimin e fondeve kapitale.

- MFE me shkresën nr. 11802/1, datë 11.07.2023 ka akorduar fonde shtesë si rezultat i rritjes së pagave në vitin 2023, referuar VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagën të zëvendësministrit, funksionarëve të kabinetit, prefektit e nënprefekti, nëpunës civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” dhe VKM-së me nr. 326 datë 31.05.2023 ”Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialistëve të ndryshëm në disa institucione administratës publike” në vlerën prej 18,500 mijë lekë.

- Kërkesës së KDIMDP me nr. 946/6, datë 24.10.2023 drejtuar Ministrisë së Financës për rialokim fondesh nga llogaria ekonomike 600 shpenzime personeli të papërdorura si rezultat i mosplotësimit me personel i strukturës së miratuar, në llogarinë ekonomike 602. me qëllim mbulimin e shpenzimeve operative në funksion të organizimit të konferencës së 15 Ndërkombëtare ICIC, ku MFE me shkresën nr. 19413/3, datë 06.11.2023 miraton rialokimin e fondeve në vlerën prej 5,000 mijë lekë.

- Me Aktit Normativ, nr. 6, datë 14.12.2023 “Për disa ndryshime në Ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, buxheti i KDIMDP-së, dhe në mbështetje të shkresës së KDIMDP me nr. 2347/1, datë 20.12.2023 është pakësuar në vlerën totale 5,500 mijë lekë konkretisht në zërin “Paga dhe Sigurime”.

- Kërkesës së KDIMDP me nr. 82, datë 11.01.2024 drejtuar Ministrisë së Financës për shtesë fondesh në vlerën prej 742 mijë lekë, në zbatim të VKM-së me nr.795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis

(screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”, ku MFE me shkresën nr. 568/1, datë 15.01.2024 ka miratuar fondin për buxhetin e 2023.

### c. Realizimi i planit të buxhetit

#### Viti 2021

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2021 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	50,226	42,726	42,142	99%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	8,300	7,300	6,987	96%
602. Mallra dhe shërbime	18,134	15,074	13,491	89%
603.Subvencion	0	0	0	
604. Transferta të brendshme		0		
605. Transferta të jashtme	100	100	74	74%
606. Transferta për familjet dhe individët	240	300	289	96%
606. Fondi i veçantë	200	200	80	40%
231.Investim me financim të brendshëm	1,000	1,000	995	100%
231.Investim me financim të huaj	0	0	0	
<b>TOTALI</b>	<b>78,200</b>	<b>66,700</b>	<b>64,058</b>	<b>94%</b>
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit	9,271	9,271	1,125	12%
Investime nga të ardhurat jashtë limitit	29,146	29,146	4,723	16%
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp. nga të ardhura jashtë limitit)</b>	<b>116,617</b>	<b>105,117</b>	<b>69,906</b>	<b>67%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KDIMDP

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 në KDIMDHP është realizuar në masën 94% ndaj buxhetit me ndryshime.

- Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore. është realizuar për numrin faktik të punonjësve (38) përkundrejt 44 punonjës të miratuar, **si dhe punonjësve jashtë strukturës**, në vlerën 42,142 mijë lekë ose 99 %. Për sa i përket kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është realizuar në vlerën 6,987 mijë lekë ose 96% e planifikimit. Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e nisjes me vonesë të rekrutimeve dhe emërimeve në pozicionet e rregullta, për shkak të situatës zgjedhore dhe parashikimeve në kodin zgjedhor (pezullimi i përkohshëm i procedurave të rekrutimeve të reja) apo edhe të lëvizjeve për periudhën deri 4 muaj përpara procesit zgjedhor.

- Fondi për Shpenzime Korrente “Mallra dhe shërbime” për periudhën Janar-Dhjetor 2021, është realizuar në vlerën 13,491 mijë lekë përkundrejt planit vjetor 15,074 mijë lekë rreth 89 % e fondit të planifikuar vjetor për vitin 2021. Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e pezullimit tërësisht të aktiviteteve jashtë vendit apo edhe inspektimeve në terren (kufizuar vetëm në Tiranë dhe jo jashtë saj), si pasojë e vijimit të situatës së krijuar nga përhapja e covid-19, por edhe procesit të ristrukturimit dhe mungesës së stafit.

- Fondi për shpenzime investime është realizuar në vlerën 995 mijë lekë ose 99.5 %.

• Nga të ardhurat jashtë limiti nga KDIMDP janë përdorur për:

- Shpenzime operative në vlerën 1,125,953 lekë;

-Shpenzime kapitale në vlerën 4,723,680 lekë, përkatësisht për blerje “Automjeti” në vlerën 3,583,200 lekë dhe për blerje “Zhvillim i sistemit elektronik te kërkesave dhe përgjigjeve” në vlerën prej 1,140,480 lekë.

#### Viti 2022

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2022 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	45,540	47,402	47,017	99%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	8,300	8,092	7,785	96%
602. Mallra dhe shërbime	17,660	18,128	18,084	99.7%
603.Subvencion	0			
604. Transferta të brendshme				
605. Transferta të jashtme	100	100	74	74%
606. Transferta për familjet dhe individët	240	240	240	100%
606. Fondi i veçantë	250	790	670	85%
231.Investim me financim të brendshëm	6,500	4,500	4,412	98%
231.Investim me financim të huaj				
<b>TOTALI</b>	<b>78,590</b>	<b>79,252</b>	<b>78,282</b>	<b>99%</b>
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit	8,156	8,156	1,677	21%
Investime nga te ardhurat jashtë limitit	24,423	24,423	92	0.4%
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga të ardhura jashtë limitit)</b>	<b>111,169</b>	<b>111,831</b>	<b>80,051</b>	<b>72%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KDIMDP

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 në KDIMDP është realizuar në masën 99% ndaj buxhetit me ndryshime.

- Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore. është realizuar për numrin faktik të punonjësve në strukture dhe jashtë saj ( 41+5 ), përkundrejt 44 punonjës të miratuar, në vlerën 47,017 mijë lekë ose 99 %. Për sa i përket kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është realizuar në vlerën 7,785 mijë lekë ose 96% e planifikimit.

- Fondi për Shpenzime Korrente “Mallra dhe shërbime” për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është realizuar në vlerën 18,084 mijë lekë përkundrejt planit vjetor 18,128 mijë lekë rreth 99.7 % e fondit të planifikuar vjetor për vitin 2022.

- Fondi për shpenzime investime është realizuar në vlerën 4,412 mijë lekë ose 98 %, ku është realizuar projekti “Blerje pajisje zyre & Kompjuterike/elektronike/vegla e instrumente” në vlerën 4,412 mijë lekë.

• Nga të ardhurat jashtë limiti nga KDIMDP janë përdorur për:

- Shpenzime operative në vlerën 1,167 mijë lekë;

-Shpenzime kapitale në vlerën 91,200 lekë, përkatësisht për blerje “Projekt/preventiv zbatimit për rikonstrukcion te zyrave te KDIMDP”.

## Viti 2023

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2023 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600. Paga	62,140	70,382	70,177	99.7%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	12,630	11,130	11,014	99%
602. Mallra dhe shërbime	17,220	22,220	20,738	93%
603.Subvencion				
604. Transferta të brendshme				
605. Transferta të jashtme	100	100	66	66%
606. Transferta për familjet dhe individët	240	240	240	100%
606. Fondi I vecante	250	250	100	40%
231.Investim me financim të brendshëm	6,000	6,000	6,000	100%
231.Investim me financim të huaj				
<b>TOTALI</b>	<b>98,580</b>	<b>110,322</b>	<b>108,335</b>	<b>98%</b>
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit	6,480	8,156	2,900	36%
Investime nga te ardhurat jashtë limitit	24,332	24,423	6,962	29%
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga të ardhura jashtë limitit)</b>	<b>129,391</b>	<b>142,901</b>	<b>118,197</b>	<b>83%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KDIMDP

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 në *KDIMDP* është realizuar në masën 98% ndaj buxhetit me ndryshime.

- Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore. është realizuar për numrin faktik të punonjësve 52, përkundrejt 60 punonjës të miratuar në strukture, në vlerën 81,191 mijë lekë ose 99 %, e fondit të planifikuar vjetor për vitin 2023.

- Fondi për Shpenzime Korrente “Mallra dhe shërbime” për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është realizuar në vlerën 20,738 mijë lekë, përkundrejt planit vjetor 22,220 mijë lekë rreth 93 % e fondit të planifikuar vjetor për vitin 2023.

- Fondi për shpenzime investime është realizuar në vlerën 6,000 mijë lekë ose 100 %, ku është realizuar projekti M890008 “Blerje Softe/sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave”, në vlerën 5,400 mijë lekë dhe projekti 18AD102 “*Blerje pajisje zyre & Kompjuterike/elektronike/vegla e instrumente*”, në vlerën 600 mijë lekë.

• Nga të ardhurat jashtë limiti nga *KDIMDP* janë përdorur për:

- Shpenzime operative në vlerën 2,900 mijë lekë;

- Shpenzime kapitale në vlerën në vlerën 6.691.552 lekë, përkatësisht për blerje “Rikonstruksion/Riparime i Godinës se *KDIMDP*”.

### **Konstatim:**

- Për vitin 2022 nga *KDIMDP* është realizuar investimi “*Rikonstruksion/Riparime i Godinës se KDIMDP*”, investim i cili nuk është planifikuar në PBA 2022-2024.

Veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7;

Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1, ku përcakton se “*Të gjitha projektet e investimeve të reja duhet të përgatiten përmes formatit të propozimit të politikave të reja dhe të ndjekin procedurat e përgjithshme të shqyrtimit dhe miratimit të tyre*”.

- Si dhe paragrafin 7.2 “*Projektet e reja të investimeve duhet t'i paraqiten ministrisë përgjegjëse për financat gjatë procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Pas kësaj, në procesin e përgatitjes së PBA-së, ministria përgjegjëse për financat përgatit listën e projekteve të propozuara rishtazi të investimeve të renditura sipas prioriteteve të tyre duke pasqyruar rëndësinë dhe relevancën e projektit specifik për zhvillimin e vendit*”.

- Udhëzimit nr.9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 64 dhe pika 203.

### **Nga auditimi i te ardhurave të trashëguara rezultoi se:**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në datat 21-24 tetor 2019, ka qenë organizatore e Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (*International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners - ICDPPC*), e cila u zhvillua në mjediset e Pallatit të Kongreseve në Tiranë.

Aktiviteti i zhvilluar ka qenë me tarifë pjesëmarrjeje, ku për këtë arsye nga *KDIMDP* është lidhur kontrata e shërbimit me shoqërinë *E- T. S. shpk* me objekt “Ofrimi i një infrastrukture/platforme shërbimi të ndërtuar dhe të gatshme për përdorim”, ku përmes kësaj platforme janë arkëtuar të gjitha tarifat për pjesëmarrje në vlerën totale prej 26,278,508 lekë, si dhe “të tjera tarifa regjistrimi në bankë” në vlerën 10,988,491 lekë.

Kjo vlerë nga KDIMDP është trajtuar si donacion, por në fakt vlera prej 37,266,999 lekë përbën të ardhura nga aktiviteti, i cili është financuar nga buxheti i shtetit.

KDIMDP ka arkëtuar dhe donacione nga donatorë vendas dhe të huaj në vitin 2019 në shumën prej 20,718,782 leke dhe në vitin 2020 në shumën prej 5,851,540 lekë.

Për vitin 2019 janë arkëtuar në total 57,985,781 lekë, nga të cilat referuar informacionit të dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, nga këto të ardhura me qëllim menaxhimin e konferencës janë përdorur rreth 25,193,635 lekë.

Nga auditimi i shpenzimeve të realizuara nga KDIMDP për vitin 2021-2023 rezultoi se nga këto të ardhura janë përdorur për blerje pajisje zyre (mobilje, pajisje kompjuterike et); për *“Rikonstruksion/Riparime i Godinës së KDIMDP”*, si dhe për shpërblime për stafin e KDIMDP përkatësisht:

- Për vitin 2021 në vlerën 1,125 mijë për shpenzime korrente dhe 4,723 mijë, për investime e ndarë sipas zërave:

Në lekë

Kapitulli 602		Kapitulli 231	
Vidio sensor	120,000	Blerje Automjeti	3,583,200
Pagese eksperte për procedurën e prokurimit blerje makine	37,825	Blerje “S... P... Site Licencë 24 copë”	1,140,480
Tatimi ne burim	12,628	<b>Totali</b>	<b>4,723,680</b>
Pagesa për platformën Zoom	98,730		
pagesa për platformën Zoom shtator	21,270		
Tatim burim	19,500		
Shpërblime stafi	816,000		
<b>Totali</b>	<b>1,125,953</b>		

- Për vitin 2022 në vlerën 1,677 mijë lekë mijë për shpenzime korrente dhe 92 mijë për investime e ndarë sipas zërave:

Në lekë

Kapitulli 602		Kapitulli 231	
Tatim burim për shpërblimet e vitit 2021	144,000	Projekt par rikonstruksionin e godinës	92,000
Qera Salle	60,000	<b>Totali</b>	<b>92,000</b>
Pagës par përkthimin e raportit vjetor	45,110		
Shpenzime për pritje përcjellje	237,974		
pagese eksperte për procedurën e prokurimit "Rikonstruksion godine"	39,958		
Shpërblime stafi	1,150,000		
<b>Totali</b>	<b>1,677,042</b>		

- Për vitin 2023 në vlerën 2,900 mijë lekë mijë për shpenzime korrente dhe 6,962 mijë për investime e ndarë sipas zërave:

Në lekë

Kapitulli 602		Kapitulli 231	
Pagesë për panairi Infest 2023	500,000	Rikonstruksioni i godinës KDIMDP	6,497,667
Shpërblime stafi	2,400,000	Mbikëqyrje punimesh rikonstruksion godine	163,435
<b>Totali</b>	<b>2,900,000</b>	Kolaudim punime për rikonstruksionin	14,850
		Blerje mobilje	262,800
		Hartim projekt preventivi	22,800



Sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të tre vitet objekt auditimi ka përdorur të ardhurat e trashëguara (nga donacionet; të ardhura nga tarifat e regjistrimit dhe të ardhura nga tarifat e pjesëmarrjes së Konferencës së 41-të Ndërkombëtare që nga viti 2019), pa marrë më parë autorizim nga Ministria e Financës.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat:

204. Kryerja e shpenzimeve nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit evidentohet me strukturë të veçantë buxhetore, sipas autorizimit që bën struktura përgjegjëse për thesarin në përputhje me të ardhurat e realizuara në fakt.

Përdorimi i të ardhurave pika:

**224.** Pas miratimit të akt-rakordimit, nëpunësi zbatues i njësisë, në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave me njësitë e qeverisjes qendrore, *përgatit “Kërkesën për rritje të autorizuar”*.

**225.** Kërkesa për rritje të autorizuar përbëhet nga dy pjesë: në pjesën e parë specifikohet struktura buxhetore e arkëtimit të të ardhurave, e cila konfirmohet nga struktura përgjegjëse e thesarit në degë dhe struktura përgjegjëse e njësisë së qeverisjes së përgjithshme, ndërsa në pjesën e dytë specifikohet struktura buxhetore në të cilën do të alokohet e ardhura, rritja e kërkuar për secilin artikull dhe totali i rritjes së kërkuar.

**226.** Për të ardhurat jashtë limitit, kërkesa për rritje të autorizuar nënshkruhet nga Titullari i njësisë së qeverisjes së përgjithshme ndërsa për të ardhurat brenda buxhetit të miratuar (brenda limitit) kërkesa nënshkruhet nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe dërgohet tek struktura përgjegjëse për thesarin në degë.

### ***Mbi marrjen e donacioneve në kushtet e konfliktit të interesit***

Neni 38 i Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, përcakton se Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë, *të cilët nuk paraqesin konflikt interesit*.

Nga auditimi rezultoi se janë arkëtuar dhe donacione nga subjekte vendas përkatësisht: A.; M. C. A.; A. B.; A. M. S./ T. dhe A. të cilat janë subjekte kontrolli nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Referuar planeve vjetore të miratuara, fokusi i hetimeve administrative të kryera nga Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave, rezulton, si më poshtë:

**Për vitin 2021**, kryerja e hetimeve administrative në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit;

**Për vitin 2022**, kryerja e hetimeve administrative pranë kontrolluesve që operojnë në këta sektorë:

- *Spektori i marketingut të drejtpërdrejtë;*
- *Spektori i sigurimeve;*
- *Spektori call-center;*
- *Kompanitë private të programimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve që kanë marrëveshje me AKSHI;*
- *Institucione financiare jobankare;*
- *Kontrolluesit e mëdhenj publik që përdorin të dhëna personale të llojit “Big data”.*

**Për vitin 2023:**

1. Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në sferën publike dhe private me fokus të veçantë në:

- *Sektorin financiar jobankar;*

- Sektorin e administrimit dhe ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme (real estate);
- 2. Hetime administrative tematike pranë kontrolluesve që i përkasin sektorëve:
  - Sektori i arsimit (parashkollor, bazë dhe i mesëm);
  - *Sektori i marketingut të drejtpërdrejtë;*
  - Shoqëritë ofruese të shërbimeve IT;
  - Sektori i shërbimit postar privat.

Nga auditimi i aktivitetit të Drejtorisë së Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave, përgjatë viteve ushtrimore 2021 – 2023, u konstatua se:

1. Sa i përket **sektorit të institucioneve financiare jobankare**, KDIMDP ka kryer hetime administrative, si më poshtë:

- F.I. – Rekomandimi nr. 49 – 2021;
- S. C. – Rekomandimi nr. 50 – 2021;
- E. P. – Rekomandimi nr. 1 – 2023;
- M. F. – Rekomandimi nr. 2 – 2023.

Nga auditimi u konstatua se Zyra e KDIMDP ka pranuar donacion në vlerën 75,000 lekë nga shoqëria “M. C. A.” dhe 75,000 lekë nga shoqëria “A. D. C. A.”, subjekte të hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin e institucioneve financiare jobankare.

2. Sa i përket sektorit të **call center**, KDIMDP ka kryer hetime administrative, si më poshtë:

- F. A. – pa vendimmarrje;
- F.I. – Vendim nr. 55 – 2022;
- B. – Vendim nr. 70 – 2022.

Nga auditimi u konstatua se Zyra e KDIMDP ka pranuar donacion në vlerën 609,700 lekë nga shoqëria “A. M. S. - T.”, subjekt i hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin e *call center*.

3. Sa i përket **sektorit të telekomunikacionit**, KDIMDP ka kryer hetime administrative, si më poshtë:

- V. A. – Vendim nr. 02 – 2021;
- A. – Rekomandim nr. 22 – 2021;
- O. T. – Rekomandim nr. 24 – 2021.

Nga auditimi u konstatua se Zyra e KDIMDP ka pranuar donacion në vlerën 245,320 lekë nga shoqëria “A.”, subjekt i hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin e telekomunikacionit.

4. Sa i përket **sektorit bankar**, KDIMDP ka kryer hetime administrative, si më poshtë:

- B.. – Rekomandim nr. 17 – 2023.

Nga auditimi u konstatua se Zyra e KDIMDP ka pranuar donacion në vlerën 363,780 lekë nga shoqëria “A. B.”, subjekt i hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin bankar.

Sa më sipër, duke shtuar faktin se KDIMDP nuk ka një metodologji të përcaktuar dhe një proces transparent të përzgjedhjes së subjekteve në bazë risku për ushtrimin e hetimeve administrative me fokus mbrojtjen e të dhënave, pranimi nga ana e KDIMDP i sponsorizimeve/ donacioneve të ardhura nga subjekte kontrolluese të të dhënave, sipas përcaktimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, konsiderohet në kushtet e konfliktit të interesit, duke cënuar paanshmërinë dhe objektivitetin e funksionit kontrollues të Zyrës së KDIMDP.

*Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi z. B. D. me detyrë Komisioner dhe znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

## 2.3 Auditimi i llogarive vjetore.

### a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndrydhime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga KDIMDP, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit. PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2023 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 590, datë 27.03.2024 “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2023” për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së

Thesarit.

***b. Saktësia dhe rregullueshmëria e pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara  
Auditimi i llogarive performancës financiare***

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirmo rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2022 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 108,133 mijë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 107,495 mijë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 639 mijë lekë

---

Totali ii + iii = 0 lekë

Nga auditimi i zërave të shpenzimeve rezulton se në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës” është pasqyruar dhe reflektuar ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën prej (639,218) lekë, veprime në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika “Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve.

Nga auditimi i shpenzimeve në “Pasqyra e Performancës” **rezultoi:**

Nga auditimi i llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” rezultoi se nga KDIMDP është bërë blerje:

- Materiale zyre/rafte metalike në vlerën 96,000 lekë, e cila ka të bëjë me aktive afatgjata dhe jo me materiale konsumi. Nga KDIMDP kjo vlerë është regjistruar si shpenzim.

Nga KDIMDP duhet të ishte debituar llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe me marrjen në dorëzim të mallrave duhet të ishte kapitalizuar në llogarinë 21 “Aktive afatgjata materiale”.

- Materiale zdruktharie për zyrat “Batiskop 200ML” në vlerën 339,840 lekë, e cila ka të bëjë me aktive afatgjata, e cila i shton vlerë ndërtesës dhe jo me materiale konsumi. Nga KDIMDP kjo vlerë është regjistruar si shpenzim.

Nga KDIMDP duhet të ishte debituar llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe me marrjen në dorëzim të mallrave duhet të ishte kapitalizuar në llogarinë 21 “Aktive afatgjata materiale”.

- “Shërbime regjistrimi për Edicioni i 15-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)” në shumën prej 1,128,000 lekë për:

- Krijimi i sistemit të ftesave me anë të qr.code
- Krijimi i sistemit të regjistrimit nëpërmjet email-it
- Krijimi i sistemit të komunikimit nëpërmjet email-it me personat e regjistruar pjesëmarrës në këtë konferencë.
- Krijimi i sistemit të check in (në ditën e eventit) të biletave me anë të tablet apo palmare.

- Krijimi i një sistemi administrimi të shpërndarjes së biletave
- Krijimi i një sistemi raportimi të check-imit të biletave.
- Të gjitha kërkesat e mësipërme të jene zhvilluar online edhe aksesueshme ngado.
- Trajnimin e stafit të institucionit mbi përdorimin e sistemeve ditën e zhvillimit të konferencës, e cila ka të bëjë me aktive afatgjata dhe jo me materiale konsumi, ku nga KDIMDP kjo vlerë është regjistruar si shpenzim.

Nga KDIMDP shuma prej 1,128,000 lekë duhet të ishte debituar në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe me marrjen në dorëzim të mallrave duhet të ishte kapitalizuar në llogarinë 21 “Aktive afatgjata materiale”.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, paragrafi Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.

### **Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.**

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 61% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 39% të totalit.

### **Aktivet qarkulluese**

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën 21,274,522 lekë përfaqëson gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466) në vlerën 324,833 lekë dhe 20,949,689 lekë është e ardhur e trashëguar, nga sponsorizimet dhe donacionet.

Pika 50 e udhëzimit. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2023 ka akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2023 reflekton me rritje prej vitit 2022 në vlerën 324,833 lekë, e cila vjen nga 5% i garancisë së mbajtur për “Rikonstruksionit e Godinës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave personale”.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2023, rezulton në vlerën **6,331,526** lekë. Në krahasim me vitin 2022 është rritur në vlerën 639,218 lekë, ku peshën më të madhe e zë rritja e zërit “Inventar i Imwte”, diferenca e cila është pasqyruar në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve

të inventarit” në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

### **Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.**

#### **\* Llogari të arkëtueshme:**

- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 47,976 lekë, përbëhet nga detyrimi të personelit, paradhënie të muajit dhjetor 2023, të cilat janë mbyllur në janar të vitit 2024.

#### **\* Situata e Detyrimeve të Prapambetura:**

Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 18,693,120 lekë, Këto debitorë kanë të bëjnë me 68 sanksionet administrative të vendosura nga Komisioneri ndaj subjekteve për kundërvajtje administratave. Gjatë vitit 2023 janë vendosur 10 sanksione administrative në vlerën prej 5,135,000 lekë.

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 8,249,218 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka Komisioneri ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2023, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2024, të cilat janë kredituar në llogarinë 467 “Kreditore te ndryshem”.

#### **Aktivitet afatgjata**

Në formatin nr. 1 “Aktivitet e Afatgjata” në vlerën neto prej 85,577 mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktive Afatgjata jo materiale” në vlerën neto 1,926 mijë lekë dhe “Aktive Afatgjata materiale” në vlerën neto 83,451 mijë lekë.

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në fund të vitit në vlerën neto prej 188,088 lekë. Gjatë vitit ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 22,800 lekë, si rezultat i projektit për “Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së”.

Nga analiza e zërit rezultoi se në këtë llogari janë kontabilizuar vlera bruto prej 114,000 lekë për “Studim projektimi” dhe vlera bruto prej 546,752 lekë për “Programin Alfa” dhe një “Program të trashëguar nga Ministria e Mbrojtjes”.

- Llogaria 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme” paraqitet në fund të vitit në vlerën neto prej 1,738,446 lekë. Nga auditimi i zërave rezultoi se nga KDIMDP është regjistruar vlera bruto prej 5,858,301 lekë, e cila ka të bëjë me projektin e “Rikonstruksionit të katit përdhe të Godinës së ish H... D...t”, e cila ka përfunduar, egzekutuar pagesa e investimit në vlerën prej 10,002,960 lekë, si dhe është kolauduar dhe marrë në dorëzim punimet në dhjetor të vitit 2019.

#### **Konstatim:**

Vlera prej 114,000 lekë e kontabilizuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” dhe vlera prej 5,858,301 lekë e kontabilizuar në llogarinë 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme” kanë të bëjnë me “Studim e projekte” dhe jo me AAGJ Jo-materiale, të cilat në momentin e konstatimit si investim nga KDIMDP duhet të ishin regjistruar në zërin 230 “Investime për Aktive Afatgjata jo materiale” dhe pasi institucioni ka përfunduar dhe marrë në dorëzim investimi për të cilën janë realizuar “Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së”. duhej të ishte kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale, sipas llojit të projektit duke bërë veprimin kontabël: debituar llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe kredituar llogarinë 230. Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime” dhe 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme”, si dhe nënvlerësimin e “Aktiveve Afatgjata Materiale” në shumën bruto prej 5,972,301 lekë. Në këtë rast, pasqyrat

financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”.

- Gjithashtu dhe vlera prej 546,752 lekë për “Programin Alfa” dhe një “Program të trashëguar nga Ministria e Mbrojtjes”, e cila është klasifikuar në 202 “Studime dhe kërkime”, vlerë e cila ka të bëjë me aktive afatgjata, duhet të ishte klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 15 % dhe jo 20%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’ dhe pika 36 “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata”, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

- Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 58,049,921 lekë. Gjatë vitit ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 6,675,952 lekë, si rezultat i “Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së”.

- Llogaria 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 918,847 lekë. Gjatë vitit nuk ka pësuar ndryshime.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 3,824,162 lekë. Gjatë vitit nuk ka pësuar ndryshime.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto prej 20,657,943 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat i blerjes së “Sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave dhe shërbim mirëmbajtje 3-vjeçare të KDIMDP-së” në vlerën 5,400,000 lekë dhe “Blerje mobilje e orendi zyre” në vlerën 862,800 lekë.

#### **Konstatim:**

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 2187 “Te tjera pajisje zyre” dhe jo në llogarinë 218600 “pajisje elektronike”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’ dhe pika 36 “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata”, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

- Një pjesë e “Pajisjeve dhe instalimi i kondicionerëve” janë klasifikuar në llogarinë 218700 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, por pa ndikim në vlerën neto të aktiveve pasi norma e amortizimit është 20% për të dy klasifikimet.

#### **Pasivet Afatshkurtra**

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2023, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 1,025,725 mijë lekë.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 5,294,492 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2023, që paguhen në Janar të vitit 2024.

- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 749,650 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2023, të cilat paguhen në Janar të vitit 2024.

- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfaqëson kontributin e sigurimit

shoqëror në shumën prej 1,827,874 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 238,130 lekë të muajit Dhjetor 2023, të cilat paguhen në muajin Janar 2024.

- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 18,741,096 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përbëhet nga saldo debitorë të llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

- Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” në shumën prej 324,833 lekë përfaqëson 5% e garancisë së mbajtur “Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së”.

#### **Konstatim:**

- Në rubrikën D “Fondet e konsoliduar nga Institucioni” është pasqyruar llogaria 115 “Nga Fondet e veta te investimeve” në vlerën 6,938,752 lekë.

Në Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto llogaria 115 është pasqyruar në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi i hyrjeve të aktiveve rezultoi se vlera e paraqitur nga KDIMDP në llogarinë 115 “Nga Fondet e veta te investimeve” ka të bëjë me “Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së” të realizuara nga të ardhurat e trashëguara, ku nga institucioni është marrë në dorëzim dhe është bërë kolaudimi i punimeve.

Pasqyrimi i llogarisë 115 “Teprica e Grantëve kapitale te Huaja” në vlerën 6,938,752 lekë në rubrikën D, është veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi “Grupi 11 “Fonde të tjera të veta”.

Sa më sipër nga Komisioneri vlera prej 6,938,752 lekë duhet të ishte pasqyruar në “Pasqyrën e ndryshimeve të aktivet neto/ fondet neto” në llogarinë 115 “Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)”, duke kredituar llogarinë 1011 “Shtesa të fondeve bazë”.

#### ***c) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël***

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se KDIMDP ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m<sup>2</sup>, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2023. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit për vitin 2021; 2022 dhe 2023, sipas përcaktimeve në Paragrafin nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e



*aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”*

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*".

### **Inventarizimi fizik**

Në urdhrin e Komisionerit çdo vit është ngritur komisioni i inventarizimit "*Mbi inventarizimin e aktiveve fizike*".

Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbali, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, ditën kur është mbyllur inventarizimi fizik i aktiveve sipas përcaktimit të paragrafit 83, të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar, ku citon "*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material*".

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë, sipas përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011. Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Në fund të procesit të inventarizimit, nga komisioni është përgatitur informacion përmbledhës mbi inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve

### **Konstatim:**

Nga auditimi i procesverbalit të komisionit është cituar se gjendja e aktiveve në magazinë:

- Me datën 19.12.2023, për Llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" është në vlerën 508,910 lekë.

- Me datën 19.12.2023, për Llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është në vlerën 5,284,757 lekë.

Në procesverbal komisioni është shprehur se një pjesë e mallrave/pajisjeve nuk janë në gjendje pune, por nuk ka evidentuar listën me zërat e aktiveve të cilat janë jashtë funksioni dhe zërat e aktiveve funksionale gjendje në magazinë as në shënimet/vërejte e "Fletë Inventarit", si dhe nuk është shprehur në lidhje me vlerësimin paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, të cilin së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" paragrafi 85/c.

Më pas, Nëpunësi Autorizues nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionin të vlerësimit, për vlerësimin e aktiveve të cilat relatohen nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" paragrafi 96-99 dhe 102. Mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mos planifikimi efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, qe janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimi.

## 2.4 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 4 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2021; 2022 dhe vitit 2023, bazuar në ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”. “ISA 530 zbatohet kur audituesi ka vendosur të përdorë kampionimin e auditimit në kryerjen e procedurave të auditimit. Ai merret me përdorimin nga audituesi të kampionimit statistikor dhe jostatistikor gjatë hartimit dhe përzgjedhjes së kampionit të auditimit, kryerjen e testeve të kontrolleve dhe testet e detajeve, dhe vlerësimin e rezultateve nga ky kampion, cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen”, mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit të realizuara në KDIMDP, veprimet e kryera me bankën konstatohet se, janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.”

### a) Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë:

Veprimet e arkës në valutë në institucion dokumentohen nëpërmjet mandat-arkëtimeve dhe mandat-pagesave të cilat nënshkruhen nga arkëtari, nga financieri dhe marrësi i paradhënies. Regjistrimet e veprimeve të arkës janë kryer në llogari kontabile të arkës, nga Sektori i Financës dhe në librin e arkës nga ana e punonjësit të caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare. Dokumentet e arkës janë shqyrtuar, kontrolluar dhe nënshkruar nga personat e poshtëshënuar: mandatarkëtimet nënshkruhen rregullisht nga personi përgjegjës për vlerat monetare dhe nga Nëpunësi Zbatues; mandatpagesat nënshkruhen nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga zyrtari që ka nënshkruar mandatpagesën (marrësi) dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare. Përgjithësisht nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të arkës në valutë konstatohet se, institucion respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve njësitë e sektorit publik” i ndryshuar të MFE, dhe sa më sipër është mbajtur libër arke ku janë regjistruar rregullisht mandat arkëtimet e pagesat dhe janë bërë mbylljet e tij rregullisht çdo muaj, në zbatim të parashikimeve të paragrafit nr.67 dhe 68 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që ka përcaktuar se:

67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke

*nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare.*

*68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtë shënuar:*

*a. mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjësi që kryen derdhjen dhe nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij;*

*b. mandatpagesa nënshkruhet nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare.*

*c. Nëpunësi Autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhëruar të nënshkruar prej tij.*

Nga auditimi, rezultoi se, regjistrimet kontabile në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, të kuadruara dhe duke u bazuar në dokumentacionin justifikues përkatës. Nga auditimi rezulton se, nëpërmjet arkës në valutë janë kryer kryesisht pagesa për shërbime udhëtimi e dieta jashtë vendit. Në të gjitha rastet e audituara, paradhënia ka rezultuar të jetë sistemuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, menjëherë pas paraqitjes së dokumenteve justifikuese, për shpenzimet e kryera, nga ana e nëpunësit udhëtues, e shoqëruar kjo sipas rastit me Mandat Pagesën ose Mandatin e Arkëtitimit. Nga testimet e kryera nuk rezultoi të jetë akorduar paradhënie e dytë pa shlyer paradhënien e parë. Transaksionet financiare, në formën e paradhënies, për udhëtime e dieta, rezultojnë të kryera në zbatim të VKM nr. 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, i ndryshuar.

Çdo veprim në arkë është kryer vetëm me Urdhër të Titullarit të Institucionit (Komisioneri). Nga auditimi rezulton se, arka është inventarizuar periodikisht çdo muaj duke mos rezultuar me diferenca. Në fund të vitit arka është mbyllur me gjendje zero.

U shqyrtua libri i arkës në valutë për disa transaksione të përzgjedhura nga grupi i auditimit bazuar në vlerat më të larta.

Praktikat për likuidimet e kryera për shërbimet jashtë vendit janë hartuar nga personat udhëtues së bashku me dokumentacionin vërtetues përkatës.

Nga auditimi i praktikave të përzgjedhura rezultoi se bashkëlidhur praktikës është Urdhër-shërbimi, autorizimi i titullarit të institucionit, dhe të gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit, sipas përcaktimit të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 5.

#### ***b) Auditimi i transaksioneve të kryera me bankën:***

U auditua me zgjedhje dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimit.

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve për muajt nëntor- dhjetor, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua mangësi në lidhje me dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur urdhër shpenzimeve si mëposhtë:

#### **Viti 2021**

- Me urdhër shpenzimin nr. 263, datë 15.12.2021 në shumën 409,200 lekë, për blerje tonera nga OE “I. O.” shpk, rezultoi se komisioni i marrjes në dorëzim në procesverbalin e mbajtur me datën 03.11.2021 relaton se komisioni merr në dorëzim mallrat dhe konfirmon faturën me nr. 6/2021, datë 08.4.2021 në vlerën 479,880 lekë nga OE “M. H.”. Pra procesverbalin i mbajtur dhe bashkëlidhur transaksionit nuk ka lidhje me procedurën në fjalë. Mallrat kanë hyrë në magazinë

me fletë hyrje nr.15 datë 03.11.2021 bazuar në faturën tatimore të subjektit me nr. 6130/2021, datë 03.11.2021

- Me urdhër shpenzimin nr. 266, datë 15.12.2021 në shumën 504,000 lekë, për blerje materiale pastrimi, nga OE "A." shpk, rezultoi se:

Mallrat kanë hyrë në magazinë me fletë hyrje nr.16, datë 04.11.2021

Ndërsa procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim është mbajtur me datën 10.12.2021. Fatura e lëshuar nga OE është me nr. 424/2021, datë 10.12.2021 në vlerën prej 504,000 lekë.

**Sa më sipër konstatohet** se magazinimi i mallrave me fletë-hyrje është bërë më përpara se komisioni të bëjë verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit dhe faturës së lëshuar nga OE.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" paragrafi 37 "Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë".

- Me urdhër shpenzimin nr. 280, datë 20.12.2021 në shumën 21,270 lekë për blerje materiale përkthimi, nga OE "T. D. A.", rezultoi se:

OE është likuiduar bazuar vetëm në faturën tatimore me nr. 47/2021, datë 14.12.2021.

Bashkëlidhur mungon procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit të realizuar, në cilësinë e dokumentacionit vërtetues sipas përcaktimeve të Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" paragrafi 35 pika b, "Dokumente vërtetues" ku citohet "vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi".

- Me urdhër shpenzimin nr. 275, datë 20.12.2021 në shumën 119,040 lekë citohet blerje për pastrim, dezinfektim dhe ndriçim. Kërkesa për realizimin e shpenzimit me nr. 1686, datë 13.10.2021 është bërë "për blerje materiale elektrike dhe hidraulike". Mallrat kanë hyrë në magazinë me fletë hyrje nr.18/1, datë 06.12.2021. Procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave me datën 06.12.2021 është relatuar në lidhje me blerje elektrike dhe hidraulike. **Përshkrimi i transaksionit** është i ndryshëm nga e gjithë dokumentacioni vërtetues bashkëlidhur, veprime në kundërshtim Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" paragrafi 35 pika b, "Dokumente vërtetues" ku citohet "vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi".

- Me urdhër shpenzimin nr. 289, datë 24.12.2021 në shumën 111,600 lekë për blerje prodhim dokumentacioni specifik, nga OE "O.", rezultoi se;

OE është likuiduar bazuar në faturën tatimore me nr.15/2021, datë 23.12.2021.

Bashkëlidhur transaksionit mungon procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave si dhe urdhri për realizimi e blerjes së këtyre mallrave. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen me nr. 23, datë 23.12.2021, pa u bërë nga komisioni verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit dhe faturës së lëshuar nga OE. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" paragrafi 37.

- Me urdhër shpenzimin nr. 296, datë 29.12.2021 në shumën 90,000 lekë për blerje sinjalistike, nga OE "A. A.", rezultoi se:

Bashkëlidhur urdhrit nuk ka asnjë kërkesë për blerjen e produkteve, sasinë e kërkuar si dhe planifikimin që institucioni ka bërë për këtë produkt.

Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni citohet se materialet janë sjellë konform kërkesave të autoritetit, ku në dosje nuk ka kërkesa të bërë nga AK si dhe specifikimet e kërkuara për këto materiale, si dhe ka konfirmuar faturën e sjellë nga OE me nr. 4/2021, datë 14.08.2021.

Materialet janë bërë hyrje në magazine me fletë hyrjen me nr. 8, datë 14.08.2021. Data e publikimit nga AK për këtë blerje është bërë me datën 14.10.2021.

- Me urdhër shpenzimin nr. 297, datë 29.12.2021 në shumën 898,800 lekë për mirëmbajtje dhe riparim sistemi kondicionimi, nga OE "K. T.", rezultoi se;

Mes AK dhe OE është lidhur kontrata me nr. 1786/5, datë 04.11.2021.

Në nenin 4 të kontratës "Afatet dhe grafiku i shërbimit" është përcaktuar se afati i realizimit të shërbimit është nga data 04.11.2021-08.11.2021, ashtu siç është përcaktuar dhe në ftesën për ofertë që afati i realizimit të shërbimit është tre ditë nga momenti i shpalljes së fituesit.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur urdhër shpenzimit si procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit të mbajtur nga komisioni me datën 10.12.2021, si dhe faturës së lëshuar nga OE fitues me nr. 41/2021, datë 10.12.2021 rezulton se shërbimi është realizuar jashtë afatit kohor të përcaktuar në kontratë.

Referuar nenin 19 të kontratës, nga AK nuk ka asnjë dokumentacion ku të vërtetoje dakortësinë për shtyrjen e realizimit të kontratës, si dhe nga AK nuk është përlogaritur asnjë penaltet ndaj OE për vonesën e realizimit të shërbimit.

## **Viti 2022**

- Me urdhër shpenzimin nr. 262, datë 22.12.2022 në shumën 422,400 lekë, për mirëmbajtje pajisje zyre, nga OE "P. S.", rezultoi se;

Mes AK dhe OE është lidhur kontrata me nr. 2038/5, datë 10.12.2022.

Në nenin 5 të kontratës "Afatet e realizimit" është përcaktuar nga data 10.12.2022-15.12.2022, ashtu siç është përcaktuar dhe në ftesën për ofertë që afati i realizimit të shërbimit është pesë ditë nga momenti i shpalljes së fituesit.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur urdhër shpenzimit si procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit të mbajtur nga komisioni me datën 20.12.2022, si dhe faturës së lëshuar nga OE fitues me nr. 11303/2022, datë 20.12.2022 rezulton se shërbimi është realizuar jashtë afatit kohor të përcaktuar në kontratë.

- Me urdhër shpenzimin nr. 268 datë 22.12.2022 në shumën 138,000 lekë, për prodhim materiale promocionale, nga OE "O." shpk rezultoi se;

Bashkëlidhur urdhër shpenzimit mungojnë kërkesat e bëra për sasinë dhe shërbimin e realizuar.

Mallrat e përshkuara në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim me datën 23.12.2022 nuk përputhen me mallrat e sjellë nga OE bazuar në faturën tatimore nr. 440/2022, datë 23.12.2022. Në procesverbal thuhet marrje në dorëzim ndërrim filtër ajri në sasinë 150, ndërsa në faturë thuhet kartolinë + zarfe me logo.

## **Viti 2023**

- Me urdhër shpenzimin nr. 189 datë 05.10.2023 në shumën 500,000 lekë për shpenzime operative, ndaj OE "A. E. A." rezultoi se;

Me autorizimin nr. 1389/2, datë 04.09.2023 të Komisionerit, njëkohësisht Nëpunës Autorizues

pranë KDIMDP, ka autorizuar Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, njëkohësisht Nëpunës Zbatues, të nënshkruajë kontratat me subjektin “A. E. A.”, për pjesëmarrjen e Zyrës së Komisionerit në aktivitetin “Festivali i Inovacionit-InnFest 2023”.

Delegimi i detyrës është në kundërshtim me Nenin 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, ku citohet se nëpunësi zbatues caktohet nga nëpunësi autorizues për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe

- Nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, ku citohet se, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre, nëpunësit autorizues kanë të drejtën të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat te punonjësit e nivelit menaxhial në varësi direkte, me përjashtim të delegimit te nëpunësit zbatues.

- Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 “*Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve*”, paragrafi 3 dhe 4.

- Udhëzimit nr.4, datë 29.01.2020 “*Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, paragrafi 3.3.

- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde mbi zbatimin e buxhetit*” pika 44 “*Nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, si dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë .....Nuk lejohet delegimi i të drejtës tek Nëpunësi Zbatues i njësisë. Delegimi i të drejtës nuk nënkupton delegimin e përgjegjësive*”.

- Me urdhër shpenzimit nr. 196, datë 09.10.2023 në shumën 70,000 lekë për shpenzime në lidhje me realizimin e planimetrisë së arredimit të zyrës së Komisionerit, ndaj OE “E. V.” rezultoi se: Mes OE dhe AK është lidhur kontrata me nr. 164/2, datë 15.06.2023. Kontrata është nënshkruar nga NZ i institucionit, i cili në të njëjtën kohë ka bërë kërkesën për realizim shërbimi, e cila nuk është miratuar paraprakisht nga titullari për vazhdimin e realizimit të shërbimit dhe ka nënshkruar urdhrin e shpenzimit në rolin e NZ.

Veprime ne kundërshtim me Udhëzimin me nr. 21, datë 25.10.2016 “*Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve*”, paragrafi 3 dhe 4.

- Udhëzimit nr. 4, datë 29.01.2020 “*Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, paragrafi 3.3.

- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde mbi zbatimin e buxhetit*” pika 44 “*Nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, si dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë .....Nuk lejohet delegimi i të drejtës tek Nëpunësi Zbatues i njësisë. Delegimi i të drejtës nuk nënkupton delegimin e përgjegjësive*”.

- Më urdhër shpenzimit nr. 81, datë 27.04.2023 në shumën 6,497,667 lekë për shpenzime rikonstruksioni i të godinës, ndaj OE “A.” shpk rezultoi se:

Me autorizimin nr. 1904, datë 03.11.2022 të Komisionerit, njëkohësisht Nëpunës Autorizues pranë KDIMDP, ka autorizuar Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, njëkohësisht Nëpunës Zbatues, të nënshkruajë kontratat me subjektin “A.” shpk. Kontrata është lidhur me nr. 1641/9, datë 04.11.2022. Gjithashtu NZ ka marrë në dorëzim shërbimin në rolin e anëtares së komisionit të marrjes në dorëzim të kontratës, si dhe ka nënshkruar faturën.

Delegimi i detyrës është në kundërshtim me Nenin 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, ku citohet se nëpunësi zbatues caktohet nga nëpunësi autorizues për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe

- Nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, ku citohet se, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre, nëpunësit autorizues kanë të

drejtën të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat te punonjësit e nivelit menaxherial në varësi direkte, me përjashtim të delegimit te nëpunësit zbatues.

- Udhëzimit nr. 4, datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.3 dhe 3.4.

- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde mbi zbatimin e buxhetit" i ndryshuar, pika 44 “*Nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, si dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë .....Nuk lejohet delegimi i të drejtës tek Nëpunësi Zbatues i njësisë. Delegimi i të drejtës nuk nënkupton delegimin e përgjegjësisë*”.

- Me urdhër shpenzimin nr. 189, datë 05.10.2023 në shumën 500,000 lekë për shpenzime operative, ndaj OE “A. E. A.” rezultoi se:

Me autorizimin nr. 1389/2, datë 04.09.2023 të Komisionerit, njëkohësisht Nëpunës Autorizues pranë KDIMDP, ka autorizuar Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, njëkohësisht Nëpunës Zbatues, të nënshkruajë kontratat me subjektin “A. E. A.”, për pjesëmarrjen e institucionit në aktivitetin “Festivali i Inovacionit- InnFest 2023”. Kontrata është lidhur me nr. 1389/3, datë 06.09.2023.

- Me urdhër shpenzimin nr. 230, datë 14.12.2023 në shumën 550,000 lekë për shpenzime operative, ndaj OE “K. E. G & T. I. F” rezultoi se;

Me autorizimin nr. 1746/5, datë 05.12.2023 të Komisionerit, njëkohësisht Nëpunës Autorizues pranë KDIMDP, ka autorizuar Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, njëkohësisht Nëpunës Zbatues, të nënshkruajë kontratat me subjektin “K. E. G & T. I. F”, për pjesëmarrjen e institucionit në edicionin e 29-të “Panairi Ndërkombëtar të Tiranës”. Kontrata është lidhur me nr. 1746/6, datë 05.12.2023.

Delegimi i detyrës është në kundërshtim me Nenin 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ku citohet se nëpunësi zbatues caktohet nga nëpunësi autorizues për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe

- Nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku citohet se, gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tyre, nëpunësit autorizues kanë të drejtën të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat te punonjësit e nivelit menaxherial në varësi direkte, me përjashtim të delegimit te nëpunësit zbatues.

- Udhëzimit nr.4, datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.3 dhe 3.4.

- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde mbi zbatimin e buxhetit" pika 44 “*Nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, si dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë .....Nuk lejohet delegimi i të drejtës tek Nëpunësi Zbatues i njësisë. Delegimi i të drejtës nuk nënkupton delegimin e përgjegjësisë*”.

- Me Urdhër shpenzimin me nr. 232, datë 29.12.2023, në shumën prej 1,128,000 lekë për shpenzime “Shërbime regjistrimi për Edicioni i 15-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)”, ndaj OE “T. D. A.” shpk rezultoi se:

Në ftesën për ofertë në shtojca 2 “Përshkrimi i punës” si dhe në nenin 4 “Detyrat e veçanta të kontraktorit” të kontratës me nr. 2092/5, datë 23.11.2023, përcaktohet se:

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të realizojë shërbimin e kërkuar për Shërbime regjistrimi për Edicioni i 15-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)” sipas kërkesave të mëposhtme:

- Krijimi i sistemit të ftesave me anë të qr.code

- Krijimi i sistemit të regjistrimit nëpërmjet email-it
- Krijimi i sistemit të komunikimit nëpërmjet email-it me personat e regjistruar pjesëmarrës në këtë konferencë.
- Krijimi i sistemit të check in (në ditën e eventit) të biletave me anë të tableta apo palmare.
- Krijimi i një sistemi administrimi të shpërndarjes së biletave
- Krijimi i një sistemi raportimi të check-imit të biletave.
- Të gjitha kërkesat e mësipërme të jene zhvilluar online edhe aksesueshme ngado
- Trajnimin e stafit të institucionit mbi përdorimin e sistemeve ditën e zhvillimit të konferencës

Bazuar në shtojcën 2 të ftesës për ofertë, institucioni prokuron një aktiv afatgjatë siç është regjistri dhe jo një shërbim siç është trajtuar nga institucioni duke e paguar nga llogaria 602 “Mallra dhe shërbime” dhe duke e kontabilizuar në kontabilitet si shpenzim për shërbime të tjera. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

**Procesverbali i mbajtur nga komisioni nuk ka një analizë të zërave të realizuara nga kontraktuesi sipas kontratës së nënshkruar**, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 35 pika b, “Dokumenta vërtetues”.

- Me Urdhër shpenzimit me nr. 233, datë 22.12.2023, në shumën prej 900,000 lekë për shpenzime “Idejimi i materialeve të konferencës”, ndaj OE “T. D. A.” shpk rezultoi se:

Procesverbali i mbajtur nga komisioni 13.12.2023 nuk ka një analizë të zërave të realizuara nga kontraktuesi sipas kontratës së nënshkruar 2090/6, datë 23.11.2023 dhe të materialeve të marra në dorëzim. Në ftesën për ofertë me termat e referencës është përcaktuar se çdo material i dorëzuar duhet të jetë i printuar dhe editueshme nga AK.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka në përbërje asnjë specialist të fushës për të vërtetuar nëse OE ka plotësuar kushtet e kontratës në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 43 si dhe paragrafi 35 pika b.

#### Blerjet nën 100 mijë lekë

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për vitin 2021; 2022 dhe 2023 në lidhje për blerjet e realizuara nën 100,000 lekë rezultoi se bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit nuk administrohet dokumentacioni vërtetues mbi realizimin e procedurës nga testimi i tregut për përcaktimin e vlerës deri në fazën e përzgjedhjes së OE, me të cilin është realizuar transaksioni.

#### Sa më sipër veprime në kundërshtim me:

Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” **nenin 4, pika 26**, “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajtje të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin që rregullon dokumentin elektronik”; neni 12, pika 3, germa a); neni 12, pika 3, germa dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset



që ndodhin në njësi; **Nenin 4, pika 19** “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”.

- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde mbi zbatimin e buxhetit" pika 165 “Për të gjitha shpenzimet e kryera nëpunësi zbatues kryen kontrollet para pagesës, lidhur me mjaftueshmërinë e disponibiliteteve mujore të parashikuara në planin e arkës, kontrollon dokumentet origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit dhe kontrollet e tjera të nevojshme dokumentare”.

## **2.5. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.**

Në zbatim të pikës nr. 5 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin;
- Listëpagesat dhe libri i pagave;
- Dosjet e personelit;
- Baza e të dhënave/data baza mbi personelin;
- Për auditimin e marrëdhënieve të punës dhe pagave grupi i auditimit është mbështetur akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar;
- VKM-së nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm” i ndryshuar;
- VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” i ndryshuar;
- VKM-së nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar;
- Vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar;
- VKM-së nr. 929, datë 27.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar;
- Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar;

- Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar;
- VKM-së me nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
- Vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar.

Në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në nenin 37 përcakton se Kuvendi vendos për pagën e Komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e Zyrës së KDIMDP dhe punonjësit e kësaj zyre gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës pranë Zyrës së KDIMDP me 37 punonjës gjithsej ka qenë fillimisht miratuar nëpërmjet Vendimit të Kuvendit me nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Përgjatë periudhës së auditimit, nëpërmjet Vendimit të Kuvendit me nr. 84/2020, datë 23.12.2020, akti i mësipërm ka pësuar ndryshimet e para, nëpërmjet të cilit organika është rritur në 44 punonjës. Ndryshimi i fundit i aktit, përgjatë periudhës së auditimit, ku është bërë miratimi i strukturës së KDIMDP me 60 punonjës është miratuar me Vendimit të Kuvendit me nr. 24/2023, datë 23.03.2023. Për shkak të ligjit të Buxhetit për vitin 2023, numri i punonjësve për Zyrën e Komisionerit, për vitin 2023 është miratuar me 52 punonjës, ku me Aktin Normativ nr. 12/2022 dhe Ligjin e Buxhetit të vitit 2023, u miratua shtesa prej 8 nëpunësish, Struktura sipas këtij vendimi me 60 punonjës është miratuar me Ligjin e Buxhetit 97/2023 me Buxhetin e vitit 2024.

#### Emërimet – largimet, pranë Zyrës së KDIMDP për vitit 2021; 2022 dhe 2023.

Pasqyra e emërimeve – largimeve, pranë Zyrës së KDIMDP, përgjatë periudhës së auditimit, rezulton, si më poshtë:

Gjatë vitit 2021, për shkak të hyrjes në fuqi të ndryshimeve në organikë, institucioni kaloi një procedurë restrukturimi, pasi ka patur ndryshime të kategorisë dhe emërtesës në disa pozicione. Nga ky proces janë larguar vetëm dy punonjës, të cilët kanë konkurruar për ngritje në detyrë (pozicion inspektor), nga të cilët ka fituar vetëm njëri prej tyre.

Për sa më sipër, nuk rezulton të ketë patur ankesa mbi procesin.

- Për vitin 2021 janë përfunduar me sukses 14 procedura rekrutimi, ndër të cilat 12 procedura ngritje në detyrë. (të brendshme ose të jashtme), si dhe 11 shkëputje të marrëdhënieve të punës, nga të cilat 9 me dorëheqje dhe 1 largim nga detyra e cila është në proces gjyqësore.
- Për vitin 2022, janë përfunduar me sukses 5 procedura, ndër të cilat 1 procedurë ngritje në detyrë, si dhe 6 shkëputje të marrëdhënieve të punës me dorëheqje.
- Për vitin 2023 janë përfunduar me sukses 10 procedura për 11 punonjës, ndër të cilat 9 procedura ngritje në detyrë (të brendshme ose të jashtme), si dhe 3 shkëputje të marrëdhënieve të punës me dorëheqje.

Zyra e KDIMDP aktualisht ka vetëm 1 çështje në proces gjyqësor sa i përket marrëdhënieve të punës, e cila nuk ka marrë ende vendim të formës së prerë.

Paralelisht me auditimin e KLSH-së, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në Programin e Mbikëqyrjes nr. 102/1prot., datë 30.01.2024, ka qenë duke ushtruar mbikëqyrjen e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga KDIMDP, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të Ligjit nr. 152/2013.

### Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore:

- Për vitin 2021 është realizuar në vlerën 42,142 mijë lekë ose në masën 98.6 % të planifikimit, për numrin faktik të punonjësve 38 përkundrejt 44 punonjës të miratuar, si dhe punonjësve jashtë strukturës. Për sa i përket kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është realizuar në vlerën 6,987 mijë lekë ose masën 95.7% të planifikimit.

Mosrealizimet në këtë zë referuar argumenteve të KDIMDP kanë ardhur si pasojë e nisjes me vonesë të rekrutimeve dhe emërimeve në pozicionet e rregullta, për shkak të situatës zgjedhore dhe parashikimeve në kodin zgjedhor (pezullimi i përkohshëm i procedurave të rekrutimeve të reja) apo edhe të lëvizjeve për periudhën deri 4 muaj përpara procesit zgjedhor.

Kjo ka sjellë që numri prej 44 punonjësish i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 84/2020 “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, reflektuar edhe në Ligjin e Buxhetit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” të mbetëj i paplotësuar.

- Për vitin 2022 është realizuar në vlerën në vlerën 47,017 mijë lekë ose në masë 99% të planifikimit, për numrin faktik të punonjësve 41 përkundrejt 52 punonjës të miratuar, si dhe punonjësve jashtë strukturës prej 5 punonjës. Kontributet për sigurimet shoqërore/shëndetësore është realizuar në vlerën 7,785 mijë lekë ose në masën 96% të planifikimit.

Gjatë vitit 2022, u zhvilluan 17 procedura rekrutimi për pozicionet vakante në organikë, ku në këtë numër përfshihen edhe ato të rishpallura. Janë kryer procedurat e emërimeve të përkohshme, për pozicionet e deklaruar përkohësisht vakante, për shkak të largimeve në detyra të tjera jashtë institucionit apo atyre me raport paaftësie (leje lindje), si dhe të tjera emëime me kontrata me afat të caktuar (punë me kohë të reduktuar 6 orë). Referuar planit vjetor të rekrutimeve, deri me 31 Dhjetor kanë mbetur 5 vende vakante, nga të cilat 3 pozicione të nivelit të mesëm drejtues, 1 inspektor i nivelit të ulët drejtues si dhe një pozicion në Drejtorinë e Kabinetit.

- Për vitin 2023 është realizuar në vlerën 81,191 mijë lekë ose në masën 99 % të planifikimit. Struktura dhe organigrama e kësaj Zyre, ka ndryshuar me një numër të miratuar në strukturë prej 60 punonjës, me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë me nr. 24/2023 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Me Aktin Normativ nr. 12/2022 dhe Ligjin e Buxhetit të vitit 2023, u miratua shtesa prej 8 nëpunësish, e cila u reflektua me vendimmarrjen përkatëse të Kuvendit gjatë vitit 2023, edhe përtej këtij numri. Struktura dhe organika prej 60 punonjës, në zbatim të Vendimit të Kuvendit të cilësuar më lart, u reflektua me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 97/2023 “ Për Buxhetin e vitit 2024”.

### Auditimi i listëpagesave

Në funksion të auditimit të respektimit të dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, etj, u përzgjedhën në bazë risku praktikat dokumentare që shoqëronin shpenzimet e kryera për muajt nëntor-dhjetor për vitet 2021; 2022 2023, nga ku rezultoi se:

- Listëpagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për hartimin e pagave, Specialisti i Financës. Ato janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues (Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës) dhe Nëpunësi Autorizues (Komisioneri), sipas përcaktimeve të pikës 69, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik” i ndryshuar. Listëpagesat nënshkruhen nga punonjësi i caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

- Përgatitja e tyre është mbështetur në listë prezencat mujore. Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e institucionit janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës në muaj të paraqitur nga çdo drejtori apo sektor dhe mbi bazën e verifikimit të prezencës çdo ditë nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

- Pagat e punonjësve janë vendosur sipas funksionit dhe kategorisë konform ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar; dhe VKM-së nr. 325, datë 31.5.2023.

- Gjithashtu janë llogaritur saktë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

### **Konstatim:**

Nga auditimi i listëpagesave mujore nga grupi i auditimit u konstatua se:

Në formatin e listëpagesave është përllogaritur si pjesë të pagës dhe “Shtesë page për kualifikim shkencor” në vlerën 40,000 lekë çdo muaj për B. D. me detyrë Komisioner; P. M. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe E. H. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm.

Për argumentimin e këtij veprimi Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës ka vënë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

Nëpërmjet relacionit nr. 1610/1 prot., datë 28.09.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, në cilësinë e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, mbështetur në VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, paraqet pranë Komisionerit kërkesën për aplikimin e shtesës për kualifikim, duke nisur nga kërkesa e punonjës E. H..

### ***Mbi procedurën e ndjekur***

Pika 2, gërma c, e VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, përcakton se shtesa për kualifikim jepet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor përputhet me përshkrimin e punës së nëpunësit dhe pas miratimit rast pas rasti nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në kuptim të kësaj dispozite, procedura për miratimin e shtesës për kualifikim, fillon me kërkesën nga punonjësi, e më tej vlerësohet nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, nëse përputhet ose jo me përshkrimin e punës.

Nga auditimi nuk rezulton që njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (i) të ketë kryer vlerësimin e përputhshmërisë së kualifikimit përkatës me përshkrimin e punës së nëpunësit, (ii) të ketë administruar kërkesë nga punonjësit B. D. dhe P. M., si dhe (ii) nuk ka miratuar rast pas rasti shtesat për kualifikim, duke i përfshirë në të njëjtën kërkesë.

*Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, në cilësinë e drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.*

### ***Mbi aktin e miratimit***

Akordimi i shtesës për kualifikim është miratuar nëpërmjet Urdhrit të Komisionerit nr. 162, nr. 1610/2 prot., datë 29.09.2022 “Për dhënie shtesë page për kualifikim”. Nëpërmjet këtij Akti, Komisioneri urdhëron dhënien e shtesës për kualifikim, në vlerën 20,000 lekë/ muaj, nëpunësve të Zyrës së KDIMDP, për punonjësit B. D., P. M., E. H., pra duke përfshirë dhe veten e tij.

Referuar nenit 3, pika 1, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, konflikt i interesit do të konsiderohet gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa

privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Për sa më sipër, miratimi i aktit nga Komisioneri për dhënie shtesë page, ndër të tjerë për veten e tij, në kushte të ekzistencës së interesit privat, është në kundërshtim me nenin 4, pika 1, nenin 5, 6, 37 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nenin 30, 108 e vijues, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

*Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi z. B. D., me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

Mbi sa trajtuar më sipër, nëpërmjet observacionit mbi Projekt-Raportin e Auditimit, administruar në KLSH me nr. 247/7 prot., datë 22.07.2024, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shprehet se mban të njëjtin qëndrim me observacionin e dërguar mbi Akt-Konstatimin nr. 10, datë 17.05.2024, administruar në KLSH me nr. 247/5 prot., datë 28.05.2024, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Zyra e Komisionerit e gjen këtë konstatim të pabazuar pasi dispozitat e cituara në raport me ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, zbatohen për rastet kur një titullar merr pjesë në vendimmarrje për kontrata apo akte administrative me palë të treta dhe këto mund të krijojnë situata që bartin konflikt interesi. Në rastin konkret bëhet fjalë për veprime të cilat hyjnë në gamën e administrimit të zakonshëm financiar, konsideruar për analogji edhe rasti i nënshkrimit të listëpagesave për dhënien e pagës për vetë titullarin, dietave në rastet e udhëzimeve jashtë vendit, veprime të cilat nënshkruhen në çdo rast nga titullari edhe kur ai është vetë përfituesi i tyre.

Sa i takon neneve 6 dhe 37, duke qenë institucioni ynë një institucion i pavarur pa organ epror, delegimi i vendimmarrjes bëhet i pamundur, përpos faktit që në rastin konkret nuk jemi përpara një procedure të mirëfilltë vendimmarrëse sikurse referuar në Akti Konstatim, por përpara veprimeve të administrimit të zakonshëm financiar të një institucioni dhe një përfitimi i cili buron nga përmbushja e disa kriterëve ligjore dhe nuk është objekt i vendimmarrjes administrative të Komisionerit.

Sa më sipër, duhet të mbahen në konsideratë kufijtë e shtrirjes së efekteve detyruese të akteve normative ligjore e nënligjore në raport me pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare të një institucioni që monitoron zbatimin e të drejtave kushtetuese.

Për më tepër pavarësia financiare e organeve ose institucioneve si rasti i Zyrës së Komisionerit, konsiston veçanërisht në të drejtën e menaxhimit të pavarur të këtij buxheti në përputhje me ligjin dhe varet nga mundësitë financiare të vet shtetit, por edhe donatorëve, të cilat reflektohen periodikisht në buxhetin vjetor të tij.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

1. Neni 4, pika 1, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, citon se kjo dispozitë është e aplikueshme për rastet kur zyrtari merr pjesë në vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative dhe jo akte administrative domosdoshmërisht me palë të treta, sikurse citohet nga Zyra e KDIMDP në observacion. Ndryshe nga aktet e listuara nga Zyra e KDIMDP në observacion, ky akt ka krijuar pasojë juridike për subjekte individualisht të përcaktuara, ku bën pjesë dhe vetë titullari.

2. Fakti se Zyra e KDIMDP është institucion i pavarur, nuk e zhvesh titullarin e KDIMDP, në cilësinë e zyrtarit, në zbatim të nenit 6 dhe 37 të Ligjit, nga detyrimi për të parandaluar dhe të zgjidhë sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme çdo gjendje të konfliktit të interesit. Në rast se titullari i KDIMDP nuk ka qenë i bindur për ekzistencën ose jo të konfliktit të

interesit, mospasja e një eprori direkt nuk e zhvesh atë nga detyrimi i sipërpërmendur, duke vlerësuar alternativa të tjera, si p.sh t'i drejtohej ILDKPKI, për vlerësimin e ekzistencës ose jo të kushteve të konfliktit të interesit.

3. Statusi i “institucionit të pavarur” dhe neni 38 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave, ku citohet se Zyra e KDIMDP ka buxhetin e vet të pavarur, në asnjë rast nuk e zhveshin Zyrën e KDIMDP dhe punonjësit nga detyrimi për të zbatuar aktet normative ligjore dhe nënligjore në fuqi, të përcaktuara në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, ky observacion nuk merret parasysh.

### **Mbi krijimin dhe pasqyrimin e detyrimit të prapambetur**

Nëpërmjet Urdhrit nr. 162, datë 29.09.2022, Komisioneri ka urdhëruar dhënien e shtesës për kualifikim, me efekt prapaveprues që nga data e fillimit të përfitimit të shtesës për kualifikim, për punonjësit, si më poshtë:

Nr.	Punonjësi	Pozicioni	Data e fillimit të efektit
1.	B. D.	Komisioner	01.09.2019
2.	P. M.	Drejtor i Përgjithshëm	01.09.2019
3.	E. H.	Drejtor i Përgjithshëm	18.03.2020

Fuqia prapavepruese e këtij Urdhri ka krijuar për Zyrën e KDIMDP një detyrim të prapambetur prej **2,020,000 lekë**, i detajuar, si më poshtë:

- Vlera prej 20,000 lekë/muaj për 36 muaj, në total 720,000 lekë, për punonjësin B. D.;
- Vlera prej 20,000 lekë/muaj, për 36 muaj, në total 720,000 lekë, për punonjësen P. M.;
- Vlera prej 20,000 lekë/muaj, për 29 muaj, në total 580,000 lekë, për punonjësin E. H..

Sipas përcaktimit në pikën 42 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve. Nga auditimi nuk rezulton që Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të ketë evidentuar veçmas këtë detyrim të prapambetur financiar.

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, njësia përgjegjëse për financat paraqet menjëherë detyrimet e prapambetura në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë, nëpërmjet dokumentit “Urdhër regjistrimi i detyrimit të prapambetur”, format tip sipas Tabelës nr. 4, Aneksi nr. 2 i këtij Udhëzimi. Struktura përgjegjëse për Thesarin në degë, pas kontrollit të ushtruar në zbatim të legjislationit në fuqi, regjistron në SIFQ detyrimin e paraqitur nga njësia shpenzuese.

Mungesa e regjistrimit të këtij detyrimi të prapambetur, përpos parregullsisë në raportimin e pasqyrave financiare, ka evituar strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, si hallkë kontrolli për zbatimin e legjislationit në fuqi, për faktin se pjesa takuese e detyrimit të prapambetur është bashkuar dhe përllogaritur si element i pagës në kolonën “Shtesë për kualifikime”, duke akorduar çdo muaj jo 20,000 lekë/muaj, sipas përcaktimeve në VKM, por 40,000 lekë/muaj (20,000 për shtesën për kualifikim, 20,000 për detyrimin e prapambetur).

Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.

### **Mbi akordimin e “shtesës për kualifikim” për Komisionerin**

Në relacionin nr. 1610/1 prot., datë 28.09.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës citon se: “Lidhja 2/1 e VKM nr. 187, datë 08.03.2017... përcakton se përfitojnë shtesë mbi pagë, ndër të tjera, Drejtorët e Përgjithshëm dhe Titullarët e Institucioneve të Pavarura”.

Në lidhjen 2/1 të këtij akti përcaktohen pozicionet e nëpunësve që përfitojnë shtesën për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor. Në listën e pozicioneve që mund të përfitojnë këtë shtesë për kualifikim, përfshihen, ndër të tjerë, Drejtorët e Përgjithshëm, por jo titullarët e institucioneve të pavarura.

*Për sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se miratimi dhe akordimi i shtesës për kualifikim për titullarin e institucionit është i pambështetur ligjërisht.*

### **Mbi akordimin e “shtesës për kualifikim” për Drejtorët e Përgjithshëm**

Për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm, referuar Lidhjes 2/1 të VKM nr. 817, datë 08.03.2017, parashikohet shtesa për kualifikimet, si më poshtë:

Nr.	Kualifikimi/ Grada/ Titulli shkencor	Shtesa (lekë/ muaj)
1.	Doktor i shkencave	20,000
2.	Doktor i shkencave në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të MA, DAP, MF	25,000
3.	Studime postmaster, sipas përcaktimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës <b>në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Departamentit të Administratës Publike dhe ministrit të Financave.</b>	20,000
	Të barasvlershme me studimet postmaster <b>në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të Arsimit, Departamentit të Administratës Publike dhe ministrit të Financave.</b>	
	Diplomat master të lëshuara në <b>sistemin anglo-sakson.</b>	
	Diplomat master të fituara në përfundim të programeve universitare që realizohen me jo më pak se 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit akademik <b>në një nga vendet e listës bashkëlidhur udhëzimit të përbashkët</b> , vetëm për nëpunësit e diplomuar më parë në programet e studimeve universitare, që kanë zgjatur minimumi 4 vite akademike (8 semestra) para zbatimit të sistemit të Bolonjës dhe nëpunësit që kanë përfunduar programet e studimeve të ciklit të dytë sipas sistemit të Bolonjës.	

Bazuar në dokumentacionin pjesë të dosjes së personelit, si dhe relacionin nr. 1610/1 prot., datë 28.09.2022 të Drejtorit të Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, grupi i auditimit vlerëson se asnjë nga Drejtorët e Përgjithshëm nuk plotëson kushtet për të përfituar shtesën për kualifikim.

- Znj. M., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave, zotëron diplomë nga Universiteti i Tiranës si “juriste” para zbatimit të sistemit të Bolonjës, Diplomë Master Profesional në Administrim Publik, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.
- Znj. H., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm për të Drejtën e Informimit, zotëron diplomë nga Universiteti i Tiranës si “juriste” para zbatimit të sistemit të Bolonjës, Diplomë Master Shkencor në të Drejtë Kushtetuese të Krahasuar dhe Evropiane nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;

1. Kualifikimi “*Master profesional*”, pjesë e dosjes personale së Drejtorit të Përgjithshëm P. M., trajtuar në relacionin e njësisë menaxhuese për burimet njerëzore, nuk konsiderohet Master i Nivelit të Dytë apo ekuivalent me Masterin ekzekutiv, pra nuk përmbush kriteret për t’u konsideruar “post-master”, në zbatim të nenit 124 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007.

2. Grupi i auditimit vlerëson se, në asnjë nga rastet e mësipërme, kualifikimi post-master i zotëruar nga dy punonjësit e mësipërm nuk përputhet me përshkrimin e punës dhe detyrat funksionale të punonjësve. Ky filtër, në zbatim të pikës 2, gërma c, të VKM nr. 817, datë 08.03.2017 duhej të ishte ushtruar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, që në momentin e parë të paraqitjes së kërkesës.

3. Asnjë prej diplomave, pjesë të dosjeve personale të punonjësve, nuk rezulton të jetë përfutuar në vendet pjesë në listën e vendeve të përcaktuara në Aneksin bashkëlidhur Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, nr. 1, datë 16.03.2012, ku përcaktohet lista e vendeve për të cilat nëpunësve civilë/ nëpunësve dhe funksionarëve do t'u njihet e drejta e shpërblimit për studimet "Postmaster" dhe "Doktor i shkencave".

Për sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se kualifikimet e zotëruara nga Drejtorët e Përgjithshëm, pjesë të dosjeve të personelit, nuk përmbushin kriteret e përcaktuar në VKM nr. 817, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/ nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar, dhe akordimi i shtesës për kualifikim për dy drejtorët e përgjithshëm është i pambështetur ligjërisht.

Mbi sa trajtuar më sipër, nëpërmjet observacionit mbi Projekt-Raportin e Auditimit, administruar në KLSH me nr. 247/7 prot., datë 22.07.2024, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shprehet se mban të njëjtin qëndrim me observacionin e dërguar mbi Akt-Konstatimin nr. 10, datë 17.05.2024, administruar në KLSH me nr. 247/5 prot., datë 28.05.2024, si më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

1. Zyra e KDIMDP pretendon se kualifikimet lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me pozicionin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit.
2. Sa i takon pikës 1, Zyra e KDIMDP shprehet se diploma DIND që P. M. zotëron është ekuivalente me Master Shkencor.
3. Sa i takon pikës 3, Zyra e KDIMDP shprehet se mbështetet gjithashtu në qëndrimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës, konkretisht në Vendimin nr. 00-2016-2736 (501) datë 11.10.2016, lidhur me një mosmarrëveshje gjyqësore, e cila kishte në themel të saj një kërkesë të njëjtë, ku ka arsyetuar dhe vendosur në favor të akordimit të shtesës mbi pagë për kërkuesit përkatës, të cilët kanë kryer studime postmaster në Shqipëri.
4. Zyra e KDIMDP sjell në vëmendje diplomën Master i ciklit të tretë të studimeve, që konsiderohet master ekzekutiv, për z. D..

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

1. Grupi i auditimit vlerëson se, jo vetëm që përputhja ose jo me pozicionin nuk është vlerësuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në momentin e trajtimit të kërkesës, por vijon të mos argumentohet.
2. DIND konsiderohet ekuivalente me diplomë të nivelit Master Shkencor; bazuar në nenin 124, pika 3, të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", por jo ekuivalente me master ekzekutiv (postmaster).
3. Nga auditimi nuk rezulton që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në Vendimin nr. 00-2016-2736 (501) datë 11.10.2016, të ketë konkluduar me sentencë njësuere, por ka trajtuar dhe është shprehur vetëm për çështjen specifike.
4. Titullari i institucionit të pavarur nuk përfshihet te pozicionet e mundshme për të përfutuar këtë shtesë për kualifikim dhe qëndrimi i grupit të auditimit është që kjo shtesë e akorduar për titullarin është e pambështetur ligjërisht.



*Për sa më sipër, ky observacion nuk merret parasysh.*

***Për veprimet pas shfuqizimit të VKM nr. 817, datë 08.03.2017***

Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë...” është shfuqizuar VKM nr. 817, datë 08.03.2017. Në këtë akt nuk parashikohet më shtesë për kualifikim. Në pikën 2 të Udhëzimit të MFE nr. 16, datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 325, datë 31.05.2023...” përcaktohet shprehimisht se shtesa për kualifikim nuk është më element i pagës mujore.

Pavarësisht kësaj, referuar listëpagesave të vëna në dispozicion, grupi i auditimit konstatoi se Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës ka vijuar të përfshijë këtë shtesë si element të pagës së punonjësve të sipërpërmendur, edhe pas shfuqizimit të aktit, me nga 40,000 lekë/muaj për secilin prej tyre.

*Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

Mbi sa trajtuar më sipër, nëpërmjet observacionit mbi Projekt-Raportin e Auditimit, administruar në KLSH me nr. 247/7 prot., datë 22.07.2024, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shprehet se mban të njëjtin qëndrim me observacionin e dërguar mbi Akt-Konstatimin nr. 10, datë 17.05.2024, administruar në KLSH me nr. 247/5 prot., datë 28.05.2024, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Lidhur me konstatimin e mësipërm, bëjmë me dije se nëpunësit që kanë përfituar pagesën për kualifikim nuk e kanë përfituar atë pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit dhe nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar. Paga që ju evidentoni në listëpagesë për muajt Maj 2023 e në vijim i takon periudhave të prapambetura që nga momenti i lindjes së të drejtës, bazuar në nenin 203 të ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në asnjë moment, pagesat e pretenduara se i takojnë periudhave të prapambetura, nuk janë njohur e regjistruar si detyrim i prapambetur nga Zyra e KDIMDP, por kanë vijuar të likuidohen në mënyrë të njëjtë në kolonën “Shtesa për kualifikim”, edhe pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 dhe Udhëzimit të MFE nr. 16, datë 16.06.2023, ku përcaktohet shprehimisht se shtesa për kualifikim nuk është më element i pagës mujore.

*Për sa më sipër, ky observacion nuk merret parasysh.*

**Konkluzion**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me frymën e Ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, që synon përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe duke shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Bazuar në dispozitat e trajtuara më sipër të VKM nr. 817, datë 08.03.2017, si dhe nenin 2, 8, 12 të Ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për miratimin dhe aplikimin e shtesës për kualifikim për punonjësit e sipërpërmendur ngarkohen me përgjegjësi z. B. D., me detyrë Komisioner, dhe znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, në rolin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

Që nga hyrja në fuqi e Urdhrit të Komisionerit nr. 162, datë 29.09.2022, referuar listëpagesave të Zyrës së KDIMDP, punonjësit kanë përfituar shtesat për kualifikim, si më poshtë:

Nr.	Punonjësi	Pozicioni	Shtesa/ muaj	Periudha	Shtesa totale për kualifikim
1.	B. D.	Komisioner	40,000	Shtator 2022 – dhjetor 2023	<b>640,000</b>
2.	E. H.	Drejtor i Përgjithshëm	40,000	Shtator 2022 – dhjetor 2023	<b>640,000</b>
3.	P. M.	Drejtor i Përgjithshëm	40,000	Shtator 2022 – dhjetor 2023	<b>640,000</b>
<b>TOTALI</b>					<b>1,920,000</b>

Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë **1,920,000 lekë**, deri në muajin dhjetor 2023, për buxhetin e shtetit. Për sa më sipër:

**1.** Punonjësit që kanë përfituar në mënyrë të padrejtë dhe të pambështetur ligjërisht shtesën për kualifikim, në dëm të buxhetit të shtetit, bazuar në përcaktimet e nenit 655 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, detyrohen të kthejnë shumën totale të përfituar përgjatë periudhës së auditimit, në total **1,920,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023, sipas përfitimeve respektive, si në vijim:

- B. D., me detyrë Komisioner, në vlerën prej **640,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023;
  - E. H., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, në vlerën prej **640,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023;
  - P. M., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, në vlerën prej **640,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023.
- 2.** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve korrigjuese (kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht nga punonjësit) edhe përtej periudhës së auditimit, nëse kjo situatë ka vijuar, si dhe të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme përfshirjen e shtesës për kualifikim si element të pagës së punonjësve.

### **Gjithashtu nga auditimi rezultoi se:**

Nga auditimi u konstatua se Komisioneri për të tre vitet objekt auditimi ka dhënë shpërblime financiare për stafin duke vetëshpërblyer dhe veten e tij, si me poshtë:

- Me urdhër shpenzimin nr. 281-284, datë 22.12.2021, në shumën 816,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, ku vlerë e përlllogaritur është 960,000 lekë për 42 punonjës, mbajtur tatim në burim në vlerën 14,400 lekë.

Pagesat e shpërblimeve është bërë bazuar në Urdhrin e Komisioneri me nr. 202, datë 20.12.2021 dalë nga Komisioneri *“Për mbështetje financiare të stafit të zyrës së komisionerit të së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale”* me argumentimin se:

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 9887 date 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, në baze të së cilit Komisioneri ka buxhetin e tij të pavarur, i cili mund të financohet nga donatore që nuk paraqesin konflikt interesi, dhe bazuar në gjendjen e fondeve në dispozicion, si rezultat i kontributeve për mbështetjen e Zyrës së Komisionerit nga donatore vendas dhe të huaja, për angazhimin e treguar dhe kontributin e dhënë gjatë vitit 2021, në kuadër të festave të fund viti, si dhe në formën e mbështetjes për ndikimin negativ që situata e krijuar nga përhapja e Covid- 19 ka krijuar në situatën financiar të punonjësve.

- Me urdhër shpenzimin nr. 264-267, datë 30.12.2022 në shumën 1,150,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, për 46 punonjës në vlerën 25,000 lekë.

Pagesat e shpërblimeve është bërë bazuar në Urdhrin e Komisioneri me nr. 244, datë 30.12.2022 *“Për mbështetje financiare të stafit të zyrës së komisionerit të së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale”* me argumentimin se:

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, në bazë të së cilit Komisioneri ka buxhetin e tij të pavarur i cili mund të financohet nga donatore që nuk paraqesin konflikt interesi, dhe bazuar në gjendjen e fondeve në dispozicion,

si rezultat i kontributeve për mbështetjen e Zyrës së Komisionerit nga donatorë vendas dhe të huaj, për angazhimin e treguar dhe kontributin e dhënë gjatë vitit 2022 në realizimin me sukses të objektivave institucionale, si dhe në kuadër të procesit të integritetit të vendit, të takimeve shpjeguese dhe dypalëshe BE-Shqipëri.

- Me urdhër shpenzimit nr. 240-243, datë 28.12.2023 në shumën 2,400,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, nga të cilat, në vlerën 50,000 lekë për 44 punonjësit e përhershëm të komisionerit, si dhe për punonjësit mbështetës brenda dhe jashtë strukturës, si dhe 25,000 lekë për 8 punonjësit e rekrutuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2023.

***Nga institucioni nuk është mbajtur dhe llogaritur as tatim mbi të ardhurat e përfituara.***

Pagesat e shpërblimeve është bërë bazuar në Urdhrin e Komisioneri me nr. 216, datë 26.12.2023 “Për mbështetje financiare të stafit të zyrës së komisionerit të së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale” me argumentimin se

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, në bazë të së cilit Komisioneri ka buxhetin e tij të pavarur, i cili mund të financohet nga donatorë që nuk paraqesin konflikt interesi, dhe bazuar në gjendjen e fondeve në dispozicion, si rezultat i kontributeve për mbështetjen e Zyrës së Komisionerit nga donatorë vendas dhe të huaj, për angazhimin e treguar dhe kontributin e dhënë gjatë vitit 2023 në realizimin me sukses të objektivave institucionale, si dhe në formë mbështetje për ndikimin negativ që rritja e inflacionit ka krijuar në situatën financiare të punonjësve.

**Sa më sipër**, akti i miratimit të shpërblimeve nga Komisioneri ndaj vetës së tij është në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 108, si dhe Ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar neni 4.

Ndërsa shpërblimi i administratës së Zyrës së Komisionerit është në kundërshtim me VKM-në me nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, pika 9, me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 224 dhe 225, ku për vlerën e përdorur nuk është përgatit “Kërkesën për rritje të autorizuar”.

### **Gjithashtu:**

- Me urdhër shpenzimit nr. 261-262, datë 29.12.2023 në shumën 630,347 lekë janë dhënë shpërblim për 4 punonjësve bazuar në VKM-në me nr. 795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të ACQUIS, në kuadër të procesit të negocimit me Bashkimin Evropian”. Fondi për shpërblimet është alokuar në llogarinë 600 “Shpenzime personeli”. Nga zyra komisioneri për shpërblime është mbajtur tatim në burim në vlerën 15%.

- Me urdhër shpenzimit nr. 255-256, datë 29.12.2023 në shumën 50,000 lekë janë dhënë shpërblim punonjësve bazuar në VKM-në me nr. 834, datë 28.12.2023 “Për një ndryshim të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar” pika 1 gërma a. Nga zyra komisioneri për shpërblime është mbajtur tatim në burim në vlerën 15%. Fondi për shpërblimet është alokuar në llogarinë 600 “Shpenzime personeli”.

*Nga Drejtori e Financës dhe Shërbimeve kjo shumë duhet të ishte trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e punonjësve dhe jo të mbahej tatim në burim.*

**Sa më sipër veprime në kundërshtim me:**

- Neni 8 dhe neni 9 pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i

ndryshuar dhe shfuqizuar me ligjin me nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” neni 12, i cili shtrin efektet nga data 1 janar 2024.

- Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar paragrafi 2.3 “Të ardhurat e tatueshme” pika 2.3.1, i shfuqizuar me Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” paragrafi 12 “Të ardhurat nga punësimi”, i cili ka hyrë në fuqi nga data 1.1.2024.

*Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi z. B. D. me detyrë Komisioner dhe znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

## **2.6 Prokurimet me fonde publike.**

Auditimi u krye me zgjedhje<sup>6</sup>.

Për vitin 2021 janë zhvilluar 27 procedura prokurimi me vlerë 8,838 mijë lekë.

Për vitin 2022, janë zhvilluar 37 procedura prokurimi me vlerë 18,620 mijë lekë.

Për vitin 2023, janë zhvilluar 42 procedura prokurimi me vlerë 23,766 mijë lekë.

Në mënyrë të detajuar si **Aneksin 1/3** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Në procedurat e audituara, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimi në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e procedurave të prokurimit, llogaritjen e fondit limit, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin, shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

*Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore, të cilat në mënyrë të detajuar për çdo procedurë prokurimi paraqiten si më poshtë vijon:*

### ***1. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë përdorur si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës dhe për të bërë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.***

Për vitin 2021 janë realizuar 21 procedura me vlerë të vogël në vlerën 9,931 mijë lekë.

Për vitin 2022 janë realizuar 33 procedura me vlerë të vogël në vlerën 13,919 mijë lekë.

Për vitin 2023 janë realizuar 36 procedura me vlerë të vogël në vlerën 16,130 mijë lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Autoriteti Kontraktor në përcaktimin e kufirit monetar, në procedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla, nuk ka marrë në konsideratë llogaritjen e grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure. Në këtë kontekst, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë përdorur si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës dhe për të bërë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.

---

<sup>6</sup> *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

*Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”*

Konkretisht procedurat e poshtëshënuara janë zhvilluar më vehte, në fakt duhet të ishin grupuar si më poshtë vijon dhe duhet të ishte zhvilluar prokurimi në një nga procedurat e prokurimit të referuar Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 1.

### **Viti 2021**

-1. Blerje siguracion TPL, fondi limit 220,000 lekë, vlera e kontratës 218,900 lekë, data e zhvillimit të procedurës 24/12/2020, operatori fitues shoqëria “I.” SH.A .

- 2. Shërbime sigurimi, fondi limit 100,000 lekë, vlera e kontratës 35,394 lekë, data e zhvillimit të procedurës 09/07/2021, operatori fitues shoqëria “I.” SH.A .

- 3. Sigurim ndërtese nga dëmtimet e ndodhura nga kushtet atmosferike, fondi limit 800,000 lekë, vlera e kontratës 784,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 21/12/2020, operatori fitues shoqëria “A.”.

### **Shuma 1,120,000 lekë.**

-1. Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar (IT etj), fondi limit 800, 000 lekë, vlera e kontratës 79,600, data e zhvillimit të procedurës 03/12/2021, operatori fitues shoqëria “P. S.”.

-2. Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit, fondi limit 750, 000 lekë, vlera e kontratës 548,000, data e zhvillimit të procedurës 08/04/2021, operatori fitues shoqëria “S. P.”.

-3. Shërbim IT Platforme webeks abonim vjetor, fondi limit 100, 000 lekë, vlera e kontratës 99,000 data e zhvillimit të procedurës 08/04/2021, operatori fitues shoqëria “P. S.”.

### **Shuma 1,426,600 lekë.**

1. Blerje pajisje kompjuterike për vitin 2021, fondi limit 800, 000 lekë, vlera e kontratës 72,1590 lekë, data e zhvillimit të procedurës 09/04/2021, operatori fitues shoqëria “P. S.”.

2. Blerje toner për printer lazer /makina fax, toner për makinat fotokopjuese, fondi limit 400, 000 lekë, vlera e kontratës 341,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 19/10/2021 operatori fitues shoqëria “I. O.”.

### **Shuma 1,200,000 lekë.**

1. Shërbime It: konsulenca, zhvillimi i softwareve, internet dhe shërbimet e suportit, fondi limit 100, 000 lekë, vlera e kontratës 100,000 lekë, operatori fitues shoqëria “T. A.”.

2. Platforma kompjuterike, Infrastruktura komunikimi, Programim të programeve kompjuterike dhe konsulence, zhvillimi i softwareve për përpunimin e transaksioneve dhe softwareve të personalizuar, fondi limit 990,720 lekë, vlera e kontratës 950,400 lekë, data e zhvillimit të procedurës 23/09/2021, operatori fitues shoqëria “S. P.”.

### **Shuma 1,200,000 lekë.**

### **Viti 2022.**

1. Ekspertizë e fushës në hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative, fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 990,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 07/12/2022, personi fizik “F. P.”.

2. Hartimin e kurrikulës për nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave personale/formim profesional, fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 980,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 07/12/2022 personi fizik “F. P.”.

### **Shuma 2,000,000 lekë.**

1. Blerje pajisje sigurie firewall për mbrojtjen e rrjetit të të dhënave për KDIMDP, fondi limit 916,000 lekë, vlera e kontratës 796,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 23/12/2022, operatori fitues shoqëria “P.S.”.

2. Pajisje zyre përveç mobiljeve, pajisje kompjuterike dhe furnizime, pajisje kompjuterike, mobilje dhe pajisje të ndryshme, fondi limit 833,333lekë, vlera e kontratës 789, 000lekë, data e zhvillimit të procedurës 07/10/2022, operatori fitues shoqëria “P. S.”.

3. Pajisje kompjuterike dhe furnizime, pajisje kompjuterike, fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 956,900 lekë, data e zhvillimit të procedurës 20/12/2022, operatori fitues shoqëria “P. S.”.

**Shuma 2,749,333 lekë.**

1. Shërbime informatike: Konsulencë, zhvillim programesh, internetit dhe suportit, shërbime mirëmbajtjeje, fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 750,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 31/01/2022 operatori fitues shoqëria “E. P.”.

2. Mirëmbajtje aparatura të ndryshme në zyra, fondi limit 400,000 lekë, vlera e kontratës 352,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 07/12/2022, operatori fitues shoqëria “P. S.”.

3. Mirëmbaje e sistemit alpha buxhetor, fondi limit 100,000 lekë, vlera e kontratës 98,206 lekë, operatori fitues shoqëria “I. M. B.”.

4. Shërbimi Upgrade dhe mirëmbajtje portali, fondi limit 980,000 lekë, vlera e kontratës 950,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 18/03/2022, operatori fitues shoqëria “S. P.”.

**Shuma 1,500,000 lekë.**

1. Shërbime për siguracion mjetesh motorike, fondi limit 300,000 lekë, vlera e kontratës 241,650 lekë, data e zhvillimit të procedurës 21/01/2022, operatori fitues shoqëria “I.”, Sh.a.

2. Sigurim ndërtese nga dëmtimet, fondi limit 980,000 lekë, vlera e kontratës 955,900 lekë, data e zhvillimit të procedurës 21/01/2022, operatori fitues shoqëria “A.”, Sh.a.

**Shuma 1,280,000 lekë.**

**Viti 2023**

1. Blerje letër format A4, fondi limit 500,000 lekë, vlera e kontratës 201,348 lekë, data e zhvillimit të procedurës 20/12/2023, operatori fitues shoqëria “I. O.”.

2. Blerje materiale kancelerike, fondi limit 400,000 lekë, vlera e kontratës 185,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 22/12/2023, operatori fitues shoqëria “I. O.”.

3. Libra të shtypur, broshura dhe fletëpalosje, fondi limit 800,000 lekë, vlera e kontratës 349,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 05/04/2023, operatori fitues shoqëria “G. L.”.

**Shuma 1,700,000 lekë**

1. Krijim dhe dizajnim i faqes për "Konferenca e 15 ndërkombëtare e informimit (ICIC)", fondi limit 800,000 lekë, vlera e kontratës 650,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 21/11/2023, operatori fitues shoqëria “T. D. A.”.

2. Organizim i konferencës së pestë kombëtare e informimit - 15 vjet institucion, fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 920,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 09/05/2023 operatori fitues shoqëria “T. D. A.”.

3. Konceptim dhe realizim video/spot për promovimin e konferenca e 15 ndërkombëtare e Informimit (ICIC), fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 890,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 12/12/2023, operatori fitues shoqëria “N. M.” (ku përfitues fundor, me 49% të aksioneve, referuar ekstraktit historik të QKB, rezulton shoqëria “T. D. A.”).

4. Shërbime për brandim/dizajnim logo dhe materiale për "Konferenca e 15 ndërkombëtare e Infomimit (ICIC), fondi limit 850,000 lekë, vlera e kontratës 750,000 lekë data e zhvillimit të procedurës 12/12/2023, operatori fitues shoqëria “N. M.” (ku përfitues fundor, me 49% të aksioneve, referuar ekstraktit historik të QKB, rezulton shoqëria “T. D. A.”).

5. Shërbime për krijim programesh për editim të faqeve të internetit, shërbimet e projektimit të faqeve për world wide web (www), fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 960,000 lekë data e zhvillimit të procedurës 26/09/2023, operatori fitues shoqëria “T. D. A.”.

6. Shërbime prodhim video sensibiluese për zyrën e KDIMDP, fondi limit 800,000 lekë, vlera e kontratës 760,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 04/05/2023, operatori fitues shoqëria “N.

M.” (ku përfitues fundor, me 49% të aksioneve, referuar ekstraktit historik të QKB, rezulton shoqëria “T. D. A.”).

7. Shërbime regjistrimi për konferencën e 15-të ndërkombëtare të informimit (ICIC), fondi limit 1,000,000 lekë, vlera e kontratës 740,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 21/11/2023, operatori fitues shoqëria “T. D. A.”.

Referuar sa më sipër, në 7 procedura prokurimi, me vlerë totale 6,450,000 lekë, përfituesi është i njëjti operator, pra shoqëria “T. D.A.”.

#### **Shuma 6,450,000 lekë.**

1. Sigurim godine KDIMDP, fondi limit 1,000,000, vlera e kontratës 960,000 lekë, data e zhvillimit të procedurës 07/02/2023, operatori fitues shoqëria “A.”, Sh.a.

2. Blerje siguracioni mjete motorike, fondi limit 350,000, vlera e kontratës 299,794 lekë, data e zhvillimit të procedurës 02/02/2023, operatori fitues shoqëria “I.”, Sh.a.

#### **Shuma 1,350,000 lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 41 “Procedurat standarde të prokurimit”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Pavarësisht nëse vlera e përlogaritur e kontratës është në kufirin e prokurimeve me vlerë të vogël, autoritetet ose entet kontraktore mund të zgjedhin të zhvillojnë një nga procedurat e prokurimit të përcaktuara në pikën 1, në përputhje me parashikimet e këtij ligji”*.

pika 1 shprehet në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti ose enti kontraktor në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj.*

*Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:a) procedurë e hapur;b) procedurë e kufizuar;c) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;ç) partneritet për inovacion;d) dialogu konkurrues;*

*dh) procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;e) procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;ë) procedurë e hapur e thjeshtuar;f) shërbim konsulence”*.

-VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 52:

- Pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.*

*Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup- mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”*.

Pika 11, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Në asnjë rast, autoriteti/enti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit”*.

-Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 të APP-së, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti/enti kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përlogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh, nuk duhet të jenë më e madhe se 1.000.000 lekë në vit”*.

-Ligjin nr. 9643 , datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1 është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Objekti dhe qëllimi”*

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 21.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b ku është shprehur në ligjëratë të drejt “Sigurimin e përdorimit me efizienzë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike që ai menaxhon. Nëpunësi autorizues vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”:

- Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, ku është shprehur në ligjëratë të drejt “Titullarët e njësive publike, të përmendura në Nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë.

-Neni 2 “Qëllimi i Ligjit” Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”.

Neni 52 “Kryerja e shpenzimeve” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik”.

Për mos maksimalizim dhe efizienzë dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit nr. 9643 , datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b dhe neni 20, ngarkohet me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.

2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion procedurën Blerje automjete, për vitin 2021, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Blerje automjete		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 3, prot, datë 17.03.2021	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit Urdhër Nr. 3, prot, datë 17.03.2021	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 29 prot, datë 17.03.2021



2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	- P.B. - N. S. - M. T.	- B. Xh - A. Gj - N. B
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,998,324 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh)  2,986,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)  12,324 leke
8. Data e hapjes së tenderit 29.03.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e Intitucionit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _1__OE a) Kualifikuar _1__OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 486/19 prot., më datë 16.04.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 3,583,200 lekë	

Me urdhër nr. 3 prot., datë 17.03.2021 të B. D. me detyrë Komisioner, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është urdhëruar të kryhet procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me fond limit 2,998,324 lekë, dhe njësia e prokurimit e përbërë nga P. B. me profesion juriste, N. S. me profesion IT dhe M. T. person i jashtëm specialist i fushës inxhinier mekanik.

Me urdhër nr. 34 prot., datë 05.12.2022 të B. D. me detyrë Komisioner, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është urdhëruar ngritja e komisionit të vlerësimit të ofertave të përbërë nga B. Xh., A. Gj. dhe N. B. person i jashtëm specialist i fushës inxhinier mekanik.

Me procesverbal të protokolluar nr. 486/3 prot., datë 17.03.2021, grupi i punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, i përbërë nga P. B. me profesion juriste, M. T. specialist i jashtëm me profesion inxhinier mekanik dhe E. M. me profesion ekonomiste ka përcaktuar vlerën 2,998,324 lekë pa TVSH, duke marr mesataren e tre ofertave, pas ofertës në çmim mesatar të ofruar nga operatorët “O. A.” me ofertë në vlerën 1.500,000 lekë, “T. C. C.” me ofertë në vlerën 1.502.486 lekë, “P. A.” me ofertë në vlerën 1,495,000 lekë.

Me procesverbal të protokolluar nr. 486/8 prot., datë 18.03.2021, grupi i punës i përbërë nga P. B., N. S. dhe M. T. ka bërë miratimin e kriterëve për kualifikim.

Në procesverbal, është cituar “Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, e cila shërben për të parë nëse operatori ekonomik ka shlyer gjithë detyrimet e energjisë elektrike, për të njohur gjendjen financiare dhe të mundësisë së tyre të përmbushjes me sukses të kontratës”.

Referenca në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, në vlerësimin e grupi të auditimit është e gabuar, pasi ky ligj është ç fuqizuar me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 135 “Shfuqizime”.

Në këtë procesverbal nuk është argumentuar në referencë ligjore/nënligjore vendosja e kriterëve/specifikimeve, të poshtëshënuara:

- a. Automjete me kilometrazh jo më shumë se 60.000 km.

-b. Automjete jo më parë se viti 2018.

-c. Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3.7 “Kapaciteti teknik” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara dhe servisin si në pikën 2.3.6, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë,

operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Vendosja e këtij kriteri/specifikimi është në keqinterpretim me:

- Rekomandimin Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.

-Ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 dhe 77.

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 28, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me Nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”.

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” apo “Super specifikimit” Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendim Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” apo “Super specifikimin” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

*Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mall/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.*

*Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, ç’ka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.*

-d. Për të verifikuar kilometrazhin e automjeteve me jo më shumë se 60.000 km, në kriteret/specifikimet teknike dhe në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023,

nuk është përcaktuar se çfarë dokumentacioni do të paraqes operatori ekonomik ofertues; Si: test teknik nga drejtorja e shfrytëzimit të mjeteve, libër shërbimi etj.

Si pasojë e mos përcaktimit të asnjë dokumenti, automjetet janë marr në dorëzim vetëm mbi bazën e fotove të leximit të matësit të kilometrave në korskotë:

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, nenin 61, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite: *"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit"*, çka ngarkon me përgjegjësi anëtarin e njësisë së prokurimit M. T. person i jashtëm specialist i fushës inxhinier mekanik. Përgjegjësi e përcaktuar referuar ndarjes së detyrave të përcaktuar në procesverbalin nr. 486/3 prot, datë 17.03.2021 të njësisë së prokurimit, si dhe shkresës së M. T. që i ka drejtuar Zyrës së Komisionerit me nr. 486/2 prot., datë 15.03.2021 për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, nuk është përcaktuar se automjetet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së automjeteve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”*.

Kontrata e nënshkruar L. M. me detyrë drejtor i shërbimeve të Brendshme dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues me autorizim të Komisionerit nr. 486/18 prot., datë 16.04.2021, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 19, 20 dhe 21, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 12, 13, 15 dhe 22 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”, pika 2.1.2, pika 3.

**Theksojmë** se referuar Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, delegimi nuk *shkarkon përgjegjësinë administrative të Titullarit*. Konkretisht në pikën 4 është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Delegimi i të drejtave dhe i detyrave sipas përcaktimeve të këtij ligji nuk çënon të drejtat e menaxherit dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat”*.

*Zhvillimi i procedurës së prokurimit.*

Në këtë procedurë prokurimi ka marr pjesë vetëm një operator ekonomik, konkretisht “A.” Shpk. Raporti përmbledhës është me nr. 486/14 prot., datë 31.03.2021 firmosur nga KVO dhe njësisia e prokurimit.

Me këtë raport është shpallur fitues operatori ekonomik “A.” shpk me ofertë në vlerën 2,986,000 lekë.

Në Shtojcën 9 “Specifikimet teknike” është përcaktuar ajër i kondicionuar; klima me shpërndarje të automatizuar.

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi: shoqëria “A.” shpk ka paraqitur në specifikimet teknike për makinat “Peugeot 308 aktive , ajër të kondicionuar automatik (2 zona) dhe jo ajër i kondicionuar; klima me shpërndarje të automatizuar.

Referuar sa më sipër: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik shoqëria “A.” shpk, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 46.

*Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi N. B. anëtar i KVO specialist i fushës i jashtëm me profesion inxhinier mekanik.*

Kontrata me operatorin ekonomik “A.” shpk, është lidhur me Nr. 486/19 prot., datë 16.04.2021 ndërmjet Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale të përfaqësuar nga L. M. me detyrë drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dhe operatorit/e shoqërisë “A.” shpk përfaqësuar nga administrator B. D. për vlerën 3,583,200 lekë me TVSH, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Nga autoriteti kontraktor nuk është hartuar plani i zbatimit të kontratës, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

-Neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj*”.

-Neni 125, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite e “Autoriteti ose enti kontraktor njofton Agjencinë e Prokurimit Publik për nënshkrimin e planit të zbatimit brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij”.

Edhe pse në deklaratën e garancisë nga shoqëria “A.” shpk datë 29.03.2021 është përcaktuar garancia me një afat 1 vjeçar ose 30,000 km duke filluar nga data e dorëzimit, por pa vlerë, nuk është përcaktuar në kontratë dhe nuk është mbajtur asnjë lekë për këtë garanci, duke riskuar në këtë mënyrë që operatori ekonomik mund të mos kryej shërbimin e kontraktuar, për arsye nga më të ndryshmet përfshi dhe ndonjë faliment të mundshëm, duke riskuar në këtë mënyrë që Zyra e Komisionerit të harxhoj fonde të tjera.

*Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

Në kontratën e furnizimit Nr. 486/19 prot., më datë 16.04.2021, nuk është përcaktuar se automjetet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së automjeteve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat*”, që

*shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

*Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

#### Zbatimi i kontratës

Në kontratën e lidhur si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës”.*

*Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

Me urdhër të Komisionerit nr. 52, datë 22.04.2021 është ngritur grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga A. L. me profesion jurist, A. B. me arsim të mesëm dhe N. B. me profesion inxhinier mekanik.

Me urdhër shpenzimin nr.102 datë 11.05.2021 për vlerën 3,583,200 lekë, është likuiduar shoqëria “A.” Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me blerje automjete”. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi: Faturë elektronike nr. 8/2021, date 27.04.2021 për vlerën 3,583,200 lekë, procesverbal i marrjes e dorëzim datë nr.486/23 prot., datë 27.04.2021 nga A. L., A. B. dhe N. B., fletë hyrje nr. 4, datë 27.04.2021, Kontrata nr. 486/19 prot., datë 16.04.2021 deklarata e garancisë për një afat 2-vjecar.

Edhe pse në kriteret/specifikimet teknike dhe në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, për të verifikuar kilometrazhin e automjeteve me jo më shumë se 60.000 km, nuk është përcaktuar se çfarë dokumentacioni do të paraqes operatori ekonomik ofertues si: test teknik nga drejtorja e shfrytëzimit të mjeteve, libër shërbimi etj, grupi i marrjes në dorëzim i ka marr automjetet në dorëzim vetëm mbi bazën e fotove të leximit të matësit të kilometrave në korskotë, foto e cila nuk është dokument i besueshëm për tu marr në konsideratë për saktësinë/vërtetësinë e numrit t kilometrazhit.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi N. B. anëtari i vetëm i grupit të marrjes në dorëzim, specialist fushe me profesion inxhinier mekanik.

Automjetet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Mos shoqërimi me raportet e testeve (test raportin e fabrikës) për automjetet, dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimin dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), nuk krijon mundësinë që të

konfirmohet që automjetet janë të njëjtë me ata të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria “A.” Shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690 dhe neni 710, pika 3, ku është shprehur në ligjëratë të drejt “*Të garantojë blerësin nga zhveshja, nga veset dhe nga mospërputhja e cilësive të sendit me kontratën*”.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122.

-VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar neni 73.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20.

Për mos maksimalizim dhe efikasitet dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar neni 73, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, dhe neni 20 ngarkohet me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.

**3. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për procedurën Rikonstruksion/riparime të ambienteve të KDIMDP, viti 2022, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:**

Rikonstruksion/riparime të ambienteve të KDIMDP		
1. Urdhër Prokurimi nr. 20, datë 27.09.2022	3. Hartimi i dokumenteve të tenderit Urdhër nr. 20, datë 27.09.2022 - I. A., juriste - V. I., juriste - D. B. ing. ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 161 prot, datë 28.09.2022 - B. N.; juriste - D. H.; jurist - A. N., ing. ndërtimi
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,500,036 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 5,417,534 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 82,502 leke
8. Data e hapjes së tenderit 17.10.2022	9. Burimi Financimit Donacion	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _3_ OE a) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. Nr. 1641/9prot., datë 04.11.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 6,501,041 lekë	

Me urdhër nr. 20, datë 27.09.2022 të B. D. me detyrë Komisioner, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është urdhëruar të kryhet procedura e prokurimit “Rikonstruksion/riparime të ambienteve të KDIMDP”, me fond limit 5,500,036 lekë, procedurë e hapur e thjeshtuar dhe njësia e prokurimit e përbërë nga I. A. me profesion juriste, V. I. me profesion juriste dhe D. B. person i jashtëm specialist i fushës inxhinier ndërtimi.

Me urdhër nr. 161, datë 28.09.2022 të B. D. me detyrë Komisioner, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është urdhëruar ngritja e komisionit të vlerësimit të ofertave e përbërë nga B. N. me profesion juriste, D. H. me profesion jurist dhe A. N. person i jashtëm specialist i fushës inxhinier ndërtimi.

Me procesverbal të protokolluar nr. 1641/2 prot., datë 28.09.2022, njësia e prokurimit e përbërë nga I. A., V. I. dhe D. B. ka bërë miratimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike. Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencë profesionale, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

-Operatori, duhet të disponojë dhe paraqesë licencën përkatëse në restaurim me 10 vjet përvojë.

Ky kriter është i ekzagjeruar dhe i pa argumentuar.

Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: .

Arkitekt 1 (një), Inxhinier Ndërtimi 1 (një), Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

Në stafin e mësipërm:

Inxhinier ndërtimi duhet të jetë i pajisur me licencë zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë të paktën 6 muajt e fundit.

Ky kriter është i ekzagjeruar dhe i pa argumentuar, pasi: Zotësia profesionale e operatorëve ekonomik është e ezauruar në kategoritë e zërave të punimeve të kërkuara si:

- NP – 1 A: Punime gjurmimi në tokë;
- NP – 3 A: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- NS – 1 A: Punime në prishjen e ndërtimeve.
- NS – 2 A: Impiante hidro-termosanitare, kuzhina, lavaxantieri, dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS – 4 A: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS – 8 A: Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri.
- NS – 14: Impjante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, Tv, etj.

Në opinionin e grupit të auditimit, referuar sa më sipër, licenca që operatori ekonomik disponon dhe paraqet, janë dëshmia se ai është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, se disponon kapacitetet dhe eksperiencën e mjaftueshme (edhe të drejtuesve teknik) për të kryer punimet e specifikuar në formularin e licencës që disponon, dhe për rrjedhim plotësimi i kërkesave të vendosura nga autoritetet kontraktor në lidhje me kategoritë dhe klasifikimet respektive që licencat profesionale duhet të përmbajnë, është kusht i mjaftueshëm për autoritetin kontraktor.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 39, pika 6/a ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret

dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, kreu III, pika 1/a , ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

"1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës,

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- Profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë”.

Në procesverbal për miratimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, protokolluar nr. 1641/2 prot., datë 28.09.2022, nuk është përcaktuar asnjë specifikim teknik për “Aspiratorin profesional 780 m<sup>3</sup>/h + Tub fleksibël inoksi Ø200-3m + Aksesore të ndryshëm montimi”.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi D. B. anëtar i njësisë së prokurimit si ekspert i fushës i jashtëm inxhinier ndërtimi.

Projekti dhe preventivi i këtij investim është hartuar nga shoqëria “R. C.” shpk.

*Zhvillimi i procedurë së prokurimit.*

Raporti përmbledhës është me nr. 17/10 prot., datë 17.10.2022 firmosur nga KVO.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë tre operatorë ekonomik, konkretisht operatori ekonomik “A. S.”, Shpk me ofertë në vlerën 5,417,534 lekë, operatori ekonomik “I.” Shpk me ofertë në vlerën 4,582,282 lekë dhe “S.” Shpk pa fertë ekonomike.

Me këtë raport është shpallur fitues operatori ekonomik “A. S.”, shpk me ofertë në vlerën 5,417,534 lekë.

Kontrata me operatorin ekonomik “A. S.”, Shpk, shpk është lidhur me Nr. 1641/9prot., datë 04.11.2022 ndërmjet Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale të përfaqësuar nga L. M. me detyrë drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dhe operatorit/e shoqërisë “A. S.”, shpk përfaqësuar nga administrator A. Ç. për vlerën 6,497,667 lekë me TVSH, me afat dy mujor.

Me autorizim nr. 1904, datë 03.11.2022, Komisioneri ka autorizuar L. M. njëkohësisht nëpunës zbatues, të nënshkruajë kontratat me subjektin “A. S.” shpk. Gjithashtu nëpunësi zbatues ka marrë në dorëzim shërbimin në rolin e anëtares së komisionit të marrjes në dorëzim të kontratës.

Autorizimi i nënshkrimit të kontratës është në kundërshtim me:

- Nenin 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, ku citohet se nëpunësi zbatues caktohet nga nëpunësi autorizues për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare.

- Nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, ku citohet se, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre, nëpunësit autorizues kanë të drejtën të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat te punonjësit e nivelit menaxherial në varësi direkte, me përjashtim të delegimit te nëpunësit zbatues.

- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “*Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve*”, pika 2.1.2, pika 3.

Plani i zbatimit të kontratës është hartuar me nr. 1641/10 prot., datë 09.11.2022 e firmosur nga L. M. me detyrë drejtor i Shërbimeve te Brendshme dhe Financës dhe operatorit/e shoqërisë “A. S.”, Shpk, përfaqësuar nga administrator A. Ç..

Plani i zbatimit të kontratës i nënshkruar nga L. M. me detyrë drejtor i Shërbimeve te Brendshme dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues me autorizim të Komisionerit nr. 486/18 prot., datë 16.04.2021, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “*Për menaxhimin e sistemit*



buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 19 , 20 dhe 21, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 12, 13, 15 dhe 22, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”, pika 2.1.2, pika 3.

*Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

*Zbatimi i kontratës*

Për kontratën e lidhur me operatorin ekonomik “A. S.”, Shpk me Nr. 1641/9prot., datë 04.11.2022, nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

-VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: Për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltitet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës”.

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës”.

*Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.*

Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të objektit është me nr. 231/2 prot., datë 10.03.2023 e firmosur nga A. Ç. administrator i shoqërisë “A. S.” shpk, mbikëqyrësi i punimeve “R. C.”, kolaudatori “S. Ç.” dhe L. M. me detyrë drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës. Procesverbali i marrjes në dorëzim të punimeve është mbajtur datë 31.03.2023 është firmosur nga V. K. me detyrë inspektore drejtoria e informimit, me profesion juriste, R. L. me detyrë Inspektor Drejtoria e vlerësimit të ankesave dhe harmonizimit me profesion jurist, A. B. me detyrë magazinier, L. M. me detyrë drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës me profesion ekonomiste dhe D. H. me detyrë përgjegjës sektori shërbimet dhe financa, me profesion jurist.

Çertifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim dhe proces verbali i marrjes në dorëzim i nënshkruar nga L. M. me detyrë drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues me autorizim të Komisionerit nr. 486/18 prot., datë 16.04.2021, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 19 , 20 dhe 21, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 12, 13, 15 dhe 22, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”, pika 2.1.2, pika 3.

Aspiratori profesional 780 m<sup>3</sup>/h + Tub fleksibël inoksi Ø200-3m + Aksesore të ndryshëm montimi”, është i pa shoqëruara me çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet vijuese të tij, nenet neni 419, 420, 476, 659, 698, 690 dhe neni 710, pika 3, ku është shprehur në ligjëratë të drejt “*Të garantojë blerësin nga zhveshja, nga veset dhe nga mospërputhja e cilësive të sendit me kontratën*”.

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 20, datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 54, ku është shprehur në mënyrë eksplicite “*Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.*”

- Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqëruar të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor*”.

Mos shoqërimi/mos paraqitja e çertifikatës së origjinës, raportet e testeve, certifikata e cilësisë, certifikata e garancisë për aspiratorin, nuk mund të provohet nga ana dokumentare që aspiratori është aspirator profesional me fuqi 780 m<sup>3</sup>/h për të cilën shoqëria “A. S.”, Shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve, kolauduarin e punimeve, grupin e marrjes në dorëzim përfundimtar dhe grupin e marrjes së përkohshme në dorëzim.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, por i kanë keq menaxhuar ato duke mos arritur qëllimin e tyre, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5.

- VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 73.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe neni 20.

Për mos maksimalizim dhe eficientësi dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b dhe neni 20, ngarkohet me përgjegjësi B. D. me detyrë Komisioner për të

Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, L. M. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.

4. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për procedurën *Ekspertizë e fushës në hartimin e metodologjisë për llogaritje e seksioneve administrative, viti 2022*, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Ekspertizë e fushës në hartimin e metodologjisë për llogaritje e seksioneve administrative”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 34 prot, datë 05.12.2022	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit Urdhër Nr. 34 prot, datë 05.12.2022 - I. A. - D. H. - V. I.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 34 prot, datë 05.12.2022 - I. A. - D. H. - V. I.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Blerje e vogël”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 960,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 40,000 leke
8. Data e hapjes së tenderit 07.12.2022	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2_ OE a) Kualifikuar _2_ OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 2053/3 prot, date 15.12.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 960,000 lekë	

Me shkresën nr. 2014 prot., datë 24.11.2022 B. N. me detyrë drejtoare e drejtorisë juridike, i është drejtuar B. D. me detyrë Komisioner, dhe për dijeni L. M. me detyrë drejtor i drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, kërkesë për hapje procedure prokurimi “Mbi domosdoshmërinë për hartimin e disa akteve nënligjore në kuadër të miratimit të projektligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Me Urdhër Nr. 34 prot., datë 05.12.2022 të B. D. me detyrë Komisioner, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është urdhëruar prokurimi me vlerë të vogël me objekt “Ekspertizë e fushës në hartimin e metodologjisë për llogaritje e seksioneve administrative”.

Me procesverbal të protokolluar nr. 2056/1 prot., datë 06.12.2022, grupi i punës për argumentimin e fondit limit, i përbërë nga L. Xh., M. C. dhe R. B. ka përcaktuar vlerën 1,000,000 lekë pa TVSH, duke marr mesataren e tre ofertave, pas ofertës në çmim mesatar të ofruar nga operatorët “S. L. B.” në vlerën 960,000 lekë, “S. L. J.” në vlerën 1,000,000 lekë, “M.” në vlerën 1,040,000 lekë.

Me procesverbal të protokolluar nr. 2056/2 prot., datë 06.12.2022, grupi i punës i përbërë nga I. A., D. H. dhe V. I. ka bërë për miratimin e kriterëve për kualifikim.

Në këtë procesverbal nuk është argumentuar vendosja e kriterëve/specifikimeve, të poshtëshënuara, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 78 , rekomandimin e APP-se me Nr. 1797/1prot. datë 10.03.2022

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura sa më sipër ngarkon me përgjegjësi grupin e punës i përbërë të përberë nga I. A., D. H. dhe V. I.

Në procesverbal, është cituar “Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, e cila shërben për të parë nëse operatori ekonomik ka shlyer gjithë detyrimet e energjisë elektrike, për të njohur gjendjen financiare dhe të mundësisë së tyre të përmbushjes me sukses të kontratës”.

Grupi i auditimit nuk e vlerëson këtë dispozitë ligjore, pasi ky ligj është shfuqizuar me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 135 “Shfuqizime”.

M.gj.th edhe referenca në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, nuk ka përcaktim të saktë, neni, pika etj, ose referencë në ndonjë akt nënligjor të dalë në zbatim të tij.

Në kërkesat për kualifikim është kërkuar:

Shtojca 2

## 2. Specifikime teknike

Profili i ekspertit/eve për hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative

-Të ketë/në eksperiencë profesionale të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune si jurist në fushën e së drejtës, ndër të cilat, të paktën 7 (shtatë) vjet përvojë në draftim aktesh ligjore dhe nënligjore në projekte të ndryshme;

-Të ketë/në njohuri të gjëra dhe shumë të mira të koncepteve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe zhvillimeve legjislative të fushës në Bashkimin Evropian, përfshirë, por jo vetëm, Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), Direktivën e Policisë, si dhe përvojë profesionale të provuar në këtë drejtim;

-Të ketë/në përvojë profesionale në administratën publike;

Për ta provuar sa më sipër duhet të paraqesin:

1. CV;

2. Kontrata të ngjashme/punë apo referenca materialesh/ekspertizash të ofruara në lidhje me hartim aktesh ligjore dhe nënligjore në sektorin publik apo privat, kërkesë në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “ *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.*

Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi ka paraqitur kontratat për punë të ngjashme me Shoqërinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në gjuhën angleze.

3. Kopje të diplomave, certifikimeve profesionale si dhe çdo dokument tjetër që provon përmbushjen e kriterëve të përcaktuara më sipër. Nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar që kopjet të jenë të noterizuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 29.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 36 dhe 77, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 41, Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 të APP-së, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 9.2, çka ngarkon me përgjegjësi grupin e punës për hartimin e dokumenteve të përbërë të përbërë nga I. A., D. H. dhe V. I..

Kontrata është lidhur nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022, ndërmjet Zyrës së Komisionerit të përfaqësuar nga L. M. dhe operatorit ekonomik “F... P...” për vlerën 990,000 lekë pa TVSH, me afat 15.12.2022-22.12.2022.

Kontrata e nënshkruar L. M. në cilësinë e nëpunësit zbatues me autorizim të Komisionerit nr. 2191 prot., datë 31.12.2021, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 19 , 20 dhe 21, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 12, 13, 15 dhe 22 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”, pika 2.1.2, pika 3.

**Theksojmë se** referuar Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, delegimi nuk *shkarkon përgjegjësi administrative të Titullarit*. Konkretisht në pikën 4 është shprehur mënyrë eksplicite se “*Delegimi i të drejtave dhe i detyrave sipas përcaktimeve të këtij ligji nuk çënon të drejtat e menaxherit dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat*”.

Referuar sa më sipër: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “F... P...”, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë I. A., V. I. dhe D. H..

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë 2 operatorë ekonomikë:

-Shoqëria “S.” me ofertë në vlerën 916.667

-F. P., person fizikë me ofertë në vlerën ekonomike 990,000 lekë.

-Janë kualifikuar të dy operatorët ekonomikë nga të cilët shoqëria “S.” me ofertë në vlerën ekonomike 916.667 është tërhequr duke dërguar mesazh në sistem.

*Zbatimi i kontratës*

Me Urdhër Nr. 113 prot., datë 31.12.2022 të B. D. me detyrë Komisioner është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga D. H., E. M. dhe A. B., komision i ngritur për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2022. Ky komision nuk ka në përbërjen e tij specialist të fushës.

Me urdhër shpenzimin nr. 263, datë 22.12.2022 nëpërmjet R. B. është likuiduar F. P. në vlerën 990,000 lekë. Dokument vërtetues: Kontrata me operatorin ekonomik “F. P.” me nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022. Fatura nr. 3/2022 datë 21.12.2022 për vlerën 990,000 lekë. Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit datë 21.12.2022 i firmosur nga D. H. me detyrë specialiste sektori i marrëdhënieve me jashtë, profesion gjuhëve te huaja, E. M. me detyrë inspektor në DVAH profesion ekonomiste dhe A. B. i mesëm me detyrë magazinier.

Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të material është shprehur në ligjëratë të drejtë “ .....Ky komision, nisur nga procesverbalin i marrjes në dorëzim të materialit me nr. 2056/6 të drejtorisë së çështjeve juridike dhe integritit, datë 21.12.2022, në të cilën konfirmohet se materiali final përputhet me termat e referencës të kërkuara në ftesën për ofertë dhe me memove përkatëse, si dhe është një material/akt në përputhshmëri të plotë me legjislacionin bazë dhe aquis në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale...”.

Në fakt nuk ka asgjë të përcaktuar në termat e referencës.

Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 2056/6 prot., datë 21.12.2022 i firmosur nga B. N. me detyrë drejtor i Çështjeve Juridike dhe Integritetit, me profesion juriste, M. K. me detyrë drejtor i Vlerësimit të Ankesave dhe Harmonizimit me profesion juriste dhe P. B. me detyrë inspektore e Procedurave Administrative, me profesion juriste.

Në këtë procesverbal është shprehur “... Metodologjia për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative” është në përputhje me specifikimet teknike të dhëna në dokumentet e tenderit”.

Në fakt nuk ka asgjë të përcaktuar në specifikimet teknike.

Njëkohësisht theksojmë se kjo metodologji nuk ka të përcaktuar asnjë referencë ligjore, nënligjore, rregullatorë, të karakterit studimor, apo praktikave të ngjashme të Zyrave Homologe.

### **Konkluzion:**

Në vlerësimin e grupit të auditimit kjo metodologji është plagjiature, referuar Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (European Data Protection Board). Ky Institucion i BE ka publikuar për konsultim në faqen zyrtare (edpb.europa.eu), Udhëzimin mbi përllogaritjen e masave administrative në zbatim të GDPR (Guidelines 04/2022 on the calculation of administrative fines under the GDPR), në datën 16 maj 2022, me referencë konsultimi publik nr. 04/2022<sup>7</sup>.

*Konkretisht sipas akteve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit në Aneksin 1.1*

Ngjashmëria e këtyre akteve nuk kufizohet vetëm në pasqyrën e lëndës, por edhe në përmbajtjen e secilit prej kapitujve, ku akti i dorëzuar konsiston më tepër në një përkthim dhe përshtatje të dokumentit të publikuar nga Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, aq më tepër kur, në asnjë rast, nuk janë përdorur referenca, ku të citohet burimi nga është marrë materiali apo fragmente të tij, duke përvetësuar në mënyrë jo të drejtë këtë material dhe duke e pasqyruar si produkt autentik. Veprime në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122.

-Kontratën me Operatorin Ekonomik “F... P...” është lidhur nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022.

- Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.

**5. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për procedurë me objekt *Hartimi i kurikulës për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe formimin profesional dhe kualifikimin e tyre*, viti 2022, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:**

Hartimi i kurikulës për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe formimin profesional dhe kualifikimin e tyre		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 33 prot., datë 05.12.2022	3. Hartimi i dokumenteve të tenderit Urdhër Nr. 33 prot., datë 05.12.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 33 prot., datë 05.12.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Blerje e vogël”	- I. A. - D. H. - V. I.	- I. A. - D. H. - V. I.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 980,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 20,000 leke
8. Data e hapjes së tenderit 07.12.2022.	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _4__OE a) Kualifikuar __1__OE

<sup>7</sup> [https://ëëë.edpb.europa.eu/our-ëork-tools/documents/public-consultations/2022/guidelines-042022-calculation-administrative\\_en](https://ëëë.edpb.europa.eu/our-ëork-tools/documents/public-consultations/2022/guidelines-042022-calculation-administrative_en)

11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik --
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 2053/3 prot, date 15.12.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 980,000 lekë	

Me shkresën nr. 2014 prot., datë 24.11.2022 B. N. me detyrë drejtores e Drejtorisë Juridike, i është drejtuar B. D. me detyrë Komisioner, dhe për dijeni L. M. me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, kërkesë për hapje procedure prokurimi “Mbi domosdoshmërinë për hartimin e disa akteve nënligjore në kuadër të miratimit të projektligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Me urdhër nr. 33 prot., datë 05.12.2022 të B. D. me detyrë Komisioner, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është urdhëruar prokurimi me vlerë të vogël me objekt “Hartimi i kurikulës për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe formimin profesional dhe kualifikimin e tyre”.

Me procesverbal të protokolluar nr. 8/12 prot., datë 05.12.2022, grupi i punës për argumentimin e fondit limit, i përbërë nga L. Xh., M. C. dhe R. B. ka përcaktuar vlerën 1,000,000 lekë pa TVSH, duke marr mesataren e tre ofertave, pas ofertës në çmim mesatar të ofruar nga operatorët “S... H.” në vlerën 1,000,000 lekë, “S... L... J. C.” në vlerën 980,000 lekë, “S... L... T...” në vlerën 1,200,000 lekë.

Me procesverbal të protokolluar nr. 2014/3 prot., datë 05.12.2022, grupi i punës i përbërë nga I. A., D. H. dhe V. I. ka bërë për miratimin e kriterëve për kualifikim.

Në këtë procesverbal nuk është argumentuar vendosja e kriterëve/specifikimeve, të poshtëshënuara, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 78 , rekomandimin e APP-se me Nr. 1797/1prot. datë 10.03.2022.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura sa më sipër ngarkon me përgjegjësi grupin e punës i përbërë të përberë nga I. A., D. H. dhe V. I.

Në procesverbal, është cituar “Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, e cila shërben për të parë nëse operatori ekonomik ka shlyer gjithë detyrimet e energjisë elektrike, për të njohur gjendjen financiare dhe të mundësisë së tyre të përmbushjes me sukses të kontratës”.

Grupi i auditimit e vlerëson këtë dispozitë ligjore jo korrekte, pasi ky ligj është shfuqizuar me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 135 “Shfuqizime”. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, shfuqizohet.

M.gj.th edhe referenca në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, nuk ka përcaktim të saktë, neni, pika etj, ose referencë në ndonjë akt nënligjor të dalë në zbatim të tij.

Në kërkesat për kualifikim është kërkuar:

Shtojca 2

## 2. Specifikime teknike

Profili i ekspertit/eve për hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative:

-Të ketë/në eksperiencë profesionale të paktën 10 vjet përvojë pune si jurist në fushën e së drejtës, ndër të cilat, të paktën 7 vjet përvojë në draftim aktesh ligjore dhe nënligjore në projekte të ndryshme;

-Të ketë/në njohuri të gjëra dhe shumë të mira të koncepteve të legjislatonit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe zhvillimeve legjislative të fushës në Bashkimin Evropian, përfshirë, por

jo vetëm, Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), Direktivën e Policisë, si dhe përvojë profesionale të provuar në këtë drejtim;

-Të ketë/në përvojë profesionale në administratën publike;

Për ta provuar sa më sipër duhet të paraqesi:

1. CV;

2. Kontrata të ngjashme/punë apo referenca materialesh/ekspertizash të ofruara në lidhje me hartim aktesh ligjore dhe nënligjore në sektorin publik apo privat, kërkesë në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”,

ika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi ka paraqitur kontratat për punë të ngjashme me Shoqërinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në gjuhën angleze. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14.

3. Kopje te diplomave, çertifikimeve profesionale si dhe çdo dokument tjetër që provon përmbushjen e kriterëve të përcaktuara më sipër. Nga autoriteti kontraktor nuk është kërkuar që kopjet të jenë të noterizuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, neni 29.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 36 dhe 77, , VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar, neni 41, Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 të APP-së, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar , pika 9.2, çka ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga I. A., D. H. dhe V. I.

Kontrata është lidhur me nr. 2014/4 prot., datë 19.12.2022, ndërmjet Zyrës së Komisionerit të përfaqësuar nga L. M. dhe operatorit ekonomik “F... P...” për vlerën 980,000 lekë pa TVSH, me afat 19.12.2022-29.12.2022.

Kontrata e nënshkruar L. M. në cilësinë e nëpunësit zbatues me autorizim të Komisionerit nr. 2191 prot., datë 31.12.2021, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 19 , 20 dhe 21, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, nenet 12, 13, 15 dhe 22 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”, pika 2.1.2, pika 3.

**Theksojmë se** referuar Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, delegimi nuk *shkarkon përgjegjësi administrative të Titullarit*. Konkretisht në pikën 4



është shprehur mënyrë eksplicite se “*Delegimi i të drejtave dhe i detyrave sipas përcaktimeve të këtij ligji nuk çënon të drejtat e menaxherit dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat*”.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë:

- Operatori Ekonomik F. P., person fizikë me ofertë në vlerën 980,000 lekë
- Operatori Ekonomik A. D., person fizikë me ofertë në vlerën 833.333 lekë
- Operatori ekonomik O. T. shpk me ofertë me vlerë 875.000 lekë
- Operatori Ekonomik J. G. shpk me ofertë me vlerë 958.333 lekë

Kanë ofertuar katër operatorë ekonomik nga të cilët tre operatorë ekonomik janë skualifikuar si më poshtë:

Operatori Ekonomik A. D., person fizikë me ofertë në vlerën 833.333 lekë

-Operatori ekonomik O. T. shpk me ofertë me vlerë 875.000 lekë

-Operatori Ekonomik J. G. shpk me ofertë me vlerë 958.333 lekë

Është kualifikuar Operatori Ekonomik F. P. person fizikë me ofertë në vlerën 980,000 lekë.

Referuar sa më sipër: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “F. P.”, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisionin i blerjeve me vlera të vogla i përbërë I. A., V. I. dhe D. H..

#### *Zbatimi i kontratës*

Me Urdhër Nr. 113 prot., datë 31.12.2022 të B. D. me detyrë Komisioner është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga D. H., E. M. dhe A. B., komision i ngritur për zhvillimin e procedurave të prokurimit për vitin 2022. Ky komision nuk ka në përbërjen e tij specialist të fushës. Me urdhër shpenzimin nr. 275, datë 28.12.2022 nëpërmjet R. Bank është likuiduar F. P. në vlerën 980,000 lekë. Dokument vërtetues: Kontrata me operatorin ekonomik “F. P.” me nr. 2014/4 prot., datë 19.12.2022. Fatura nr. 4/2022 datë 27.12.2022 për vlerën 980,000 lekë. Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit, datë 27.12.2022 i firmosur nga D. H. me specialiste sektori i marrëdhënieve me jashtë, profesion gjuhëve të huaja, E. M. me detyrë inspektor në DVAH profesion ekonomiste dhe A. B. i mesëm me detyrë magazinier.

Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të materialit është shprehur në ligjëratë të drejtë “ .....Ky komision, nisur nga procesverbalin i marrjes në dorëzim të materialit të drejtorisë së çështjeve juridike dhe integritetit, datë 27.12.2022, në të cilën konfirmohet se materiali final përputhet me termat e referencës të kërkuara në ftesën për ofertë dhe me memove përkatëse, si dhe është një material/akt në përputhshmëri të plotë me legjislacionin bazë dhe aquiss në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale...”, konfirmon kryerjen e shërbimit (dorëzimin) e dy udhëzimeve;

Formimi profesional dhe kualifikim e nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe hartimi i korikulës për nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në fakt nuk ka azgjë të përcaktuar në termat e referencës.

Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit, pa nr. protokollin, datë 27.12.2022 i firmosur nga D. H., E. M. dhe A. B..

Në këtë procesverbal është shprehur “.... Formimi profesional dhe kualifikim i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe hartimi i korikulës për nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave personale” është hartuar në përputhje me specifikimet teknike të dhëna në dokumentet e tenderit të zhvilluar datë 06.12.2022”. Në fakt nuk ka asgjë të përcaktuar në specifikimet teknike.

Veprime në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122.

- Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe neni 20.

Veprimi i cili ngarkon me përgjegjësi grupin e marrjes në dorëzim i përbërë nga D. H., E. M., dhe A. B.

**6. Mbi procedurën e prokurimit me objekt “Sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave dhe shërbim mirëmbajtje 3-vjeçare të KDIMDP-së”, me nr. ref. REF-61805-03-08-2023, me fond limit 6,950,000 lekë pa TVSh.**

Procedura e prokurimit “Sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave dhe shërbim mirëmbajtje”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 09, prot., datë 22.02.2023	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit Urdhër nr. 09, prot, datë 22.02.2023 - D. H. - I. A. - N. S.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 40 prot., datë 06.03.2023 - B. N. - R. B. - U. H.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh)  6,950,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh)  6,000,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)  950,000 lekë (86.3%)
8. Data e hapjes së tenderit 08.03.2021	9. Burimi i financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Kualifikuar: 1 OE
Zbatimi i Kontratës		
11. Lidhja e kontratës Nr. 360/15 prot., më datë 05.04.2021	12. Vlera e kontratës (me TVSh), 7,200,000 lekë	13. Komisioni i marrjes në dorëzim Urdhër nr. 57, datë 11.04.2023 - I. A. - R. L. - A. B.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe nga asistimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik, u konstatua se:

**Argumentimi i kërkesës dhe përlogaritja e fondit limit**

Me anë të shkresës nr. 1296 prot., datë 08.07.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit dhe Personit përgjegjës për prokurimin kërkesën për krijimin e një soft-i të ri “Program aplikativ për automatizimin e proceseve të punës së Zyrës së Protokoll – Arkivit”, për shkak të problematikave të konstatuara të sistemit ekzistues, si:

- Bllokime të shpeshta të sistemit;
- Sistemi ekzistues kërkon instalimin fizik në çdo kompjuter;
- Sistemi aktual nuk ka një hartë të procesit të punës, të ndarë në mënyrë të qartë në role dhe përdorues të caktuar;
- Sistemi nuk mund të aksesohet në versionin *mobile*;
- Nuk ofrohet mundësia e shkarkimit të dokumenteve direkt nga sistemi.

Në këtë kërkesë përcaktohet se programi duhet të mundësojë autentikimin e punonjësve nëpërmjet vendosjes së e-mail dhe verifikimit të identitetit nëpërmjet llogarisë së Google Mail (Gmail). Në shkresë citohet se, me një vlerësim paraprak tregu, duke patur parasysh kriteret dhe kërkesat, fondi limit paraprak është përafërsisht 3,850,000 lekë pa TVSh.

Me anë të shkresës nr. 1296/1 prot., datë 02.11.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dërgon kërkesën e rishikuar për krijimin e soft-it, ku vlera e parashikuar është mesatarisht 5,000,000 lekë pa TVSh për blerjen e soft-it dhe 2,340,000 lekë pa TVSh për mirëmbajtjen 3-vjeçare.

Me anë të shkresës nr. 360 prot., datë 15.02.2023, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës kërkesën për nisjen e procesit për blerjen e “Sistemit elektronik për menaxhimin e praktikave dhe të dhënave”. Vlera e parashikuar është 6,000,000 lekë me TVSh për shpenzime kapitale për blerjen e soft-it, si dhe 2,340,000 lekë me TVSh për shpenzime operative për mirëmbajtjen e sistemit.

Me anë të Urdhrit të Komisionerit nr. 32, datë 21.02.2023, është ngritur Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit Limit, i përbërë nga I. H. (IT), kryetar, L. Xh. (ekonomist), E. M. (ekonomist), anëtarë.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 09, datë 22.02.2023, Titullari i AK ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt “Sistemi i menaxhimit të praktikave të të dhënave dhe shërbim mirëmbajtje 3-vjet”, me fond limit 6,950,000 lekë pa TVSh, si dhe duke caktuar njësinë e prokurimit, të përbërë nga D. H. (jurist), kryetar, I. A. (jurist), N. S. (IT), anëtarë.

Me anë të procesverbalit nr. 360/3 prot., datë 24.02.2023, Komisioni ka kryer përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në testimin e tregut, duke përcaktuar fondin limit prej 6,950,000 lekë pa TVSh. Hartimi i këtij procesverbali është thjesht formal, kjo pasi fondi limit ishte përcaktuar nga Titullari i AK përpara përlllogaritjes së tij nga komisioni i ngarkuar me atë detyrë.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me nenin 12, pika 4 dhe nenin 76, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se vlera e përlllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përlllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit dhe AK, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

*Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK.*

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit**

Me anë të procesverbalit nr. 360/4 prot., datë 24.02.2023, Njësia e prokurimit ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.

Sa i përket kapacitetit teknik, AK kërkon:

**“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në ekipin e tij të paktën 2 (dy) punonjës, nga të cilët:**

- 1 (një) punonjës me eksperiencë si drejtues projekti dhe zhvillues (programues) me mbi të paktën 10 vite punë, me përvojë në zhvillim dhe implementim sistemesh, që të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në fushën e Informatikës ose ekuivalente.
- 1 (një) punonjës me eksperiencë si zhvillues (programues) me përvojë, me eksperiencë mbi 5 vite punë në zhvillim dhe implementim sistemesh, i pajisur me diplomë Master i Shkencave në fushën e Informatikës ose ekuivalente.”

Grupi i auditimit vlerëson se vendosja e kriterëve që punonjësit të jenë minimalisht me 5 apo 10 vite eksperiencë nuk është e argumentuar as ligjërisht e as teknikisht, duke ndikuar si pengesë për konkurrencën e hapur në procedurën e prokurimit. Për sa më sipër, ky kriter duhej formuluar, duke kërkuar përvojën specifike që kërkohet nga punonjësit, pa kushtëzuar në vitet e eksperiencës.

**“2.3.4 Të paktën 2 (dy) nga anëtarët e ekipit të operatorit ekonomik duhet të jenë të certifikuar për “S. P. Certified Professional”, për platformën “S. P.” të lëshuar nga prodhuesi i tij ose ente të certifikuar/autorizuar prej tij.”**

Referenca ligjore për vendosjen e këtij kriteri është neni 40, pika 5, gërma b, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se për të provuar kapacitetet teknike/ profesionale, AK kërkon, ndër të tjera, licencat profesionale të personelit kryesor, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

Grupi i auditimit vlerëson se specifikimi i këtij certifikimi nuk është i argumentuar as ligjërisht e as teknikisht, duke ndikuar si pengesë për konkurrencën e hapur në procedurën e prokurimit. Për sa më sipër, ky kriter duhej hequr.

Vendosja e kriterëve të mësipërme është në kundërshtim me:

- Nenin 77, pika 1, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një ofertues ka kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet dhe të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës;
- Nenin 39, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
- Nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, në çdo rast, hartimi i kërkesave për kualifikim duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

Për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve të mësipërme, AK ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit, si diplomat e shkollimit, certifikatat përkatëse, CV, listëpagesën e sigurimeve shoqërore për tre muajt e fundit. Grupi i auditimit konstaton se asnjë prej dokumentacionit të kërkuar nuk shërben si dokumentacion vërtetues për përmbushjen e kriterit të viteve të eksperiencës.

*Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit.*

Me anë të shkresës nr. 360/10 prot., datë 08.03.2023, Njësia e prokurimit ka publikuar Njoftimin e shkurtuar të kontratës, ku është përcaktuar afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave në datën 21.03.2023.

### ***Vlerësimi i ofertave***

Në procedurë morën pjesë 2 OE, me ofertat ekonomike, si më poshtë:

1. “E. P.” ShPK – 4,505,000 lekë pa TVSh;
2. “S. P.” ShPK – 6,000,000 lekë pa TVSh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar OE “E. P.” ShPK, për arsye se, pas shqyrtimit të dokumentacionit, konstatoi se mungonte Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, si dhe nuk është përmbushur kriteri i dytë i pikës 2.3.3, OE nuk ka sjellë dokumentacion që vërteton se ka një punonjës me eksperiencë si programues, mbi 5 vite pune, të diplomuar me MSc në shkenca kompjuterike.

Me anë të shkresës nr. 360/11 prot., datë 21.03.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shpallur fituesin OE “S. P.” ShPK.

Nga dokumentacioni i administruar, OE “S. P.” ShPK, për plotësimin e kritereve teknike, ka paraqitur dokumentacion për 4 punonjës, si më poshtë:

- E. Xh., për të cilin është paraqitur dokumentacioni: Diplomë, certifikim për S. P., CV (mbi 10 vjet eksperiencë), i punësuar si Drejtor Ekzekutiv në Tregti, referuar kodit në listëpagesa.
- K. K., për të cilin është paraqitur dokumentacioni: Diplomë Bachelor, Vërtetim kryerje të MSc në “Informatikë”, Certifikim për S. P. CV (ku citohet se është pjesë e S. P. ShPK që prej 01.07.2020) (më pak se 5 vite), i punësuar si “informatikan”, referuar kodit në listëpagesa.
- E. K., për të cilin është paraqitur dokumentacioni: Diplomë Bachelor, Diplomë Master Profesional (jo MSc, sipas kërkesës), Certifikim për S. P., CV (ku citohet se është pjesë e S. P. që prej muajit mars 2018), e punësuar si asistente programesh kompjuterike, referuar kodit në listëpagesa.
- O. Sh., për të cilin është paraqitur dokumentacioni: Diplomë, Certifikim për S. P., certifikime të tjera, CV (nuk figuron në listëpagesat e muajit dhjetor 2022 – janar 2023).

Kriteri i dytë i pikës 2.3.3 nuk plotësohet nga asnjë prej 3 punonjësve të tjerë, ku njëkohësisht të plotësohet kriteri i 5 viteve të eksperiencës, pajisjes me diplomë Master të Shkencave, që do të vërtetohej me diplomat përkatëse, dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore për tre muajt e fundit. Këto mangësi nuk janë evidentuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, çka do të përbënte shkak për të skualifikuar edhe OE “S. P.”.

*Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.*

Neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se Titullari i AK është përgjegjës, ndër të tjera, për miratimin e raportit përmbledhës të procedurës së prokurimit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i dërgon Titullarit të AK, në datën 21.03.2023, raportin përmbledhës (të paprotokolluar) pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe, në datën 03.04.2023, raportin përmbledhës (të paprotokolluar) pas vlerësimit të dokumentacionit fizik, të miratuar nga Komisioneri, në cilësinë e Titullarit të AK.

Komisioneri, me anë të Urdhrit nr. 50, datë 28.03.2023, ka urdhëruar delegimin e kompetencave të Titullarit të Zyrës së KDIMDP të B. V., me detyrë Drejtor Kabineti, për periudhën nga data 03.04.2023 deri më datë 07.04.2023. Për sa më sipër, Komisioneri rezulton të ketë nënshkruar/miratuar raportin përfundimtar të datës 03.04.2023, në një datë kur kompetencat për ta bërë këtë ishin deleguar te Drejtori i Kabinetit.

Me anë të Autorizimit nr. 360/14 prot., datë 05.04.2023, Drejtori i Kabinetit, në mungesë dhe me urdhër të Komisionerit, autorizon Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të nënshkruajë kontratën me OE “S. P.”.

Referuar nenit 28, pika 4, të Kodit të Procedurave Administrative, organi i deleguar ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfuara përmes delegimit. Për sa më sipër, referuar pikës 5 të kësaj dispozite, ky autorizim është i pavlefshëm.

AK dhe OE kanë nënshkruar kontratën nr. 360/15 prot., datë 05.04.2023, me vlerë totale 7,200,000 lekë me TVSh, nga të cilat 5,400,000 lekë me TVSh për blerjen e soft-it dhe 1,800,000 lekë me TVSh për shërbimin e mirëmbajtjes për 36 muaj. Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është znj. L. M., njëkohësisht NZ, mbështetur në Autorizimin e sipërpërmendur. Nënshkrimi i kontratës nga NZ është në kundërshtim me nenet 19 – 21 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 12, 13, 15 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe pikat 2.1.2, 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të

*gjithë niveleve*". Referuar nenit 15, pika 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, delegimi nuk e shkarkon Titullarit e AK nga përgjegjshmëria për realizimin e detyrave përkatëse.

Referuar sa më sipër, në vlerësimin e grupit të auditimit, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik "S. P." ShPK, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me nenet 77, 87, 89, 90, 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*".

### **Zbatimi i kontratës**

Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga I. A., R. L. dhe A. B. u krijua me Urdhrin e Titullarit të AK nr. 57, datë 11.04.2023.

OE është likuiduar pjesërisht nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 94, datë 18.05.2023, në vlerën **5,400,000 lekë me TVSh**, bazuar në faturën nr. 33/2023, datë 05.05.2023, si dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të datës 05.05.2023, të paprotokolluar, ku citohet se janë zhvilluar 4 (katër) seanca trajnimi. Procesverbali është nënshkruar nga Komisioni i marrjes në dorëzim, si dhe I. H. (specialist IT), ku përmenden dhe 3 emra punonjësish, si "staf i trajnuar".

Në dosje gjithashtu administrohet procesverbali i datës 05.05.2023 mbi trajnimin e punonjësve, i paprotokolluar, ku citohet se një grup prej 9 (nëntë) punonjësish kanë marrë pjesë në 4 (katër) seanca trajnimi. Procesverbali nuk është i protokolluar dhe është nënshkruar vetëm nga I. A. dhe një përfaqësues i OE.

Procesverbalet e marrjes në dorëzim të shërbimit janë hartuar jo në momentin e marrjes së shërbimit, por në momentin e dorëzimit të faturës tatimore nga ana e OE, duke përfshirë 4 trajnime të marra, të realizuara në kohë të ndryshme. Këto procesverbale nuk plotësojnë kriteret për t'u konsideruar dokumentacion vërtetues, referuar pikës 35, gërma b, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2021, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", pasi nuk vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve. Në pikën 36 të këtij udhëzimi, përcaktohet se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore apo administrative.

Në konkluzion, të gjitha veprimet e mësipërme, trajtuar rast pas rasti në secilën prej fazave të procedurës, duke mbështetur në kriteret përkatëse, janë në kundërshtim me:

- Nenin 2 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, ku përcaktohet se qëllimi i këtij ligji është (i) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, (ii) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, (iii) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, (iv) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, (v) të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe (vi) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik;
- Nenin 2 të Ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, ku përcaktohet se qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.

Për gjithë sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. B. D., me detyrë Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, bazuar në:

- Nenin 21, pika 5 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet se të gjitha proceset zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të AK ose personit të autorizuar prej tij;
- Nenin 73 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohen roli dhe përgjegjësitë e titullarit të AK;
- Nenin 8 dhe 12 të Ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku përcaktohet përgjegjshmëria menaxheriale e (i) titullarit të institucionit dhe (ii) nëpunësit zbatues.
- Nenin 19 dhe 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohen përgjegjësitë e (i) nëpunësit autorizues e (ii) nëpunësit zbatues.

### **Procedura blerje me vlerë të vogël**

#### **Për vitin 2021**

***Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 202, datë 30.12.2020, me përbërje:

- M. C., kryetar
- D. H., anëtar
- A. Xh., anëtar.

Urdhri i Komisionerit nr. 17, datë 08.02.2021: I. A. zëvendëson M. C.

Urdhri i Komisionerit nr. 23, datë 10.03.2021: P. B. zëvendëson I. A.

Urdhri i Komisionerit nr. 54, datë 29.04.2021: A. L. zëvendëson A. Xh.

Urdhri i Komisionerit nr. 166, datë 03.11.2021: M. C. zëvendëson P. B.

***Komisioni për përlogaritjen e fondit limit për blerjet e vogla*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 03, datë 07.01.2021, me përbërje:

- L. Xh.
- E. M.
- E. M.

***Komisioni i marrjes në dorëzim*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 03, datë 07.01.2021, me përbërje:

- A. K.
- P. B.
- A. B.

**I.** Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “***Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, për vitin 2021***”, me nr. ref. REF-90721-03-23-2021, me fond limit **440,000 lekë pa TVSh**.

Me anë të shkresës nr. 509 prot., datë 12.03.2021, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për materialet e nevojshme për mbrojtjen personale nga covid-19, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallit	Sasia	Njësia matëse
1.	Maska kirurgjikale	10,000	Copë
2.	Alkool etilik i denaturuar ose alkool izopropilik 1 litër	300	Copë
3.	Dezinfektues për duart me bazë alkooli etilik 500 ml	300	Copë
4.	Dezinfektues për sipërfaqe të lëngshëm pa shpëlarje, antibakterial ose antimikrobial me alkool etilik 750 ml	300	Copë

Me anë të procesverbalit nr. 509/1 prot., datë 19.03.2021, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 440,000 lekë pa TVSh.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 05, datë 19.03.2021, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt sipas kërkesës fillestare. Me anë të procesverbalit të datës 23.03.2021 (i paprotokolluar), Komisioni i Prokurimit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KPBVV) ka hartuar dhe argumentuar kriteret e përgjithshme e të veçanta.

Me anë të procesverbalit të datës 24.03.2021 (i paprotokolluar), KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës, ku u kualifikuan 18 OE dhe u skualifikuan 9 OE që kishin ofruar mbi vlerën e fondit limit. Pasi ka dokumentuar rast pas rasti nëpërmjet procesverbaleve kalimet tek OE të rradhës dhe skualifikimet përkatëse, për arsye të tërheqjes së OE ose mosplotësimit të dokumentacionit përkatës, nëpërmjet procesverbalit të datës 25.02.2021, KPBVV ka kaluar tek OE i renditur në vend të 8 (tetë), “M. H.” person fizik, me ofertë në vlerë **399,900 lekë pa TVSh**. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 78, datë 26.04.2021, në vlerën 479,880 lekë me TVSh**, bazuar në faturën elektronike nr. 6/2021, datë 08.04.2021 dhe në procesverbalin e datës 08.04.2021 të Komisionit për marrjen në dorëzim. Mallrat kanë hyrë në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 2, datë 08.04.2021.

## **II. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2021”, me nr. ref. REF-92502-04-08-2021, me fond limit 798,000 lekë pa TVSh.**

Me anë të shkresës nr. 487 prot., datë 11.03.2021, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për blerjen e pajisjeve kompjuterike, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1.	Desktop	Copë	8
2.	Skaner	Copë	1

Nëpërmjet procesverbalit të datës 19.03.2021 (i paprotokolluar), Komisioni i Prokurimit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KPBVV) ka hartuar dhe argumentuar kriteret e përgjithshme e të veçanta.

Me anë të procesverbalit nr. 487/1 prot., datë 19.03.2021, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 798,000 lekë pa TVSh. Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 4, datë 19.03.2021, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt sipas kërkesës fillestare. Me anë të procesverbalit nr. 487/7 prot., datë 07.04.2021, KPBVV ka dokumentuar anulimin e procedurës, për shkak se OE të renditur deri në vendin e 10 (dhjetë) nuk kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar apo janë tërhequr nga gara.

Me anë të procesverbalit nr. 487/4 prot., datë 07.04.2021, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 798,000 lekë pa TVSh. Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 7, datë 07.04.2021, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt sipas kërkesës fillestare. Me anë të procesverbalit të datës 09.04.2021 (i paprotokolluar), KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës, ku, nga 10 ofertues, u kualifikuan 9 dhe u skualifikua 1.

Me argumentin e mungesës së korrektesës në procedura të mëparshme, KPBVV ka skualifikuar OE “S.” ShPK.

Nga auditimi u konstatua se, OE “S.” ShPK, në procedurën me nr. REF-90706-03-23-2021, ka paraqitur nëpërmjet SPE “Njoftim për paraqitje”, në datën 29.03.2021, por është njoftuar nga



KPBVV se ka kaluar afati që nga momenti që është shpallur fitues, duke bërë me dije se OE është paraqitur në orën 11:26, ndërkohë njoftimi i ka shkuar në orën 10:30, ndaj është vijuar me OE të rradhës. Ky tejkalim afati është bërë shkak për skualifikimin e OE dhe kalimin në ofertuesin e rradhës.

Referuar pikës 15, gërma b, të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël do të refuzojnë automatikisht ofertën e paraqitur nga një OE, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga ky AK, brenda periudhës 1-vjeçare nga data e zhvillimit të kësaj procedure, nuk është paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë për të realizuar objektin e prokurimit, pavarësisht faktit se mund të ketë njoftuar AK, por nuk ka dhënë arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

OE “S.” ShPK, në procedurën me nr. REF-90706-03-23-2021, nuk u paraqit brenda afatit për dorëzimin e dokumentacionit fizik (pa marrë parasysh komunikimin në SPE), dhe jo për realizimin e objektit të prokurimit, sikurse është përcaktuar në Udhëzim.

Për sa më sipër, refuzimi i ofertës së OE “S.” ShPK, njëkohësisht oferta më e ulët, në vlerë 689,000 lekë pa TVSh, është i pambështetur në legjislacionin e prokurimit publik dhe bie në kundërshtim me frymën e Ligjit “Për prokurimin publik”, që, sipas përcaktimit në nenet 2 dhe 3 të tij, synon të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën, duke siguruar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Me anë të procesverbalit të datës 13.04.2021 (i paprotokolluar), KPBVV ka dokumentuar kalimin tek OE “P. S.” i radhës, në vlerë 721,590 lekë pa TVSh, i cili ka dorëzuar dokumentacionin fizik, protokolluar në KDIMDP nr. 487/11 prot., datë 14.04.2021.

Nga auditimi u konstatua se:

- Mbi autorizimin nga firma prodhuese/ distributori i autorizuar nga prodhuesi për kompjuter/ skaner:

OE ka paraqitur shkresën e “I.” ShPK që autorizon “P. S.” ShPK të paraqesë ofertë në këtë procedurë prokurimi, duke bashkëlidhur:

1. Kontratën (në gjuhën angleze) që “I.” ShPK ka lidhur me prodhuesin “E.”. Në pikën 3.1 të kësaj kontrate citohet se “I.” ShPK mund të blejë nga prodhuesi vetëm produktet e listuara në Aneksin 1. Ky aneks nuk është bashkëlidhur kontratës, duke mos dhënë garanci që skaneri i ofruar është pjesë e produkteve të listuara.
2. Vetëm faqen e parë të kontratës (në gjuhën angleze) që “I.” ShPK ka lidhur me prodhuesin “L.”, duke mos dhënë garanci që kompjuterët e ofruar janë pjesë e produkteve të listuara.

Dokumentacioni i mësipërm është i pamjaftueshëm për të vërtetuar të drejtën e distributorit për të ofruar mallrat objekt prokurimi, pasi lidhjet/ anekset e kontratave nuk janë dorëzuar pranë AK.

- Mbi punonjësit e OE, për të garantuar shërbimin e garancisë për pajisjet:

Për kërkesën e një specialisti në nivel inxhinier, të certifikuar nga prodhuesi në nivelin ekspert për pajisje kompjuterike, ku AK cilëson se punonjësit duhet të figurojnë në listëpagesa me kodin e caktuar, OE ka paraqitur punonjësin E.M, i cili referuar kodit, ka funksionin e Drejtorit Ekzekutiv në Tregti (1120.10).

Parregullsitë e mësipërme nuk janë konstatuar dhe evidentuar në procesverbal nga ana e KPBVV, që ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “P. S.”.

Në pikën 6 të Ftesës për ofertë përcaktohet se OE i renditur në vend të parë duhet të paraqesë pranë AK mostra të mallit që do të përdorë brenda dy orëve nga njoftimi. Bazuar në pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 2, datë 02.05.2019 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE”,

AK duhet të mbajë procesverbale për të administruar procesin e paraqitjes së mostrave, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi. Pika 4 e udhëzimit përcakton se procesverbali i paraqitjes së mostrave të mallit duhet të pasqyrojë çdo hap të ndjekur nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në lidhje me administrimin e tyre. Pavarësisht sa më sipër, nuk ka dokumentacion që KPBBV të ketë administruar dhe pranuar mostrat e dërguara nga OE.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 79, datë 28.04.2021, në vlerën 865,908 lekë me TVSh**, bazuar në faturën elektronike nr. 55/2021, datë 19.04.2021 dhe në procesverbalin e datës 19.04.2021 (i paprotokolluar). Materialet kanë hyrë në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 3, datë 19.04.2021.

Marrja në dorëzim e mallrave është kryer nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe E. M. (specialist IT). Në procesverbalin e hartuar, komisioni konfirmon marrjen në dorëzim të “*Kompjutera PC – 8 copë*” dhe “*Skaner – 1 copë*”, pa dhënë asnjë detaj mbi treguesit cilësorë të mallit të marrë në dorëzim, në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, duke mos ofruar garanci se pajisjet e marra në dorëzim janë apo jo në përputhje me specifikimet teknike dhe dokumentet e paraqitur nga OE. Nga fletë-hyrja në magazinë, grupi i auditimit konstatoi se pajisja “*Skaner*” e marrë në dorëzim është e llojit “*B.*”, për të cilën OE nuk ka sjellë asnjë nga dokumentacioni i kërkuar, si:

- Autorizim nga firma prodhuese ose distributori i autorizuar, për të vërtetuar se është i autorizuar nga prodhuesi;
- Vërtetim se ka të punësuar një specialist në nivelin inxhinier të certifikuar nga prodhuesi në nivelin ekspert për pajisjen skaner të firmës që do të ofertojë;
- Certifikatat e kërkuara në specifikimet teknike (Deklaratat CE dhe RoHS). Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka administruar fletën e garancisë të mallrave, të kërkuar në Ftesën për ofertë, si dhe dokumentacionin shoqërues, si *certifikatat e cilësisë, certifikatat e origjinës, certifikatat e garancisë dhe raportet e testeve*, në kundërshtim me pikën 1 të Rekomandimeve të Veçanta, në Rekomandimin e APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021.

**III.** Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “*Mirëmbajtje e sistemit “Regjistri Elektronik i Kërkesave/ Ankesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit” (REKPDI)*”, me nr. ref. REF-92401-04-07-2021 me fond limit **550,000 lekë pa TVSh**.

Me anë të shkresës nr. 643 prot., datë 02.04.2021, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit dhe KPBBV kërkesën për nisjen e procedurës për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit REKPDI, për vitin 2021, i cili, nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 6, datë 06.04.2021, ka kërkuar përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël për të siguruar këtë shërbim. Me anë të procesverbalit nr. 643/2 prot., datë 06.04.2021, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 550,000 lekë pa TVSh dhe, me anë të procesverbalit të datës 06.04.2021 (i paprotokolluar), KPBBV ka dokumentuar hartimin e kritereve të përgjithshme e të veçanta.

KPBBV, me anë të procesverbalit të datës 08.04.2021 (i paprotokolluar), ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës së prokurimit, ku u konstatua se kishte vetëm 1 (një) OE ofertues në vlerën 548,000 lekë pa TVSh.

Nëpërmjet AK dhe OE “*S. P.*” është lidhur kontrata e shërbimit nr. 643/6 prot., datë 09.04.2021, me vlerë 548,000 lekë pa TVSh ose 657,000 lekë me TVSh, me kohëzgjatje deri në 31.12.2021.

Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është znj. L. M., mbështetur në Autorizimin nr. 30 prot., datë 06.01.2021.

Kontrata është likuiduar, si më poshtë:

Nr.	Urdhër shpenzimi	Vlera në USH	Fatura	Vlera (në lekë me TVSh)	Procesverbali
1.	170/ 18.08.2021	205,500	11/2021 21.07.2021	205,500	21.07.2021 P. B.; A. K.; A. B.
2.	236/ 05.11.2021	205,500	38/2021 14.10.2021	205,500	14.10.2021 P. B.; A. K.; A. B.
3.	303/ 31.12.2021	246,600	63/2021 31.12.2021	246,600	31.12.2021 P. B.; A. K.; A. B.
<b>TOTALI</b>					<b>657,600</b>

Nga auditimi u konstatua se Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka në përbërje të tij asnjë specialist të fushës, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Procesverbalet e Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit nuk janë hartuar në momentin e marrjes së shërbimit, por në momentin e dorëzimit të faturave tatimore. Ato nuk japin të dhëna mbi datën dhe vendin e kryerjes së veprimeve për marrjen e shërbimit, objektin dhe shkakun, personat që kanë kërkuar e ekzekutuar veprimet për marrjen e shërbimit, si dhe të tjera të dhëna të nevojshme që do t’i jepnin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**IV. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim dezinfektimi dhe 3D për zyrën e Komisionerit në kuadër të Covid-19, për vitin 2021”, me nr. ref. REF-87194-02-2021 me fond limit 470,000 lekë pa TVSh.**

Me anë të shkresës nr. 310 prot., datë 10.02.2021, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për shërbimet e dezinfektimit, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Seanca trajtimi
1.	Shërbim dezinfektimi për Zyrën e Komisionerit në kuadër të Covid-19	m <sup>2</sup>	2000	25
2.	Shërbim 3D (Dezinfektim, Dezinsktim, Deratizim)	m <sup>2</sup>	2000	2

Me anë të procesverbalit nr. 310/1 prot., datë 10.02.2021, Komisioni i përllogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 470,000 lekë pa TVSh.

1. Shërbimi 3D (Dezinfektim, Dezinsktim, Deratizim) i kërkuar nuk konsiderohet i lidhur ngushtësisht dhe i nevojshëm për objektin e prokurimit, bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 294, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19”.

2. Ky udhëzim gjithashtu përcakton se njësia matëse mbi të cilën do të prokurohet ky shërbim, do të jetë në metra katror (m<sup>2</sup>) për sipërfaqe ose metra kub (m<sup>3</sup>) për vëllim. Në shkresën e sipërcituar nr. 310 prot., datë 10.02.2021, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës ka përcaktuar se ky shërbim do të ofrohet për një sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup>.

Sipërfaqja totale që Zyra e KDIMDP ka në përgjegjësi administrimi është 768m<sup>2</sup>, duke përfshirë bordrumin, katin përdhës dhe katin e parë të godinës, bazuar në pikën 2, gërma a e VKM nr. 484,

datë 10.06.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi...të mjediseve në godinën e ish-hotel Drini”.

### ***Procedura e parë (e anuluar)***

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 01, datë 10.02.2021, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, në emër të Titullarit të AK, ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objektin sipas kërkesës fillestare.

Me anë të procesverbalit të datës 10.02.2021 (i paprotokolluar), Komisioni i Prokurimit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KPBVV) ka hartuar dhe argumentuar kriteret e përgjithshme e të veçanta, miratuar nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, në emër të Titullarit të AK.

Me anë të procesverbalit të datës 11.02.2021 (i paprotokolluar), KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës në sistem, ku është konstatuar se një prej operatorëve ka ngritur pretendimin në lidhje me kërkesën për licencën II.8.C, e cila në atë moment posedohej vetëm nga 1 OE dhe cënonte garën. KPBVV ka marrë parasysh ankesën, ka anuluar tenderin dhe ka kryer rishikimin e kriterit, duke e hequr licencën II.8.C si kriter.

Me anë të shkresës nr. Extra prot., datë 11.02.2021, KPBVV njofton vendimin e anulimit të procedurës së prokurimit dhe rishikimin e kriterëve.

### ***Procedura e dytë***

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 02, datë 16.02.2021, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objektin sipas kërkesës fillestare.

Me anë të shkresës nr. 310/5 prot., datë 16.02.2021, Titullari i AK ka miratuar formularin e ftesës për ofertë, bashkëlidhur Shtojca 1 me kërkesat për dokumentacion kualifikues.

Në dosje nuk administrohet një procesverbal nga KPBVV për hartimin dhe argumentimin e kriterëve, duke konsideruar shterues procesverbalin e hartuar në procedurën e parë (të anuluar) dhe njoftimin nr. Extra prot., datë 11.02.2021, ku është njoftuar rishikimi i kriterëve dhe heqja e kriterit për licencën II.8.C. Nga auditimi u konstatua se, në kriteret e reja është shtuar kërkesa që OE duhet të ketë jo më pak se 3 punonjës, e vërtetuar me vërtetim nga organet tatimore, duke përcaktuar vetëm numrin e punonjësve që OE duhet të ketë, mbështetur me vërtetim nga organet tatimore, por jo profesionin e tyre, që do të jepte garanci për zbatimin e kontratës me standardin e përshtatshëm të cilësisë, nw kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914/2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik”, i ndryshuar (në fuqi në kohën e kryerjes së veprimit), ku përcaktohet se në çdo rast, hartimi i kriterëve duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.

Me anë të procesverbalit të datës 17.02.2021 (i paprotokolluar), KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës së prokurimit, ku u skualifikuan fillimisht OE që kishin ofertuar mbi vlerën e fondit limit të përcaktuar. Nëpërmjet procesverbalit të datës 25.02.2021, KPBVV ka kaluar tek OE i renditur i gjashti, “C. A.” ShPK, i cili ka dorëzuar dokumentacionin fizik pranë KDIMDP, protokolluar me nr. 310/8 prot., datë 26.02.2021.

Nëpërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata e shërbimit nr. 310/9 prot., datë 26.02.2021, me vlerë **390,000 lekë pa TVSh** ose **468,000 lekë me TVSh**. Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, njëkohësisht NZ, mbështetur në Autorizimin nr. 30 prot., datë 06.01.2021. Nënshkrimi i kontratës nga NZ është në kundërshtim me nenet 19 – 21 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 12, 13, 15 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe pikat 2.1.2, 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”.

Kontrata është likuiduar, sipas Aneksit 1.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në procesverbalet e Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit, nuk ka dokumentacion vërtetues mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga ana e shoqërisë “C. A.” ShPK, referuar Kontratës së lidhur ndërmjet palëve, ku përfshihen, pa u kufizuar:

- Inspektimi i situatës dhe terrenit të brendshëm nga ana e drejtuesit teknik të shoqërisë, përpara kryerjes së çdo shërbimi, për të përcaktuar vendet e nevojshme dhe të përshtatshme, ku duhen kryer shërbimet për të qenë sa më efektive;
- Monitorimi dhe verifikimi i rezultatit të shërbimit nga ana e drejtuesit teknik të shoqërisë, për të rivlerësuar pikat apo vendet kritike; etj.

4. Procesverbalet e marrjes në dorëzim të shërbimit janë hartuar jo në momentin e marrjes së shërbimit, por në momentin e dorëzimit të faturave tatimore nga ana e OE, duke përfshirë 3 ose më shumë shërbime të marra, të realizuara në kohë të ndryshme. Këto procesverbale nuk plotësojnë kriteret për t’u konsideruar dokumentacion vërtetues, referuar pikës 35, gërma b, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2021, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve. Në pikën 36 të këtij udhëzimi, përcaktohet se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore apo administrative.

5. Të gjithë procesverbalet e hartuar nga Komisioni i marrjes në dorëzim janë të paprotokolluar, në kundërshtim me nenin 18 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet kanë të gjithë elementët e dokumenteve të brendshëm dhe duhet të protokollohen.

### **Për vitin 2022**

***Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 216, datë 31.12.2021, me përbërje:

- A. L., kryetar
- I. M., anëtar
- V. I., anëtar.

I. A. rikthehet nga leja e lindjes dhe zëvendëson A. Leskovikun, datë 01.04.2022.

Urdhri i Komisionerit nr. 67, datë 26.04.2022: A. L. zëvendëson I. M.

Urdhri i Komisionerit nr. 169, datë 05.10.2022: D. H. zëvendëson A. L.

***Komisioni për përlllogaritjen e fondit limit për blerjet e vogla*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 215, datë 31.12.2021, me përbërje:

- L. Xh.
- R. B.
- M. C..

***Komisioni i marrjes në dorëzim*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 213, datë 31.12.2021, me përbërje:

- D. H.
- E. M.
- A. B.

I. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “*Blerje pajisje zyre, mobilje*”, me nr. ref. REF-54052-12-19-2022, me fond limit **975,000 lekë pa TVSh**.

Me anë të shkresës nr. 2051/1 prot., datë 09.12.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, ku ndër shkaqet e përmendura është edhe amortizimi i karrigeve për një pjesë të tyre të blera ndër vite, i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për blerjen e pajisjeve të zyrës/ mobilje, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1.	Karrige rrotulluese drejtuesi	Copë	6
2.	Karrige ergonomike rrotulluese zyre	Copë	2

Me anë të procesverbalit nr. 2051/5 prot., datë 19.12.2022, Komisioni i përlogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 975,000 lekë pa TVSh.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 35, datë 15.12.2022, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt sipas kërkesës fillestare.

KPBVV ka hartuar procesverbalin nr. 2132/2 prot., datë 15.12.2022 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike,

Me anë të procesverbalit të datës 20.12.2022, KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës së prokurimit, ku janë kualifikuar 8 OE dhe janë skualifikuar 11 OE për mospërputhje të objektit të veprimtarisë, mungesë korrektese në procedurat e mëparshme ose tejkalim të fondit limit.

Me argumentin e mungesës së korrektesës në procedura të mëparshme, KPBVV ka skualifikuar OE, me ofertat ekonomike, si më poshtë:

- M. M. – 490,000 lekë pa TVSh;
- E. K. & T. – 898,000 lekë pa TVSh;
- A. – 916,667 lekë pa TVSh;
- J. P. & P. – 950,000 lekë pa TVSh;
- E. A. – 958,000 lekë pa TVSh.

Referuar pikës 15, gërma b, të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël do të refuzojnë automatikisht ofertën e paraqitur nga një OE, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga ky AK, brenda periudhës 1-vjeçare nga data e zhvillimit të kësaj procedure, nuk është paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë për të realizuar objektin e prokurimit, pavarësisht faktit se mund të ketë njoftuar AK, por nuk ka dhënë arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Nga auditimi u konstatua se:

- OE “A. D.”, në procedurën nr. REF-44640-10-06-2022, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, ka njoftuar tërheqjen, për arsye të pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore për realizimin e procedurës;
- Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion procedura që është bërë shkak për refuzimin e ofertës së OE “M. M.”, “J. P. & P.”, “E. A.”.

Për sa më sipër, refuzimi i ofertave të sipërpërmendura është i pambështetur në legjislacionin e prokurimit publik dhe bie në kundërshtim me frymën e Ligjit “*Për prokurimin publik*”, që, sipas përcaktimit në nenet 2 dhe 3 të tij, synon të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën, duke siguruar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

- OE “E. K. & T.”, në procedurën nr. REF-44640-10-06-2022, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, nuk është paraqitur dhe nuk ka njoftuar AK mbi arsyen. KPBBV ka vijuar me refuzimin e OE, në kushtet e parashikuara në pikën 15, gërma b, të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021.

Pas tërheqjes apo mosparaqitjes së OE sipas renditjes, të dokumentuara me procesverbalet përkatës, nëpërmjet procesverbalit të datës 27.12.2022, KPBBV ka kaluar te OE “D...”, me vlerë ekonomike 969,500 lekë pa TVSh.

Në procesverbalin e specifikimeve teknike, AK ka kërkuar garanci se produkti është konform standardeve evropiane, duke listuar “EN 1335-1:2000”, “EN 1335 -1/AC:2002”, “EN 1335-2:2009”, “EN 1335-3:2009”. OE ka paraqitur pranë certifikatën e konformitetit nr. 030-03-026-00266 nga një subjekt certifikues i huaj, për standardet e kërkuara. Nga auditimi u konstatua se këto standarde janë shfuqizuar që në vitin 2018, duke u përditësuar me standarde të reja.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 276, datë 29.12.2022**, në vlerën **1,163,400 lekë me TVSh**, bazuar në faturën elektronike nr. 971/2022, datë 29.12.2022 dhe në procesverbalin e datës 29.12.2022 (i paprotokolluar). Materialet kanë hyrë në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 12, datë 29.12.2022.

Në procesverbalin e hartuar, komisioni konfirmon marrjen në dorëzim të mallrave të kërkuar, por pa dhënë detaje mbi treguesit cilësorë të tyre, në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke mos ofruar garanci se pajisjet e marra në dorëzim janë apo jo në përputhje me specifikimet teknike dhe dokumentet e paraqitur nga OE.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të kërkuar në Shtojcën nr. 2 të procesverbalit nr. 2132/2 prot., datë 15.12.2022, si *certifikatat e garancisë* dhe *certifikatat e cilësisë*. KPBBV nuk ka kërkuar, e më tej komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka administruar, dokumentacionin shoqërues, si *certifikatat e origjinës* dhe *raportet e testeve* për mallrat e kërkuara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1 të Rekomandimeve të Veçanta, në Rekomandimin e APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021.

## II. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2022*”, me nr. ref. REF-54061-12-19-2022, me fond limit **976,000 lekë pa TVSh**.

Me anë të shkresës nr. 2051 prot., datë 03.12.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për blerjen e pajisjeve kompjuterike, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1.	Desktop	Copë	5
2.	Laptop	Copë	2

Me anë të procesverbalit nr. 2051/3 prot., datë 15.12.2022, Komisioni i përlogaritjes së fondit limit, referuar kërkesës nr. 2051 prot., datë 03..12.2022, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 976,000 lekë pa TVSh.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 36, datë 15.12.2022, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia
1.	Desktop	Copë	11
2.	Fotokopje Multifunction	Copë	1
3.	HDD 1 TB External	Copë	1

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se ka mospërputhje mes mallrave të kërkuar në kërkesën fillestare, për të cilat është kryer dhe përlogaritja e fondit limit, dhe mallrave të kërkuar në Urdhrin e prokurimit.

KPBVV ka hartuar procesverbalin nr. 2133/2 prot., datë 15.12.2022 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike. Ndër të tjera, KPBVV ka kërkuar:

- Autorizim nga firma prodhuese/ distributori për licencë platforme menaxhimi virtual;
- Të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i platformës së menaxhimit virtual.

Platforma e menaxhimit virtual nuk është e lidhur me mallrat që kërkohen të prokurohen. Ky kriter është argumentuar vetëm ligjrisht, por jo teknikisht, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të procesverbalit të datës 20.12.2022, KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës së prokurimit, ku janë kualifikuar 9 (nëntë) OE dhe janë skualifikuar 7 (shtatë) OE për mospërputhje të objektit të veprimtarisë, mungesë korrekte në procedurat e mëparshme ose tejkallim të fondit limit.

Me argumentin e mungesës së korrektesës në procedura të mëparshme, KPBVV ka skualifikuar OE, me ofertat ekonomike, si më poshtë:

- A. D. – 916,667 lekë pa TVSh;
- E. I. – 919,900 lekë pa TVSh;
- X. S. – 925,000 lekë pa TVSh;
- J. P. & P. – 950,000 lekë pa TVSh.

Nga auditimi u konstatua se:

- OE “A. D.”, në procedurën nr. REF-44640-10-06-2022, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, ka njoftuar tërheqjen, për arsye të pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore për realizimin e procedurës;
- OE “X. S.”, në procedurën nr. REF-44640-10-06-2022, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, ka njoftuar tërheqjen, duke argumentuar se stafi është i angazhuar në një procedurë tjetër;
- OE “E. I.”, në procedurën nr. REF-44640-10-06-2022, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, ka njoftuar tërheqjen, për arsye të mosrealizimit në kohë të procedurës;
- Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion mbi procedurën që është bërë shkak për refuzimin e ofertës së OE “J. P. & P.”.

Për sa më sipër, refuzimi i ofertave të sipërpërmendura është i pambështetur në legjislacionin e prokurimit publik dhe bie në kundërshtim me frymën e Ligjit “Për prokurimin publik”, që, sipas përcaktimit në nenet 2 dhe 3 të tij, synon të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën, duke siguruar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

OE “C.” ShPK, i renditur i dyti, me ofertë ekonomike 795,000 lekë pa TVSh, ka dorëzuar dokumentacionin fizik, protokolluar pranë KDIMDP me nr. 2133/3 prot., datë 22.12.2022. Me anë të procesverbalit të datës 22.12.2022, KPBVV ka dokumentuar skualifikimin e tij mungesë të autorizimit nga prodhuesi/ distributori për kompjuter/ licencë platforme menaxhimi virtual.

OE “I.” ShPK, i renditur i treti, me ofertë ekonomike 850,600 lekë pa TVSh, ka dorëzuar dokumentacionin fizik, protokolluar pranë KDIMDP me nr. 2133/4 prot., datë 23.12.2022. Me anë të procesverbalit të datës 23.12.2022, KPBVV ka dokumentuar skualifikimin e tij duke pretenduar se OE u paraqit me mungesë dokumentacioni, por pa zbardhur në procesverbal dokumentacionin që mungon.



OE "P. S." ShPK, i renditur i shtati, me ofertë ekonomike 956,900 lekë pa TVSh, ka dorëzuar dokumentacionin fizik, protokolluar pranë KDIMDP me nr. 2133/5 prot., datë 28.12.2022.

OE ka përcjellë pranë KDIMDP autorizim nga prodhuesi "H." për rishitjen e produkteve (përfshirë kompjuter), si dhe certifikimin e E. M., si teknik për pajisjet nga prodhuesi "H.". Për këtë kërkesë, AK cilëson se punonjësit duhet të figurojnë në listëpagesa me kodin e caktuar, ndërkohë që ky punonjës, referuar kodit, mban detyrën e Drejtorit Ekzekutiv në Tregti (1120.10).

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 278, datë 29.12.2022**, në vlerën **1,148,280 lekë me TVSh**, bazuar në faturën elektronike nr. 11590/2022, datë 29.12.2022 dhe në procesverbalin e datës 29.12.2022 (i paprotokolluar). Materialet kanë hyrë në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 13, datë 29.12.2022.

Marrja në dorëzim e mallrave është kryer nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe I. H. (specialist IT).

Në procesverbalin e hartuar, komisioni konfirmon marrjen në dorëzim të mallrave të kërkuar dhe specifikimet teknike të kompjuterëve, pa cilësuar llojin e tyre, duke mos ofruar garanci se pajisjet e marra në dorëzim janë apo jo në përputhje me specifikimet teknike dhe dokumentet e paraqitur nga OE.

Nga auditimi u konstatua se kompjuterët e marrë në dorëzim ishin të llojit "L.", për të cilin OE nuk ka sjellë asnjë nga dokumentacioni i kërkuar, si:

- Autorizim nga firma prodhuese ose distributori i autorizuar, për të vërtetuar se është i autorizuar nga prodhuesi;
- Vërtetim se ka të punësuar një specialist në nivelin inxhinier të certifikuar nga prodhuesi në nivelin ekspert për pajisje kompjuter, laptop të firmës që do të ofertojë.

Gjithashtu, Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka administruar fletën e garancisë të mallrave, të kërkuar në Ftesën për ofertë, si dhe dokumentacionin shoqërues, si *certifikatat e cilësisë, certifikatat e origjinës, certifikatat e garancisë dhe raportet e testeve*, në kundërshtim me pikën 1 të Rekomandimeve të Veçanta, në Rekomandimin e APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021.

**III. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt "Mirëmbajtje dhe përmirësim/ upgrade i platformës/ portalit pyetshtetin.al, për vitin 2022", me nr. ref. REF-22922-03-17-2022, me fond limit 970,000 lekë pa TVSh.**

Me anë të shkresës nr. 552 prot., datë 08.03.2022, Drejtori i Drejtorisë së Informimit i dërgon Drejtorit të Shërbimeve të Brendshme dhe Financës kërkesën për nisjen e procedurës për përmirësimin e portalit "pyetshtetin.al" dhe mirëmbajtjen e tij, i cili, nëpërmjet shkresës nr. 552/1 prot., bën me dije Komisionerin dhe KPBBV.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 07, datë 16.03.2022, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objektin sipas kërkesës fillestare. Me anë të procesverbalit nr. 552/4 prot., datë 16.03.2022, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar fondin limit në vlerën 970,000 lekë pa TVSh. Me anë të procesverbalit nr. 552/5 prot., datë 17.03.2022, KPBBV ka dokumentuar argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Me anë të procesverbalit të datës 18.03.2022 (i paprotokolluar), KPBBV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës, nga ku janë kualifikuar 4 (katër) OE dhe janë skualifikuar 4 (katër) OE për shkak se objekti i veprimtarisë referuar QKB nuk përfshin objektin e prokurimit ose mosparaqitjeve të paarsyetuara në procedura të mëparshme.

Me argumentin e mungesës së korrektesës në procedura të mëparshme, KPBBV ka skualifikuar OE "E. W. S.", me ofertë ekonomike 799,000 lekë pa TVSh. Ky OE, në procedurën nr. REF-17958-01-28-2022, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, nuk është paraqitur dhe

nuk ka njoftuar AK mbi arsyen. KPBBV ka vijuar me refuzimin e OE, në kushtet e parashikuara në pikën 15, gërma b, të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021.

Pas tërheqjes apo mosparaqitjes së OE sipas renditjes, të dokumentuara me procesverbalet përkatës, nëpërmjet procesverbalit të datës 25.03.2022 për kalimin të OE “S. P.”, me vlerë ekonomike 950,000 lekë pa TVSh.

Nëpërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata nr. 552/8 prot., datë 01.04.2022, me vlerë totale **950,000 lekë pa TVSh ose 1,140,000 lekë me TVSh**. Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është znj. L. M., njëkohësisht NZ, mbështetur në Autorizimin nr. 2191 prot., datë 31.12.2021. Nënshkrimi i kontratës nga NZ është në kundërshtim me nenet 19 – 21 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 12, 13, 15 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe pikat 2.1.2, 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”.

Kontrata është likuiduar në vlerën **1,140,000 lekë me TVSh**, si më poshtë:

Nr.	USH	Vlera në USH	Fatura	Vlera në faturë	Marrja në dorëzim
1.	101/ 23.05.2022	1,020,000	22/2022 16.05.2022	1,020,000	16.05.2022 D. H.; E. M.; A. B.; A. K. - DPDI
2.	256/ 21.12.2022	120,000	54/2022 20.12.2022	120,000	20.12.2022 D. H.; E. M.; A. B.; A. K. - DPDI
<b>TOTALI</b>		<b>1,140,000</b>			

Nga auditimi u konstatua se Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka në përbërje të tij asnjë specialist të fushës IT, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Procesverbalet e Komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimit nuk janë hartuar në momentin e marrjes së shërbimit, por në momentin e dorëzimit të faturave tatimore. Ato nuk japin të dhëna mbi datën dhe vendin e kryerjes së veprimeve për marrjen e shërbimit, objektin dhe shkakun, personat që kanë kërkuar e ekzekutuar veprimet për marrjen e shërbimit, si dhe të tjera të dhëna të nevojshme që do t’i jepnin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Mungesa e specialistit të fushës në përbërje të komisionit ka bërë që procesverbalet e hartuara të mos përshkruajnë shërbimin e marrë me të dhëna mbi treguesit cilësorë të marrjes së shërbimit, pra aspektin teknik, si asistencën teknike për specialistët TIK apo në ruajtjen e kopjes së sigurtë të të dhënave (backup), por vetëm aspektin vizual të portalit “pyetshtetin.al”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**IV. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim dezinfektimi dhe 3D për zyrën e Komisionerit në kuadër të Covid-19, për vitin 2022”, me nr. ref. REF-18031-01-28-2022, me fond limit 480,000 lekë pa TVSh.**

Me anë të shkresës nr. 218 prot., datë 27.01.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për shërbimet e dezinfektimit, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Seanca trajtimi
1.	Shërbim dezinfektimi për Zyrën e Komisionerit në kuadër të Covid-19	m <sup>2</sup>	2000	28
2.	Shërbim 3D (Dezinfektim, Dezinsëktim, Deratizim)	m <sup>2</sup>	2000	2

Me anë të procesverbalit nr. 218/1 prot., datë 28.01.2022, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 480,000 lekë pa TVSh.

Shërbimi 3D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim) i kërkuar nuk konsiderohet i lidhur ngushtësisht dhe i nevojshëm për objektin e prokurimit, bazuar në Udhëzimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 294, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19”.

Ky udhëzim gjithashtu përcakton se njësia matëse mbi të cilën do të prokurohet ky shërbim, do të jetë në metra katror (m<sup>2</sup>) për sipërfaqe ose metra kub (m<sup>3</sup>) për vëllim. Në shkresën e sipërcituar nr. 218 prot., datë 27.01.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës ka përcaktuar se ky shërbim do të ofrohet për një sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup>.

Sipërfaqja totale që Zyra e KDIMDP ka në përgjegjësi administrimi është 768m<sup>2</sup>, duke përfshirë bordrumin, katin përdhës dhe katin e parë të godinës, bazuar në pikën 2, gërma a e VKM nr. 484, datë 10.06.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi...të mjediseve në godinën e ish-hotel Drini”.

Me anë të procesverbalit nr. 218/2 prot., datë 28.01.2022, KPBBV ka dokumentuar argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 05, datë 28.01.2022, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objektin sipas kërkesës fillestare. Me anë të shkresës nr. 218/4 prot., datë 28.01.2022, Titullari i AK ka miratuar formularin e ftesës për ofertë.

Me anë të procesverbalit nr. 218/7 prot., datë 31.01.2022, KPBBV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës së prokurimit, ku u kualifikuan 11 OE dhe u skualifikuan 10 OE që kishin ofertuar mbi vlerën e fondit limit të përcaktuar.

Duke qenë se 4 ofertat e renditura të para ishin të barabarta, OE iu dërgua nëpërmjet SPE kërkesa për hedhje shorti. Me anë të procesverbalit nr. 218/8 prot., datë 01.02.2022, KPBBV shpall OE “A.” ShPK si fitues, me ofertë në vlerën 250,000 lekë pa TVSh, i cili ka dorëzuar dokumentacionin fizik pranë Zyrës së KDIMDP, protokolluar me nr. 218/9 prot., datë 02.02.2022.

Nëpërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata e shërbimit nr. 218/10 prot., datë 07.02.2022, me vlerë 250,000 lekë pa TVSh ose 300,000 lekë me TVSh. Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është znj. L. M., njëkohësisht NZ, mbështetur në Autorizimin nr. 2191 prot., datë 31.12.2021. Nënshkrimi i kontratës nga NZ është në kundërshtim me nenet 19 – 21 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 12, 13, 15 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe pikat 2.1.2, 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”.

Kontrata e shërbimit është likuiduar në vlerën **300,000 lekë me TVSh**, si më poshtë:

Nr.	Urdhër shpenzimi	Vlera në USH (në lekë)	Fatura	Vlera pa TVSh (në lekë)	Vlera totale (në lekë)	Shërbimi	Procesverbali	Marrja në dorëzim
1.	86/ 10.05.2022	96,000	113/2022 03.05.2022	80,000	96,000	Dezinfektim (7x) 3D (1x)	03.05.2022	D. H.; E.M.; A. B.
2.	166/ 14.09.2022	108,000	238/2022 02.08.2022	90,000	108,000	Dezinfektim (12x)	01.08.2022	D. H.; E.M.; A. B.
3.	269/ 27.12.2022	96,000	411/2022 23.12.2022	80,000	96,000	Dezinfektim (8x) 3D (1x)	23.12.2022	D. H.; E.M.; A. B.
<b>TOTALI</b>		<b>300,000</b>		<b>250,000</b>	<b>300,000</b>	<b>Dezinfektim (27x) 3D (2x)</b>		

Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit nuk ka vërtetuar përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga ana e shoqërisë “A.” ShPK, referuar Kontratës së lidhur ndërmjet palëve, ku përfshihen, pa u kufizuar:

- Inspektimi i situatës dhe terrenit të brendshëm nga ana e drejtuesit teknik të shoqërisë, përpara kryerjes së çdo shërbimi, për të përcaktuar vendet e nevojshme dhe të përshtatshme, ku duhen kryer shërbimet për të qenë sa më efektive;
- Monitorimi dhe verifikimi i rezultatit të shërbimit nga ana e drejtuesit teknik të shoqërisë, për të rivlerësuar pikat apo vendet kritike; etj.

Gjithashtu, Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit nuk ka administruar certifikatën dhe raportin e kryerjes së shërbimit, sa herë ky shërbim është kryer, sipas përcaktimit në Shtojcën 3 “Specifikimet teknike”.

Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit ka hartuar procesverbalet jo në momentin e marrjes së shërbimit, por në momentin e dorëzimit të faturave tatimore nga ana e OE, duke përfshirë 8 ose më shumë shërbime të marra, të realizuara në kohë të ndryshme. Këto procesverbale nuk plotësojnë kriteret për t’u konsideruar dokumentacion vërtetues, referuar pikës 35, gërma b, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2021, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike të veprimeve. Në pikën 36 të këtij udhëzimi, përcaktohet se dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore apo administrative. Të gjithë procesverbalet e hartuar nga Komisioni i marrjes në dorëzim janë të paprotokolluar, në kundërshtim me nenin 18 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet kanë të gjithë elementët e dokumenteve të brendshëm dhe duhet të protokollohen.

**V. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Përmirësim i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, me nr. ref. REF-54836-12-22-2022, me fond limit 875,000 lekë pa TVSh.**

Me anë të shkresës nr. 2051/2 prot., datë 09.12.2022, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës së prokurimit me objekt përmirësim i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit, që konsiston në blerjen dhe instalimin e një *firewall*-i.

Me anë të procesverbalit nr. 2051/4 prot., datë 15.12.2022, Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 875,000 lekë pa TVSh. Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 37, datë 19.12.2022, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, sipas kërkesës fillestare. KPBBV ka hartuar procesverbalin nr. 2155/1 prot., datë 19.12.2022 për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike.

Me anë të procesverbalit të datës 23.12.2022, KPBBV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës së prokurimit, ku është kualifikuar 1 (një) OE dhe janë refuzuar 2 (dy) OE, njëri prej të cilëve pasi ka ofertuar mbi vlerën e fondit limit.

Me argumentin e mungesës së korrektesës në procedura të mëparshme, KPBBV ka refuzuar OE “X. S.”, me ofertë ekonomike 577,000 lekë pa TVSh.

Referuar pikës 15, gërma b, të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël do të refuzojnë automatikisht ofertën e paraqitur nga një OE, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga ky AK, brenda periudhës 1-vjeçare nga data e zhvillimit të kësaj procedure, nuk është paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë për të realizuar objektin e prokurimit, pavarësisht faktit se mund të

ketë njoftuar AK, por nuk ka dhënë arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Nga auditimi u konstatua se OE “X. S.”, në procedurën nr. REF-44640-10-06-2022, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, ka njoftuar tërheqjen, duke argumentuar se stafi është i angazhuar në një procedurë tjetër.

Për sa më sipër, refuzimi i ofertës së OE “X. S.”, njëkohësisht oferta më e ulët, në vlerë 577,000 lekë pa TVSh, është i pambështetur në legjislacionin e prokurimit publik dhe bie në kundërshtim me frymën e Ligjit “Për prokurimin publik”, sipas përcaktimit në nenet 2 dhe 3 të tij, që synon të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën, duke siguruar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

OE “P. S.”, i shpallur fitues me ofertë ekonomike në vlerë 796,000 lekë pa TVSh, ka dorëzuar dokumentacionin fizik, administruar pranë KDIMDP me nr. 2155/3 prot., datë 27.12.2022.

Mbi kërkesën e autorizimit nga firma prodhuese ose distributori i autorizuar, OE ka paraqitur Formularin e autorizimit të prodhuesit nga kompania “C. I. L.”.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 279, datë 29.12.2022**, në vlerën **955,200 lekë me TVSh**, bazuar në faturën elektronike nr. 11591/2022, datë 29.12.2022 dhe në procesverbalin e datës 29.12.2022 (i paprotokolluar). Materialet kanë hyrë në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 14, datë 29.12.2022.

Marrja në dorëzim e mallrave është kryer nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe I. H. (specialist IT).

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka administruar fletën e garancisë 1-vjeçare të mallit, të kërkuar në Ftesën për ofertë, si dhe dokumentacionin shoqërues të mallit, si *certifikatat e cilësisë, certifikatat e origjinës, certifikatat e garancisë dhe raportet e testeve*, në kundërshtim me pikën 1 të Rekomandimeve të Veçanta, në Rekomandimin e APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021.

### **Për vitin 2023**

***Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 02, datë 04.01.2023, me përbërje:

- D. H., kryetar
- M. C., anëtar
- A. L., anëtar.

Urdhri i Komisionerit nr. 64, datë 02.05.2023: V. I. zëvendëson D. Habibasi për periudhë 4-javore.

Urdhri i Komisionerit nr. 119, datë 11.07.2023, V. I. zëvendëson D. Habibasi për kohësisht (leje vjetore).

***Komisioni për përlogaritjen e fondit limit për blerjet e vogla*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 03, datë 04.01.2023, me përbërje:

- L. Xh.
- I. A.
- B. T.

***Komisioni i marrjes në dorëzim*** përbëhet, si më poshtë:

Urdhri i Komisionerit nr. 01, datë 04.01.2023, me përbërje:

- R. L.
- V. K.
- A. B.

I. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “***Konceptim dhe realizim video/ spot për promovimin e Konferenca e 15-të Ndërkombëtare e Informimit (ICIC)***”, me nr. ref. REF-90282-12-11-2023, me fond limit **970,000 lekë pa TVSh**.

Me anë të shkresës nr. 1247/8 prot., datë 05.12.2023, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për blerjen e konceptimit dhe video/ spot për promovimin e Konferencës XV Ndërkombëtare të Informimit (ICIC).

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 38, datë 07.12.2023, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt sipas kërkesës fillestare.

KPBVV ka hartuar procesverbalin nr. 2273/1 prot., datë 07.12.2023 për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim. Ky procesverbal, pavarësisht emërimit, nuk përmban asnjë kriter që OE duhet të plotësojë e as argumentimet ligjore e teknike të tyre, por vetëm specifikimet e video/ spot-it të kërkuar.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, ku citohet se, në çdo rast, hartimi i kërkesave për kualifikim duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Me anë të procesverbalit nr. 2273/2 prot., datë 07.12.2023, Komisioni për përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në treguesit e çmimeve të marra në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën objekt prokurimi, ka përcaktuar fondin limit në vlerën 970,000 lekë pa TVSh.

Titullari i AK, nëpërmjet shkresës nr. 2273/3 prot., datë 07.12.2023, ka miratuar formularin e ftesës për ofertë, duke bashkëlidhur Shtojcën 1 *“Kërkesa mbi dokumentacion kualifikues”* dhe Shtojca 2 *“Përshkrimi i punës”*.

Në pikën II *“Aftësitë teknike dhe profesionale”*, AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar, ndër të tjerë, 3 aktorë. Ky kriter, përveçse i paargumentuar teknikisht, nuk ka lidhje me objektin e kontratës, pasi shërbimi nuk kërkon aktorë.

Me anë të procesverbalit të datës 13.12.2023, KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës, ku u konstatua vetëm 1 ofertues OE *“N. M.”*, i shpallur fitues me ofertë ekonomike 890,000 lekë pa TVSh.

Nga auditimi u konstatua se:

1. OE *“N. M.”* ShPK rezulton të jetë regjistruar në QKB në datën 02.12.2020, ndërkohë që në Kriteret për Kualifikim, OE duhet të vërtetojë që ka një aktivitet pa shpëputje prej të paktën 4 (katër) vjetësh;

2. Mbi kërkesën e AK që OE duhet të paraqesë punë të ngjashme mbi krijimin e videove të animuara të realizuara, OE ka paraqitur dy kontrata, pa fatura bashkëlidhur apo dokumentacion tjetër vërtetues të realizimit. Këto kontrata kanë objekt keçe të xhiruar, video të dubluara, reklama radiofonike, por jo video të animuara, sipas kërkesës së AK.

Për sa më sipër, KPBVV, pas konstatimit të elementëve të mësipërm, duhej ta kishte skualifikuar OE *“N. M.”*.

Ndërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata nr. 2273/5 prot., datë 13.12.2023, me vlerë 1,068,000 lekë me TVSh. Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është znj. L. M., njëkohësisht NZ, mbështetur në Autorizimin nr. 2259 prot., datë 30.12.2022. Nënshkrimi i kontratës nga NZ është në kundërshtim me nenet 19 – 21 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, nenet 12, 13, 15 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, dhe pikat 2.1.2, 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 *“Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”*.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 251, datë 29.12.2023**, në vlerën **1,068,000 lekë me TVSh**, bazuar në faturën elektronike nr. 51/2023, datë 21.12.2023 dhe në procesverbalin e datës 21.12.2022 (i paprotokolluar) të Komisionit të marrjes në dorëzim.

Objekti i prokuruar është trajtuar si shërbim, e jo si mall, duke mos i bërë hyrje në magazinë. Referuar nenit 3, pika 25, të Ligjit “Për prokurimin publik”, mall do të konsiderojmë çdo gjë materiale me vlerë ekonomike.

**II.** Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Rikonceptim i faqes zyrtare të KDIMDP-së**”, me nr. ref. REF-81034-09-25-2023, me fond limit **980,000 lekë pa TVSh**.

Me anë të shkresës së datës 02.03.2023, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës për rikonceptimin e faqes zyrtare të KDIMDP-së. Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 11, datë 06.03.2023, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt sipas kërkesës fillestare.

KPBVV ka hartuar procesverbalin nr. 525/1 prot., datë 11.03.2023, për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim, duke përcaktuar vetëm kriteret, por pa argumentimet ligjore e teknike të tyre, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se, në çdo rast, hartimi i kërkesave për kualifikim duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Në pikën II “Aftësitë teknike dhe profesionale”, AK ka kërkuar që OE të ketë:

- “Në përbërje të stafit të punësuar të paktën 1 (një) zhvillues (developer), me eksperiencë punë rreth 10 vjet si zhvillues, të vërtetuar me paraqitjen e CV, listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe kontratë të rregullt pune;
- Kontratë të rregullt shërbimi me specialistët, si 2 dizenjues me eksperiencë mbi 5 vjet, 1 teknik audio, 1 montues video.”

Sa i takon stafit të punësuar, kërkesa mbi eksperiencën prej rreth 10 vitesh, veçse e paargumentuar ligjërisht dhe teknikisht, nuk vërtetohet me asnjë prej dokumentacionit të kërkuar nga OE. AK nuk ka argumentuar kërkesën për kontratë shërbimi me specialistët e listuar, kërkesën që 2 dizenjuesit duhet të kenë eksperiencë mbi 5 vjet, si dhe pse zhvilluesi duhet të jetë pjesë e stafit, ndërsa specialistët e tjerë duhet të jenë kontraktuar me kontratë shërbimi.

Grupi i auditimit vlerëson se këto kriterë, jo vetëm që nuk janë të argumentuar ligjërisht e teknikisht, por nuk janë në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe, njëkohësisht, ndikojnë si pengesë për konkurrencën e hapur.

Pas anulimit të procedurës, për shkak se asnjë prej OE të skualifikimit (të dokumentuar me procesverbalet përkatës), Titullari i AK, me anë të urdhrit të prokurimit nr. 31, datë 22.09.2023 ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt sipas kërkesës fillestare.

Me anë të procesverbalit të datës 26.09.2023, KPBVV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës, ku u kualifikuan 3 OE dhe u skualifikua 1 OE, për shkak se objekti i veprimtarisë së tij nuk është i njëjtë me atë të procedurës së prokurimit. Me anë të procesverbalit për kalimin tek OE i rradhës, KPBVV ka shpallur fitues OE “T.” ShPK, me ofertë ekonomike 960,000 lekë pa TVSh.

Për plotësimin e kriterëve të aftësive teknike dhe profesionale, OE ka paraqitur dokumentacionin, si më poshtë:

- 1 (një) zhvillues me eksperiencë punë rreth 10 vjet

Referuar listëpagesave të kontributeve shoqërore, OE “T.” ShPK ka në organikë vetëm punonjësin T. K., sipas kodit përkatës me funksion “Administrator”, për të cilin është paraqitur CV përkatëse. Grupi i auditimit vlerëson se eksperiencia është marrë e mirëqenë nga vetëdeklarimi në CV dhe nuk ka asnjë dokument vërtetues bashkëlidhur.

- Kontratë të rregullt shërbimi me specialistët e listuar

OE ka paraqitur kontratat, si më poshtë:

- Marrëveshje/ kontratë shërbimi, e datës 01.09.2023, e panoterizuar, ndërmjet shoqërisë “T.” ShPK dhe “B. G.” PF;
- Kontratë shërbimi, e datës 01.09.2023, e panoterizuar, ndërmjet shoqërisë “T.” ShPK dhe “E. L.”;
- Marrëveshje/ kontratë shërbimi, e datës 01.09.2023, e panoterizuar, ndërmjet shoqërisë “T.” ShPK dhe “O.”, bashkëlidhur dhe listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të shoqërisë.

Asnjë nga kontratat nuk specifikon rolin që do të mbulojë secili prej palëve, detyrën specifike dhe kohëzgjatjen. Kontrata me shoqërinë “O.” nuk specifikon stafin që do të angazhohet në përmbushje të kësaj kontrate.

Grupi i auditimit vlerëson se kontratat e paraqitura nuk konsiderohen dokumentacion i rregullt vërtetues për përmbushjen e kriterit të vendosur nga AK. Për sa më sipër, OE “T.” ShPK duhej të ishte skualifikuar.

Ndërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata nr. 535/8 prot., datë 03.10.2023, me vlerë totale 960,000 lekë pa TVSh ose 1,152,000 lekë me TVSh. Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është znj. L. M., njëkohësisht NZ, mbështetur në Autorizimin nr. 2259 prot., datë 30.12.2022. Nënshkrimi i kontratës nga NZ është në kundërshtim me nenet 19 – 21 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 12, 13, 15 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe pikat 2.1.2, 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve”.

Nëpërmjet procesverbalit të datës 16.10.2023, Grupi i IT i përbërë nga R. B., I. H. dhe U. H. kanë konfirmuar marrjen në dorëzim të shërbimit sipas detajeve të kërkuara në specifikimet e shërbimit. OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 235/1, datë 21.12.2023**, në vlerën **960,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 18/2023, datë 16.11.2023 dhe në procesverbalin e datës 16.11.2022 (i paprotokolluar) të Komisionit të marrjes në dorëzim.

**III. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Krijim dhe dizejmim i faqes për Edicionin i 15-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)”**, me nr. ref. REF-88280-11-20-2023, me fond limit **800,000 lekë pa TVSh**.

Me anë të shkresës nr. 2090 prot., datë 20.11.2023, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës i dërgon Komisionerit kërkesën për nisjen e procedurës me objekt, si më poshtë:

- Realizimi i një simbolike që përfaqëson konceptin e transparencës;
- Dizejmimi dhe funksionaliteti i faqes së konferencës;
- Dizejmimi dhe funksionaliteti i mekanizmit të regjistrimit të pjesëmarrësve;
- Shërbimi i materialeve bazë (dosje, stilolapsa, blloqe, dhurata, etj.) për pjesëmarrësit.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 36, datë 20.11.2023, Titullari i AK ka kërkuar përdorimin e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt krijimin dhe dizejmimin e faqes për Edicionin e 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, që është vetëm 1 nga kërkesat e parashtruara në shkresën e mësipërme.

KPBVV ka hartuar procesverbalin nr. 2091/1 prot., datë 20.11.2023, për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim. Ky procesverbal përcakton vetëm kriteret, por pa argumentimet ligjore e teknike të tyre.

Në pikën II “Aftësitë teknike dhe profesionale”, AK ka kërkuar që OE të ketë:

- “1. *Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të ketë në përbërje të stafit të tij të punësuar të paktën për periudhën janar-tetor këta punonjës të cilën duhet ta vërtetojë me paraqitjen e CV, listë pagesat e sigurimeve shoqërore: 2 Designer & 3 Zhvillues programues;*



- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë punë të ngjashme mbi krijimin e faqeve, të realizuara (minimumi 5 punë të ngjashme).*”

Grupi i auditimit vlerëson se, të dyja kërkesat e mësipërme, veçse të paargumentuara ligjërisht dhe teknikisht, nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, duke ndikuar si pengesë për konkurrencën e hapur.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Nenin 77, pika 1, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një ofertues ka kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet dhe të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës;
- Nenin 39, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
- Nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, në çdo rast, hartimi i kërkesave për kualifikim duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

Me anë të procesverbalit nr. 2091/3 prot., datë 20.11.2023, komisioni ka dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit, ku pas studimit të tregut është përcaktuar fondi limit prej 800,000 lekë pa TVSh.

Me anë të procesverbalit të datës 21.11.2023, KPBBV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e procedurës, ku u kualifikuan 3 OE dhe u skualifikuan 4 OE, 3 prej të cilëve u skualifikuan për shkak se kishin ofertuar mbi ose nën 50% të fondit limit.

Me argumentin e mungesës së korrektesës në procedura të mëparshme, KPBBV ka skualifikuar OE “E. W. S.”, me ofertë ekonomike 400,001 lekë pa TVSh.

Nga auditimi u konstatua se, OE “E. W. S.”, në procedurën nr. REF-79891-09-13-2023, pasi është shpallur fitues dhe njoftuar nëpërmjet SPE, nuk është paraqitur dhe nuk ka njoftuar AK mbi arsyen (*rishikuar pas observacionit nr. 247/5 prot., datë 28.05.2024*).

Referuar procesverbalit të datës 22.11.2023, KPBBV ka skualifikuar OE “I”, me ofertë në vlerë 449,900 lekë pa TVSh, duke u shprehur se “*OE ka paraqitur dokumentacion jo të plotë, sipas ftesës për ofertë*”, por pa dhënë arsyet e skualifikimit. Duke kaluar tek OE i rradhës, KPBBV ka shpallur fitues OE “T. D. A.”, me ofertë ekonomike 650,000 lekë pa TVSh, i cili ka përcjellë dokumentacionin fizik, administruar pranë KDIMDP me nr. 2091/5 prot., datë 23.11.2023.

Ndërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata nr. 2091/6 prot., datë 30.11.2023, me vlerë totale 650,000 lekë pa TVSh ose 780,000 lekë me TVSh. Përfaqësues i AK për lidhjen e kontratës është znj. L. M., njëkohësisht NZ, mbështetur në Autorizimin nr. 2259 prot., datë 30.12.2022. Nënshkrimi i kontratës nga NZ është në kundërshtim me nenet 19 – 21 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenet 12, 13, 15 dhe 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, dhe pikat 2.1.2, 3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 14.10.2016 “*Për nëpunësin zbatues të të gjithë niveleve*”.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 231, datë 14.12.2023**, në vlerën **780,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 409/2023, datë 13.12.2023 dhe në procesverbalin e datës 13.12.2023 (i paprotokolluar) të Komisionit të marrjes në dorëzim.

Në dosje, jo bashkëlidhur Urdhër-shpenzimit, administrohet procesverbali i datës 13.12.2023 (i ndryshëm nga procesverbali i Komisionit të marrjes në dorëzim) për marrjen në dorëzim, i nënshkruar nga I. H., U. H., B. T., R. S. dhe S. B..

Objekti i prokuruar është trajtuar si shërbim, e jo si mall, duke mos i bërë hyrje në magazinë. Referuar nenit 3, pika 25, të Ligjit “Për prokurimin publik”, mall do të konsiderojmë çdo gjë materiale me vlerë ekonomike.

## **2.7 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar**

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u realizua bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij Ligji.

Sipas përcaktimeve të këtij Ligji, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike.

### ***Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues***

Përgjatë periudhës së auditimit, pranë Zyrës së KDIMDP, Nëpunësi Autorizues ka qenë z. B. D., me detyrë Komisioner, konfirmuar nëpërmjet shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, administruar pranë KDIMDP nr. 1581/1 prot., datë 08.08.2014, dhe Nëpunësi Zbatues ka qenë znj. L. M., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, konfirmuar nëpërmjet shkresës nr. 202/1 prot., datë 10.02.2017 drejtuar Ministrisë së Financave.

### ***Grupi i menaxhimit strategjik (GMS)***

Titullari i njësisë ka krijuar GMS për vitet periudhë auditimi, si më poshtë:

Për vitin 2021, nëpërmjet Urdhrit të Komisionerit nr. 26, datë 12.03.2021, me përbërje (i) Komisioneri; (ii) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit; (iii) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; (iv) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës;

Për vitin 2022, nëpërmjet Urdhrit të Komisionerit nr. 212, datë 31.12.2021, me përbërje (i) Komisioneri; (ii) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit; (iii) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; (iv) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës;

Për vitin 2023, nëpërmjet Urdhrit të Komisionerit nr. 246, datë 30.12.2022, me përbërje (i) Komisioneri; (ii) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit; (iii) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; (iv) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.

*Kontrolli i brendshëm* përbëhet nga pesë komponentë të ndërlidhur, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si më poshtë:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;
- Monitorimi.

## **I. Mjedisi i Kontrollit**

Ky komponent i kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në një njësi të caktuar. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë, filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon e zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep niveli drejtues. Ky mjedis ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë dhe marrëdhëniet e llogaridhënies.

### ***Integriteti dhe vlerat etike***

Me anë të Urdhrit nr. 109, datë 14.07.2022, Komisioneri ka miratuar Kodin e Etikës, ku përfshihen dispozitat e përgjithshme, rregullat për zbatimin e parimeve të etikës, përcaktime të veçanta për titullarin e institucionit, rregullat e klasifikimit të veprimtarive të jashtme, dhuratat dhe favorët, këshillimi, trajnimi, mbikëqyrja dhe disiplina për zbatimin e rregullave të etikës, si dhe 3 shtojca, ku bëjnë pjesë deklaratat e konfliktit të interesit, Regjistri i Posaçëm i Dhuratave dhe deklarata për dhënien e pëlqimit për dypunësim.

### ***Struktura organizative***

Neni 37 i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përcakton se Kuvendi vendos për pagën e Komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e Zyrës së KDIMDP dhe punonjësit e kësaj zyre gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës pranë Zyrës së KDIMDP ka qenë fillimisht miratuar nëpërmjet Vendimit të Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, me 37 punonjës gjithsej. Përgjatë periudhës së auditimit, nëpërmjet Vendimit të Kuvendit nr. 84/2020, datë 23.12.2020, akti i mësipërm ka pësuar ndryshimet e para, nëpërmjet të cilit organika është rritur në 44 punonjës.

Ndryshimi i fundit i aktit, përgjatë periudhës së auditimit, është miratuar nëpërmjet Vendimit të Kuvendit nr. 24/2023, datë 23.03.2023, me numër total prej 60 punonjësish. Për shkak të ligjit të Buxhetit për vitin 2023, numri i punonjësve për Zyrën e Komisionerit për vitin 2023 është miratuar me 52 punonjës. Struktura sipas këtij vendimi me 60 punonjës është miratuar me Ligjin e Buxhetit 97/2023 me Buxhetin e vitit 2024.

### ***Delegimi i detyrave***

Neni 15 i Ligjit përcakton rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave, ku përcaktohet e drejta e NA, NZ dhe menaxherëve të tjerë për të deleguar disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre të vartësit direkt.

1. Nga auditimi u konstatua se Komisioneri, njëkohësisht Nëpunës Autorizues pranë KDIMDP, ka autorizuar Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, njëkohësisht Nëpunës Zbatues, të nënshkruajë kontratat e punëve, mallrave apo shërbimeve me çdo OE, shpallur fitues nga procedurat e prokurimit apo realizimi i blerjeve nën 100,000 lekë, me mjete elektronike ose jo, përgjatë gjithë viteve periudhë auditimi, nëpërmjet shkresave, si më poshtë:

- Për vitin 2021, nëpërmjet Autorizimit nr. 30 prot., datë 06.01.2021;
- Për vitin 2022, nëpërmjet Autorizimit nr. 2191 prot., datë 31.12.2021;
- Për vitin 2023, nëpërmjet Autorizimit nr. 2259 prot., datë 30.12.2022.

Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk duhet të çenojë në asnjë rast të drejtat e menaxherit që i delegohen këto të drejta, ose ta shkarkojë atë nga përgjegjshmëria për realizimin e detyrave përkatëse. Konkretisht, NZ është përgjegjës dhe jep llogari para NA, ndër të tjera, për garantimin para miratimit të shkresave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, si dhe për pranimin ose jo

të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor. Në rastin e delegimit të të drejtës së nënshkrimit të kontratave, që konsistojnë në angazhime financiare për njësinë, NZ, duke kryer detyrat e deleguara nga NA, perceptohet e pamundur të kryejë funksionet e përcaktuara shprehimisht për NZ.

Delegimi i sipërpërmendur është në kundërshtim me:

- Nenin 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, ku citohet se nëpunësi zbatues caktohet nga nëpunësi autorizues për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, ku citohet se, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre, nëpunësit autorizues kanë të drejtën të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat te punonjësit e nivelit menaxhial në varësi direkte, me përjashtim të delegimit te nëpunësit zbatues.

2. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave dhe shërbim mirëmbajtje 3-vjeçare të KDIMDP-së*”, u konstatua se Komisioneri, me anë të Urdhrit nr. 50, datë 28.03.2023, ka urdhëruar delegimin e kompetencave të Titullarit të Zyrës së KDIMDP te B. V., me detyrë Drejtor Kabineti, për periudhën nga data 03.04.2023 deri më datë 07.04.2023.

Me anë të Autorizimit nr. 360/14 prot., datë 05.04.2023, Drejtori i Kabinetit, në mungesë dhe me urdhër të Komisionerit, autorizon Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të nënshkruajë kontratën.

Referuar nenit 28, pika 4, të Kodit të Procedurave Administrative, organi i deleguar ndalohej të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfuara përmes delegimit. Për sa më sipër, referuar pikës 5 të kësaj dispozite, ky autorizim është i pavlefshëm.

3. Nëpërmjet shkresës nr. 202/1 prot., datë 10.02.2017 drejtuar MFE, Komisioneri, njëkohësisht NA, ka njoftuar se ka deleguar znj. L. M., njëkohësisht NZ, si koordinator risku të KDIMDP.

Neni 10, pika 1, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, përcakton se nëpunësi autorizues i njësisë publike është koordinator risku. Në pikën 2.2.2 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “*Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e riskut në njësitë publike*” përcaktohet, ndër të tjera, se NA nuk kanë të drejtë delegimi të disa prej përgjegjësive dhe detyrave kryesore të koordinatorit të riskut. Për më tepër, neni 15 i Ligjit përcakton se delegimi te nëpunësit zbatues është i ndaluar.

Pra, jo vetëm që disa prej përgjegjësive dhe detyrave janë shprehimisht të ndaluara të delegohen, por edhe delegimi te NZ është shprehimisht i ndaluar.

## **II. Menaxhimi i Riskut**

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen për arritjen e objektivave të vendosura.

### **Strategjia institucionale**

Nëpërmjet procesverbalit nr. 1716/1 prot., datë 05.10.2022, GMS ka dokumentuar finalizimin dhe miratimin e Strategjisë institucionale, së bashku me planin e veprimit për 3 vite, të cilat janë miratuar nëpërmjet Urdhrit të Komisionerit nr. 168, datë 05.10.2022.

Në këtë strategji, rezulton të jenë përcaktuar objektivat, si më poshtë:

### ***E Drejta për Informim***

- Objektivi 1** Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në përputhje me standardet ndërkombëtare
- Objektivi 2** Komunikimi proaktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës së autoriteteve publike
- Objektivi 3** Bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe të drejtat që u burojnë në fushën e të drejtës për informim
- Objektivi 4** Zhvillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda komunitetit global rregullator të të drejtës për informim

### ***Mbrojtja e të Dhënave Personale***

- Objektivi 1** Arritja e standardeve më të larta rregullatore për të forcuar mbrojtjen e të dhënave në epokën digjitale
- Objektivi 2** Rritja e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmirësimeve ligjore, me fokus të veçantë në sistemet e sigurisë së menaxhimit të informacionit
- Objektivi 3** Rol aktiv në ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve me fokus edukimin e brezit të ri
- Objektivi 4** Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e përvojave më të mira, me fokus rrishtë që sjell zbatimin e legjislacionit të harmonizuar me *acquis* të BE

### ***Planet e punës***

Komisioneri ka miratuar Programet vjetore të punës, si më poshtë:

- Për vitin 2021, nr. 117 prot., datë 15.01.2021;
- Për vitin 2022, nr. 384 prot., datë 15.02.2022;
- Për vitin 2023, nr. 265 prot., datë 31.01.2023.

Nga auditimi u konstatua se objektivat dhe aktivitetet e vendosura në këto plane pune janë të përgjithshme dhe konsistojnë kryesisht në detyrat funksionale të secilës prej njësive.

Në veçanti, sa i përket Drejtorisë së Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave, pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave, si njësi përgjegjëse për kryerjen e hetimeve administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave, objektivi i përvitshëm i kryerjes së hetimeve administrative orientohet me sektorë dhe jo me subjekte konkrete. Zyra e KDIMDP nuk ka asnjë rregullore të shkruar se si kryhet identifikimi, e më tej përzgjedhja, e subjekteve private të secilit sektor të parashikuar në plan vjetor. Ky lloj përcaktimi, përveçse pamundëson krahasimin vjetor plan – fakt, për të vlerësuar performancën e departamentit, pasi objektivi në vetvete nuk është i matshëm, nuk ofron garanci të planifikimit në bazë risku të subjekteve ndaj të cilëve do të ushtrohet inspektim.

Në mungesë të një metodologjie specifike për hartimin e planit strategjik dhe planeve periodike të punës, KDIMDP mund t'i referohet *për analogji* Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë, miratuar nëpërmjet Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.04.2015, në mbështetje të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”.

Në pikën 2.1 të manualit përcaktohet metodologjia që njësi duhet të ndjekë për hartimin e planit strategjik të inspektimeve, që mbulon periudhë 3-vjeçare, ndarë në faza, ku përfshihen, ndër të tjera, njohja me subjektet e inspektimit dhe identifikimi i objekteve dhe fushave të rëndësishme të kontrollit.

Në asnjë rast, KDIMDP nuk ka kryer një analizë në bazë risku, për të identifikuar sektorë me risk, duke kushtëzuar aktivitetin institucional vetëm në rekomandimet e Rezolutave vjetore të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në pikën 2.2 të manualit përcaktohet se, ndërsa plani strategjik i inspektimit përmbledh tregues të përgjithshëm, plani vjetor është më i detajuar dhe bazohet më shumë mbi *informacionet dhe vlerësimet e riskut*. Në këtë fazë, kryhet planifikimi në mënyrë sasiore i aktivitetit inspektues, duke u bazuar në (i) numrin e inspektorëve dhe kualifikimet përkatëse, (ii) numrin e subjekteve të inspektimit dhe kategoritë e tyre, (iii) shpërndarjen territoriale të subjekteve të inspektimit, (iv) kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e inspektimeve sipas subjekteve, si dhe (v) numrin e personelit mbështetës ose mjeteve të nevojshme për kryerjen e inspektimit.

Në asnjë rast, KDIMDP nuk ka kryer një analizë risku dhe nuk ka përcaktuar në mënyrë të detajuar sasiore aktivitetin inspektues, ku të detajohen të dhënat e mësipërme.

Në pikën 2.6 të manualit cilësohet se njësitë përcaktojnë *treguesit e faktorëve të riskut të sektorëve, subjekteve dhe objekteve* të inspektimit, duke marrë si standard edhe praktikatat më të mira kombëtare dhe/ ose ndërkombëtare.

Në asnjë rast, KDIMDP nuk ka përcaktuar treguesit e faktorëve të riskut të sektorëve, subjekteve dhe objekteve ku kanë ushtruar inspektimet.

Në pikën 2.7 të manualit përcaktohet se planifikimi mujor bëhet i detajuar me subjekte të përzgjedhura për inspektime mujore, sipas planit vjetor. Sikur është parashtruar në manual, i gjithë aktiviteti inspektues kryhet me bazë risku. Numri i subjekteve që do të inspektohen do të varen nga niveli i riskut të subjektit/ fushës përkatëse të inspektimit.

Në asnjë rast, KDIMDP nuk ka detajuar planifikimin mujor, me përzgjedhjen e subjekteve, argumentuar me faktorët e riskut përkatës.

Për gjithë sa më sipër, planet e punës të hartuara për Drejtorinë e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave janë formale dhe nuk konsistojnë në planifikim në bazë risku të aktivitetit inspektues.

### ***Strategjia e riskut***

Nëpërmjet procesverbalit nr. 1716/1 prot., datë 05.10.2022, GMS ka dokumentuar finalizimin dhe miratimin e Strategjisë së riskut, të rishikuar, për vitet 2022 – 2025, miratuar nëpërmjet Urdhrit të Komisionerit nr. 168, datë 05.10.2022.

## **III. Aktivitetet e Kontrollit**

### ***Procedurat e shkruara***

Nga auditimi u konstatua se, pavarësisht se kryerja e hetimeve administrative konsiderohet një prej aktiviteteve kryesore, detyrë dhe përgjegjësi e KDIMDP, Zyra e KDIMDP nuk ka hartuar dhe miratuar një procedurë të shkruar dhe një hartë mbi realizimin e këtij procesi. Në vendimet e hetimeve të kryera, Komisioneri i referohet Kodit të Procedurave Administrative, që përmban dispozita të përgjithshme mbi kryerjen e procedurave administrative.

Përgatitja e një manuali të proceseve kryesore të punës garanton njehsimin në kryerjen e tyre, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto afate duhet të kryhen, së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. Pamja e përgjithshme e procesit përmban jo vetëm një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit, por edhe dokumentacionin që përdoret dhe administrohet gjatë ecurisë së tyre. Hartimi i këtij akti do të shërbente si udhëzues, jo vetëm për Zyrën e KDIMDP, por edhe për të gjitha njësitë publike e private, subjekte të hetimeve administrative të KDIMDP me fokus të drejtën e informimit apo mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 22 i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, përcakton se njësitë publike miratojnë aktivitetin e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara. Detajuar më tej, në pikën 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin përcaktohet se njësitë publike duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për procese dhe procedura përkatëse, duke filluar nga zbatimi i ligjeve, e duke vijuar me miratimin e rregulloreve të tyre të brendshme (udhëzime, direktiva) për të evidentuar më hollësisht procedurat, përcaktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, si dhe procedurat e kontrollit. Neni 16 i Ligjit “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” përcakton se, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë, titullari miraton *gjurmën e auditimit*, duke siguruar që të gjithë operacionet dokumentohen në formë të tillë, që u mundësojnë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Për sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me drejtuesit e njësisë përkatëse (i) për hartimin e procedurave të shkruara për kryerjen e hetimeve administrative në fushat përkatëse, ku të detajohet procedura e ndjekur që në fazën e planifikimit vjetor, përzgjedhja e subjekteve, procedura e hetimit administrativ, afatet përkatëse dhe ndarja e roleve e përgjegjësisë të palëve të përfshira, si dhe (ii) për hartimin dhe miratimin e hartës e manualit të procesit të punës dhe gjurmës së auditimit për secilin nga proceset.

#### **IV. Informimi dhe Komunikimi**

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë. Punonjësit e KDIMDP janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij (@idp.org.al). Përgjatë auditimit, nuk u konstatuan raste të mungesës së komunikimit horizontal efektiv të brendshëm.

Sa i përket komunikimit të jashtëm, nga auditimi i procedurave të aktivitetit inspektues të KDIMDP (trajtuar më gjerësisht në drejtimin përkatës), grupi i auditimit konstatoi se shkresat përcjellëse, pjesë e korrespondencave me subjektet e inspektuara janë nënshkruar nga Drejtori i Departamentit përkatës dhe jo nga titullari i institucionit, në mungesë të një Urdhri specifik për delegimin e kësaj kompetence.

Grupi i auditimit vlerëson se ky veprim është në kundërshtim me:

- Nenet 28-29 të Ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, për arsye të mungesës së Urdhrit të Komisionerit për delegimin e kompetencës së nënshkrimit të dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Komisionerit;
- Modelin 1 të Shtojcës nr. 1, të VKM nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”;
- Nenin 12 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ku, ndër të tjera, përcaktohet se data dhe numri i protokollit vendosen pas nënshkrimit nga titullari;
- Nenin 5, pika 3, të Rregullores së brendshme, ku përcaktohet se Komisioneri përfaqëson institucionin në marrëdhëniet brenda e jashtë vendit;
- Nenin 32, gërma d, të Rregullores së brendshme, ku përcaktohet se në mungesë të titullarit, aktet dhe dokumentet nënshkruhen nga zyrtari i autorizuar nga Komisioneri, duke shënuar në dokumentin zyrtar, sipas rastit, “*Në mungesë dhe me urdhër*”.

#### **V. Monitorimi dhe Raportimi**

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë,

i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

### ***Vetëvlerësimi***

Neni 18 i Ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, përcakton se NA i njësisë publike depoziton te titullari i njësisë raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt i vitit aktual. NPA, më tej, përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit prill.

Nga auditimi u konstatua se, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dërguar pranë Ministrin përgjegjës për financat deklaratat dhe raportin vjetor, së bashku me pyetësonin e vetëvlerësimit, si më poshtë:

- Për vitin 2021, nëpërmjet shkresës nr. 433/2 prot., datë 20.02.2022;
- Për vitin 2022, nëpërmjet shkresës nr. 485/2 prot., datë 28.02.2023;
- Për vitin 2023, nëpërmjet shkresës nr. 572/3 prot., datë 29.02.2024.

### ***Auditimi i brendshëm***

Përveç monitorimeve të vazhdueshme, titullari i njësisë mund të përdorë AB për efekt të vlerësimit të kontrollit të brendshëm që ekziston në njësinë publike. Vlerësimi i sistemeve të MFK-së që kryhet nga audituesit e brendshëm, i ofron informacion titullarit të njësisë, lidhur me efikasitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të MFK-së. Kështu, veprimtaria e AB mbështet titullarin e njësisë në monitorimin e sistemeve të MFK-së.

Nga auditimi u konstatua se, përgjatë periudhës së auditimit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka siguruar shërbim të auditimit të brendshëm, çka do të ofronte siguri të arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në kundërshtim me nenin 12, pika 1, të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar.

Neni 10, pika 1, i këtij Ligji, përcakton se njësitë publike sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm. Format e përcaktuara për aplikimin e kësaj dispozite janë nëpërmjet kryerjes së shërbimit të auditimit të brendshëm (i) nga njësia e auditimit të brendshëm, kur ka një të tillë të parashikuar në strukturën organizative të njësisë publike; (ii) nga NjAB e institucionit epror ose e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse (në këtë rast, marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat); si dhe (iii) me kontraktim, sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa për vlerësimin e formës më të përshtatshme nga mundësitë e parashikuara në ligj, me qëllim sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm për njësinë.

## **2.8 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme**

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet shkresës nr. 119/6 prot., datë 30/04/2015, protokolluar pranë KDIMDP me nr. 122/10 prot., datë 05/05/2015, ka paraqitur pranë KDIMDP Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe 15 masa organizative, për zbatimin e të cilave Komisioneri i DIMDP ka miratuar Urdhrin nr. 106, nr. 122/11 prot., datë 15/05/2015 “Mbi marrjen e masave organizative për zbatimin e rekomandimeve të KLSH”.



Komisioneri i DIMDP paraqet pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet shkresës nr. 122/12 prot., datë 22/05/2015, planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna, si dhe nëpërmjet shkresës nr. 122/13 prot., datë 02/10/2015, informacionin 6-mujor mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet shkresës nr. 1026/7 prot., datë 06/11/2015, protokolluar pranë KDIMDP me nr. 122/14 prot., datë 09/11/2015, ka autorizuar grupin e auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Nëpërmjet Akt-verifikimit të datës 16/11/2015, protokolluar pranë KDIMDP me nr. 122/16 prot., datë 15/11/2015, grupi i auditimit shprehet se nga 15 masa organizative të lëna, rezulton të jenë zbatuar plotësisht të gjitha.

Për sa më sipër, nuk rezulton të ketë rekomandime të tjera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, subjekt për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve.

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë zhvilluar në total 211 procedura/ hetime administrative/inspektive, nga të cilat 192 janë kryer nga Drejtoria e Monitorimit të Programit të Transparencës dhe Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave si dhe 19 janë kryer nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri nuk është shprehur për përfundimin e 211 procedurave/hetimeve administrative/inspektive, në formën e një akti administrativ, si:

Vendim përfundimtar/Deklaratë të përfundimit të procedurës administrative /Rekomandim /Urdhër /Autorizim, parashikuar në Kodin e Procedurës administrative si dhe në Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 11 dhe 90 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 31 të Rregullosës së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr. 949 prot, datë 21.5.2021.

Nga auditimi i 11 (njëmbëdhjetë) praktikave të procedurave administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale rezultoi se:

- Në 6 (gjashtë) praktika, Komisioneri nuk ka përfunduar procedurën e nisur, përmes deklaratës së përfundimit sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 90 të ligjit nr.45.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Në 2 (dy) raste, Komisioneri nuk është shprehur për verifikimet jo të plota të grupit të inspektimit, mosveprimet vijnë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr.45/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Në 4 (katër) praktika, nga ana e Komisionerit nuk është marrë vendim përfundimtar mbi shkeljet administrative të Kontrollorëve për të cilat parashikohen sanksione administrative sipas nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, mosveprimi i Komisionerit në formën e mosshprehjes së vullnetit të tij për përfundimin e procedurave administrative përmes nxjerrjes së aktit administrativ është në kundërshtim me nenin 90 të KPA-së, nenin 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, si dhe nenin 31 të Rregullosës së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr. 949 prot, datë 21.5.2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa në vijim për përfundimin e procedurave administrative/ hetimeve administrative /inspektive në formën e nxjerrjes së një akti administrativ, parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Zyra e Komisionerit ka nisur hetim administrativ ndaj Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, pas ngjarjeve të datës 22.12.2021 dhe 24.12.2021, mbi publikimin në aplikacionin *Whats'app* të bazës së të dhënave personale të nëpunësve/punëmarrësve të sektorit publik dhe atij privat si dhe pronarë automjeteve. Objekt i hetimit administrativ ishte verifikimi i ligjshmërinë së përpunimit të të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave “*nëpunës*” në sektorin publik dhe privat si dhe subjekteve të të dhënave “*pronar të automjeteve*”, nisur nga informacionet e publikuara në media.

Në përfundim të hetimit ndaj DPT dhe DPSHTRR, Komisioneri ka disponuar me vendim për dënimin me gjobë për secilin nga kontrolluesit, si dhe ka informuar/ka vënë në dijeni mbi rezultatet e vendimmarrjes së tij Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Lidhur me hetimin administrativ të nisur ndaj AKSHI-t, nga ana e Komisionerit nuk ka nxjerrje të një akti administrativ për përfundimin e procedurës administrative si: Vendim përfundimtar/ Deklaratë të përfundimit të procedurës administrative./Rekomandim/Urdhër, parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative si dhe Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit. Referuar përmbajtjes së procesverbalit nr.478/3 prot, datë 05.7.2022, të mbajtur nga grupi i inspektimit lidhur me konstatimet e tij, ndër të tjera citohet se:-*AKSHI nuk përmbushi të gjitha kërkesat për informacion të parashtruar nga grupi i inspektimit duke penguar zhvillimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të hetimit administrativ në kundërshtim me parashikimet e nenit 32 si dhe nuk ka respektuar detyrimet e parashikuara në nenet 5, 6, 7, 18, 20, 21, 22, 27, 28 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe aktet nënligjore të Komisionerit.*

Në vlerësimin e grupit të auditimit, mosveprimet e Komisionerit për mospërfundimin e procedurës administrative ndaj AKSHI-t në formën e nxjerrjes së një akti administrativ, janë në kundërshtim me nenin 30, pikën 4 të nenit 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, nenin 8 të Ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, nenin 11 dhe 90 të KPA-së, si dhe nenin 31 të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit nr.949, datë 21.5.2021. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa për përfundimin e procedurës administrative të nisur ndaj AKSHI-t dhe nxjerrjen e përgjegjësive ligjore për shkeljet e konstatuara nga grupi i hetimit.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Zyra e KDIMDP nuk ka hartuar një rregullore të brendshme/manual lidhur me përcaktimin e kërkesave, metodave që ndiqen për procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, identifikimin e përgjegjësive si dhe evidentimin e punës së gjithsecilit në këtë proces si dhe në hierarkinë organizative institucionale. Referuar pikës 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin përcaktohet se, njësitë publike duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për procese dhe procedura përkatëse, duke filluar nga zbatimi i ligjeve, e duke vijuar me miratimin e rregulloreve të tyre të brendshme (udhëzime, direktiva) për të evidentuar më hollësisht procedurat, përcaktimin e autoritetit dhe

përgjegjësisë, si dhe procedurat e kontrollit. Për më tepër, edhe në rregulloren e brendshme të Zyrës së Komisionerit miratuar me Urdhër nr.71, datë 21.5.2021, rezultoi se mungonin përshkrimet e detyrave për çdo/inspektor/specialist brenda sektorit/drejtorisë, të proceseve të tyre të punës brenda sektorit përkatës, duke lënë vend për mbivendosje të tyre si dhe krijimin e problematikave në evidentimin e përgjegjësisë ligjore.

Pasqyrimi në rregulloren e brendshme të ndarjes së duhur të detyrave dhe fushave të përgjegjësisë për çdo punonjës zvogëlon mundësitë për modifikim të pa autorizuar apo të pa qëllimshëm apo keqpërdorim të tyre. Në bazë të nenit 20, shkronja c, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, përcaktohet se: “ *titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit lidhur me strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Zyra e KDIMDP të marrë masa për (i) hartimin e një manuali/rregulloreje për përcaktimin e kërkesave, metodave që ndiqen për procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, identifikimin e përgjegjësive dhe evidentimin e punës së gjithsecilit në këtë proces si dhe për (ii) kryerjen e plotësimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Me Vendimin nr. 45, datë 20.09.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është vendosur sanksioni administrativ dënimit me gjobë në vlerën prej 50,000 lekë për A. B. me detyrë sekretare e përgjithshme, Bashkia Elbasan. Në këtë procedurë administrative nuk është marrë në konsideratë kuadri ligjor e nënligjor në fuqi, konkretisht:

a. Fillimi i gjykimit të kundërvajtjes administrative nuk është bërë mbi bazën e procesverbalit, i cili duhet të ishte mbajtur nga personat e autorizuar nga ligji, të ketë shënuar identitetin e kundërvajtjes, llojin e kundërvajtjes dhe të jetë nënshkruar, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, neni 14, pika 1 dhe pika 2.

b. Gjatë gjykimit të kundërvajtës nuk janë administruar provat e nevojshme për zbulimin e së drejtës objektive, d.m.th të administrohen ato prova që hedhin dritë dhe sqarojnë kryerjen e kundërvajtës dhe subjektin e saj, pasi seanca dëgjimore online e datës 14.07.2021 nuk është e dokumentar në formën e transkriptuar, regjistrim audio, ose një procesverbal/dokument të barasvlerëshëm i nënshkruar nga palët pjesëmarrëse, ose e konfirmuar në mënyrë elektronike.

c. Në gjykimin e kundërvajtës nuk kanë marrë pjesë palët, të cilat nëpërmjet debatit, gjatë gjykimit dhe në përfundimin e tij ndikojnë në zbulimin e të vërtetës:

-Nuk është vënë në dijeni pala Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan, që ka vendosur formalisht dokumentin e Programit të Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhër nr. 211, datë 10.09.2018, për këtë nuk ka:

-Nuk ka Korrespondencë me Autoritetin Publik/Bashkia Elbasan në mënyrë shkresore ose elektronike me e-mail, etj.

-Nuk ka seancë dëgjimore të re ku të ketë marrë pjesë pala Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan, përveç asaj të datës 14.07.2021.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 87, pika 1 dhe 2/dh, pika 3, Neni 53, pika 2 dhe neni 82.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, referuar komenteve sa më sipër, vendimi nr. 45, datë 20.09.2021 i Komisionerit për dënimin me 50,000 lekë gjobë për A. B. me detyrë sekretare e

përgjithshme, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”, nenet 7, 14 dhe 19 dhe Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij neni 53 pika 2, neni 82 dhe neni 87, pika 1, 2/dh, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa për dokumentimin e procesit të vendosjes së sanksioneve administrative në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Shkolla “U. S.” me e-mailin e datës 25 janar 2024 ora 14 .00 dhe e-mailin e datës 29.01.2024 ora 11.33, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me kërkesën me objekt: “Të marrë në shqyrtim praktikën e hedhjes e të përpunimit të të dhënave personale online në databazën qendrore SMIP të administruar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në këndvështrim të Ligjit 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave”.

Përmes adresës zyrtare elektronike të Zyrës së Komisionerit, është dërguar përgjigje me e-mail me nr. 244/1 prot., datë 02.02.2024 shkollës “U. S.”, ku në mënyrë eksplicite është shprehur “Përgjatë vitit 2023 ka ushtruar hetim administrativ ndaj QSHA në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale për sistemin SMIP. Në përfundim të hetimit administrativ Zyra e Komisionerit ka dalë me rekomandimin nr. 33, datë 27.06.2023, të cilin mund të gjeni të publikuar në faqen zyrtare të internetit në lidhjen, <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2023/01/Rekomandimin-QSHA.pd.....>”.

Zyra Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka njoftuar Shkollën “U. S.” Tiranë, për regjistrimin e kërkesës së saj dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurës. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 44 pika 2/a. Në dosje nuk disponohet relacion/plan me veprime nga grupi i punës së caktuar nga titullari.

-Në mungesë të kryerjes se veprimeve procedurale nga grupi i caktuar, nuk ka një vendimarrje nga Komisioneri, lidhur me këtë procedurë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 90.

-Nga intervistat e zhvilluara me personat përgjegjës të Zyrës së Komisionerit, është argumentuar se, dy e-mailet e dërguara nga Shkolla “U. S.”, nuk janë trajtuar si ankesë, por vënie në dijeni. Ky fakt është në kundërshtim me pjesën narrative të kërkesë-ankesës, si dhe provat dokumentare/ Libri “Firmat e prindit” SMIP, që i bashkëlidhen kërkesës.

Veprim në kundërshtim me pikën 3/b e nenit 41, neni 47, neni 48, neni 58 pika 3, neni 59 pika 3, neni 77, neni 90, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 5, 6 dhe 16 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Nga Zyra e Komisionerit të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për trajtimin e kërkesave/ankesave/informacioneve/dijenive, duke kryer hetim administrativ në “Qendrën e Shërbimeve Arsimore”, Tiranë, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Brenda datës 31.10.2024

**6. Gjetje nga auditimi:** Në 10 praktika të vendimarrjes së Komisionerit në fushën e të drejtës së informimit dhe që parashikojnë sanksione administrative rezultuan parregullsi në procedurën e

konstatimit të kundërvajtjes si dhe në përmbajtjen e dokumentacionit që shoqëronte Vendimin e Komisionerit, rezultoi se:

- Në 8 raste nuk është ndjekur dhe zbatuar procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, sipas pikën 1, të nenit 14 të ligjit të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjen administrative*”, pasi nga personat përgjegjës për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk është kryer dokumentimi i saj me procesverbal të firmosur edhe nga kundërvajtësi.

- Në 7 raste mungon Urdhri i Komisionerit “*Për kryerjen e hetimit administrativ*”, mbi caktimin e personave përgjegjës për hetimin e çështjes, fakt në mospërputhje me nenin 43, të Kodit të Procedurës Administrative.

- Nga inspektorët/specialisti përgjegjës për kryerjen e inspektimit nuk janë hartuar dhe miratuar deklaratat e ekzistencës/jo të konfliktit të interesave në momentin e fillimit të hetimit administrativ, sipas shkronjës “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 të nenit 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar.

- Në 6 raste nga personat përgjegjës të ngarkuar me monitorimin e faqeve zyrtare të Autoriteteve publike/Bashkitë nuk kryhet dokumentimi me procesverbal apo relacion i rezultateve të monitorimit për secilin nga rastet por, ato janë pasqyruar në dokumente me emërtim: “Raport konstatimi “*Rimonitorim i Programit të Transparencës së autoritetit publik*”. Dokumenti është i pa protokolluar dhe nuk ka të dhëna për strukturën përgjegjëse dhe personat përgjegjës që e kanë hartuar, duke mos përmbushur elementët formal të një dokumenti zyrtar.

- Në 2 raste, seanca dëgjimore nuk është e dokumentuar në formë elektronike (CD) /transkriptim i regjistrimit audio si dhe dokumentuar me procesverbal/dokument të barasvlershëm të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse.

Sa konstatuar më sipër vijnë në kundërshtim me nenet 13, 19 dhe 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, nenin 24 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “*Për arkivat*”.

- Në të gjitha praktikat dokumentacioni i praktikave është i pa arkivuar, Në kundërshtim me nenin me nenin 24 i Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “*Për arkivat*”, dhe pikën 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

- Në një rast nga personat përgjegjës nuk është mbajtur një relacion/memo për rezultatet e veprimeve procedurale të kryera në funksion të procedurës së zhvilluar, në kundërshtim me nenin 43, pika 3 të Ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

- Në një rast procesverbali i konstatimit të shkeljes administrative dhe ngarkimit me përgjegjësi të funksionarit publik rezulton i pa protokolluar. Veprime në kundërshtim me pikën 1 të nenit 104 të Ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 24 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “*Për arkivat*”, si dhe pikën 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Zyra e Komisionerit të marrë masa për (i) dokumentimin e veprimeve procedurale të kryera në funksion të procedurave administrative, si domosdoshmëri në rast përdorimi të një mjeti ligjor të mundshëm (*si ankimi gjyqësor*) si dhe me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit, (ii) arkivim të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit si dhe në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të

gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në procedurat e prokurimit për vitin 2022 me objekt: “*Ekspertizë e fushës në hartimin e metodologjisë për llogaritje e seksioneve administrative*” me vlerë 1,000,000 lekë dhe “*Hartimi i kurikulës për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe formimin profesional*” me vlerë 1,000,000 lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “F... P...”, nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 82, konkretisht:

-Në specifikimet teknike, shtojca 2, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë/në njohuri të gjëra dhe shumë të mira të koncepteve të legjisllacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe zhvillimeve legjisllative të fushës në Bashkimin Evropian, përfshirë, por jo vetëm, Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), Direktivën e Policisë, si dhe përvojë profesionale të provuar në këtë drejtim duhet të paraqesin kontrata të ngjashme/punë apo referenca materialesh/ekspertizash të ofruara në lidhje me hartim aktesh ligjore dhe nënligjore në sektorin publik apo privat. Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi ka paraqitur kontratat për punë të ngjashme me Shoqërinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në gjuhën angleze.

**7.1** Në procedurën e prokurimit blerje automjete në vlerën 2,998 mijë lekë realizuar në vitin 2021, në Shtojcën 9 “*Specifikimet teknike*” është përcaktuar ajër i kondicionuar; klima me shpërndarje të automatizuar. Operatori fitues “A.” shpk nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi ka paraqitur në specifikimet teknike për makinat “Peugeot 308 aktive, ajër të kondicionuar automatik (2 zona) dhe jo ajër i kondicionuar; klima me shpërndarje të automatizuar. Referuar sa më sipër: Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik shoqëria “A.” shpk, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*” nenet 77, 87, 89, 90, 92 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 46.

**7.2.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave dhe shërbim mirëmbajtje 3-vjeçare të KDIMDP-së*” u konstatua se, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga OE “S. P.”, asnjë punonjës i stafit nuk përmbush kriterin që të ketë mbi 5 vite eksperiencë pune si zhvillues, i pajisur me diplomë MSc në fushën e informatikës ose ekuivalente. Për sa më sipër, KVO duhej të kishte skualifikuar OE “S. P.”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 75 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

**7.3.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatuan parregullsi në vlerësimin e ofertave, duke kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e vendosura në DST dhe rrjedhimisht duheshin skualifikuar, përkatësisht:

Në procedurën “*Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2021*”, OE “P. S.” nuk ka sjellë dokumentacion të rregullt për të provuar autorizimin nga firma prodhuese/ distributori i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet kompjuter/ skaner;

Në procedurën “*Konceptim dhe realizim video/spot për promovimin e Konf. XV Ndërkombëtare e Informimit*”, OE “N. M.” nuk rezulton të përmbushë kriterin e vendosur që të ketë aktivitet pa shkëputje prej 4 vjetësh, pasi është regjistruar në QKR vetëm 3 vite përpara pjesëmarrjes në procedurë. Mbi kërkesën e AK që OE duhet të paraqesë punë të ngjashme mbi krijimin e videove të animuara të realizuara, OE ka paraqitur dy kontrata, pa fatura bashkëlidhur apo dokumentacion

tjetër vërtetues të realizimit. Këto kontrata kanë objekt skeçe të xhiruar, video të dubluara, reklama radiofonike, por jo video të animuara, sipas kërkesës së AK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.2.3. Rekomandimi:** Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor t'i kushtohet vëmendje procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 90 procedura prokurimi me vlerë të vogël në vlerën 39,980 mijë lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Autoriteti Kontraktor në përcaktimin e kufirit monetar, në procedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla, nuk ka marrë në konsideratë llogaritjen e grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure. Në këtë kontekst, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë përdorur si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës dhe për të bërë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit. Konkretisht për vitin 2021, dhjetë procedura për vlerën 4,947 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 4 procedura, për vitin 2022, njëmbëdhjetë procedura për vlerën 7,529 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 4 procedura dhe për vitin 2023, dymbëdhjetë procedura për vlerën 9,500 mijë lekë, duhet të ishin grupuar në 3 procedura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 41 “Procedurat standarde të prokurimit”, pika 3, neni 2 dhe neni 21, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 52, pika 2, pika 11, Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021 të APP-së, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9643 , datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, 8 dhe Neni 52. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe mos përsëritjen e rasteve të tilla për të ardhmen.

*Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Ne procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 17.03.2021 me objekt “Blerje automjete, për vitin 2021”, në vlerën 2,998 mijë lekë u konstatua vendosje të kriterëve për kualifikim të cilat ngushtojnë konkurrencën dhe orientojnë tregun drejt operatorëve të caktuar. Konkretisht në kërkesat për kualifikim është vendosur si kriterit “Autorizim nga prodhuesit”. Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejt një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik orientohet të jetë si fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme kufizojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3/1 dhe 77, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të

*prokurimit publik*”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 28, pika 2, Rekomandimin nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12, Ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” nenet 4/1, 5, 11/a;b, 13, 14 dhe 17/1;2, Vendimin nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

**9.1.** Në procedurën e prokurimit blerje automjete në vlerën 2,998 mijë lekë, për vitin 2021 nuk është argumentuar në referencë ligjore/nënligjore vendosja e kriterëve/specifikimeve si; a. Automjete me kilometrazh jo më shumë se 60.000 km; b. Automjete jo më parë se viti 2018.

**9.2.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Sistemi elektronik i menaxhimit të praktikave dhe të dhënave dhe shërbim mirëmbajtje 3-vjeçare të KDIMDP-së*” u konstatua se njësia e prokurimit ka kërkuar që OE të ketë (i) të paktën 2 punonjës, nga të cilët, 1 punonjës me eksperiencë si drejtues projekti dhe zhvillues me mbi të paktën 10 vjet punë, të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve MSc në fushën e informatikës ose ekuivalente dhe 1 punonjës me eksperiencë si zhvillues me eksperiencë mbi 5 vjet punë, i pajisur me diplomë MSc në fushën e Informatikës ose ekuivalente. Vendosja e kriterëve që punonjësit të jenë minimalisht me 5 apo 10 vite eksperiencë nuk është e argumentuar as ligjërisht e as teknikisht, dhe konsiderohet si pengesë për konkurrencën e hapur në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër, ky kriter duhej formuluar, duke kërkuar përvojën specifike që kërkohet nga punonjësit, pa kushtëzuar në vitet e eksperiencës. Njësia e prokurimit kërkon të paktën dy nga anëtarët të certifikuar për “S. P. Certified Professional”. Grupi i auditimit vlerëson se specifikimi i këtij certifikimi nuk është i argumentuar as ligjërisht e as teknikisht, duke ndikuar si pengesë për konkurrencën e hapur në procedurën e prokurimit. Për sa më sipër, ky kriter duhej hequr. Vendosja e kriterëve të mësipërme është në kundërshtim me nenin 77, pika 1, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, dhe nenin 39, pika 4, nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar.

**9.3.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatuan parregullsi në përcaktimin e kriterëve, përkatësisht:

Në procedurën “*Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2022*”, KPVV ka kërkuar paraqitjen e autorizimit nga firma prodhuese/ distributori për licencën e platformës së menaxhimit virtual dhe të ketë të paktën një punonjës të certifikuar nga prodhuesi i platformës së menaxhimit virtual. Grupi i auditimit vlerëson se kjo kërkesë nuk është e lidhur me mallrat që prokurohen. Ky kriter është argumentuar vetëm ligjërisht, por jo teknikisht, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

Në procedurën “*Konceptim dhe realizim video/spot për promovimin e Konf. XV Ndërkombëtare e Informimit*”, KPVV nuk ka argumentuar ligjërisht dhe teknikisht kriteret e vendosura në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. KPVV ka kërkuar që OE të ketë të punësuar, ndër të tjerë, 3 aktorë. Ky kriter, përveçse i paargumentuar teknikisht, nuk ka lidhje me objektin e kontratës, pasi shërbimi nuk kërkon aktorë.

Në procedurën “*Rikonceptim i faqes zyrtare të KDIMDP*”, KPVV nuk ka argumentuar ligjërisht dhe teknikisht kriteret e vendosura, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. KPVV ka kërkuar që OE të ketë (i) në përbërje të stafit 1 zhvillues developer me eksperiencë mbi 10 vjet dhe (ii) kontratë të rregullt shërbimi me 2 dizenjues me eksperiencë mbi 5 vjet, 1 teknik audio dhe 1 montues video. Grupi i



auditimit vlerëson se këto kritere, jo vetëm që nuk janë të argumentuar ligjërisht e teknikisht, por nuk janë në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe, njëkohësisht, ndikojnë si pengesë për konkurrencën e hapur.

Në procedurën “Krijim dhe dizajnim i faqes për Edicioni XV i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)”, KPVV nuk ka argumentuar ligjërisht dhe teknikisht kriteret e vendosura, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. KPVV ka kërkuar që OE të ketë në përbërje të stafit 2 designer dhe 3 zhvillues programues, si dhe të paraqesë punë të ngjashme mbi krijimin e faqeve minimumi 5 punë. Grupi i auditimit vlerëson se, të dyja kërkesat e mësipërme, veçse të paargumentuara ligjërisht dhe teknikisht, nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, duke ndikuar si pengesë për konkurrencën e hapur. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.2.3. Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

*Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Kontrata me operatorin ekonomik “A.” shpk, është lidhur me nr. 486/19 prot., datë 16.04.2021 për vlerën 3,583,200 lekë me TVSH. Në deklaratën e garancisë nga shoqëria “A” shpk me datë 29.03.2021 është përcaktuar garancia me një afat 1 vjeçar ose 30,000 km duke filluar nga data e dorëzimit, por pa vlerë, e cila nuk është përcaktuar në kontratë dhe nuk është mbajtur asnjë lekë për këtë garanci, duke mundësuar në këtë mënyrë që operatori ekonomik mund të mos kryej shërbimin e kontraktuar, për arsye nga më të ndryshmet përfshi dhe ndonjë faliment të mundshëm, duke rrezikuar në këtë mënyrë që Zyra e Komisionerit të harxhoj fonde të tjera. Autoriteti Kontraktor nuk ka hartuar planin e zbatimit të kontratës, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, pika 3, dhe Neni 125, pika 1, Udhëzimin e APP nr. 8, datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”, Rekomandimin APP “Drejtorja e Koordinimit dhe Monitorimit”, nr. 7212 prot., date 19.11.2021

**10.1.** Për kontratën e lidhur me operatorin ekonomik “A.” shpk me nr. 486/19 prot., datë 16.04.2021 nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3.

**10.2** Për kontratën e lidhur me operatorin ekonomik “A. S.”, Shpk me nr. 1641/9prot., datë 04.11.2022 nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5, pika 6, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.2. Rekomandimi:** Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në përcaktimin e vlerës/shumës për garancinë e kontratës, hartimin e planit të zbatimit të kontratës, raportimin në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi të gjitha kontratat për punët publike, mallrat dhe shërbimet në emër të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes

së të Dhënave Personale janë nënshkruar nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës me autorizimet përkatëse nga Komisioneri. Gjithashtu Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës si nëpunës zbatues ka firmosur urdhër shpenzimet për transaksione bankare, në shumë raste ka marrë në dorëzim shërbimin/mallin ose punën publike në rolin e anëtares së komisionit të marrjes në dorëzim.

Autorizimi i nënshkrimit të kontratës është në kundërshtim me Nenin 20 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve”, paragrafi 3 dhe 4, si dhe kërkesat e Manualit për MFK të MF, në fuqi gjatë periudhës së auditimit (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale nënshkrimit të kontratave për punët publike, mallrat dhe shërbimet duke korigjuar praktikën e deritanishme, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

*Në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël ka rezultuar se, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, përkatësisht (i dhe ii) .“Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2021 & për vitin 2022 (iii) “Blerje pajisje zyre, mobilje”, (iv) “Përmirësim i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka refuzuar automatikisht ofertat e operatorëve ekonomikë të caktuar, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Ofertat e refuzuara kanë qenë në çdo rast më të ulëta se oferta e shpallur fituese dhe janë refuzuar me argumentin se në procedura të mëparshme nuk janë paraqitur brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë për të realizuar objektin e prokurimit, pavarësisht nëse kanë njoftuar AK, por duke mos dhënë arsytet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Grupi i auditimit konstatoi se (i) KPVV nuk kishte dokumentuar rastet në procedurat e mëparshme të cilat ishin bërë shkak për refuzimin e ofertave për OE, si dhe (ii) në shumicën e rasteve, operatorët ekonomikë kishin paraqitur argumentet e tyre për pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, duke mos ligjësuar refuzimin e ofertave të tyre në procedura pasuese. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël të marrë masa për dokumentimin rast pas rasti të shkaqeve të refuzimit të ofertës, duke minimizuar ndikimin në pjesëmarrje e konkurrencë të drejtë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

*Në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatuan parregullsi në marrjen në dorëzim të mallrave/ shërbimeve, përkatësisht:

- Në procedurën “Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2021”, Komisioni i marrjes në dorëzim konfirmon nëpërmjet procesverbalit vetëm marrjen në dorëzim të pajisjeve, por pa specifikuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat në DST dhe dokumentacionin e tenderit. Grupi i auditimit konstatoi se, edhe pse OE “P. S.” ka sjellë dokumentacionin si: (i) autorizim nga firma prodhuese, (ii) vërtetim se ka të punësuar specialist të certifikuar nga prodhuesi dhe (iii) certifikatat e sigurisë CE dhe RoHS) për pajisje skaner të llojit “E.”, pajisja e marrë në dorëzim rezultoi e llojit “B.”, për të cilën nuk është paraqitur dokumentacioni vërtetues i cilësisë i kërkuar në DST.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 45 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Në procedurën “Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2022”, Komisioni i marrjes në dorëzim konfirmon nëpërmjet procesverbalit vetëm marrjen në dorëzim të pajisjeve, por pa specifikuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat në DST dhe dokumentacionin e tenderit. Grupi i auditimit konstatoi se, edhe pse OE “P. S.” ka sjellë dokumentacionin si: (i) autorizim nga firma prodhuese dhe (ii) vërtetim se ka të punësuar specialist të certifikuar nga prodhuesi) për pajisje kompjuter të llojit “HP”, kompjuterët e marrë në dorëzim rezultojnë të llojit “L...”, për të cilët nuk është paraqitur dokumentacioni vërtetues i cilësisë i kërkuar në DST. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 45 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar dokumentacionin shoqërues si *certifikatat e cilësisë, certifikatat e origjinës, certifikatat e garancisë dhe raportet e testeve*, për mallrat e prokuruar nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, si “Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2021”, “Blerje pajisje zyre, mobilje, për vitin 2021”, “Blerje pajisje kompjuterike për KDIMDP, për vitin 2022”, “Përmirësim i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të KDIMDP, 2022”, në kundërshtim me pikën 1 të Rekomandimeve të Veçanta, në Rekomandimin e APP nr. 2106 prot., datë 24.03.2021.

Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka hartuar procesverbalet në momentin e marrjes së shërbimit, por në momentin e dorëzimit të faturave tatimore, duke përmbledhur disa shërbime të marra në të njëjtin procesverbal, njëkohësisht duke mos i dhënë dokumentit forcën e një prove administrative, në rastin e marrjes në dorëzim të shërbimeve si “Mirëmbajtje e sistemit REKPDI, për vitin 2021”, “Shërbim dezinfektimi dhe 3D, për vitin 2021” & “...për vitin 2022”, “Mirëmbajtje dhe përmirësim i platformës/ portalit “pyetshtetin.al”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 35, 36, 39 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga Titullari i Institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të mallrave/shërbimeve/punëve sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

*Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave, si njësi përgjegjëse për kryerjen e hetimeve administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave, i harton planet vjetore të kryerjes së hetimeve administrative duke u bazuar në sektorë dhe jo në subjekte konkrete. Mënyra e përzgjedhjes së subjekteve që do t’i nënshtrohen hetimit administrativ mbi mbrojtjen e të dhënave personale nuk përcaktohet në aktet e brendshme të Zyrës së KDIMDP, si dhe në asnjë rast nuk rezulton të jetë kryer një proces i vlerësimit të riskut, për përzgjedhjen e këtyre subjekteve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe pikën 3.2 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 147-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Zyra e KDIMDP të marrë masa për dokumentimin e procesit të përzgjedhjes së subjekteve që do t’i nënshtrohen hetimeve administrative, duke kryer paraprakisht një proces transparent (i) evidentimi të subjekteve që operojnë në sektorët e përzgjedhur e (ii) vlerësimi i riskut të mirëfilltë.

*Në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e titullarit nuk është miratuar gjurma e auditimit për proceset kryesore të institucionit si: procesi i monitorimit të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit si dhe të hetimeve administrative, në të cilën përcaktohen hapat e proceseve kryesore, referencat ligjore, aktivitetet e kontrollit dhe strukturat përgjegjëse. Konkretisht lidhur me veprimtarinë monitoruese, Zyra e Komisionerit nuk ka hartuar një rregullore të brendshme për procedurën e ndjekur për monitorimet online, kriteret e përzgjedhjes së autoriteteve publike, afati kohor i monitorimit, evidencat e mbajtura si dhe raportimi i tyre në strukturat e tjera brenda Zyrës së Komisionerit.

Zyra e KDIMDP nuk ka hartuar dhe miratuar një procedurë të shkruar dhe një hartë mbi kryerjen e hetimeve administrative, pavarësisht se konsiderohet një prej aktiviteteve kryesore të institucionit. Në vendimet e hetimeve të kryera, Komisioneri i referohet Kodit të Procedurave Administrative, që përmban dispozita të përgjithshme mbi kryerjen e procedurave administrative. Përgatitja e një manuali të proceseve kryesore të punës garanton njehsimin në kryerjen e tyre, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen, së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. Mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 dhe nenin 23 pika 5 e Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, si dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 147-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me drejtuesit e njësive përkatëse, (i) për hartimin e një rregulloreje të brendshme për procedurën e ndjekur nga Zyra e Komisionerit për monitorimet online të autoriteteve publike, (ii) për hartimin e procedurave të shkruara për kryerjen e hetimeve administrative në fushat përkatëse, ku të detajohet procedura e ndjekur që në fazën e planifikimit vjetor, përzgjedhja e subjekteve, procedura e hetimit administrativ, afatet përkatëse dhe ndarja e roleve e përgjegjësive të palëve të përfshira, si dhe (iii) për hartimin dhe miratimin e hartës e manualit të procesit të punës dhe gjurmës së auditimit për secilin nga proceset.

*Në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka siguruar shërbim të auditimit të brendshëm për Zyrën e KDIMDP, çka do të ofronte siguri të arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në kundërshtim me nenin 12, pika 1, të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 147-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa për vlerësimin e formës më të përshtatshme nga mundësitë e parashikuara në ligj, me qëllim sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm për njësinë.

*Në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve në “*Pasqyra e Performancës*” rezultoi se në llogarinë 602 “*Blerje mallra e shërbime*” nga KDIMDP është bërë blerje për “*Materiale zyre/rafte metalike*” në vlerën 96,000 lekë, “*Materiale zdrukthëtarie për zyrat “Batiskop 200ML*” në vlerën 339,840 lekë, si dhe “*Shërbime regjistrimi për Edicioni i 15-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)*”, i cili ka të bëjë me krijimin e regjistrit E-

ticket në vlerën prej 1,128,000 lekë. Vlera prej 1,563,840 lekë e paguar nga llogaria 602 dhe kontabilizuar si shpenzim nga KDIMDP ka të bëjë me aktive afatgjata dhe jo me materiale konsumi.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, paragrafi Klasa 2 “*Aktivet Afatgjata*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr.75-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa menjëherë, për debitimin e shumave përkatëse në llogarinë 21 “*Aktivet Afatgjata*”, me qëllim paraqitjen e drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit.

*Menjëherë*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi analitik i llogarive të aktiveve afatgjata, u konstatua se:  
- Në zërin 202 “*Studime dhe kërkime*” në vlerën bruto prej 114,000 lekë janë kontabilizuar shpenzimet për “*Studime e projekte*” të realizuara nga institucioni për “*Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së*”.

- Në zërin 203 “*Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme*” në vlerën bruto prej 5,858,301 lekë janë kontabilizuar shpenzimet për projektin e “*Rikonstruksionit të katit përdhe të Godinës së ish Hotel Drinit*”, e cila ka përfunduar, ekzekutuar pagesa e investimit në vlerën prej 10,002,960 lekë, si dhe është kolauduar dhe marrë në dorëzim punimet në dhjetor të vitit 2019.

Sa më sipër vlera prej 5,972,301 lekë nuk ka të bëjë me AAGJ Jo-materiale, por janë “*Studim e projekte*”, të cilat në momentin e konstatimit si investim nga KDIMDP duhet të ishin regjistruar në zërin 230 “*Investime për Aktive Afatgjata jo materiale*” dhe pasi institucioni ka përfunduar dhe marrë në dorëzim investimi për të cilën janë realizuar “*Studim e projektimi*”, duhet të ishte kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit duke bërë veprimin kontabël: debituar llogarinë 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*” dhe kredituar llogarinë 230. Keqklasifikimi i regjistrimit kontabël ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” dhe llogarisë 203 “*Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme*” si dhe nënvlerësimin e “*Aktiveve Afatgjata Materiale*” në shumën bruto prej 5,972,301 lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar, si dhe me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, pika “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 75-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa, për sistemimin e shumës 5,972,301 lekë, duke kredituar përkatësisht llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” në vlerën prej 114,000 lekë dhe llogarinë 203 “*Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme*” në vlerë prej 5,858,301, në debi të llogarisë 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”.

*Menjëherë*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitin 2021; vitin 2022 dhe vitin 2023 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivitetet.

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 2187 “Te tjera pajisje zyre” dhe jo në llogarinë 218600 “pajisje elektronike”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

- Një pjesë e “Pajisjeve dhe instalimi i kondicionerëve” janë klasifikuar në llogarinë 218700 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, por pa ndikim në vlerën neto të aktiveve pasi norma e amortizimit është 20% për të dy klasifikimet.

- Gjithashtu vlera prej 546,752 lekë për “Programin Alfa” dhe një “Program të trashëguar nga Ministria e Mbrojtjes”, vlerë e cila i përket llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” është klasifikuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 15 % dhe jo 20%, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Klasa 2 ‘Aktive afatgjata’, si dhe pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 75-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa, për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve, me qëllim paraqitjen e drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit.

*Menjëherë*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit u konstatua se, në rubrikën D “Fondet e konsoliduara nga Institucioni” është pasqyruar llogaria 115 “Nga fondet e veta të investimeve” në vlerën 6,938,752 lekë.

Nga analiza e zërave në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto llogaria 115 është pasqyruar në vlerën zero lekë.

Nga auditimi i hyrjeve të aktiveve rezultoi se vlera e paraqitur nga KDIMDP në llogarinë 115 “Caktim fondi për investime nga rezultati i vitit” ka të bëjë me “Rikonstruksion/riparime të godinës së KDIMDP-së” të realizuara nga të ardhurat e trashëguara, ku nga institucioni është marrë në dorëzim dhe është bërë kolaudimi i punimeve.

Pasqyrimi i llogarisë 115 “Caktim fondi për investime nga rezultati i vitit” në vlerën 6,938,752 lekë në rubrikën D, është veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi “Grupi 11 “Fonde të tjera të veta”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 75-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa, për sistemimin e llogarive në kontabilitet, duke debituar llogarinë 115 “Caktim fondi për investime nga rezultati i vitit” në vlerën 6,938,752 lekë dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa të fondit bazë” për të njëjtën vlerë.

*Menjëherë*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesit të inventarizimit të pasurisë u konstatua se:

Në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i inventarizimit është cituar se gjendja e aktiveve në magazinë me datën 19.12.2023 është:

- Për llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 508,910 lekë.

- Për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 5,284,757 lekë.

Në procesverbal komisioni është shprehur se një pjesë e mallrave/pajisjeve nuk janë në gjendje pune, por nuk ka evidentuar listën me zërat e aktiveve të cilat janë jashtë funksioni dhe zërat e aktiveve funksionale gjendje në magazinë, si dhe nuk është shprehur në lidhje me vlerësimin paraprak për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, të cilin së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" paragrafi 85/c.

Më pas, Nëpunësi Autorizues nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionin të vlerësimit, për vlerësimin e aktiveve të cilat relatohen nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" paragrafi 96-99 dhe 102. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet nr. 75-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1. Rekomandimi:** KDIMDP të marra masa në vijimësi që procesi i vlerësimit dhe më pas i tjetërsimit/nxjerrjes jashtë përdorimit, të realizohen menjëherë pas procesit të inventarizimit, me qëllim identifikimin e aktiveve gjendje/funksionale që disponon institucioni, rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si dhe planifikimin sa më efektiv të fondeve të nevojshme në PBA, për blerjen e tyre në të ardhmen.

*Në vijimësi*

## **22. Gjetje nga auditimi:**

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe kryqëzimit dhe krahasimit të të dhënave për PBA-në 2022-2024; PBA-në 2023-2025 dhe PBA-në 2024-2026 u konstatua se: Kërkesa buxhetore të PBA-së në të dy fazat strategjike dhe teknike janë paraqitur në tejkallim të tavanit të miratuar, të cilat ndryshonin nga faza strategjike në fazën teknike, duke shtuar politika të reja dhe duke ndryshuar vlerat e politikave ekzistuese për të cilat nuk ka argumente dhe analiza të ndryshimit të këtyre kërkesave, si dhe indikatorët të qartë mbi përlllogaritjen e kërkesave shtesë të bëra nga KDIMDP, në fazën teknike.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" pika 3 "*Hapat ndërinstitucionale për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm*".

- Nga analiza e zërave të investimeve të parashikuara në PBA-të ka një mospërputhje të ndarjes së tyre mes politikave të reja dhe atyre ekzistuese, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" pika 4.5 "*Hapat për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit*" paragrafi 3.4, pika 3.

- Nga auditimi rezultoi se në PBA-të e përgatitura nga KDIMDP nuk janë përgatitur tregues performace gjinore, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët nr. 21, datë 21.06.2013 "*Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm, si dhe Udhëzimeve plotësuese vjetore për "Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm"*, pika 9/a.

- Nga auditimi rezultoi se projektet që janë kërkuar/planifikuar në PBA-në e vitit 2022-2024, të cilat nuk janë miratuar dhe realizuar në buxhetin vjetor 2022, nuk janë kërkuar si projekte për tu realizuara në 2023-2025, por janë shtuar projekte të reja. Veprime në kundërshtim me udhëzimin MFE nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*".

Gjithashtu dhe nga krahasimi i projekteve të PBA-së 2023-2025 me atë të PBA-së 2024-2026 ka

ndryshime në lidhje me projektet, çka tregon se objektivat dhe qëllimet për të cilat janë bërë kërkesat për fonde shtesë në lidhje me këto projekte nuk kanë qenë të mbështetura në identifikimi i nevojave reale të institucionit për këto projekte, në një analizë e detajuar prioritizimi, duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, veprime në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

- Për vitin 2022 nga KDIMDP është realizuar investimi “Rikonstruksion/Riparime i Godinës së KDIMDP”, investim i cili nuk ishte planifikuar në PBA-në 2022-2024, veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, pika 7; Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” paragrafi 7.1 dhe 7.2 dhe Udhëzimit nr.9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 64 dhe pika 203. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 55-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1. Rekomandimi:** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të programeve të PBA-së brenda tavaneve të miratuara paraprakisht, si dhe të krahasojë kërkesat buxhetore të vitit aktual me kërkesat buxhetore të PBA-ve të viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale, me qëllim mirëmenaxhimin e tyre për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe ndryshimet në prioritetet e projekteve.

*Në vijimësi*

### **23. Gjetje nga auditimi:**

- Nga auditimi i te ardhurave të trashëguara u konstatua se; Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në datat 21-24 tetor 2019, ka qenë organizatore e Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (*International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners - ICDPPC*), e cila u zhvillua në Tiranë.

Për vitin 2019 janë arkëtuar në total 57,985,781 lekë, nga të cilat referuar informacionit të dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, nga këto të ardhura me qëllim menaxhimin e konferencës janë përdorur rreth 25,193,635 lekë.

Aktiviteti i zhvilluar ka qenë me tarifë pjesëmarrjeje, ku për këtë arsye nga KDIMDP është lidhur kontrata e shërbimit me shoqërinë E- T. S. shpk me objekt “Ofrimi i një infrastrukture/platforme shërbimi të ndërtuar dhe të gatshme për përdorim”, ku përmes kësaj platforme janë arkëtuar të gjitha tarifat për pjesëmarrje në vlerën totale prej 26,278,508 lekë, si dhe “Të tjera tarifa regjistrimi në bankë” në vlerën 10,988,491 lekë. Kjo vlerë nga KDIMDP është trajtuar si donacion, por në fakt vlera prej 37,266,999 lekë përbën të ardhura nga aktiviteti, i cili është financuar nga buxheti i shtetit. Nga KDIMDP për vitin 2021-2023 këto të ardhura janë përdorur për blerje pajisje zyre (mobilje, pajisje kompjuterike et), për rikonstruksion godine, si dhe për shpërblyme për stafin e KDIMDP, pa marrë më parë autorizim nga Ministria e Financës përkatësisht:

- Për vitin 2021 në vlerën 1,125 mijë për shpenzime korrente dhe 4,723 mijë, për investime,
- Për vitin 2022 në vlerën 1,677 mijë lekë mijë për shpenzime korrente dhe 92 mijë për investime.
- Për vitin 2023 në vlerën 2,900 mijë lekë mijë për shpenzime korrente dhe 6,962 mijë për investime.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 204; 224;225 dhe 226.



- Nga auditimi i te ardhurave të trashëguara rezultoi se; Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka arkëtuar dhe donacione nga subjekte vendas, të cilat janë *subjekte kontrolli/hetimi* nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përkatësisht:

Në vlerën 75,000 lekë nga shoqëria “M. C. A.” dhe në vlerën 75,000 lekë nga shoqëria “A. D. C. A.” të cilat janë subjekte të hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin e institucioneve financiare jobankare;

Në vlerën 609,700 lekë nga shoqëria “A. M. S. – T.”, subjekt i hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin e *call center*.

Në vlerën 245,320 lekë nga shoqëria “A.”, subjekt i hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin e telekomunikacionit.

Në vlerën 363,780 lekë nga shoqëria “A. B.”, subjekt i hetimeve administrative, përkatësisht në sektorin bankar.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me nenin 38 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar.

KDIMDP nuk kishte një metodologji të përcaktuar dhe një proces transparent të përzgjedhjes së subjekteve në bazë risku për ushtrimin e hetimeve administrative me fokus mbrojtjen e të dhënave, si rrjedhojë pranimi nga ana e KDIMDP i sponsorizimeve/ donacioneve të ardhura nga subjekte kontrolluese të të dhënave, sipas përcaktimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, konsiderohet në kushtet e konfliktit të interesit, duke cenuar paanshmërinë dhe objektivitetin e funksionit kontrollues të Zyrës së KDIMDP. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 55-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.1. Rekomandimi:** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të marrë masa në vijimësi, që për çdo përdorim të të ardhurave të trashëguara, për nevojat e institucionit për blerje mallra/shërbime/punë të përgatisë kërkesën për rritje të autorizua, duke specifikuar rritjen e kërkuar për secilin artikull.

*Në vijimësi*

**23.2. Rekomandimi:** Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa që për çdo donacion/sponsorizim të marrë nga subjektet vendase të verifikojë nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, me qëllim ruajtjen e paanshmërisë dhe objektivitetit të funksionimit kontrollues të Zyrës së KDIMDP.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se:

- Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës me urdhër shpenzimin nr. 261-262, datë 29.12.2023 në shumën 630,347 lekë ka likuiduar shpërblimin për 4 punonjës, bazuar në VKM-në me nr. 795, datë 28.12.2023 “*Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të ACQUIS, në kuadër të procesit të negociimit me Bashkimin Evropian*”.

- Me urdhër shpenzimin nr. 255-256, datë 29.12.2023 në shumën 50,000 lekë ka likuiduar shpërblimin për 5 punonjës, bazuar në VKM-në me nr. 834, datë 28.12.2023 “*Për një ndryshim të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”* i ndryshuar” pika 1 germa a.

Nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës për shpërblime është mbajtur tatim në burim në vlerën 15% dhe nuk është trajtuar dhe bashkuar bashkë me pagën e punonjësve.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me nenin 8 dhe nenin 9 pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar dhe shfuqizuar me ligjin me nr. 29/2023 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” neni 12, i cili shtrin efektet nga data 1 janar 2024 dhe Udhëzimin

nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar paragrafi 2.3, pika 2.3.1, i shfuqizuar me Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” paragrafi 12, i cili ka hyrë në fuqi nga data 1.1.2024. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 89-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1. Rekomandimi:** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa për rillogaritjen e detyrimeve tatimore ndaj punonjësve bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe të reflektohet ndryshimet në pagën e muajit në vijim.

*Menjëherë*

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimeve për muajt nëntor dhjetor të vitit 2021-2023 rezultoi se:

- Në dy praktika urdhër shpenzimi rezultoi se mallrat janë bërë hyrje në magazine, përpara se të bëhet verifikimi fizik i sasisë, cilësisë, çmimit dhe faturës së lëshuar nga OE. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37.

- Në dy praktika urdhër shpenzimi rezultoi se në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim relatohet se komisioni merr në dorëzim mallrat dhe konfirmon faturën duke vënë produkte dhe OE të ndryshëm nga fatura. Pra procesverbali i mbajtur dhe bashkëlidhur transaksionit nuk ka lidhje me procedurën në fjalë.

- Në një praktikë urdhër shpenzimi rezultoi se, përshkrimi i transaksionit është i ndryshëm nga e gjithë dokumentacioni vërtetues bashkëlidhur, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 35 pika b.

- Në dy praktika urdhër shpenzimi rezultoi se, shërbimi është realizuar jashtë afatit kohor të përcaktuar në kontratën tip, në nenin “Afatet e realizimit/ grafiku i shërbimit”, si dhe nga AK nuk ka asnjë dokumentacion ku të vërtetoje dakordësinë për shtyrjen e realizimit të kontratës.

- Në të gjithë procesverbalet e mbajtura nga komisioni mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve rezultoi se, Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve në çdo rast ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim por plotësimi i tij është thjesht formal, duke ju referuar faturës dhe kontratës, pa një përshkrim të hollësishëm të mallrave/shërbimeve dhe punëve të marra, si dhe pa specifikuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë/DT. Gjithashtu rezultoi se, në përbërje të komisionit të marrjes në dorëzim, për marrja e mallra/shërbime të cilat kishin karakter të veçantë, nuk kishte specialist të fushës për të vërtetuar nëse OE ka plotësuar kushtet e kontratës në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 43 si dhe paragrafi 35 pika b.

- Nga auditimi i urdhër shpenzimeve në lidhje për blerjet e realizuara nën 100,000 lekë rezultoi se në të gjithë praktikat mungonte dokumentacioni vërtetues mbi realizimin e procedurës nga testimi i tregut për përcaktimin e vlerës deri në fazën e përzgjedhjes së OE, me të cilin është realizuar transaksioni, si dhe procesverbali i mbajtur nga komisioni për finalizimin e blerjes shkresore.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar nenin 4, pika 19, 26., neni 12, pika 3, germa a) dh) si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b; Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde mbi zbatimin e

*buxhetit" pika 165. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet nr. 82-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**25.1. Rekomandimi:** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa në vijimësi, që mallrat shërbimet të merren në dorëzim nga OE, pas verifikimit fizik të sasisë, cilësisë, duke specifikuar e analizuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë/DT dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

*Në vijimësi*

**25.2. Rekomandimi:** Komisionet e marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve/punëve të ngritura nga Titullari i Institucionit të marrin masa në vijimësi që procesverbalet e mbajtura për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve të jenë të detajuara sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe në kontratën e lidhur mes AK dhe OE fitues, me qëllim evidentimin e realizimit të mallrave/shërbimeve/punëve sipas kërkesave dhe cilësisë së kërkuar nga AK.

*Në vijimësi*

**25.3. Rekomandimi:** NA pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa në vijimësi, që për marrjen në dorëzim të mallrave me karakter të veçantë, në përbërje të komisionit të marrjes në dorëzim të tyre të ketë specialist fushe, me qëllim analizimin dhe argumentimin e zërave të realizuara nga kontraktuesi sipas kontratës së nënshkruar.

*Në vijimësi*

**25.4. Rekomandimi:** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të marrë masa në vijimësi, që për shërbime/mallra/punë të cilat realizohen nga OE jashtë afatit të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe në kontratën e lidhur mes palëve të përllogaritet penaliteti, në rastet kur mes palëve nuk dokumentohet dakortësinë për shtyrjen e realizimit të kontratës.

*Në vijimësi*

**26. Gjetje nga auditimi:** Për hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative” është lidhur kontrata me nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022 me operatorin ekonomik “F. P.” dhe është likuiduar vlera 990,000 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se kjo është një metodologji plagjatur, referuar Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (European Data Protection Board). Ky Institucion i BE ka publikuar për konsultim në faqen zyrtare (edpb.europa.eu), Udhëzimin mbi përllogaritjen e masave administrative në zbatim të GDPR (Guidelines 04/2022 on the calculation of administrative fines under the GDPR), në datën 16 maj 2022, me referencë konsultimi publik nr. 04/2022.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, Kontratën me Operatorin Ekonomik “F. P.” është lidhur nr. 2056/5 prot., datë 15.12.2022, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**26.1. Rekomandimi:** Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e marrjes në dorëzim), i cili të kryejë verifikimet përkatëse dhe të konfirmojë

se ekspertiza në hartimin e metodologjisë për llogaritjen e sanksioneve administrative është ose jo plagjiaturë.

Brenda datës 31.10.2024

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin dhe shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,920,000 lekë**, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka akorduar shtesën për kualifikim në vlerën 20,000 lekë/ muaj, me fuqi prapavepruese që nga data e fillimit të përfitimit të shtesës për kualifikim, nëpunësve të Zyrës së KDIMDP, për punonjësit B. D., P. M., E. H.. Fuqia prapavepruese e këtij Urdhri ka krijuar për Zyrën e KDIMDP një detyrim të prapambetur prej 2,020,000 lekë, i cili nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të institucionit e nuk është paraqitur në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë, në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 dhe Tabelës nr. 4, Aneksi nr. 2 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë 06.10.2020.

Miratimi dhe akordimi i shtesës për kualifikim nga Komisioneri për veten e tij është i pambështetur ligjërisht, pasi pozicioni i titullarit të institucionit të pavarur nuk përfshihet në kategoritë përfituese të mundshme të kësaj shtese për kualifikim. Nga auditimi, gjithashtu, u konstatua se asnjë nga Drejtorët e Përgjithshëm nuk plotëson kushtet për të përfituar shtesën për kualifikim, pasi (i) diplomat e nivelit master të zotëruara nga punonjëset janë përftuar brenda vendit, jo sipas përcaktimeve të VKM, (ii) diploma e një prej punonjësve nuk është ekuivalente me nivelin postmaster dhe (iii) kualifikimet nuk përputhen me përshkrimin e punës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Lidhjen 2/1 e VKM nr. 187, datë 08.03.2017.

Referuar listëpagesave të vëna në dispozicion, grupi i auditimit konstatoi se Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës ka vijuar të përfshijë këtë shtesë si element të pagës së punonjësve të sipërpërmendur, edhe pas shfuqizimit të aktit, me nga 40,000 lekë/muaj për secilin prej tyre, ku në total shuma e përfituar përgjatë periudhës së auditimit është në vlerën prej **1,920,000 lekë**, veprime në kundërshtim me pikën 2 të Udhëzimit të MFE nr. 16, datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 325, datë 31.05.2023...”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 89-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Punonjësit që kanë përfituar në mënyrë të padrejtë dhe të pambështetur ligjërisht shtesën për kualifikim, në dëm të buxhetit të shtetit, bazuar në përcaktimet e nenit 655 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, detyrohen të kthejnë shumën totale të përfituar përgjatë periudhës së auditimit, në total **1,920,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023, sipas përfitimeve respektive, si në vijim:

- B. D., me detyrë Komisioner, në vlerën prej **640,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023;
- E. H., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, në vlerën prej **640,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023;
- P. M., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, në vlerën prej **640,000 lekë** deri në muajin dhjetor 2023.

*Menjëherë*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtori i Shërbimeve të Brendshme dhe Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve korigjuese (kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht nga punonjësit) edhe përtej periudhës së auditimit, nëse kjo situatë ka vijuar, si dhe të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme përfshirjen e shtesës për kualifikim si element të pagës së punonjësve.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatuase:

Komisioneri i Zyrës së KDIMDP për të tre vitet objekt auditimi ka dhënë shpërblime financiare për stafin duke shpërblyer dhe veten e tij, përkatësisht:

- Me urdhër shpenzimin me nr. 281-284, datë 22.12.2021, në shumën 816,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, ku vlerë e përlogaritur është 960,000 lekë për 42 punonjës, mbajtur tatim në burim në vlerën 14,400 lekë.

- Me urdhër shpenzimin me nr. 264-267, datë 30.12.2022 në shumën 1,150,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, për 46 punonjës në vlerën 25,000 lekë.

- Me urdhër shpenzimin nr. 240-243, datë 28.12.2023 në shumën 2,400,000 lekë ka dhënë shpërblime financiare për stafin, nga të cilat, në vlerën 50,000 lekë për 44 punonjësit e përhershëm të komisionerit, si dhe për punonjësit mbështetës brenda dhe jashtë strukturës, si dhe 25,000 lekë për 8 punonjësit e rekrutuar në 6 mujorin e dytë të vitit 2023.

Për vitin 2022 dhe vitin 2023, nga institucioni nuk është mbajtur dhe llogaritur as tatim mbi të ardhurat e përfituara veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe me Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” paragrafi 12.

Sa më sipër, akti i miratimit të shpërblimeve nga Komisioneri ndaj vetës së tij është në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 108, si dhe Ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar neni 4. Ndërsa shpërblimi i administratës së Zyrës së Komisionerit është në kundërshtim me VKM-në me nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, pika 9, me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 224 dhe 225, ku për vlerën e përdorur nuk është përgatit “Kërkesën për rritje të autorizuar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 89-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Nga Zyra e Komisioneri të analizohet vlera prej 4,366 mijë leke si shpenzim pa ekonomikitet, të nxirren përgjegjësitë dhe të marrë masa në të ardhmen që fondet të shpenzohen sipas parimeve të ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficensës.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “A. S.” shpk, me objekt: “Rikonstruksion/riparime të ambienteve të KDIMDP”, për vlerën prej 5,500,036 lekë në vitin 2022, u konstatua se: Dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së aspiratorit profesional 780 m<sup>3</sup>/h + tub fleksibël inoksi Ø200-3m + aksesore të ndryshëm montimi” nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht aspiratori profesional 780 m<sup>3</sup>/h + Tub fleksibël inoksi Ø200-3m + aksesore të

ndryshëm montimi”, me vlerë 591,000 lekë është i pa shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat dhe vlera prej 591,000 lekë përbën shpenzime pa eficencë.

Veprimet më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet vijuese të tij, nenet neni 419, 420, 476, 659, 698, 690 dhe neni 710, pika 3, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 20, datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 54, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1; Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “A. S.” Shpk, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga Zyra e Komisioneri të analizohet vlera prej 591,000 leke si shpenzim pa eficencë, të nxirren përgjegjësitë dhe të marrë masa në të ardhmen që fondet të shpenzohen sipas parimeve të ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës.

Brenda datës 30.09.2024

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga shoqëria “A.” Shpk, me objekt: Blerje automjete në vlerën 2,998 mijë lekë pa TVSH, në vitin 2021, u konstatua se në kriteret/specifikimet teknike dhe në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, për të verifikuar kilometrazhin e automjeteve me jo më shumë se 60.000 km nuk është përcaktuar se çfarë dokumentacioni do të paraqes operatori ekonomik ofertues si: test teknik nga Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve të Transportit Rrugor, libër shërbimi etj. gjë që ka sjellë përdorimin e fondit pa ekonomicitet.

Automjetet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, “Rekomandime të veçanta “Për kontratat tip malli”, pika 1. Dhe Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690 dhe neni 710, pika 3, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar neni 73, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Nga Zyra e Komisionerit të analizohet vlera prej **2,998,324 lekë** si shpenzim pa ekonomicitet, të nxirren përgjegjësitë dhe të marrë masa në të ardhmen që fondet të shpenzohen sipas parimeve të ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës.

Brenda datës 31.10.2024

## **D. MASA DISIPLINORE:**

### **D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE:**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të cituara më poshtë, sipas përgjegjësisë individuale të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës nga “Vërejtje” deri në “Largim”, për punonjësit si më poshtë:

**1. Znj. E. H.**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Informimit, për mangësitë e konstatuara në:

- Mosdokumentimin e veprimeve procedurale në fushën e të drejtës së informimit, për të gjitha fazat e ndjekura nga Zyra e Komisionerit, gjatë zhvillimit të procedurave administrative, e cila ka sjellë si pasojë, mungesën e plotësisë së dosjes së procedurës, një domosdoshmëri në rast përdorimi të një mjeti ligjor të mundshëm (si ankimi gjyqësor).

- Vendimin e Komisionerit nr.48, datë 04.11.2021, ku nuk është ndjekur dhe zbatuar procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative. Mungon Urdhri i Komisionerit “Për kryerjen e hetimit administrativ”, mbi caktimin e personave përgjegjës për hetimin e kësaj çështjeje, veprime në kundërshtim me nenin 43, të Kodit të Procedurës Administrative.

- Vendimin e Komisionerit nr.53, datë 25.11.2022, ku procesverbali i konstatimit të shkeljes administrative dhe ngarkimit me përgjegjësi të funksionarit publik rezulton i pa protokolluar, edhe pse në përmbajtje të tij përcaktohet se: “Procesverbali mbahet në dy kopje, njëra nga të cilat i dorëzohet Autoritetit Publik”, si dhe nuk ka të dhëna se është dorëzuar zyrtarisht në zyrën e protokollit të Bashkisë Tiranë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2. Znj. P. M.**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Mbrojtjes së të Dhënave Personale, për mangësitë e konstatuara në:

- Procedurën/hetimin administrativ tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ku shkeljet e konstatuara në procesverbalin nr.478/3 prot, datë 05.7.2022 nuk pasqyrohen në relacionin e hartuar nga grupi i hetimit me datë 20.12.2022. Për pasojë, nga ana e Komisionerit nuk janë vendosur sanksione administrative për shkeljet e detyrimeve ligjore të konstatuara nga grupi i inspektimit dhe të pasqyruara në procesverbalin e hetimit administrativ.

-Në gjashtë praktika të procedurave administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Komisioneri nuk ka përfunduar procedurën e nisur, përmes deklaratës së përfundimit sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 90 të ligjit nr.45.2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

-Në dy praktika të procedurave administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Komisioneri nuk është shprehur për verifikimet jo të plota të grupit të inspektimit, mosveprime që vijnë në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr.45/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

- Vlerësimin e ankesës së Shkollës “U. S.” Tiranë, ku rezultoi mungesë e nisjes së një hetimi administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit, pasi trajtimi i kërkesë/ankesës nga Zyra e

Komisionerit ka mbetur në kuadrin e një përgjigje shkresore formale, duke mos i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së ngritur nga ankuesi, si dhe duke mospërbushur detyrimet ligjore që parashikon legjislacioni në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3. Znj. L. M.** me detyre Drejtor i Shërbimeve të Brendshëm dhe Financës, Nëpunës Zbatues, për mangësitë e konstatuara në:

- Pranimin e donacioneve pa kryer vlerësim të ekzistencës ose jo të kushteve të konfliktit të interesit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 55-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Moskryerjen e verifikimeve të nevojshme, në cilësinë e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, për akordimin e shtesës për kualifikim për 3 punonjës, që ka shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,920 mijë lekë, për periudhën e auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 100-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Ndërmarrjen e angazhimeve financiare (lidhje e kontratave), me delegim të titullarit të institucionit, duke pamundësuar ushtrimin e përgjegjësive si Nëpunës Zbatues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4; 2.6 dhe 2.7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- Autorizimin e shpërblimeve financiare për stafin, në vlerën 4,366 mijë lekë për periudhën e auditimit, të pambështetur në akte ligjore/nënligjore, si dhe për vitin 2022 dhe vitin 2023 moslogaritja e rrjedhimisht mosmbajtja e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga ky shpërblim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet nr. 89-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**D.2.** Mbështetur në nenin 59, pika 4, germa “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në vlerësim të shkeljeve sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe nenit 57, pika 1, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit sipas përgjegjësive të tyre, në lidhje me çështjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara, sipas nenit 58, germa “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**



## VI. ANEKSE.

### Aneksi nr.1: Prokurimet Publike.

**Aneksi nr. 1/1:** Për procedurën me objekt “Ekspertizë e fushës në hartimin e metodologjisë për llogaritje e seksioneve administrative”.”

Table of Contents		Table of Contents	
<b>CHAPTER 1 – INTRODUCTION</b> .....	5	6.2.1 - Determining an undertaking and corporate liability .....	34
1.1 - Legal framework .....	5	6.2.2 - Determining the turnover .....	36
1.2 - Objective .....	5	<b>CHAPTER 7 – EFFECTIVENESS, PROPORTIONALITY AND DISSUASIVENESS</b> .....	37
1.3 - Scope .....	6	7.1 - Effectiveness .....	37
1.4 - Applicability .....	7	7.2 - Proportionality .....	37
<b>CHAPTER 2 – METHODOLOGY FOR CALCULATING THE AMOUNT OF THE FINE</b> .....	7	7.3 - Dissuasiveness .....	39
2.1 - General considerations .....	7	<b>CHAPTER 8 – FLEXIBILITY AND REGULAR EVALUATION</b> .....	40
2.2 - Overview of the methodology .....	7		
2.3 - Infringements with fixed amounts .....	8		
<b>CHAPTER 3 – CONCURRENT INFRINGEMENTS AND THE APPLICATION OF ARTICLE 83(3) GDPR</b> .....	8		
3.1 - One sanctionable conduct .....	11		
3.1.1 - Concurrence of offences .....	12		
Principle of speciality .....	12		
Principle of subsidiarity .....	13		
Principle of consumption .....	13		
3.1.2 - Unity of action - Article 83(3) GDPR .....	15		
3.2 - Multiple sanctionable conducts .....	15		
<b>CHAPTER 4 – STARTING POINT FOR CALCULATION</b> .....	15		
4.1 - Categorisation of infringements under Articles 83(4) GDPR .....	16		
4.2 - Seriousness of the infringement in each individual case .....	16		
4.2.1 - Nature, gravity and duration of the infringement .....	16		
4.2.2 - Intentional or negligent character of infringements .....	18		
4.2.3 - Categories of personal data affected .....	19		
4.2.4 - Classifying the seriousness of the infringement and identifying the appropriate starting amount .....	19		
4.3 - Turnover of the undertaking with a view to imposing an effective, dissuasive and proportionate fine .....	22		
<b>CHAPTER 5 – AGGRAVATING AND MITIGATING CIRCUMSTANCES</b> .....	25		
5.1 - Identification of aggravating and mitigating factors .....	25		
5.2 - Actions taken by controller or processor to mitigate damage suffered by data subjects .....	25		
5.3 - Degree of responsibility of the controller or processor .....	25		
5.4 - Mitigating circumstances by the controller or processor .....	26		
5.4.1 - Time frame .....	26		
5.4.2 - Sollicitudine .....	27		
5.4.3 - Other considerations .....	27		
5.5 - Degree of cooperation with the supervisory authority in order to remedy the infringement and mitigate the possible adverse effects of the infringement .....	28		
5.6 - The manner in which the infringement became known to the supervisory authority .....	28		
5.7 - Compliance with measures previously ordered with regard to the same subject matter .....	28		
5.8 - Adherence to approved codes of conduct or approved certification mechanisms .....	29		
5.9 - Other aggravating and mitigating circumstances .....	29		
<b>CHAPTER 6 – LEGAL MAXIMUM AND CORPORATE LIABILITY</b> .....	32		
6.1 - Determining the legal maximum .....	32		
6.1.1 - Static maximum amounts .....	32		
6.1.2 - Dynamic maximum amounts .....	33		
6.2 - Determining the undertaking's turnover and corporate liability .....	34		

Imazhi 1: Tabela e përmbajtjes, Udhëzimi 04/2022 mbi përllogaritjen e masave administrative në zbatim të GDPR Burimi: Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (European Board of Data Protection)

<b>Pasqyra e Lëndës</b>		5.2 - Veprimet e kontrolluesit/përpunuesit në zbatim e dëmit të pësuar nga subjektet e të dhënave .....	26
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	4	5.3 - Shkalla e përgjegjësisë së kontrolluesit/përpunuesit .....	26
<b>KAPITULLI 1 – HYRJE</b> .....	5	5.4 - Shkëlqet e mospajshme të kontrolluesit/përpunuesit .....	27
1.1 - Kuadri ligjor .....	5	5.4.1 - Korniza kohore .....	27
1.2 - Objektivi .....	5	5.4.2 - Çështja .....	28
1.3 - Qëllimi/Fushë-veprimi .....	6	5.4.3 - Konsiderata të tjera .....	28
1.4 - Zbatueshmëria .....	6	5.5 - Shkalla e bashkëpunimit me Zyren e Komisionerit për korrigjimin e shkeljes dhe zbutjen e efektëve negative të saj .....	28
<b>KAPITULLI 2 – METODOLOGJIA E PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SANKSIONIT ADMINISTRATIV</b> .....	7	5.6 - Mënyra sesi shkelja i është bërë e ditur Zyres së Komisionerit .....	29
2.1 - Konsiderata të përgjithshme .....	7	5.7 - Pajmëshmëria me detyrat e lëna në hetim për të njëjtën çështje .....	29
2.2 - Pasqyrë e sintezuar e metodologjisë .....	7	5.8 - Respektimi i kodeve të miratuar të sjelljes dhe/ose mekanizmave të miratuar të certifikimit .....	30
2.3 - Shkeljet të sanksioneshme me masa fikse .....	8	5.9 - Rrethanat të tjera rëndësuese dhe lehtësuese .....	30
<b>KAPITULLI 3 – SHKELJE KONKURREUSE DHE ZBATIMI I NENIT 9(3) TË LIGJIT</b> .....	9	<b>KAPITULLI 6 – TAVANI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSIA KORPORATIVE</b> .....	34
3.1 - Një tjetër e sanksioneshme .....	11	6.1 - Përcaktimi i tavani ligjor .....	34
3.1.1 - Konkurrenca e shkeljeve .....	13	6.1.1 - Tavani ligjore statike .....	34
<i>Parimi i specialitetit</i> .....	13	6.1.2 - Tavani ligjore dinamike .....	34
<i>Parimi i subsidiaritetit</i> .....	13	6.2 - Përcaktimi i shirës së ndërmarrjes dhe përgjegjësia korporative .....	35
<i>Parimi i konsumit</i> .....	14	6.2.1 - Përcaktimi i një ndërmarrjeje dhe përgjegjësia korporative .....	36
3.1.2 - Uniciteti i veprimit - Neni 9(3) i ligjit .....	14	6.2.2 - Përcaktimi i shirës .....	37
3.2 - Shmësi veprimesh të sanksioneshme .....	15	<b>KAPITULLI 7 – EFEKTIVITETI, PROPORCIONALITETI DHE KARAKTERI SHTRËNGUES/DEKURAJUES</b> .....	38
<b>KAPITULLI 4 – PËKËNISJA E PËRLLOGARITJES</b> .....	16	7.1 - Efektiviteti .....	38
4.1 - Kategorizimi i shkeljeve sipas nenit 95 të ligjit .....	16	7.2 - Proporcionaliteti .....	38
4.2 - Shkalla e rëndësisë së shkeljes në çdo rast individual .....	16	7.3 - Karakteri shtrëngues/dekurajues .....	39
4.2.1 - Natyra, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes .....	17	<b>KAPITULLI 8 – FLEKSIBILITETI DHE VLERËSIMI I RREGULLT</b> .....	40
4.2.2 - Karakteri i qëllimshëm (dashja) ose pakujdesia .....	18		
4.2.3 - Kategoritë e të dhënave personale të prekura .....	19		
4.2.4 - Klasifikimi i rëndësisë së shkeljes dhe identifikimi i shumës së pikëzimit së përllogaritjes .....	20		
4.3 - Xharrja e ndërmarrjes si element për vendosjen e një sanksioni administrativ: efektiv, proporcional dhe me karakter shtrëngues/dekurajues .....	23		
<b>KAPITULLI 5 – RRETHANAT RËNDËSËSE DHE LEHTËSUESE</b> .....	26		
5.1 - Identifikimi i faktorëve rëndësues dhe lehtësues .....	26		

Imazhi 2: Pasqyra e lëndës, Metodologjia për përllogaritjen për masën e sanksioneve administrative

Burimi: Produkti i marrë në dorëzim në zbatim të kontratës

**Aneksi 1/2: “Likuidimi i Kontratë nr. 310/9 prot., datë 26.02.2021, me vlerë 390,000 lekë pa TVSh”**

Nr.	Urdhër shpenzimi	Vlera në USH (në lekë)	Fatura	Vlera pa TVSh (në lekë)	Vlera totale (në lekë)	Shërbimi	Procesverbali	Marrja në dorëzim
1	75/ 26.04.2021	62,000	12/2021 19.04.2021	20,000	20,000	3D (1x)	<b>19.04.2021</b> 3x dezinfektim 06.03.2021 20.03.2021 16.04.2021 1x 3D 27.03.2021	P. B. A. K. A. B.
			11/2021 19.04.2021	42,000	42,000	Dezinfektim (3x)		
2	123/ 07.06.2021	42,000	18/2021 01.06.2021	14,000	14,000	Dezinfektim (1x)	<b>01.06.2021</b> 3x dezinfektim 10.05.2021 20.05.2021 30.05.2021	P. B. A. K. A. B.
			19/2021 01.06.2021	28,000	28,000	Dezinfektim (2x)		
3.	172/ 18.08.2021	42,000	24/2021 29.06.2021	42,000	42,000	Dezinfektim (3x)	<b>29.06.2021</b> 3x dezinfektim 09.06.2021 18.06.2021 29.06.2021	P. B. A. K. A. B.
4.	173/ 18.08.2021	42,000	29/2021 02.08.2021	42,000	42,000	Dezinfektim (3x)	<b>01.06.2021</b> 3x dezinfektim 09.07.2021 20.07.2021 30.07.2021	P. B. A. K. A. B.
5.	198/ 15.09.2021	42,000	45/2021 08.09.2021	42,000	42,000	Dezinfektim (3x)	<b>08.09.2021</b> 3x dezinfektim 10.08.2021 20.08.2021 31.08.2021	P. B. A. K. A. B.
6.	216/ 07.10.2021	42,000	53/2021 04.10.2021	42,000	42,000	Dezinfektim (3x)	<b>04.10.2021</b> 3x dezinfektim 10.09.2021 20.09.2021 30.09.2021	P. B. A. K. A. B.
7.	237/ 05.11.2021	48,000	58/2021 02.11.2021	28,000	28,000	Dezinfektim (2x)	<b>02.11.2021</b> 2x dezinfektim 08.10.2021 29.10.2021 1x 3D 20.10.2021	P. B. A. K. A. B.
			60/2021 02.11.2021	20,000	20,000	3D (1x)		
8.	285/ 23.12.2021	56,000	77/2021	28,000	28,000	Dezinfektim (2x)	<b>18.12.2021</b> 4x dezinfektim 05.11.2021 12.11.2021 19.11.2021 26.11.2021	P. B. A. K. A. B.
			78/2021 18.12.2021	28,000	28,000	Dezinfektim (2x)		
<b>TOTALI</b>		<b>376,000</b>		376,000	376,000		<b>24x dezinfektim 2x 3D</b>	

**Aneksi 1/3: Prokurimet publike “Për vitin 2021 janë zhvilluar 27 procedura prokurimi me vlerë 8,838 mijë lekë; Për vitin 2022, janë zhvilluar 37 procedura prokurimi me vlerë 18,620 mijë lekë; Për vitin 2023, janë zhvilluar 42 procedura prokurimi me vlerë 23,766 mijë lekë.**

Në lekë

Nr	Viti 2021 Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës pa tvsh	Diferenca	
					Vlere	%

1	Procedure e hapur	0	0	0	0	0
2	Procedure e hapur ndërkombëtare	0	0	0	0	0
3	Procedure Kërkese për propozim	0	0	0	0	0
4	Procedure Negocim pa shpallje	0	0	0	0	0
5	Modifikim Kontrate	0	0	0	0	0
6	Procedure Blerje e vogël	27	8.838.220	6.673.314	2.164.906	75.5
7	Sistem dinamik (Blerje bileta për udhëtime)	0	0	0	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>27</b>	<b>8.838.220</b>	<b>6.673.314</b>	<b>2.164.906</b>	<b>75.5</b>

Burimi të dhënave: KDIMDP

*Në lekë*

Viti 2022						
Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedure e hapur	0	0	0	0	0
2	Procedure e hapur e thjeshtuar	0	0	0	0	0
3	Procedure Kërkese për propozim	1	3.000.000	2.986.000	14.000	99.5
4	Procedure Negocim pa shpallje	0	0	0	0	0
5		0	0	0	0	0

	Modifikim Kontrate					
6	Procedure Blerje e vogël	23	13.620.000	12.608.314	1.011.686	92.5
7	Sistem dinamik (Blerje bileta për udhëtime)	13	2.000.000	1.564.000	436.000	78.2
	<b>Shuma</b>	<b>37</b>	<b>18.620.000</b>	<b>17.158.314</b>	<b>1.461.686</b>	<b>92.14</b>

Burimi të dhënave: KDIMDP

*Në lekë*

Nr	Viti 2023 Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës	Diferenca	
					Vlere	%
					1	Procedure e hapur
2	Procedure e hapur e thjeshtuar	0	0	0	0	0
3	Procedure Kërkese për propozim	0	0	0	0	0
4	Procedure Negocim pa shpallje	0	0	0	0	0
5	Modifikim Kontrate	0	0	0	0	0
6	Procedure Blerje e vogël	27	14.216.000	11.116.118	2.599.882	81.7%
7	Sistem dinamik (Blerje bileta për udhëtime)	13	2.600.000	1.454.888	1.145.112	55.9%
	<b>Shuma</b>	<b>42</b>	<b>23.766.000</b>	<b>18.571.006</b>	<b>5.194.994</b>	<b>78.14%</b>

Burimi të dhënave: KDIMDP